

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI KRIJIMIN E AKADEMISË SË SHKENCAVE TË RP TË SHQIPËRISË»

20 qershor 1972

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë me kënaqësi të veçantë konstaton se në vendin tonë, në shumë degë të ekonomisë e të kulturës, zhvillohet një veprimtari e gjerë kërkimore-shkencore. Kjo është fryti i politikës së drejtë dhe largpamëse të Partisë, e cila, duke vlerësuar si duhet rëndësinë e shkencës dhe rolin e madh që luan ajo për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës, jo vetëm ka inkurajuar me të gjitha mënyrat punën kërkimore-shkencore, por hap pas hapi ka marrë masa të gjithanshme organizative, tekniko-materiale dhe për përgatitjen e kuadrit për të krijuar kushtet e nevojshme për zgjerimin e saj.

Sot në vendin tonë veç Universitetit Shtetëror të Tiranës, Institutit të Lartë Bujqësor, Institutit të Lartë të Arteve dhe instituteve pedagogjike, ku krahas procesit mësimor zhvillohet një punë e gjerë kërkimore-shkencore, funksionojnë rreth 25 institute e stacione qendrore që bëjnë kërkime e studime në shkencat shoqërore, teknike e natyrore. Në këto qendra të rëndësishme, si dhe në qindra bërthama, byro teknologjike, teknike, rrethe e shoqata të eksperimentimit shkencor, në lidhje të ngushtë me prodhimin e me masat, merren me punë shkencore disa mijëra quadro të lartë, specialistë, teknikë e punëtorë të pararojës. Rezultatet e deritanishme në lëmin e studimeve e të kërkimeve shkencore janë inkurajuese dhe në disa fusha me vlerë të veçantë.

Stadi i tanishëm i zhvillimit ekonomik e kulturor të vendit kërkon që studimet shkencore të zgjerohen e të thellohen më tej, që të ngrihet në një shkallë më të lartë dhe të përmirësohet metoda e drejtimit të punës shkencore, që gjithë veprimtaria shkencore të bashkërendohet e të drejtohet në shkallë kombëtare, me

qëllim që forcat e mjetet shkencore e teknike të përdoren në mënyrë sa më të plotë, racionale e frytdhënëse dhe përgatitja e kualifikimi i kuadrit shkencor të vihet mbi baza më të shëndosha.

Duke u nisur nga konsideratat e mësipërme dhe në përputhje me porosinë e Kongresit të 6-të që të merren masa «për një organizim dhe drejtim më të koordinuar e të përqendruar të të gjithë punës e jetës shkencore në shkallë republike, në përshtatje me mundësitë e sotme dhe me detyrat e perspektivës», Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, me propozimin e Byrosë Politike

V e n d o s i :

1. — Të krijohet Akademia e Shkencave e Republikës Popullore të Shqipërisë, si qendra më e rëndësishme e kërkimeve shkencore në vendin tonë.

2. — Akademia e Shkencave e Republikës Popullore të Shqipërisë të ketë si detyrë themelore zhvillimin e kërkimeve e studimeve, të mbështetura në kritere shkencore e në metodologjinë marksiste-leniniste në ato fusha të shkencave që përfshihen në institutet që do të varen drejtpërdrejt prej saj, të ndihmojë në bashkërendimin e kërkimeve shkencore në shkallë Republike, të parashtrijë përpara organeve shtetërore çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me zhvillimin e degëve të reja të shkencës e të teknikës, me futjen e metodave të reja e të teknikës së re në prodhimin e në kërkimet shkencore, si dhe çështje që kanë të bëjnë me rritjen e shpejtë e të shëndoshë të forcave të reja shkencore.

3. — Të ngarkojë Këshillin e Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë që të marrë të gjitha masat e nevojshme organizative dhe materiale për ngritjen dhe funksionimin sa më parë të Akademisë së Shkencave të Republikës Popullore të Shqipërisë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë në ga-
zetën «Zëri i popullit», Nr. 148
(7440), 21 qershor 1972*

V E N D I M

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI ORGANIZIMIN MË TË MIRË TË INFORMIMIT TË MASAVE TË POPULLIT PËR VEPRIMTARINË DHE VENDIMET E ORGANEVE SHTETËRORE TË ZGJEDHURA

18 shtator 1972

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, pasi mori në shqyrtim raportin e Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe të Kryesisë së Këshillit të Ministrave «Mbi organizimin më të mirë të informimit të masave të popullit për veprimtarinë dhe vendimet e organeve të zgjedhura nga qendra në bazë», konstatoi se organet e pushtetit dhe të administratës nga qendra në bazë kanë bërë përpjekje më të mëdha për të kuptuar thellë e për të zbatuar direktivën e Kongresit të 6-të të PPSH se informimi i masave është mjet efikas dhe i domosdoshëm për zhvillimin e mëtejshëm të demokracisë socialiste.

Me qëllim që në të ardhmen të mënjanohej të metat dhe dobësitë e vërtetuara në këtë drejtim dhe që e tërë puna të ngrihet në një nivel më të lartë, Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH

V e n d o s i :

1.— Të forcohet më tej puna edukative e organizatave të Partisë, e organeve shtetërore dhe e organizatave shoqërore për të rrenjosur thellë konceptin se me informimin më të mirë të masave mbi veprimtarinë dhe vendimet e marra nga organet e zgjedhura të pushtetit, lidhet ngushtë forcimi i mëtejshëm i diktaturës së proletariatit dhe zgjerimi i demokracisë socialiste.

Informimi i masave mbi veprimtarinë dhe vendimet e marra të bëhet medoemos pjesë përbërëse e metodës së punës të të gjitha organeve shtetërore nga qendra deri në bazë.

2.— Kujdes i veçantë t'i kushtohet zgjerimit të mëtejshëm të kontakteve të këshilltarëve dhe deputetëve me zgjedhësit,

dhënies llogari përpara tyre në mënyrë sistematike, si dhe informimit të rregullt mbi veprimtarinë dhe vendimet e marra.

Anëtarët e këshillave popullorë, që janë më afër popullit, të mbajnë lidhje të vazhdueshme me zgjedhësit kudo që ata punojnë e jetojnë, të dëgjojnë me kujdes zërin e tyre, të vlerësojnë në frymë partie propozimet e sugjerimet dhe të luftojnë për vënien në jetë të kërkesave që janë të drejta e të mundshme për t'u realizuar.

Deputetët e Kuvendit Popullor të njihen më mirë me problemet e rëndësishme që shqetësojnë zgjedhësit, t'i mësojnë masat që, kur paraqesin kërkesa, këto të jenë me vend, të përkrahin kritikën e masës kundër shfaqjeve e shtrembërimeve burokratike, të sjellin në mbledhjet e Kuvendit Popullor përvojën pozitive, në mënyrë që këto mbledhje të gjallërohen edhe më shumë, t'i informojnë rregullisht zgjedhësit për veprimtarinë e Kuvendit Popullor, për ligjet dhe vendimet e aprovuara.

3.— Edukimi i masave dhe i punonjësve të aparateve dhe ngjallja e interesit për njohjen e përmbajtjes ideopolitike dhe morale të ligjeve e vendimeve dhe për respektimin rigoroz të ligjshmërisë socialiste është pjesë përbërëse e edukimit komunist.

Ligjet dhe vendimet e organeve të zgjedhura të pushtetit popullor mishërojnë politikën e Partisë, prandaj askush nuk duhet t'i shmanget zbatimit të ligjit, ose të veprojë në kundërshtim me të. Ligjet janë të detyrueshme njëjloj për të gjithë.

Puna për t'i njohur masat me ligjet dhe vendimet, sidomos me ato që u takojnë, sipas sektorit përkatës, të bëhet sistem i një pune të organizuar dhe të detyrueshme. Gjithashtu të çohet më tej tërheqja e mendimit të masave dhe të organeve të zgjedhura në përgatitjen dhe marrjen e vendimeve dhe të ligjeve që kanë të bëjnë me problemet e rëndësishme të jetës së vendit.

4.— Për informimin e masave të gjera të popullit mbi veprimtarinë dhe vendimet e organeve të zgjedhura, krahas formave të tjera të larmishme, një rol shumë i rëndësishëm i takon shtypit dhe propagandës së Partisë. Për këtë qëllim të shfrytëzohen sa më gjerë shtypi, radioja, televizioni etj.

5.— Ngarkohen Presidiumi i Kuvendit Popullor, Këshilli i Ministrave dhe aparati i Komitetit Qendror të PPSH të marrin masa për zbrëthimin dhe konkretizimin e mëtejshëm të detyrave që shtrihen ky vendim.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I SEKRETARIATIT TË KQ TË PPSH MBI FORCIMIN E GJITHANSHËM TË MASAVE TEKNIKO-ORGANIZATIVE PËR SIGURIMIN TEKNIK DHE PARANDALIMIN E AKSIDENTEVE NË PUNË

28 tetor 1972

Në ndërtimin socialist të vendit, në zhvillimin progresiv të prodhimit e në ngritjen e nivelit teknik të tij, në krijimin e degëve të reja të ekonomisë, Partia është udhëhequr kurdoherë nga qëllimi i plotësimit gjithmonë e më mirë të kërkesave në rritje të popullsisë, nga plotësimi i kushteve gjithmonë e më të mira të punës e të jetesës. Në këtë prizëm ajo e ka parë edhe vendosjen e forcimin e masave për sigurimin teknik, me qëllim që të mënjanohej e të parandaloheshin aksidentet e dëmtimit në punë.

Krijimi i fronteve të reja të punës, përvetësimi i profesioneve për prodhime të reja janë shoqëruar kurdoherë me një kujdes e punë të veçantë për të mbrojtur punonjësit e qytetit e të fshatit nga rreziqet e pakujdesitë që kërcënojnë shëndetin dhe jetën e tyre.

Partia ka orientuar e ka porositur vazhdimisht që shëndeti dhe jeta e punonjësve tanë, kudo që ata luftojnë e derdhin djersën për ndërtimin e jetës së re, të ruhen në të gjitha rrethanat dhe me të gjitha mjetet. Për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të tyre nuk mund të lejohen as pakujdesia e neglizhenca, as edhe kursime të pavend.

Sekretariati i Komitetit Qendror, në shqyrtimin që i bëri problemit të sigurimit teknik në punë, konstaton se janë vërtetuar raste pakujdesie e pune të pamjaftueshme në shumë drejtime që kanë dëmtuar shëndetin e punonjësve të veçantë dhe në ndonjë rast dhe jetën e tyre. Këta tre vjetët e fundit, aksidentet në punë kanë pësuar një rritje, që në asnjë mënyrë nuk duhej lejuar. Për pakujdesi e masa jo të plota teknike e organizative në sigu-

rimin e punës dhe mënjanimin e rreziqeve, në mjaft degë të ekonomisë e veçanërisht në miniera, në industri, ndërtim e në komunikacion aksidentet në punë janë shtuar dhe pasojat e tyre kanë qenë të rënda e në disa raste kanë shkaktuar vdekje. Duke marrë parasysh gjendjen që paraqitet dhe nevojën e domosdoshme për masat që duhen marrë në këtë drejtim, Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH

V e n d o s i :

1. — Organet e organizatat e Partisë, organet ekonomike e shtetërore dhe organizatat e masave në gjithë punën e luftën që bëjnë bashkë me punonjësit për ndërtimin socialist të vendit, të tregojnë kujdes të veçantë për shëndetin e jetën e punonjësve.

Mbrojtja e shëndetit të tyre, mënjanimi sa më i plotë i rreziqeve që mund të ndeshen në prodhim, si dhe masat e gjithanshme për parandalimin e çdo rrethane që mund të shkaktojë aksident në punë apo dëmtim të shëndetit të punonjësve, të vlerësohen si detyra të dorës së parë, ku nuk lejohet zvarritje e neglizhencë, ku nuk tolerohen pakujdesi e nënvleftësime. Organizatat e Partisë, për asnjë rast dhe në asnjë kohë, nuk duhet të pajtohen me qëndrime nënvleftësuese e burokratike ndaj kësaj çështjeje, të jenë këmbëngulëse në zbatimin e orientimeve dhe porosive të Partisë për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve.

Mbrojtja e shëndetit dhe e jetës së punëtorit, e kooperativistit dhe e çdo punonjësi tjetër të përbëjë një ndër objektet kryesore të punës së organizatave-bazë të Partisë dhe të organeve ekonomiko-drejtuese në çdo qendër pune. Në radhë të parë është vetë kolektivi punonjës që duhet ta marrë fort në duar këtë çështje dhe të vërë përpara përgjegjësisë shoqërore e penale atë që sadopak tregon pakujdesi, nënvleftëson pa vend rrezikun, zvarrit marrjen e masave të plota për të pasur kushte të përshtatshme e të sigurta pune. Në këtë çështje të udhëhiqemi nga parimi se «mbi të gjitha është jeta dhe shëndeti i punonjësve».

2. — Organet drejtuese shtetërore dhe ekonomike në rrethe e në qendër të kuptojnë në thelb përgjegjësinë dhe detyrat që kanë për plotësimin e kushteve normale të punës, për pajisjen e punëtorëve e të kooperativistëve jo vetëm me mjete mbrojtjeje në punë, por dhe me dijenitë e nevojshme për mbrojtjen nga rreziqet e punës, me literaturën e rregulloret e nevojshme për çdo proces pune e prodhimi, si dhe me përcaktimin e rregulloreve dhe të dispozitave që ata kanë në kompetencë, për të parandaluar çdo dëmtim e aksident sado i vogël që të jetë.

Organizatat e Partisë në këto organe, si dhe në çdo qendër

pune e prodhimi, të bëjnë një luftë të papajtueshme kundër konceptit që ndeshet shpeshherë se «përgjegjësia dhe faji është i të dëmtuarit dhe jo i personave që i drejtojnë ata». Asnjë nuk do dëmtimin e shëndetit apo humbjen e jetës së vet, por kur ndodhin raste të tilla, nuk mund të mos kenë përgjegjësi edhe ata që nuk i parashikuan dhe nuk morën masat për mënjanimin e shkakut, që nuk instruktuan për mbrojtjen dhe nuk paralajmëruan për rrezikun.

Këtej duhet të nisen edhe organet përkatëse juridike për të nxjerrë përgjegjësinë dhe për të dënuar me rreptësi fajtorët. Këto organe në asnjë mënyrë të mos pajtohen me shfaqje e qëndrime liberale të administratave të ndërmarrjeve, të cilat u hapin shteg pakujdesive e nënvleftësimeve të pavend, as edhe me lëshimet e sentimentalizmin që shfaqen nga disa punëtorë kur fajtorët merren në përgjegjësi penale.

3. — Klasa punëtoresh dhe kooperativistët të ngrenë me forcë kontrollin punëtor e fshatar, për t'u zbatuar deri në fund të gjitha masat teknike e organizative të domosdoshme që kërkohen në kryerjen e çdo procesi pune e prodhimi pa rreziqe e dëmtim të shëndetit dhe të jetës së tyre. Ata vetë të bëhen zot për të vënë rregull e disiplinë kudo që është e nevojshme dhe të kërkojnë deri në një zbatimin e masave të nevojshme për mbrojtjen në punë si nga administratat, ashtu dhe nga vetë punëtorët. Kontrolli i tyre të shtrihet gjerësisht nga reparti e skuadra deri në organet drejtuese në rreth e në qendër, për t'i vënë në lëvizje dhe para përgjegjësisë gjithsecilin në zbatim të detyrave që i janë ngarkuar. Asnjë lëshim, asnjë liberalizëm e sentimentalizëm mikroborgjez nuk duhet lejuar në këtë çështje.

4. — Dikasteret qendrore ekonomike të forcojnë punën e organeve të specializuara që kanë për këtë qëllim dhe të mobilizojnë të gjithë punonjësit e tyre për të ndihmuar e për të zbatuar plotësisht detyrat që kanë për mbrojtjen në punë të punonjësve.

Institutet e kërkimeve dhe të studimeve pranë dikastereve qendrore, sipas profilit të prodhimit e të punës, të krijojnë bërthama ose kabinete për të studiuar e për të zgjidhur, në bashkëpunim me njerëzit e prodhimit, një sërë problemesh që lidhen me përmirësimin e kushteve të punës dhe mbrojtjen e shëndetit e të jetës së punonjësve.

Komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve të organizojnë në forma të ndryshme studimin dhe zgjidhjen e problemeve që dalin në këtë fushë, si dhe kontrollin e vazhdueshëm të masave që lidhen me sigurimin teknik në punë.

5. — Komitetet e Partisë në rrethe, organet dhe organizatat e Partisë në qendra të mëdha pune e në rajonet industriale, organizatat e masave, e sidomos bashkimet profesionale, të vlerësoj-

në më mirë e më drejt gjendjen mbi teknikën e sigurimit në punë dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e saj dhe të mobilizojnë organet përkatëse ekonomiko-shtetërore, kolektivat punonjës për zbatimin e shpejtë të tyre. Në të njëjtën kohë t'u kushtojnë një vëmendje më të madhe propagandës dhe edukimit tekniko-profesional për të ngritur nivelin e dijenive të punonjësve, për t'i bërë ata të aftë e të ndërgjegjshëm në vlerësimin e parandalimin e rreziqeve në punë. Në këtë punë ata të mobilizojnë këdo, duke filluar nga mjeshtri e punëtorët me eksperiencë deri te dikasteret qendrore.

Në rastet kur ndodhin dëmtime ose vdekje nga aksidentet në punë, organizatat e Partisë dhe të bashkimeve profesionale duhet ta vlerësojnë ngjarjen si një çështje serioze, nga e cila duhet të nxjerrin mësim jo vetëm atje ku ka ndodhur aksidenti, por të gjithë punëtorët e ndërmarrjes apo të ndërmarrjeve të atij sistemi, duke analizuar shkaqet, duke përcaktuar masat dhe detyrat që të evitohet çdo rrezik për të ardhmen.

6. — Një vend të rëndësishëm në mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve e të kooperativistëve duhet të zërë puna edukative e bindëse për njohjen dhe zbatimin e rregullave, si dhe për përdorimin e mjeteve mbrojtëse në punë dhe të antidotëve. Punëtorëve t'u mësohet jo vetëm mjeshhtëria, por edhe rreziqet që mund të ndodhin në punë gjatë ushtrimit të saj. Të konsiderohen të dëmshme e të palejueshme qëndrimet e disa punëtorëve që nuk përdorin aty ku duhet këto mjete (syze mbrojtëse, dorashka, çizme, rroba e përparëse mbrojtëse, maska, litarlidhës etj.), duke nënvleftësuar rrezikun e duke pasur besim të tepruar të dijenitë, aftësitë e përvoja e tyre personale. Më i dituri e më i afti është ai që punon mirë dhe mbrohet mirë, duke respektuar rigorozisht rregullat e sigurimit teknik në punë, dhe jo ai që as i njeh, as i përfill këto rregulla. Njerëz të tillë jo vetëm mund të rrezikojnë vetveten, por rrezikojnë edhe objektin e punës që u është besuar.

Edhe lufta për mekanizimin e punimeve të vështira e të rënda, për krijimin e ambienteve të përshtatshme të punës, duhet të zërë një vend gjithashtu të rëndësishëm në mobilizimin e kolektivave punonjës për sigurimin e kushteve të mira të punës. Metoda e aksioneve, e iniciativave dhe e përqendrimit të përkohshëm të forcave, duhet të zbatohet në të gjitha qendrat e punës e të prodhimit sipas nevojave dhe rrethanave për zgjidhjen e shpejtë të disa problemeve që dalin në fushën e teknikës së sigurimit në punë.

7. — Ministria e Shëndetësisë dhe organet e saj të thellojnë më tej masat për riaftësimin fizik të të aksidentuarve, kurse dikasteret qendrore, komitetet ekzekutive të këshillave popullorë dhe organet ekonomike të marrin masa konkrete për riaftësimin

e tyre profesional. Organizatat e Partisë dhe të bashkimeve profesionale, përmes punës edukative, duhet të shtyjnë e të nxitin moralisht e politikisht punëtorët e aksidentuar që ata vetë të kërkojnë të riaftësohen dhe të ngrenë vazhdimisht nivelin profesional në përshtatje me kushtet e tyre konkrete fizike.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI PËRSOSJEN E MËTEJSHME TË MARRËDHËNIEVE TË SHPËRNDARJES SIPAS PUNËS

22 nëntor 1972

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e saj të datës 22 nëntor 1972, pasi mori në shqyrtim studimin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave «Mbi disa probleme të punës e të pagave»,

V e n d o s i :

1. — T'i rekomandojë Këshillit të Ministrave që problemet e punës dhe të pagave, si çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë në mënyrë të përfunduar të mëtejshme të marrëdhënieve socialiste të shpërndarjes, të vazhdojë t'i plotësojë dhe t'i thellojë edhe më tej për të bërë rregullimet e përmirësimit e nevojshme për të tashmen dhe për perspektivën në përputhje me krijimin e mundësive ekonomike, duke mbajtur parasysh orientimet e rëndësishme që u dhanë në këtë mbledhje të Byrosë Politike.

2. — Pagesa për punën me copë dhe me kohë të bëhet duke u mbështetur në kategorizimin e vendeve (procese) të punës, duke marrë parasysh edhe veçoritë e degëve të ekonomisë. Në lidhje me këtë të merren masa për të bërë kategorizimin e vendeve të punës edhe për rastet ku zbatohet mënyra e shpërblyerimit sipas shkallës së kualifikimit të punëtorëve. Në veprat e reja industriale për një periudhë të caktuar, pagesa mund të bëhet sipas atestimit kulturor e profesional të punonjësve.

3. — Normat teknike të jenë baza orientuese, si për të përcaktuar masën e harxhimit të punës, ashtu edhe atë të pagesës. Lidhur me këtë të studiohen format dhe rrugët e diferencimit të

shpërblimit për punën me norma teknike dhe me norma statistikore.

Të mos ketë kufi shpërblimi për tejkalimin e normave të punës. Normat statistikore të rishikohen dhe të vendosen kurdoherë mbi bazën e mesatares progresive, me synim që në një të ardhme të afërt të zëvendësohen me norma teknike...

4. — Në bujqësi të studiohet mundësia që vendet e punës të ndahen në 5 kategori, nga 4 që janë sot. Në përputhje me këtë të bëhet edhe kategorizimi i vendeve të punës. Shpërblimi të bëhet duke u mbështetur në kategorizimin e vendeve të punës. Gjithashtu të studiohet e të eksperimentohet mundësia që në shpërblimin e punonjësve të bujqësisë në të ardhmen të merret parasysh edhe shkalla e kualifikimit të tyre, në përshtatje me veçoritë që paraqet puna në bujqësi.

5. — Të studiohen e të përcaktohen kriteret e ndërtimit të sistemit të pagave të punonjësve tekniko-administrativë për të kaluar nga mënyra e sotme me kufij minimalë-maksimalë në atë me kategori.

6. — Brenda vitit 1973 të studiohen dhe të përcaktohen shkencërisht librat e atestimit profesional e kulturor të punonjësve në të gjitha degët e ekonomisë, si dhe librat e kategorizimit të vendeve të punës, të cilët në periudha të caktuara, të azhurnohen me zhvillimin e ekonomisë në përgjithësi dhe brenda degëve në veçanti.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI GJENDJEN DHE MASAT QË DUHEN MARRË PËR ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË PESHKIMIT»

22 nëntor 1972

Në mbledhjen e datës 22 nëntor 1972 Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH mori në shqyrtim gjendjen në sektorin e peshkimit dhe konstatoi:

Me gjithë masat e marra deri tani dhe përparimet e bëra, ky sektor i rëndësishëm i industrisë ushqimore prej disa vjetësh nuk po plotëson si duhet detyrat e planifikuara dhe ritmet e zhvillimit të tij janë akoma të ulëta e të pakënaqshme. Sasia e peshkut të zënë nuk plotëson kërkesat e popullsisë për këtë artikull ushqimor.

Vendi ynë ka kushte të përshtatshme e të mira për të siguruar sasi më të mëdha peshku, si në det ashtu dhe në ujërat e brendshme, por këto kushte nuk po shfrytëzohen në masën e duhur dhe në nivelin tekniko-shkencor të mundshëm, sepse, siç duket, kërkimet dhe studimet ihtiologjike të rritjes dhe të lëvizjes së tufave të peshkut janë fare të pamjaftueshme, metodat e rritjes dhe të gjuetisë së peshkut janë përgjithësisht mbi baza artisanale, flota e peshkimit është ende e dobët dhe me një bazë materialo-teknike të pamjaftueshme. Ka një nënvleftësim të pa-justifikuar të shfrytëzimit të ujërave të brendshme, një kujdes e drejtim të dobët të gjithë sektorit të peshkimit si nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave ashtu dhe nga komitetet ekzekutive të rretheve.

Problemet e rëndësishme që ka pasur dhe ka ky sektor nuk janë vlerësuar si duhet si nga dikasteret qendrore ashtu dhe nga ndërmarrjet dhe nga organet ekonomiko-shtetërore të bazës. Shumë pëllgje ujore të mundshme për t'u kthyer në baza të mira për rritjen e peshkut me rregullimet e nevojshme, janë lënë pas

dore dhe po kthehen në pellgje të pavlefshme për këtë qëllim. Mirëmbajtja e pajisja e flotës së peshkimit dhe rikonstruksioni gradual i saj akoma nuk po u përgjigjen nivelit teknik e gatishmërisë së kërkuar, si pasojë dhe rendimenti i saj vjen duke rënë.

Kjo gjendje duhet të tërheqë vëmendjen e Partisë në rreth e aq më tepër të organeve ekonomike e shtetërore në qendër e në bazë.

Byroja Politike, pasi diskutoi rreth këtyre problemeve dhe me qëllim që t'i japë sektorit të peshkimit një zhvillim më të shpejtë për plotësimin e për tejkalimin me sukses të detyrave të rëndësishme që caktoi Kongresi i 6-të i Partisë dhe që shtron perspektiva,

V e n d o s i :

1. — Të përmirësohet e të forcohet organizimi i sektorit të peshkimit nga qendra deri në bazë. Për këtë qëllim:

a) Të riorganizohet Drejtoria Qendrore e Peshkimit:...

b) Në vartësi të Drejtorisë Qendrore të Peshkimit, në rrethe, sipas nevojës, të krijohen dora-dorës sektorë, reparte e stacione në hozrashot, si dhe ndërmarrje të veçanta: për riparime e mirëmbajtje të flotës së peshkimit e të pajisjeve të saj; për prodhimin e riparimin e mjeteve të peshkimit si sandale¹, rrjeta etj.; për prodhimin e për shumëzimin e rasateve të peshkut, për prodhimin e ushqimeve të industrializuara, për rasatet; për ndërtimin e objekteve të peshkimit (hidrovore, pontile, kanale, prita, pastrime të grykave e të daljeve në det etj.).

2. — Të organizohen mbi baza shkencore studime dhe kërkime ihtiologjike të ujërave tona detare e të ëmbla për të sqaruar një sërë problemesh që lidhen me llojet dhe me sasinë e peshqve që ndodhen e mund të kultivohen me ligjshmërinë e lëvizjes së tufave të tyre, si dhe me faktorët biologjikë dhe ihtiologjikë që përcaktojnë suksesin në gjuetinë dhe në zënien e peshkut në këto ujëra. Në këtë vështrim edhe puna kërkimore-shkencore të ngrihet dora-dorës në një stacion të veçantë kërkimor, që të studiojë mbi baza shkencore gjendjen dhe perspektivën.

3. — Të bëhet një studim më i plotë për një organizim më të mirë të prapavijës së peshkimit, si në drejtim të fuqizimit të flotës dhe bazës për riparimin e ndërtimin e motobarkave, ashtu dhe për prodhimin e kooperuar të rrjetave, të pajisjeve dhe të aparatave akustike e radioteknike etj.

4. — Popullimi i ujërave të brendshme me llojet e përshtatshme të peshqve dhe në sasinë e nevojshme të bëhet në mënyrë të planifikuar e të programuar, i centralizuar dhe i decentrali-

1 Varka të vogla peshkimi.

zuar njëkohësisht. Krahas kësaj pune të forcohen e të zgjerohen ekonomitë e prodhimit të rasatit e të rritjes intensive kudo ku është e mundur e ka kushte të përshtatshme për këtë qëllim, kryesisht me mjete rrethore e nën kujdesin e specialistëve (zooteknikë e peshkatarë).

5. — Krahas rritjes së sasisë së peshkut të merren masa dhe për shtimin e bazës ushqimore, në përputhje me kërkesat zooteknike nëpërmjet pasurimit të bimësive ujore, përmirësimit të regjimit ujor, sidomos në rezervuarët ujorë, si dhe organizimit të prodhimit të ushqimeve të kombinuara e të balancuara për rritjen intensive të peshqve në ekonomi të organizuara.

6. — Të rritet më shumë kujdesi për ruajtjen dhe për mbrojtjen e kësaj pasurie të madhe të popullit nga dëmtuesit e ndryshëm, duke zbatuar rigorozisht dispozitat në fuqi ose edhe duke u bërë atyre ndonjë përmirësim. Të kufizohen në maksimum lejet për gjuetinë e peshkut, por në të njëjtën kohë të merren masa të rënda ndaj gjithë atyre që përdorin për peshkim lëndë plasëse të çdo lloji, që derdhin mbeturina industriale kur ato përbëjnë rrezik për jetën e nënujshme, që ndryshojnë regjimin ujor të lumenjve pa marrë masa për mbrojtjen e peshqve, që presin pa kriter bimësinë e lumenjve e të liqeneve etj.

7. — Për të përballuar më mirë nevojat e peshkimit me specialistë të mesëm e të lartë, të organizohet përgatitja e tyre e planifikuar, siç bëhet edhe për specialistët e llojeve të blegtorisë. Në fakultetet zooveterinare t'u jepet një vend më i gjerë marrjes së njohurive mbi peshkun, si dhe futjes së disiplinës së veçantë të ihtiologjisë, në mënyrë që zootekniku dhe veterineri të njohin më konkretisht edhe peshqit dhe të jenë në gjendje të punojnë në këtë drejtim.

8. — Këshilli i Ministrave dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse, si dhe komitetet e Partisë dhe ato ekzekutive të rrethëve, drejtoritë e ndërmarrjeve dhe agjencitë e peshkimit në përputhje me këtë vendim të marrin masat e nevojshme për ta organizuar mbi baza më të shëndosha peshkimin e për ta zhvilluar më tej atë, për të plotësuar më mirë detyrat e mëdha që ka ky sektor i rëndësishëm i ekonomisë popullore.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

K O N K L U Z I O N E

TË SEKRETARIATIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI DISA PROBLEME TË PUNËS IDEOPOLITIKE DHE KULTURORE NË USHTRI»

19 janar 1973

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 19 janar 1973, pasi shqyrtoi raportin «Mbi disa probleme të punës ideopolitike dhe kulturore në ushtri», arriti në këto konkluzione...

1. — Puna politike duhet të përballojë më mirë problemet e mëdha dhe kërkesat e reja që ka shtruar Partia në fushën e mbrojtjes dhe në ushtri

Në ushtri është bërë një punë e madhe për shpjegimin e zbatimit të parimeve të Artit Ushtarak Popullor. Megjithatë mbetet akoma shumë për të bërë për sa i përket zbërthimit ideoteorik të disa çështjeve të veçanta e konkrete të këtyre parimeve. Kuadrot, ushtarët dhe gjithë punonjësit e vendit duhet të kenë përfytyrime më të qarta dhe reale për tërë kërkesat e luftës në të gjitha fazat që mund të zhvillohet ajo në praktikë, mbi gjithë armiqtë e mundshëm. Prandaj kërkohet të bëhet më shumë dhe më e mirë përgatitja e gjithanshme ushtarake e moralo-politike, fizike e psikologjike, me argumente më të thella shkencore e me norma konkrete. Në këtë punë duhet të angazhohen më shumë se deri tani të gjithë kuadrot politikë e ushtarakë, duke filluar nga kuadrot kryesorë të Ministrisë së Mbrojtjes, të Akademisë Ushtarake, të Institutit të Studimeve Ushtarake etj.

Një punë më e thellë për zbërthimin ideoteorik të parimeve të Artit Ushtarak Popullor do të ndihmonte jo vetëm ushtrinë, por edhe terrenin për t'i kuptuar më gjerë problemet e mbrojt-

tjes. Kjo do të bënte që të kapërcehen edhe ato raste ngushtësie që vihen re si në komandat dhe në organet politike të ushtrisë, për sa u përket detyrave që kanë në lidhje me përgatitjen ushtarake të popullit për mbrojtje dhe bashkëpunimin me organet e Partisë e të pushtetit në rrethe, ashtu edhe në organizatat e Partisë dhe të pushtetit në rreth e bazë për detyrat që kanë në lidhje me mbrojtjen, për pjesëmarrjen aktive të rezervistëve në stërvitje, për mobilizimin, organizimin dhe gatishmërinë e të gjitha forcave njerëzore dhe materiale qysh tashti në kohë paqeje në shërbim të mbrojtjes, për një kuptim më të mirë të detyrës që kanë kuadrot rezervistë si gjatë dhe pas stërvitjes, me qëllim që të rritin vazhdimisht aftësitë drejtuese dhe udhëheqëse ushtarake dhe politike.

Kuptimi më i thellë dhe zbatimi më drejt i demokracisë e i disiplinës duhet të përbëjnë një objekt tjetër të rëndësishëm për punën ideopolitike në ushtri. Lufta e Partisë në ushtri duhet drejtuar njëkohësisht në të dy krahët, si kundër arbitrariteteve ashtu dhe kundër lëshimeve, sepse të dy rreziqet ekzistojnë dhe dëmtojnë forcimin e ushtrisë.

Duke zbatuar drejt vijën e masave, organet politike dhe organizatat e Partisë në ushtri t'i kushtojnë kujdes të veçantë punës ideopolitike me efektivin, të tërheqin sa më aktivisht ushtarët në jetën e veprimtarinë e repartit, të pyeten ata dhe të dëgjoher me kujdes zëri i tyre, të aktivizohen gjerësisht në kontrollin e zbatimit të rregullave, të programeve, të përgatitjes politiko-luftarake etj. Puna politiko-ideologjike e gjallë, konkrete, intensive dhe e larmishme me masën e ushtarëve do të ndihmojë në rritjen e shkallës së ndërgjegjes ndaj detyrës, të ndjenjës së përgjegjësisë, do t'i vërë ata në pozita të tilla që ta ndiejnë se efektivisht janë ata që i hartojnë programet për zbatimin e detyrave, janë ata vetë që marrin pjesë në organizimin e jetës politike, ushtarake dhe ekonomike, në forcimin e rregullit e të disiplinës etj. Ata vetë duhet t'i kërkojnë llogari vetvetes, shokut, kolektivit që detyrat të kryhen në mënyrë të përpiktë.

Organet politike dhe të Partisë në ushtri t'i kushtojnë vëmendje të veçantë organizimit të kontrollit të drejtpërdrejtë të klasës punëtore në ushtri. Të thellohet më tej eksperiencia e fituar, të kuptohet mirë ideologjikisht direktiva e Partisë mbi kontrollin punëtor kudo dhe mbi çdo gjë. Duke mbajtur parasysh specifikën që ka ushtria, nevojën e ruajtjes së sekretit, të përcaktohet me kujdes fusha e veprimit të kontrollit punëtor në ushtri, ku duhet bërë, për se duhet bërë, si duhet bërë, kush duhet ta bëjë etj. Çdo organizim i kontrollit punëtor në ushtri të bëhet në bashkëpunim të ngushtë midis organeve të Partisë në rrethe dhe në ushtri.

Në ushtri vihen re dhe mjaft raste të shkeljeve të vogla, por

të vazhdueshme të rregulloreve e të rregullit ushtarak, si largim pa leje nga reparti apo shërbimi, moszbatimi i kërkesave për paraqitjen e ushtarit, mbajtjen e uniformës etj. Këto ngjasin edhe sepse disa herë mbahen qëndrime liberale nga disa komanda, si dhe sepse mjaft organizata rinie tregohen indiferente kundër këtyre shfaqjeve. Prandaj nga të gjithë kuadrot dhe komandat duhet të sigurohet një qëndrim më rigoroz dhe unik ndaj këtyre fenomeneve, duke mos bërë as lëshimin më të vogël. Njëkohësisht në organizatat e rinisë duhet të forcohen puna edukative dhe kritika kundër të gjitha shfaqjeve të shkeljes së disiplinës.

Më shumë rëndësi i duhet dhënë formimit moral dhe ideologjik të ushtarëve e kuadrove. Është e drejtë që theksi në punën ideopolitike në ushtri të vihet, në radhë të parë, në ato probleme që kanë të bëjnë me plotësimin e detyrave ushtarake, por më shumë vend duhet të zërë dhe puna për formimin e gjithanshëm ideologjik të efektivit, për edukimin e tij me vetitë e moralit proletar. Jeta e përbashkët e njerëzve në stërviçje, në kohën e lirë, në mensë, fjetore, në kushte të vështira shërbimi etj., i zbulon mirë karakteret e tyre, vetitë e mira dhe difektet që kanë ata në formimin ideologjik dhe moral. Por puna ideopolitike për problemet e edukimit të karakterit të ushtarit është akoma e pamjaftueshme. Ka ardhur koha që problemet e formimit moralopsikologjik të ushtarëve të përpunohen më mirë, duke synuar jo vetëm në ato veti që lidhen me detyrat si ushtar, por dhe si qytetar. Në këtë drejtim duhet të rritet jo vetëm ndikimi nëpërmjet organizmave politikë dhe ushtarakë, por dhe nga vetë ushtarët mbi njëri-tjetrin.

2. — Të çohet më tej lufta kundër formalizmit në metodat e punës edukative

Për punën ideopolitike në ushtri ka një kohë të programuar e të mjaftueshme. Edhe nga kjo pikëpamje ushtria është gati një shkollë më vete. Por do të ishte gabim të reduktohej roli i ushtrisë si shkollë vetëm ose kryesisht në atë punë që realizohet nëpërmjet programeve ushtarake e ideopolitike. Ajo në të vërtetë është, dhe duhet të bëhet gjithnjë e më shumë, një shkollë e gjithanshme edukimi, ku i riu formohet edhe si qytetar, njihet me kërkesat e një discipline të lartë, mësohet me një regjim rigoroz jete dhe pune, me vështirësitë e shërbimit, me kërkesa të larta për sjellje shembullore, higjienë, rregull etj.

Në procesin e punës ideopolitike të programuar duhet të luftohet çdo lloj standardizimi që duket më shpesh në caktimin e orëve të njëjta për çdo temë, në ndarjen e saj patjetër në 3 etapa: tregim, lexim, bisedë, gjë që e ka bërë të mërzitshme. Të

luftohet për më shumë variacion në gjithë këtë punë, t'i lihet më tepër iniciativë bazës, sidomos organizatës së rinisë, për të gjetur forma më efikase për përvetësimin e programit, për të aktivizuar më shumë ushtarë si drejtues të punës ideopolitike etj. Programet e përgatitjes marksiste-leniniste të kuadrove të kenë më tepër karakter problemor, të jenë të diferencuara sipas nivelit të kuadrit, sidomos në shtabet e njëjsteve, t'u jepet më tepër rëndësi e vend studimit individual e punës së pavarur.

Është një gjë e mirë që tani programet e punës ideopolitike në ushtri bëhen mbi bazën e një iniciative më të madhe të komiteteve e të organizatave-bazë të Partisë. Por megjithatë, për gjëra të përbashkëta, mund dhe duhet të dërgohen edhe programe apo tematika orientuese edhe nga ana e Drejtorisë Politike dhe nga komitetet e Partisë të njëjsteve të bashkuara.

3. — Të shfrytëzohen më me efikasitet koha dhe mjetet e punës kulturore, të ngrihet më lart niveli i saj

Me ushtarët zhvillohet një veprimtari e dendur kulturore. Por në organizimin e kësaj pune vihen re mjaft elementë formalizmi, forma pune mekanike, siç janë leximi apo komentimi i thjeshtë i artikujve të shtypit, zhvillimi i aktiviteteve vetëm brenda në klasë etj. Do të ishte më mirë sikur tërë këto aktivitete të zhvilloheshin më lirshëm, në mënyrë që disa prej tyre të mos duken gjithmonë të programuara, por si një shfrytëzim më produktiv e në forma më të ndryshme i një kohe që mund të konsiderohet e lirë dhe që mund të jetë si njëfarë alternimi me veprimtarinë tjetër rigorozisht të programuar.

Veprimtaria kulturore në ushtri duhet t'i përgjigjet më mirë strukturës së ushtrisë, duke kapërcyer format e punës së mbyllur e duke forcuar lidhjet e bashkëpunimin me institucionet e forcat artistike kulturore të terrenit.

Të tregohet më shumë kujdes për punën e shtëpive të ushtarakëve, duke krijuar në to ambiente sa më të përshtatshme për veprimtarinë kulturore-masive dhe duke i plotësuar ato me kuadro të mjaftueshëm dhe të kualifikuar.

Gjithashtu edhe krijimtaria e veprimtaria letraro-artistike në ushtri duhet të zgjerohet nga sasia e të pasurohet nga brendia e cilësia, por gjithnjë duke u mbështetur gjerësisht në forcat e veta, në grupet amatore e rrethet letrare të ushtarakëve, si dhe duke përdorur mirë gjithë krijimtarinë e pasur letrare e artistike të vendit.

4. — Zbatimi i të gjitha detyrave që qëndrojnë sot para ushtrisë kërkon një kujdes të posaçëm për përgatitjen dhe ngritjen e vazhdueshme ideopolitike dhe profesionale të kuadrove e posaçërisht të kuadrit politik

Duke marrë parasysh kërkesat që shtrohen sot për një punë më të thellë ideoteorike mbi baza të shëndosha shkencore, si dhe nivelin arsimor-kulturor në përgjithësi të ngritur të efektivitetit, duhet të tregohet një kujdes i veçantë për rritjen e aftësive drejtuese, të dijeve ideopolitike e ushtarake dhe të nivelit të përgjithshëm kulturor të të gjithë kuadrove, veçanërisht të kuadrove politikë e në mënyrë të posaçme të atyre të bazës.

Të punohet me plan për përtëritjen e këtyre kuadrove, sepse moshja e punëtorëve politikë në përgjithësi është e madhe. Përveç rrugës së kalimit të kuadrove ushtarake në politikë, duke zgjedhur gjithnjë për këtë punë njerëzit më të përshtatshëm e të aftë, del nevoja që të kemi dhe një sistem të organizuar me vazhdimësi për përgatitjen e kuadrove politikë. Ngarkohet Drejtoria Politike që brenda vitit 1973 të studiojë mënyrën praktike të zgjidhjes së këtij problemi dhe të dalë me propozime konkrete. Por në përgatitjen e kuadrove të ushtrisë pavarësisht nga detyra që ata do të kryejnë, qofshin të sektorit politik apo ushtarak, duhet të mbahet parasysh që në të gjitha llojet e shkollave të mësojnë si për detyrat ushtarake ashtu dhe për ato politike.

Një kujdes më i madh të tregohet për jetën personale e familjare të kuadrove, sidomos për kuadrot e rinj dhe për ata që punojnë në pikat e hapjes. Të punohet vazhdimisht për të çliruar shumë kuadro nga ngarkesa e tepërt. Për këtë qëllim duhet të shfrytëzohet më mirë se deri tani si një rezervë e madhe, aktivizimi i ushtarëve më të aftë.

Përmirësime të mëtejshme duhet të bëhen me domosdo edhe në punën me kuadrin politik rezervist. Komitetet e Partisë në rrethet tok me komitetet e Partisë në ushtri të ndërmarrin një studim të përgjithshëm për të përcaktuar më drejt kuadrot që do të kryejnë funksione politike e detyra partie në ushtri, si dhe për të hartuar një plan konkret për edukimin e tyre. Këta kuadro së bashku me oficerët efektivë të ushtrisë të përdoren si propagandistë të mësimëve të Partisë për mbrojtjen e atdheut në masat.

5. — Në tërë punën për edukimin e ushtarëve një vend të rëndësishëm duhet të zërë gjallërimi i jetës dhe i veprimtarisë së organizatave të rinisë

Duke qenë e vetmja organizatë masash në ushtri dhe duke pasur parasysh faktin se në ushtrinë efektive kryesisht kemi të bëjmë me rininë, roli i organizatave të rinisë duhet të ndihet

shumë më tepër në të gjithë organizmat e ushtrisë. Komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë duhet të punojnë në mënyrë më serioze për t'u hapur organizatave të rinisë më mirë horizontin për kryerjen e detyrave të tyre, t'i përkrahin e t'u japin atyre më tepër iniciativë në veprimtarinë e gjithanshme të ushtrisë. Të dëgjohet më shumë zëri i të rinjve, jo vetëm në mbledhjet e rinisë, por dhe në mbledhjet e Partisë, të shtabeve, në hartimin e zbatimit e detyrave, të programeve të punës ideopolitike etj.

6. — Ngritja cilësore e punës ideopolitike e kulturore varet shumë nga përmirësimi i mëtejshëm i nivelit të drejtimit nga komitetet dhe organizatat e Partisë

Vitet e fundit edhe në këtë drejtim janë vënë re mjaft përmirësime, megjithatë vend për t'u kënaqur nuk ka.

Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë tërheq vëmendjen e organizatave dhe të komiteteve të Partisë në ushtri që t'i kushtojnë një vëmendje më të madhe përmbajtjes së punës ideopolitike e kulturore, dhe të mos kapen vetëm pas formave të punës, indekseve sasiore të plotësimit të programeve, gjë që vihet re shpeshherë në punën e tyre.

Duhet të luftohet ndarja që vihet re në disa raste midis punës ushtarake e asaj ideopolitike. Me gjithë luftën që është bërë akoma ka raste që puna politike shikohet si detyrë vetëm e disa kuadrove të ngarkuar posaçërisht dhe jo e të gjithë kuadrove. Shoku Enver na mëson se që nga ushtari i thjeshtë deri te oficeri më i lartë, të gjithë duhet të jenë më parë njerëz politikë.

Nga ana tjetër duhet të luftohet edhe mendimi që e shikon punën politike si diçka më vete, të palidhur ngushtë me të gjitha punët e detyrat e tjera. Si puna politike dhe ajo ushtarake duhet të gërshetohen me njëra-tjetrën. Në ushtri s'mund të ketë punë politike pa e lidhur me detyrat ushtarake, ashtu siç s'mund të flitet për detyra ushtarake pa shtruar dhe anën politike të tyre.

Lëvizjet e ndryshme revolucionare kanë gjetur një përkrahje të gjerë. Por ato kanë nevojë të drejtohen e të përkrahen më mirë nga organizatat e Partisë, të zhvishen nga formalizmi e puna me fushata.

Në veprimtarinë e organeve drejtuese të Partisë në ushtri, një vend më të madh duhet të zërë bashkërendimi i punës së tyre me komitetet dhe organizatat e Partisë në terren. Kjo punë të mos kufizohet vetëm në kuadrin e stërvitjeve ushtarake ose të punimeve fortifikuese, por të shtrihet edhe në çështje të tjera që lidhen me përgatitjen e popullit për mbrojtjen, deri tek edukimi ideopolitik i rezervistëve për problemet që kanë të bëjnë me

mbrojtjen. Nën udhëheqjen e komiteteve të Partisë në rrethe e sipas kërkesave të tyre, këtë punë duhet ta organizojë e ta kontrollojë ushtria, duke aktivizuar jo vetëm kuadrin efektiv por dhe atë rezervist, pensionistët etj. Për këtë duhet të sigurohen një bashkëpunim e një ndihmë më e mirë nga ana e Drejtorisë Politike dhe e komiteteve të Partisë të njësive e reparteve ushtarake me komitetet e Partisë në rrethe.

Duke pasur parasysh se komitetet dhe organizatat e Partisë në ushtri sot kanë grumbulluar një eksperiencë të pasur dhe kanë mjaft kuadro të ngritur, të aftë për të zgjidhur me iniciativë detyrat që u ngarkohen, kërkohet që Drejtoria Politike të bëjë një punë me nivel më të lartë për të studiuar e për të përgjithësuar problemet kryesore, si dhe për t'u hapur horizont për drejtimet më të rëndësishme të punës.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PROTOKOLL

I SEKRETARIATIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI PUNËN E ORGANIZATAVE TË PARTISË PËR EDUKIMIN MASIV AGROZOOTEKNIK TË KOOPERATIVISTËVE

19 janar 1973

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 19 janar 1973, pasi shqyrtoi raportet e paraqitura nga komitetet e Partisë të rretheve Lushnjë e Skrapar mbi punën e organizatave të Partisë për edukimin masiv agrozooteknik të kooperativistëve në bujqësi, arriti në këto konkluzione:

Komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë, të udhëhequra nga orientimet e Partisë dhe nga porositë e vazhdueshme të shokut Enver, kanë përmirësuar punën për edukimin agrozooteknik të punonjësve të bujqësisë. Ato, sipas kushteve konkrete, kanë përdorur një larmi më të madhe formash dhe kanë shtuar në to pjesëmarrjen e punonjësve të bujqësisë. Është shtuar numri i shkollave të mesme bujqësore pa shkëputje nga puna dhe pjesëmarrja në to. Ngritja e stacioneve bujqësore, e kabineteve agrozooteknike, e laboratorëve në rrethe dhe në ekonomitë bujqësore, zgjerimi i pjesëmarrjes së masave në eksperimentimin që bëhet në parcelat dhe tufat e rendimenteve të larta, zhvillimi i aktiveve, sesioneve shkencore, konsultave e seminareve, si dhe shtimi i literaturës e i propagandës bujqësore, kanë qenë mjete të dobishme për ngritjen e nivelit agrozooteknik të punonjësve të bujqësisë.

Por, në punën për edukimin masiv agrozooteknik të punonjësve të bujqësisë, janë vërejtur e vërehen mjaft të meta e dobësi. Puna e bërë deri tani nuk u përgjigjet sa e si duhet detyrave dhe orientimeve që ka vënë Partia, si dhe kërkesave që shtrën intensifikimi dhe modernizimi i bujqësisë. Veprimtaria e komiteteve dhe e organizatave të Partisë, si dhe e organeve ekonomike e shte-

tërore për edukimin dhe krijimin e bindjes së plotë të masat, mbi domosdoshmërinë e mësimit e të përvetësimit të shkencës bujqësore dhe të shtimit të dashurisë për fshatin e profesionin e bujkut, sidomos të disa të rinj, ka qenë e pakët, me hope dhe nuk ka lënë kurdoherë gjurmë.

Ministria e Bujqësisë nuk është thëlluar sa duhet në përcaktimin dhe programimin e problemeve kyç që dalin sot për kualifikimin e mëtëjshëm të punonjësve të bujqësisë. Vërehen akoma formalizëm, njëfarë pune për bujë dhe vetëkënaqësi për rezultatet mbi bazën e të dhënave globale.

Kabinetet agrozooteknike dhe këshillat e bërthamat shkencore në rrethe dhe në ekonomitë bujqësore akoma nuk janë kthyer në qendra të rëndësishme të edukimit agrozooteknik të punonjësve të bujqësisë. Nga organizimi i ekspozitave dhe i konkurseve pothuajse është hequr dorë kudo. Literatura dhe botimet e tjera të propagandës bujqësore nuk studiohen dhe nuk përdoren sa duhet për masivizimin e njohurive shkencore e të përvojës së përparuar. Organizatat e Partisë në kooperativa e ndërmarrje bujqësore nuk janë ndalur mirë mbi këto çështje dhe nuk kanë marrë masa serioze për përmirësimin rrënjësor të gjendjes.

Me qëllim që në të ardhmen puna për edukimin agrozooteknik të punonjësve të bujqësisë të ketë më shumë rezultate, Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH

Porosit:

1. — Organet dhe organizatat-bazë të Partisë, organet shtetërore dhe të ekonomisë, edukimin agrozooteknik të punonjësve të bujqësisë ta konsiderojnë si pjesë përbërëse të punës së tyre për edukimin e gjithanshëm të masave punonjëse dhe si një hallkë të rëndësishme për realizimin e detyrave në bujqësi, për intensifikimin dhe modernizimin e saj. Për këtë qëllim të punohet që të punonjësit dhe të kuadrot e bujqësisë të krijohen bindje të plota ideologjike së edukimi agrozooteknik i tyre është bërë tani një domosdoshmëri objektive, se pa dije të plota prodhimi bujqësor nuk mund të vihet mbi baza shkencore. Të luftohet më me këmbëngulje nga ana ideologjike, morale e organizative për të thyer kudo mendimin që vihet re në mjaft raste se bujqësia është një mjeshtëri që nuk kërkon njohuri të shumta teknike e shkencore, si dhe për të mënjeluar prirjen që ekziston të disa të rinj që nuk duan të qëndrojnë e të punojnë në bujqësi.

2. — Organet e Partisë e të pushtetit në rrethe, organizatat-bazë dhe levat e tyre në ekonomitë bujqësore, të luftojnë formalizmin dhe shkollarizmin që vihen re në punën për kualifikimin e punonjësve të bujqësisë, si një nga çështjet kryesore që

pengon çuarjen e tij më përpara. Veçanërisht të luftohet tendenca e të kënaqurit me shifrat globale në dëm të përmbajtjes dhe të cilësisë, në mënyrë që kualifikimi të shërbejë gjithmonë e më mirë për të çrrënjësuar dijet dhe metodat empirike të organizimit dhe të drejtimit të punëve në bujqësi, për futjen dhe zgjerimin e dijeve e të metodave të përparuar, për të vendosur prodhimin bujqësor mbi baza thellësisht shkencore. Prandaj format e edukimit agrozooteknik të bëhen sa më të gjalla e tërheqëse dhe të nxitin interesin e pjesëmarrësve për të mësuar. Një kujdes i veçantë të tregohet për të rinjtë e të rejtat, si bartës dhe përçues të së resë në bujqësi, për të ngjallur tek ata dashuri e respekt për bujqësinë, për shkencën bujqësore, për punën e bujkut e të blegtorit.

3. — Ministria e Bujqësisë duke pasur parasysh direktivat që shtroi Kongresi i 6-të i Partisë dhe Letra e Komitetit Qendror të PPSH e 8 janarit 1971, si dhe porositë e shokut Enver për edukimin agrozooteknik të punonjësve të bujqësisë, të thellohet më shumë për të nxjerrë problemet kyç që i dalin sot e në të ardhmen bujqësisë sonë dhe t'ua rekomandojë ato rretheve për t'i bërë objekt mësimi e diskutimi në kurse e shkolla, si dhe në forma të tjera.

Çdo ekonomi bujqësore tani ka nevojë për grupe punonjësish të specializuar që të dinë teorikisht e praktikisht si bëhen, si perfeksionohen dhe si ruhen sistemimi dhe nivelimi i tokave, si bëhen kullimi e ujitja; si nxirren konkluzione dhe si përdoren konkretisht të dhënat që kanë rezultuar nga studimi agrokimik e pedologjik i tokave; si përdoren mbi baza shkencore e me efektivitet të lartë preparatet kimike; si bëhet përgatitja dhe kur e si përdoren plehrat organike e kimike ose të kombinuara midis tyre; si përgatiten, kombinohen dhe përdoren ushqimet e fermentuara e të balancuara për kafshët etj. Në kushtet e tanishme dhe për të ardhmen, ekonomitë bujqësore kanë nevojë jo thjesht për drejtues e manovrues të traktorëve e të makinave bujqësore, por për bujq të shquar që punojnë në bazë të kërkesave të shkencës bujqësore, që janë njohës të thellë të kërkesave të tokës, të bimëve etj. Këto grupe punonjësish të specializuar, me shkollë të mesme bujqësore apo 8-vjeçare, duhet të përgatiten e të kualifikohen, duke ndjekur kurse e shkolla të veçanta, që më vonë të bëhen krahu i djathtë i specialistit dhe i brigadierit jo vetëm për vënien në jetë të njohurive të fituara nga ana e tyre, por edhe për të tërhequr në këtë punë gjithë punonjësit e bujqësisë.

4. — Në eksperimentimin shkencor dhe në parcelat e rendimenteve të larta ose në tufat e bagëtive me prodhueshmëri të lartë, punonjësit e bujqësisë të mos përdoren thjesht si forcë fizike, por të jenë pjesëtarë aktivë dhe nën drejtimin e specialistëve të ndjekin e të zbatojnë me konsekuencë e vetëdije këto

eksperimente, të nxjerrin mësim e konkluzione që t'u vlejné në punën e tyre të sotme e të ardhme.

5. — Ministria e Bujqësisë, komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë, si dhe organet ekonomike e shtetërore, të zgjerojnë dhe të përmirësojnë punën e deritanishme për gjallërimin e propagandës bujqësore, nëpërmjet aktivizimit të kabineteve agrozooteknike, të filmave e të dokumentarëve bujqësorë, të ekspozitave dhe konkurseve bujqësore e blegtorale në shkallë kombëtare e rrethi. Krahas përmirësimit të cilësisë, një kthesë rrënjësore duhet të bëhet në organizimin dhe në shfrytëzimin e mirë të botimeve me karakter bujqësor.

Të përdoren gjerësisht stimujt moralë si certifikatat, fletë-lavdërimet, çmimet, dekoratat etj., të cilat në mjaft raste janë lënë pas dore. Ministria e Bujqësisë dhe organet e Partisë e të pushtetit në rrethe t'i konsiderojnë këto si leva të fuqishme për të nxitur e për të inkurajuar shembullin pozitiv dhe dëshirën për punë e për kualifikim.

6. — Organizatat-bazë të Partisë, organet drejtuese të ekonomisë bujqësore e veçanërisht ato kooperativiste t'i drejtojnë dhe t'i përkrahin më mirë specialistët, që ata të bëjnë një punë më të organizuar dhe më të frytshme për ngritjen e mëtejshme të kualifikimit të punonjësve, në përputhje me kërkesat e intensifikimit dhe të modernizimit të bujqësisë. Stacionet bujqësore shkencore të rretheve të bëhen pikë mbështetjeje jo vetëm për zgjerimin e eksperimentimit shkencor masiv, por edhe për përhapjen e eksperiencës së përparuar e të dijeve teknike e shkencore, si dhe për kualifikimin e mëtejshëm të punonjësve të bujqësisë.

Sekretari i Komitetit Qendror të PPSH

Hysni Kapo

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PLENUMI I 3-TË I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 5-6 shkurt 1973

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në datën 5 e 6 shkurt 1973, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi i 3-të i Komitetit Qendror të PPSH, i cili dëgjoji raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi plotësimin e planit të vitit 1972, detyrat kryesore për vitin 1973 dhe disa probleme për përsosjen e mëtejshme të drejtimit të ekonomisë», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave, shoku Adil Çarçani.

Plenumi diskutoi gjerësisht rreth raportit dhe e aprovoi atë njëzëri.

Plenumi gjithashtu vendosi të shtohet edhe një sekretar në Sekretariatën e Komitetit Qendror. Sekretar i Komitetit Qendror të PPSH u zgjodh njëzëri shoku Petro Dode.

Në mbyllje të punimeve të mbledhjes së Plenumit Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, mbajti një fjalim të rëndësishëm.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

R A P O R T

I BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI PLOTËSIMIN E PLANIT TË VITIT 1972, DETYRAT KRYESORE PËR VITIN 1973 DHE DISA PROBLEME PËR PËRSOSJEN E MËTEJSHME TË DREJTIMIT TË EKONOMISË»

5 shkurt 1973

Shokë e shoqe,

Me vitin 1972 ne mbyllëm njëkohësisht dy vjetët e parë të planit të pestë pesëvjeçar. Këto kanë qenë vite përpjekjesh të mëdha nga ana e klasës punëtore dhe e gjithë popullit tonë për të vënë në jetë vendimet e Kongresit të 6-të të PPSH për ndërtimin socialist të vendit. Gjatë këtyre dy vjetëve rendi ynë ekonomik-shoqëror ka bërë hapa të rinj e të rëndësishëm përpara në të gjitha fushat e jetës. Forcat prodhuese janë ngritur në një nivel më të lartë e janë përsosur më tej marrëdhëniet socialiste në prodhim, është përmirësuar jetesa e masave punonjëse dhe është rritur aftësia mbrojtëse e atdheut. Republika Popullore e Shqipërisë ka forcuar më tej pozitën e saj në arenën ndërkombëtare dhe ecën me vendosmëri në rrugën e socializmit.

Sukseset e arritura gjatë vitit 1972 ishin të gjithanshme. Plani i prodhimit të përgjithshëm industrial u plotësua 101 për qind dhe për të dy vjetët e pesëvjeçarit të marrë së bashku 102 për qind. Në përgjithësi plani i prodhimit industrial u plotësua në të gjitha degët, me përjashtim të industrisë së nxjerrjes së kromit, qymyrgurit dhe degës së materialeve të ndërtimit. Në vitin 1972, në krahasim me vitin 1970, u prodhuan më shumë: naftë brut rreth 30 për qind, mineral kromi rreth 12 për qind, qymyrguri rreth 28 për qind, energji elektrike 31 për qind, çimento 20 për qind etj. Në bujqësi vëllimi i përgjithshëm i prodhimit për vitin 1972, sipas shifrave më të plota të realizimit të pritshëm, në krahasim me

vitin 1971, është rritur rreth 11 për qind. Në krahasim me vitin 1970 u prodhuan më shumë: drithëra buke afërsisht 14 për qind, patate 25 për qind, pambuk 38 për qind, duhan 27 për qind, panxharsheqeri 16 për qind, qumësht 22 për qind etj. Gjatë dy vjetëve u hapën 42,7 mijë ha toka të reja.

Megjithëkëtë, detyrat e planit në bujqësi nuk u plotësuan. Në vitin 1972 plani i prodhimit të përgjithshëm bujqësor u plotësua në masën rreth 86 për qind, nga i cili në bimët e arave rreth 84 për qind, në blegtori rreth 90 për qind, në pemëtari rreth 81 për qind.

Të gjitha këto mosrealizime në sektorin e bujqësisë krijuan vështirësi serioze për ekonominë, veçanërisht në furnizimin e popullit, në sigurimin e lëndëve të para për industrinë dhe në bilancin e tregtisë së jashtme.

Plani i ndërtimeve dhe i montimeve për vitin 1972 u plotësua rreth 96 për qind, ndërsa për të dy vjetët të marrë së bashku ai u plotësua 103 për qind. Vëllimi i transportit të mallrave në llojet e ndryshme të transportit u plotësua si për vitin 1972 ashtu edhe për të dy vjetët e pesëvjeçarit. Detyrat e planit të shitjes së mallrave me pakicë në rrjetin e tregtisë, si për vitin 1972, ashtu edhe për të dy vjetët e pesëvjeçarit të marrë së bashku, në përgjithësi, janë plotësuar.

Plani i rendimentit të punës në industri në vitin 1972 u plotësua 100 për qind; po kështu në ndërtim detyrat e rendimentit të punës për të dy vjetët e pesëvjeçarit u plotësuan, duke shënuar një rritje prej 16 për qind kundrejt vitit 1970.

Në sektorët e arsimit, të kulturës e të shëndetësisë detyrat e planit të vitit 1972, në përgjithësi, janë plotësuar e tejkaluar. Numri i nxënësve e i studentëve ka arritur rreth 700 mijë veta. Ky vit shënoi zbatimin në front të gjerë të programit për revolucionarizimin e shkollës në të gjitha hallkat e saj. Shërbimi shëndetësor është përmirësuar në përmbajtje dhe është shtrirë më shumë, sidomos në zonat e thella e në përgjithësi në fshat. Detyrat e caktuara nga Kongresi i 6-të i Partisë për rritjen e të ardhurave reale për frymë të popullsisë si në qytet ashtu edhe në fshat, për të dy vjetët të marrë së bashku, janë plotësuar.

Në vija të përgjithshme rezultatet kryesore të zhvillimit të ekonomisë popullore në vitet 1971-1972, të marrë në tërësinë e tyre, mund të konsiderohen të kënaqshme dhe inkurajuese. Por në të njëjtën kohë duhet të jemi të ndërgjegjshëm se prapa shifrave të përgjithshme dhe rezultateve të mira që janë arritur, ekzistojnë akoma rezerva të pashfrytëzuara dhe fshihen të meta e mosrealizime diku më pak e diku më shumë të ndjeshme. Në disa sektorë të ekonomisë, si në industrinë e kromit, të qymyrgurit, të materialeve të ndërtimit, në prodhimin e drithit, të lulediellit, të mishit, të perimeve, të vezëve, në vëllimin e ndërtim-montimit të

ndërmarrjeve të Ministrisë së Ndërtimit, në transportimin e disa mallrave kryesore, sidomos minerale, lëndë druri etj., janë krijuar deficite të konsiderueshme në realizimin e detyrave të planit, kryesisht për shkaqe dhe të meta me karakter subjektiv, të cilat kanë krijuar vështirësi në zhvillimin harmonik të degëve të ndryshme të ekonomisë, në furnizimin e rregullt të tregut dhe në plotësimin e kërkesave në rritje të popullit dhe në përgjithësi në zhvillimin ekonomik-shoqëror të vendit.

Masat punonjëse të vendit janë mobilizuar tani me të gjitha forcat për të realizuar detyrat e planit të vitit 1973, vitit të tretë të pesëvjeçarit.

Në vitin 1973 prodhimi i përgjithshëm industrial është parashikuar të rritet mbi 10 për qind kundrejt planit të vitit 1972; prodhimi i përgjithshëm bujqësor do të rritet 6,6 për qind, ose afro 24 për qind më shumë se plotësimi i pritshëm i këtij viti; vëllimi i ndërtim-montimeve 17 për qind, qarkullimi i mallrave me pakicë rreth 10 për qind, ndërsa të ardhurat reale të punonjësve të qytetit e të fshatit do të rriten rreth 13 për qind në krahasim me vitin 1970. Rendimenti i punës në prodhimin industrial është parashikuar të rritet afërsisht 6 për qind, ndërsa në ndërtim-montim mbi 8 për qind. Zhvillim të mëtejshëm do të marrë arsimi, kultura, shëndetësia dhe shërbimet e ndryshme ndaj popullit. Shpenzimet e prodhimit e të qarkullimit parashikohet të ulen mbi 205 milionë lekë.

Në këtë mënyrë ekonomia jonë popullore do të vazhdojë të zhvillohet me ritme të shpejta. Shprehje e përqendruar e këtij zhvillimi është rritja e të ardhurave kombëtare, të cilat do të shtohen rreth 11 për qind kundrejt planit të vitit 1972 nga rreth 9,5 për qind që duhet të rriten mesatarisht gjatë planit të pestë pesëvjeçar.

Si shihet detyrat e këtij viti janë të mëdha e të ngjeshura. Përveç këtyre, përpjekjet e mëdha dhe të gjithanshme që do të duhet të bëhen, mbi bazën e shfrytëzimit më të plotë të rezervave të brendshme, për të mbuluar edhe disa nga deficitet e krijuara gjatë dy vjetëve të mëparshëm, e bëjnë planin e vitit 1973 dhe realizimin me sukses të tij, një faktor të dorës së parë dhe vendimtar për plotësimin e të gjitha detyrave të planit të pestë pesëvjeçar në tërësi. Kjo kërkon mbi të gjitha një vlerësim e trajtim të thellë politik e ideologjik të detyrave, disiplinë të fortë partie e shtetërore, ndjenjë të lartë përgjegjësie, dhe veçanërisht një punë të organizuar, këmbëngulëse e sistematike nga organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe ato të ekonomisë në qendër e në bazë.

Byroja Politike e gjen të nevojshme të vërë gjithashtu në di-

jeni Plenumin e Komitetit Qendror se në planin e vitit 1973 ritmi i ndërtimit të disa objekteve, që kanë filluar të ndërtohen, do të jetë më i ulët nga ai i parashikuar në planin pesëvjeçar dhe si rrjedhim edhe afatet e parashikuara të mbarimit dhe vënies së tyre në shfrytëzim do të kenë një shtytje të mëtejshme. Kjo ndodh kryesisht për shkak të mospajtimin në kohë të projekteve, mosdhënies nga investitorët në afatet e caktuara të detyrave për projektim dhe të mospajtimin në kohë të disa makinerive dhe pajisjeve të nevojshme.

Zgjatja e afatit të ndërtimit të disa prej këtyre objekteve do të ketë sigurisht pasoja për prodhimin në vitet e ardhshme të pesëvjeçarit. Prandaj, ministritë përkatëse dhe organet e tjera shtetërore dhe ekonomike, është e nevojshme t'i dalin përpara problemit, duke kërkuar e gjetur rrugë të tjera për shtimin e prodhimeve të dobishme për ekonominë dhe eksportin, me qëllim që të realizojmë me sukses planin pesëvjeçar. Krahas kësaj, lufta dhe përpjekjet e gjithanshme, për të plotësuar në kohë dhe para afatit planin e ndërtimeve në këto objekte dhe në të gjitha objektet e tjera të planit, duhet të ngrihen në një shkallë më të lartë.

Duke shtruar në këtë Plenum të Komitetit Qendror të Partisë rezultatet e arritura në vitin 1972 dhe detyrat më kryesore që na dalin për planin e vitit 1973, Byroja Politike është e mendimit që të diskutohet e të vendoset mbi masat më të rëndësishme që duhen marrë për të siguruar plotësimin me sukses të detyrave të planit të vitit 1973 dhe të planit pesëvjeçar në tërësi. Për këtë qëllim është e domosdoshme të përqendrojmë më shumë vëmendjen në disa probleme, zgjidhja e të cilave garanton mbarëvajtjen e punës edhe në degë e sektorë të tjerë të ekonomisë popullore.

1. DISA NGA ÇËSHTJET MË TË RËNDËSISHME NË FUSHËN E PRODHIMIT INDUSTRIAL

Byroja Politike mendon që në këtë fushë, pa u kapur pas të gjitha çështjeve, të tërhiqet më tepër vëmendja në dy probleme kryesore që aktualisht na preokupojnë më shumë, siç janë: së pari, disa të meta të rëndësishme që vihen re në industrinë nxjerrëse të mineraleve dhe së dyti, mbi dobësitë e theksuara që akoma kanë vend në plotësimin e asortimenteve dhe cilësinë e punës e të prodhimit të mallrave.

a) Mbi disa probleme në industrinë nxjerrëse të mineraleve

Në vitin 1971 plani u plotësua pothuajse në të gjitha degët e industrisë nxjerrëse të mineraleve, ndërsa në vitin 1972 rezultatet nuk qenë ato që priteshin dhe në disa prodhime e sektorë u krijuan deficite dhe një prapambetje e atillë në plotësimin e planit,

që do ta vështirësojnë seriozisht zbatimin e detyrave shumë të mëdha që parashikohen në vitet e ardhshme, në qoftë se nuk merren masa të menjëhershme dhe të efektshme për ndreqjen e të metave të vërtetuara. Më e rëndë paraqitet gjendja në minierat e nxjerrjes së mineralit të kromit, sidomos në minierën e Bulqizës e cila vitin që kaloi krijoi një deficit të madh... deficit që sigurisht ndihet në bilancin e tregtisë sonë të jashtme dhe në ekonominë tonë në përgjithësi.

Deficite gjithashtu të ndjeshme janë krijuar edhe në disa lloj mineralesh të tjera dhe nënprodukte të naftës.

Kongresi i 6-të i PPSH theksoi se pikësynimi kryesor i industrializimit të vendit në pesëvjeçarin e pestë duhet të jetë shfrytëzimi më i gjerë dhe me efektivitet sa më të madh i pasurive natyrore të vendit për të plotësuar nevojat gjithnjë më të mëdha të riprodhimit të zgjeruar socialist. Në qoftë se do të vazhdohet të ecet kështu, më deficite të tilla në nxjerrjen e mineraleve, siç u vërtetua gjatë vitit 1972, duhet të jemi të ndërgjegjshëm se rrezikohet zbatimi i plotë i direktivës së mësipërme lidhur me rolin dhe vendin e industrisë nxjerrëse në procesin e industrializimit socialist. Një gjë e tillë patjetër do të ndikojë me pasoja negative të drejtpërdrejta në degët dhe sektorët e tjerë të ekonomisë popullore. Duke shqyrtuar me hollësi dhe në mënyrë kritike shkaqet e deficiteve të krijuara vitin e kaluar në nxjerrjen e disa mineraleve, del e qartë se arsyeja kryesore e këtyre deficiteve qëndron, në radhë të parë, në prapambetjen e theksuar të punimeve minerare dhe në mospërgatitjen me kohë të disa minierave për të përballuar si duhet detyrat e mëdha të prodhimit në pesëvjeçarin e pestë. Gjatë viteve 1971-1972, plani i punimeve minerare në minierat është realizuar rreth 86 për qind, pra me një deficit të konsiderueshëm. Në mënyrë të veçantë miniera e kromit të Bulqizës, duke mos menduar shumë për perspektivën, që nga viti 1969 deri sot ka krijuar në punimet minerare një deficit... të barabartë me më shumë se gjysmën e planit të një viti. Kjo ka ndikuar për keq në realizimin ritmik të planit të kësaj miniere dhe në cilësinë e mineralit. Një situatë e tillë është edhe në minierën e Batrës. Si rrjedhim, vetëm në këto dy ndërmarrje, që kanë peshën kryesore në nxjerrjen e kromit, si nga organizatat-bazë të Partisë, drejtuesit e vetë ndërmarrjeve, ashtu edhe nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe komitetet e Partisë të rretheve Dibër e Mat, janë lejuar të meta serioze në organizimin e punës dhe në drejtim, sidomos në përgatitjen me kohë të fronteve të prodhimit, gjë që i ka kushtuar dhe i kushton shumë ekonomisë dhe ndërtimit tonë socialist.

Nuk mund të justifikohet fakti që, ndërsa sektori i gjeologjisë në përgjithësi po i plotëson mirë detyrat në zbulimin dhe rritjen e rezervave të mineraleve, vazhdimi i kësaj pune nga punonjësit dhe

drejtuesit e minierave, lidhur me përgatitjen e këtyre rezervave për një shfrytëzim racional të tyre, nuk është i kënaqshëm.

Me sa duket, veç të tjerave, këtu kemi të bëjmë me një koncept të dëmshëm që vihet re në bazë e në qendër, për të nënvlefësuar detyrat e perspektivës, duke lënë pas dore punimet minerare, dhe duke e përqendruar vëmendjen kryesisht në nxjerrjen e mineraleve për sot, pa u shqetësuar shumë për pasojat e pakënaqshme për të ardhmen që sjell me vete një metodë e tillë pune. Ministria e Industrisë dhe e Minierave nuk ka luftuar sa duhet kundër një koncepti të tillë, nuk ka marrë me kohë masat e duhura për të ndaluar krijimin e një deficiti kaq të madh në punimet minerare, bazë e zhvillimit perspektiv të prodhimit minerar. Drejtoria e minierave e kësaj ministrie shpeshherë është pajtuar me këtë gjendje, në vend që të luftonte me këmbëngulje e gjer në fund për një drejtim shkencor e perspektiv të minierave, për një disiplinë të vërtetë shkencore, domosdoshmëri kjo e shfrytëzimit racional të mineraleve tona.

Detyrat në industrinë nxjerrëse të mineraleve nuk mund të realizohen si duhet pa disiplinën shkencore, pa e ngritur nivelin e organizimit e të drejtimit të prodhimit në lartësinë e kërkesave e të detyrave të kohës. Kjo shtron nevojën që çdo ndërmarrje, çdo minierë, sektor apo karrierë, ashtu si edhe çdo ndërmarrje apo sektor tjetër ekonomik, të ketë të qartë jo vetëm detyrat e ditës, por patjetër edhe perspektivën dhe rrugët e zhvillimit, të përgatitet për këto në mënyrë sa më të plotë dhe t'i dalë përpara çdo të papriture që mund të lindë. A mund të thuhet se është punuar me disiplinë dhe organizim shkencor si nga ndërmarrjet në bazë ashtu edhe nga Ministria në një kohë kur në disa miniera gjendja aktuale e përgatitjes së fronteve të prodhimit nuk përballon e nuk siguron prodhimin as për 3-4 muaj të vitit? Jo, në asnjë mënyrë, përkundrazi një gjendje e tillë krijon gjithmonë premisat e rrjedhimeve jo të mira.

Koço Theodhosi¹ mban përgjegjësi të veçantë për gjithë të metat e mësipërme, prandaj duhet të marrë masa të shpejta dhe të efektshme për përmirësimin e kësaj gjendjeje dhe sigurimin e detyrave të planit, jo vetëm të këtij viti, por për të gjithë pesëvjeçarin.

Është e domosdoshme që brenda një kohe sa më të shkurtër në të gjithë industrinë nxjerrëse, e në mënyrë të veçantë në industrinë e kromit, të mënjanohet kontradikta e krijuar midis punimeve minerare me atë të nxjerrjes së mineraleve dhe të krijohet kudo koncepti i drejtë se gjeologjia dhe punimet minerare në çdo

1 Në Plenumin e 7-të të KQ të PPSH u shkarkua nga të gjitha funksionet, u përjashtua nga Partia dhe më vonë u dënua për krimin e tradhtisë ndaj atdheut.

minierë duhet kurdoherë t'i paraprijnë prodhimit dhe të garantojnë plotësimin në mënyrë ritmike të detyrave të planit sot dhe në perspektivë. Kjo çështje është e nevojshme të vlerësohet drejt nga organizatat-bazë të Partisë dhe nga vetë punëtorët, nga komitetet e Partisë të rretheve përkatëse e në mënyrë të veçantë nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave, duke luftuar çdo tendencë njëanshmërie e me karakter të çastit në plotësimin e detyrave të planit. Po nuk u bë kjo, do të ekzistojë kurdoherë rreziku i të papriturave, të cilat duan kohë relativisht të gjatë dhe shpenzime suplementare për t'u kapërcyer, përveç pasojave e shpërpjesëtimeve që krijojnë në ekonominë popullore.

Përveç të tjerave, në arritjen e një objekti të tillë, një rol të rëndësishëm do të luajë mekanizimi i mëtejshëm i proceseve të punës në minierat, si edhe plotësimi në kohë i fuqisë punëtore dhe trajtimi më i mirë i saj.

Shkalla e ulët e mekanizimit në shumë miniera kërkon që të caktohen detyra dhe programe më konkrete nga ndërmarrjet minerare dhe nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave për mekanizimin e mjaft proceseve të punës që sot kryhen me dorë, jo vetëm duke siguruar makineritë dhe pajisjet e nevojshme nga jashtë, por sidomos me prodhimin në vend, në bazat e industrisë sonë mekanike, të shumë makinerive e pajisjeve të domosdoshme për rritjen e rendimentit në punë, për kursimin e fuqisë punëtore dhe për lehtësimin e kushteve të rënda të punës në minierat.

Në industrinë minerare gjithashtu prej kohësh qëndron i pa zgjidhur si duhet problemi i sigurimit të fuqisë punëtore. Kjo ka krijuar dhe krijon vështirësi të shumta në plotësimin e detyrave të planit. Byroja Politike edhe një herë tërheq vëmendjen e organeve të Partisë e të pushtetit në rrethe, veçanërisht në Dibër, Mat, Pukë, Tiranë, Librazhd e Pogradec dhe porosit që të marrin masa të shpejta e të plota për të siguruar, sipas planeve, fuqinë e nevojshme punëtore për minierat ekzistuese dhe për ato të reja, për të pakësuar sa më shumë fluktuacionin e fuqisë punëtore në minierat dhe për të përmirësuar më tej trajtimin e tyre.

Praktika e deritanishme e punës në minierat ka treguar se stabilizimi në punë i minatorëve, përmirësimi i kushteve të punës e të jetës së tyre, si dhe mekanizimi i vazhdueshëm i proceseve të punës luajnë rol vendimtar në arritjen dhe tejkalimin e rendimentit të punës, në rritjen e efektivitetit të prodhimit minerar, që mbetet një nga detyrat tona më të rëndësishme. Është për t'u lavdëruar iniciativa e kolektivit punonjës të minierës së hekur-nikelit në Çervenakë, ku drejton kandidati i Komitetit Qendror, shoku Llambi Gegprifti, që si kolektiv, duke u mbështetur në dijenitë dhe forcat e veta, duke përgatitur dhe duke vënë në shfrytëzim mekanizma të ndryshëm, ka rritur mjaft rendimentin e punës, ka siguruar një trajtim të mirë të punëtorëve,

një stabilizim të kënaqshëm të tyre dhe i ka vënë vetes detyrën që gjatë gjithë pesëvjeçarit të realizojë detyrat e planit pa shtesë në fuqinë punëtore dhe në fakt këtë zotim po e mban dhe po e vë në jetë me sukses. Nuk duhet pritur më nga minierat e tjera, si edhe nga vetë Ministria e Industrisë dhe e Minierave, që një përvojë e tillë me vlerë të përhapet dhe të përgjithësohet sa më parë kur të gjitha kushtet ekzistojnë, kur vetë kuadrot kryesorë të minierave, të ministrisë dhe të bashkimeve profesionale, në aktivin e organizuar për këtë qëllim në Çervenakë, panë dhe u bindën mbi mundësitë e zbatimit kudo të kësaj përvoje.

Duke e analizuar objektivisht dhe në mënyrë kritike gjendjen, duke u mbështetur në frymën e lartë revolucionare dhe në punën vetëmohuese që karakterizon të gjithë punonjësit e minierave tona, si edhe në mundësitë e mjetet materiale e teknike që ekzistojnë, Byroja Politike shpreh bindjen e plotë se situata e krijuar në disa nga minierat e vendit, sidomos vitin e kaluar, do të kapërcehet shpejt, të metat do të ndreqen dhe planet do të plotësohen ritmiksht dhe në të gjithë treguesit.

Disa probleme shqetësuese, sidomos për perspektivën, kanë lindur edhe në industrinë e naftës, megjithëse plani i këtyre dy vjetëve është plotësuar në tërësi. Detyra e rritjes së rezervave të naftës për vitin 1972 u realizua mjaft ulët. Kjo duhet t'i shqetësojë të gjithë punonjësit e naftës e në mënyrë të veçantë ata të kërkimit dhe shokun Pjetër Leka që nuk po drejton mirë sektorin e shpimit në naftë, sepse lidhet jo vetëm me uljen e efektivitetit në kërkimin e naftës por cenon ritmet e parashikuara të nxjerrjes së naftës në vitet e ardhshme të pesëvjeçarit.

Ministria e Industrisë dhe e Minierave, dhe në mënyrë të veçantë Drejtoria e Përgjithshme e Naftës, brenda një kohe sa më të shkurtër, është e nevojshme të marrë të gjitha masat për forcimin e punës kërkimore-shkencore dhe kryerjen e studimeve më të thelluara, më të plota dhe më me përgjegjësi në kërkimet e naftës, në mënyrë që përgatitja dhe dhënia për shpim e strukturave për naftë dhe gaz të jetë e një cilësie më të mirë. Ata duhet të rishikojnë e të thellojnë tematikën e studimeve të Institutit gjeologjik të naftës e të gazit dhe të vënë më mirë përpara përgjegjësinë punonjësit e këtij instituti për të ngritur në një nivel më të lartë cilësinë e punës së tyre dhe ndjenjën e përgjegjësisë. Në të njëjtën kohë mjaft të meta e dobësi, që akoma ekzistojnë në shpimin dhe sidomos në përvetësimin e puseve të naftës dhe të gazit, duhet të ndreqen brenda një kohe sa më të shkurtër, në mënyrë që detyrat e caktuara nga Kongresi i 6-të i Partisë për zbulimin e rezervave të naftës dhe të gazit të realizohen patjetër.

Rëndësi e veçantë t'u kushtohet shfrytëzimit racional të vendburimeve ekzistuese të naftës, zbatimit të disiplinës teknike e teknologjike në marrjen e naftës nga pusët dhe kthimit të metodave

ndihmëse në metoda të dorës së parë për nxjerrjen e naftës dhe rritjen e prodhimit. Më shumë përpjekje duhet të bëhen gjithashtu për njohjen e të rejave të shkencës dhe të teknikës botërore në këtë degë të rëndësishme, dhe për vënien e tyre në zbatim në sektorët e shpimit, të prodhimit dhe të përpunimit të naftës dhe të gazit në vendin tonë.

b) Të bëhet një kthesë rrënjësore në plotësimin e planit në asortimentet dhe cilësinë e planifikuar të prodhimeve, ndërtimeve dhe shërbimeve.

Zhvillimi harmonik i degëve të ndryshme të ekonomisë popullore nuk mund të kuptohet pa vendosjen e një disipline të fortë në plotësimin ritmik të planit të prodhimit industrial, të ndërtimeve e të shërbimeve, sipas asortimentit, objekteve dhe cilësisë së planifikuar. Nevojat në rritje të popullit dhe të ekonomisë nuk mund të plotësohen vetëm me shifrat globale, sepse kërkesat për asortimentet dhe cilësinë janë kurdoherë konkrete dhe të përcaktuara. Çdo shmangie nga ky kuptim i detyrave të prodhimit, sjell rezultate negative në marrëdhëniet midis ndërmarrjeve ekonomike, në furnizimin e popullit dhe në ekonomi. Komiteti Qendror i Partisë është ndalur edhe herë të tjera në këto probleme dhe direktivat janë të qarta. U rikthehemi përsëri këtyre çështjeve, sepse me gjithë përparimet e bëra, të metat dhe dobësitë në këtë fushë janë të shumta dhe kërkojnë marrjen e masave të reja, më rrënjësore për zhdukjen e tyre.

Karakteristikë e përgjithshme e ndërmarrjeve tona ekonomike, e organeve të Partisë e të pushtetit në bazë e në qendër, janë lufta dhe përpjekjet që bëhen për të plotësuar detyrat e planit në të gjitha drejtimet. Por, ndërsa ka një mobilizim më të mirë dhe bëhen përpjekje të gjithanshme për realizimin global të planit të prodhimit, të ndërtimeve e të shërbimeve, për realizimin e asortimenteve dhe për cilësinë, ky mobilizim nuk është në lartësinë e duhur.

Çfarë konkluzionesh mund të nxirren në këtë drejtim nga analiza e shifrave kryesore të realizimit të planit të vitit 1972? Ndërsa prodhimi i përgjithshëm industrial u plotësua 101 për qind, duke dhënë rreth 109 milionë lekë prodhime mbi planin, artikujt e planifikuar të nomenklaturës së përqendruar u plotësuan vetëm 64 për qind, ose nga 140 artikuj u realizuan plotësisht dhe u tejkaluuan vetëm 89. Në prodhimin bujqësor e blegtoral nuk është realizuar pothuajse asnjë nga zërat e planifikuar. Në sektorin e ndërtimit vetëm në 36 për qind të objekteve kryesore janë realizuar fondet e planifikuara. Plani i eksportit, sipas artikujve të planifikuar, u realizua plotësisht dhe u tejkalua vetëm në rreth 50 për qind të tyre.

Në rrethin e Fierit artikujt e planifikuar u plotësuan vetëm

në 60 për qind të tyre, në rrethin e Korçës e të Krujës në 63 për qind, në rrethin e Elbasanit 70 për qind, në atë të Beratit 71 për qind, në atë të Durrësit 72 për qind etj. Shifrat e mësipërme janë shumë kuptimplote dhe prej tyre nuk është e vështirë të nxirren pasojat e mosplotësimit të gjithë këtyre asortimenteve nga ana e shumë ndërmarrjeve ekonomike dhe kooperativave bujqësore. Ato kanë krijuar shqetësime serioze për ekonominë popullore, si në fushën e plotësimit të detyrimeve kontraktuale ndërmjet ndërmarrjeve ekonomike, ashtu edhe për plotësimin e nevojave të popullit me mallrat e konsumit të gjerë. Mungesat e herëpamëshme në treg për disa produkte bujqësore e industriale si mish, vezët, fasulet, disa lloj frutash e perimesh, prodhimet e sheqerit, pijet alkoolike, prodhimet e galanterisë, mobiljet, disa lloj pajisjesh shtëpiake e sidomos disa artikuj të imtë dhe shumë të imtë etj. kanë vështirësuar plotësimin e nevojave të përditshme të popullit.

Për të plotësuar boshllëqet e krijuara nga mosrealizimi i planit sipas asortimentit të planifikuar, shtetit i është dashur t'i kompensojë këto, nëpërmjet burimeve të tjera. Kjo duhet të na bëjë të mendojmë thellë, t'i vëmë gishtin plagës dhe të mos lejojmë gjatë këtij viti, dhe në të ardhmen, të meta të tilla të përsëritura.

Analiza e këtyre të metave vërteton se ato në përgjithësi kanë karakter subjektiv, ku mbizotëron kryesisht niveli i pakënaqshëm i organizimit dhe i drejtimit të prodhimit, qysh nga baza deri në qendër. Edhe në këtë drejtim ne duhet të udhëhiqemi nga shembulli pozitiv. Jeta na vërteton se me një luftë më këmbëngulëse, më të organizuar dhe duke krijuar kudo një botëkuptim më të drejtë për nevojën e realizimit të planit në asortimentet dhe cilësinë e planifikuar, rezultatet kanë qenë dhe janë më të mira. Kështu, në rrethin e Tiranës e të Shkodrës, plotësimi i asortimentit të planifikuar është mbi 80 për qind, përqindje kjo mbi mesataren si Republikë. Në ndërmarrje të veçanta ky tregues paraqitet edhe më mirë. Është për t'u lavdëruar puna e mirë e organizatës së Partisë dhe e kolektivit punonjës të kombinatit ushqimor «Ali Kelmendi» në Tiranë, Ndërmarrjes së Gomës Durrës, Ndërmarrjes së Qelqit Tiranë etj.. që e kanë realizuar asortimentin e planifikuar mbi 90 për qind, duke lënë pa plotësuar vetëm ndonjë artikull që nuk varet nga mundësitë dhe forcat e tyre. Në këtë mënyrë janë mundësitë që të punojnë edhe të gjitha ndërmarrjet e tjera të prodhimit, të ndërtimit dhe të shërbimit. Në punën e tyre të përditshme kurdoherë duhet të paraprijë lufta për të realizuar asortimentet e planifikuara, treguesit e tjerë të planit, objektet e caktuara në plan. E gjithë propaganda e prodhimit dhe emulacioni socialist, shkëmbimi i përvojës dhe garat, duhet të kenë këtë pikësynim kryesor dhe jo globalin, i

cili mbetet gjithnjë një tregues llogaritës dhe prapa të cilit fshihen shumë të meta, mosrealizime dhe shpeshherë jepen edhe vlerësime të gabuara.

Një punë akoma më e kujdesshme duhet bërë gjithashtu në drejtim të përmirësimit të cilësisë së prodhimit, sepse akoma shumë mallra dhe artikuj të ndryshëm prodhohen me cilësi jo të mirë. Dërgohet në Laç dhe në Durrës mineral kromi me përzierje gurësh dhe pluhur mbi normën e lejuar; prodhohet gymyrguri me fuqi kalorifike më të ulët, shpeshherë me baltë dhe gurë; cilësia e pjesëve të këmbimit të industrisë mekanike është akoma e dobët; cilësia e riparimit të automjeteve është e ulët dhe pengon planin e qarkullimit të mallrave. Të meta dhe dobësi serioze vërehen edhe në cilësinë e ndërtimeve dhe në shërbimet për popullin.

Gjithashtu cilësia e disa mallrave të konsumit të gjerë lë shumë për të dëshiruar. Prodhimi i një sasive të madhe këpucësh që rrinë stoqe në depot e tregtisë, prodhimi i dobët i konfeksioneve, artikujve metalikë, shitja në popull e perimeve e frutave të paselksionuara dhe me cilësi jo të mirë dhe në përgjithësi prodhimi dhe shërbimi akoma i dobët i popullit në hotelet dhe lokalet e shërbimit social dhe në dyqanet e tregtisë, janë probleme shqetësuese për Partinë, Qeverinë dhe popullin. Reklamime dhe kërkesa ka gjithashtu për mallrat që eksportohen, sidomos për cilësinë e kromit, të hekur-nikelit, për cilësinë e dobët të batanijeve dhe në përgjithësi të tekstileve, konfeksioneve etj., të cilat nga cilësia e parë vlerësohen shpeshherë si cilësi e dytë etj.

Të metat dhe dobësitë në fushën e cilësisë së prodhimit, të ndërtimit dhe të shërbimit kanë gjithashtu karakter subjektiv. Shpeshherë drejtuesit e ndërmarrjeve të ndryshme, përpara vështrirësive të shumta që u dalin sidomos në lëmin e furnizimit material e teknik, në vend që të shtojnë luftën e përpjekjet për kapërcimin e tyre dhe të realizojnë patjetër cilësinë e planifikuar, gjejnë si rrugë më të shkurtër shkeljen e disiplinës teknike e teknologjike dhe prishjen e cilësisë vetëm për të qenë në rregull me sasinë dhe globalin.

Të metat dhe dobësitë në drejtim të cilësisë së prodhimit, të ndërtimit e të shërbimit e kanë burimin gjithashtu tek organizimi i dobët i kontrollit të cilësisë, si edhe te puna e pamjaftueshme politike dhe ideologjike sqaruese që bëjnë organizatat-bazë të Partisë dhe komitetet e Partisë, për të krijuar te punonjësit e kuadrot koncepte më të shëndosha mbi punën me cilësi të lartë, për të edukuar tek ata ndjenjën e punës së kualifikuar e të pastër, në çdo hap të procesit teknologjik.

Prandaj ka ardhur koha që ky problem të merret plotësisht në dorë nga organet e pushtetit, të ekonomisë dhe nga organizatat e masave, të cilat nën drejtimin e organizatave-bazë të Partisë është e domosdoshme të realizojnë një kthesë rrënjësore në fushën

e cilësisë, duke ngritur peshë të gjithë opinionin shoqëror në çdo kolektiv punonjës.

Detyrat e mëdha që shtrohen për përmirësimin e cilësisë nuk mund të zgjidhen me sukses pa ngritur gjithashtu nivelin tekniko-profesional të punonjësve. Këtë e kërkon vetë rritja e nivelit të bazës materialo-teknike të prodhimit, vënia në shfrytëzim e makinerive e pajisjeve moderne, të cilat pa punonjës të kualifikuar nuk mund të japin prodhime me cilësi të lartë.

Stadi i arritur në zhvillimin ekonomik-shoqëror të vendit, baza teknike e krijuar dhe kërkesat në rritje të popullit për mallra të cilësisë së mirë, shtrojnë përpara nesh detyra imediate për të ndërmarrë masa të shpejta në fushën e përmirësimit të cilësisë, për të çrrënjësuar një herë e mirë konceptet artizanale të prodhimit të vogël, tendencën e globalizmit dhe të kënaqurit me rezultatet që kemi arritur deri sot. Është e domosdoshme t'u jepet fund qëndrimeve liberale dhe pa përgjegjësi në këtë drejtim, duke vendosur rregull e disiplinë më të fortë në çdo hallkë të procesit teknologjik, dhe të ngrihet në një nivel më të lartë kontrolli shtetëror dhe punëtor, i organizuar dhe i përditshëm, për të vënë përpara përgjegjësisë cilindo që prodhon, ose lejon nxjerrjen e mallrave dhe kryerjen e ndërtimeve dhe të shërbimeve me cilësi të keqe.

2. DREJTIMET KRYESORE KU DUHET PËRQENDRUAR VËMENDJA PËR REALIZIMIN E DETYRAVE TË PLANIT NË BUJQËSI

Duke vlerësuar drejt vendin që zë bujqësia në ekonominë tonë popullore, Komiteti Qendror i Partisë ka porositur vazhdimisht që të tregohet një kujdes i posaçëm për zhvillimin e saj me ritme më të shpejta.

Nuk ka dyshim se në këtë drejtim janë bërë përparime të mëdha dhe bujqësia jonë e ka shtuar prodhimin nga viti në vit, sidomos në drithërat e bukës. Megjithëkëtë, planet e prodhimit bujqësor për vitet 1971-1972 nuk janë plotësuar as në tërësi e as në zëra e rrethe të veçanta. Në mënyrë të posaçme duhet të theksojmë deficitet e mëdha në drithërat e bukës, ndonëse vjet u prodhuan 34 mijë tonë më shumë se më 1971.

Rrethet Korçë, Shkodër, Lushnjë, Elbasan, Berat dhe Dibër krijojnë deficitin më të madh. Por edhe Saranda, Përmeti, Tepele-na e disa rrethe të tjera, ndonëse kanë një peshë më të vogël në prodhimin e përgjithshëm, përsëri kanë krijuar deficite tepër të ndjeshme, sepse planin e drithërave e realizuan më pak se 70 për qind.

Për këtë gjendje kemi përgjegjësi të gjithë, por në radhë të

parë duhet të përgjigjet Ministria e Bujqësisë, me Pirro Dodbibën¹ në krye, që nuk ka marrë me kohë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar patjetër realizimin e planit. Në të njëjtën kohë përgjegjësi të veçantë kanë komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve përkatëse, të cilat, duke mos zbatuar deri në fund detyrat e shtruara nga Kongresi i 6-të dhe Letra e Komitetit Qendror (8 janar 1971) për bujqësinë, krijuan deficite të mëdha që e rënduan shumë ekonominë e vendit. Për të gjitha këto, anëtarët e Komitetit Qendror të Partisë, sekretarë të parë të rretheve, ku nuk u plotësuan planet e bujqësisë, duhet të nxjerrin konkluzionet përkatëse.

Ne nuk mund të mos marrim parasysh faktin që prodhimi bujqësor ndikohet edhe nga kushtet e motit, sepse akoma varem shpesh prej tyre. Por kjo nuk i shpjegon në asnjë mënyrë deficitet e mëdha që kemi në bujqësi. Faktet tregojnë se edhe më 1972 disa rrethe i plotësuan më mirë detyrat e planit në drithërat e bukës dhe në treguesit e tjerë. Për këtë flet në mënyrën më bindëse shembulli i kooperativave, i ndërmarrjeve bujqësore dhe i brigadave të përparuara, të cilat, në kushte të ngjashme me ato që krijuan deficite, realizuan më mirë planin e drithërave dhe dolën faqebardhë. E njëjta gjë mund të thuhet për orizin, patatet, fasulet, luledielliin, mishin e vezët, ku gjithashtu u krijuan deficite mjaft të ndjeshme.

Po atëherë përse nuk u realizua plani i prodhimeve bujqësore?

Kësaj pyetjeje iu dha një përgjigje e argumentuar në Plenumin e 2-të të Komitetit Qendror (qershor 1972) kur shqyrtuam eksperiencën e përparuar në bujqësi². Mbi bazën e analizës shkencore të fakteve, në atë mbledhje të Komitetit Qendror u treguan qartë se ku qëndrojnë të metat e punës së organizatave të Partisë e të organeve shtetërore; u caktuan njëkohësisht edhe detyrat tona për njohjen, studimin dhe përhapjen e gjithanshme të eksperiencës së përparuar.

Vërtet që atëherë e deri sot kanë kaluar vetëm 7 muaj, por edhe kjo kohë ishte e mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione e për të zbatuar detyrat më të hollësishme që caktuan vetë rrethet, në analizat që bënë lidhur me detyrat e Plenumit të 2-të të Komitetit Qendror. Edhe para mbledhjes së Plenumit të 2-të Komiteti Qendror i kishte zbuluar shkaqet e vërteta të mosrealizimit

¹ Ish-kandidat i Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe ministër i Bujqësisë. Plenumi i 9-të i KQ të PPSH datë 19 korrik 1976 e përjashtoi nga Komiteti Qendror dhe e shkarkoi si ministër për dobësi të theksuara në dikasterin e Ministrisë së Bujqësisë dhe veçanërisht për dëmet e mëdha që i shkaktoi ekonomisë sonë, duke vepruar në kundërshtim me vijën, vendimet dhe orientimet e Partisë.

² Shih në këtë vëllim, f. 240.

mit të planeve në bujqësi, në letrën e posaçme të 8 janarit 1971 drejtuar organizatave të Partisë dhe gjithë punonjësve, ku me analizë e detyra shumë të qarta u bëhej thirrje punonjësve të bujqësisë dhe kadrove të Partisë e të pushtetit për të marrë një sërë masash konkrete, zbatimimi i të cilave kishte rëndësi vendimtare. Mirëpo këto detyra, në shumë raste, nuk janë zbatuar, sepse nuk janë kuptuar deri në fund siç duhet, as nga disa komitete partie.

Nuk mund të thuhet se nuk është bërë gjë për zbatimin e detyrave të shtruara nga Komiteti Qendror, sepse ndryshe në kushtet e vështira të motit, që kemi pasur herë pas herë, e në mënyrë të veçantë vitin e kaluar, ne do të ishim ndodhur para katastrofave të vërteta, por jo të gjithë u mobilizuan për kapërcimin e vështirësive. Është fakt se ne kemi akoma të meta serioze në organizimin dhe drejtimin e prodhimit bujqësor; në shumë rrethe, kooperativa e ndërmarrje, bëhet punë formale për zëritimin e detyrave lidhur me vendosjen e prodhimit bujqësor mbi baza shkencore. Këto gjëra nuk mund të lejohen. Vendimet e Partisë për bujqësinë duhet të kuptohen drejt e të zbatohen deri në fund në radhë të parë nga komunistët, sepse nga puna e tyre dhe mobilizimi i masave varet fati i prodhimit. Nga ana tjetër, edhe organet shtetërore duhet t'i përgjigjen më mirë bujqësisë, jo vetëm duke i plotësuar me përpikëri detyrat e planit ndaj saj, por duke bërë edhe çdo gjë tjetër të mundur për ta ndihmuar sa më shumë bujqësinë, që në të vërtetë ka vështirësi të shumta e të ndryshme.

Partia e ka theksuar shpeshherë nevojën që direktivat të kuptohen sa më thellë politikisht dhe ideologjikisht, kurdoherë në lidhje të ngushtë me situatat që jetojmë. Mirëpo nuk veprohet kurdoherë kështu, prandaj ngjasin edhe gjëra të papëlqyeshme, bile shumë të dëmshme. Kështu, për shembull, në vitin 1971, për t'iu afruar sa më shumë planit të shitjes së drithërave, në ndonjë rreth pati edhe kooperativa ku u prek dhe kontingjenti i bukës për anëtarët, për të cilët u desh më vonë të bëhej furnizim nga shteti, pa folur më për bazën ushqimore të blektorisë. Komiteti Qendror dhe Qeveria i kritikuan rëndë këto veprime, mirëpo në vend që të nxirreshin mësimet e dhura, sivjet në disa raste u kalua në anën e kundërt. Kështu, shumica e rretheve, pa menduar pothuajse fare se si do të përballonë deficitin e bujqësisë, konsumuan drithë ose e mbajtën atë për vete sikur çdo gjë të ishte zhvilluar normalisht, ndërsa shitjet për shtetin ranë nën nivelin e vitit 1971.

Veprime të tilla janë të palejueshme, sepse është e qartë që në kushtet tona, sidomos kur plani i prodhimit nuk realizohet, duhet të tregohemi të kujdesshëm e nikoqirë të mirë në konsumin e drithërave dhe me çdo prodhim tjetër. Pa prekur aspak nevojat e domosdoshme për bukën dhe zahirenë e fshatarëve, këto duhen llogaritur drejt, sepse nuk mund të lejohet që në furrat e shumë kooperativave të merrret një rreze e bukës 10-20 për

qind më e ulët sesa në furrat shtetërore. Nuk mund të lejohet gjithashtu që misri të përdoret në vend të foragjereve të njoma apo të ushqimeve të ashpra, siç ndodh në shumë kooperativa e ndërmarrje bujqësore. Për të gjitha këto Partia e Qeveria janë mjaft të shqetësuara sepse shohin që në disa rrethe nuk ka një kuptim e qëndrim të drejtë ndaj drithërave të bukës, që janë një problem shumë i madh për ne.

Për vitin 1973 para punonjësve të bujqësisë shtrohen detyra të mëdha e të vështira, në përqindje të atilla të larta, që nuk janë realizuar asnjëherë tjetër më parë. Mjafton të themi se prodhimi i përgjithshëm bujqësor, ndaj realizimit të vitit 1972, duhet të rritet mbi 23 për qind, nga i cili drithërat e bukës 27 për qind, pambuku 45 për qind, orizi 64 për qind, luledielli 100 për qind, qumshti 17 për qind, mishi 33 për qind, vezët 55 për qind.

Vendi ynë, jo vetëm ka nevojë absolute për realizimin e detyrave që shtrohen, por ai ka dhe kushtet për këtë qëllim. Këtë e vërtetojnë eksperiencia dhe rezultatet e arritura nga brigadat, kooperativat dhe ndërmarrjet bujqësore të përparuara, të cilat, në kushte të ngjashme tokësore dhe klimaterike, me të njëjtat forca e mjete, kanë arritur e tejkaluar treguesit që kërkon plani i vitit 1973. Për më tepër duhet thënë se sivjet bujqësia do të ketë një bazë materialo-teknike e furnizim më të mirë se në të kaluarën. Përveç kësaj, përfundimi i matjes së tokave dhe hartimi i planimeve për çdo kooperativë e ndërmarrje bujqësore, krahas studimit pedologjik dhe agrokimik të tokave, kanë krijuar kushte të reja më të mira për të organizuar prodhimin mbi baza shkencore. Më mirë se asnjëherë tjetër plani i bujqësisë sivjet është i mbështetur mbi gjendjen reale të fondit të tokës e të krerëve të blegtorisë, duke mbajtur parasysh edhe shtesat që janë parashikuar për vitin 1973. Detyra është që faktorët, kushtet dhe mundësitë që janë krijuar të njihen, të përdoren drejt e në mënyrë sa më të plotë.

Në këtë drejtim, një punë të mirë bëri muajt e fundit Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës, duke vënë në lëvizje masat e punonjësve dhe specialistët, mbështetur në mendimin krijues të tyre, për përgjithësimin e eksperiencës së përparuar.

E theksojmë këtë se në disa rrethe dhe në shumë ekonomi nuk u bënë ballafaqimet, siç porositi Plenumi i 2-të i Komitetit Qendror dhe nuk u punua me seriozitetin e duhur për hartimin e projektplanit të vitit 1973. Prandaj, nga mjaft rrethe ai u paraqit me ulje të ndjeshme ndaj kuotave të prodhimit që kërkon pesëvjeçari, kurse studimet e bëra më parë për këtë qëllim, në disa raste, u lanë krejt pas dore.

Duhet të vëmë në dukje gjithashtu se, me gjithë orientimet e dhëna nga KQ e Qeveria, përsëri sivjet shumë kooperativa e rrethe propozuan të ulet edhe plani i tokave të reja nën kuotat e pesëvjeçarit. Një gjë e tillë është e papranueshme dhe pa baza.

Komiteti Qendror nuk mund të pajtohet me justifikimet se gjoja nuk ka toka të reja për t'u hapur, apo se nuk kemi forca për to. Kjo nuk i përgjigjet realitetit, prandaj planet tona duhet të realizohen medoemos nga të gjithë. Organizatat-bazë dhe komitetet e Partisë nuk duhet të tërhiqen para vështirësive, por t'i përvishen seriozisht punës, në mënyrë të organizuar dhe me aksione masive ta realizojnë planin e tokave të reja brenda tremujorit të parë.

Viti bujqësor 1973 ka filluar që me mbjelljet e vjeshtës, dhe, me gjithë kushtet e vështira, plani i sipërfaqeve të grurit si Republikë u realizua. Puna e mirë që është bërë për përmirësimin e strukturës varietore dhe për një renditje më të drejtë të kulturës së grurit, tani duhet të shoqërohet medoemos me shërbimet kulturore në një nivel më të lartë. Në radhë të parë është e domosdoshme të sigurohet një kullim sa më i përsosur i ngastrave dhe pastaj të jepen sa më të plota dozat e plehut organik e kimik.

Ne duhet të ngremë në një nivel më të lartë luftën për të realizuar me çdo kusht rendimentet e planifikuar të grurit. Nuk i lejohet askujt të mos zbatojë masat e njohura e të përcaktuara, duke shkuar me shpresë se po nuk u realizua plani i grurit, do ta plotësojë këtë me misër dhe, po nuk u realizua as ky, kemi rezervë misrin hamullor. Planin e drithërave garantohej, kur realizohet si gruri ashtu edhe misri.

Me përjashtime të vogla, plani i drithërave të bukës sivjet nuk u realizua, kryesisht nga rendimentet e ulëta që u morën nga misri. Dhe kjo ndodh në një kohë kur ne kemi bërë investime të mëdha për rritjen e sipërfaqes së vaditshme, futjen e misrave hibride, shtimin e plehrave kimike, të mekanizmave etj.

Si mund të pranojmë që, në vitin 1972, rrethet Lushnjë, Fier, Durrës e Dibër të marrin nga 20-25 kv për ha misër, në një kohë që nga kooperativat, dhe sidomos nga brigadat e përparuara, qoftë edhe brenda këtyre rrethëve merren rendimente 50-100 për qind më të larta?

Nuk mund të justifikohet asnjë, gjoja me kushtet e veçanta, kur krahason mesataren e rrethit përkatës me ndërmarrjen bujqësore të Sukthit, apo me kooperativat e Shijakut, Mashkullorës, Ndroqit etj., të cilat në sipërfaqe të gjera morën më shumë se 50 kv për ha. Shumë brigada në kooperativën e Cakranit kanë marrë mbi 70 kv për ha misër, ndërsa dhjetëra brigada të tjera në të gjitha rrethet kanë marrë nga 50-70 kv për ha. Mos vallë për këto pati kushte klimaterike të veçanta? Jo, por këta kolektiva luftuan me këmbëngulje vështirësitë e krijuara dhe fituan.

Në kushtet e kooperativave, ndërmarrjeve dhe brigadave të përparuara, që përmendëm më lart, përfshihet gati i gjithë territori i Republikës, por jo kudo punohet me të njëjtat përfundime. Ne nuk do t'i analizojmë këtu faktorët që përcaktojnë marrjen e rendimenteve të larta në misër, apo në grurë, sepse këtë gjë e bëmë

në Plenumin e 2-të, por duam të tërheqim vëmendjen në faktin se për detyrat e shtruara nuk po punohet kudo siç duhet.

Të gjithëve na kujtohet se vitet e fundit me gjendjen e krijuar në kulturën e pambukut dukej sikur ishim pa rrugëdalje për shtimin e prodhimit. Konceptet konservatore, justifikimet me gjoja «kushtet objektive» ua kishin errësuar perspektivën mjaft specialistëve dhe disa shokëve drejtues të rretheve dhe vetë Ministrisë së Bujqësisë. Mirëpo, kur çështja u kuptua drejt, kur masat u mobilizuan dhe Partia u vu në krye për të zbatuar siç duhet eksperiencën e përparuar, brenda një viti u realizua një kthesë e madhe: më 1972 prodhimi i pambukut u rrit 50 për qind më shumë se në vitin 1971. U dallua rrethi i Durrësit, që iu afrua më shumë realizimit të planit, e sidomos rrethi i Vlorës, që e plotësoi 100 për qind planin e prodhimit e të dorëzimit. Në të gjithë vendin 12 kooperativa e realizuan planin në tërësi, ndërsa nga 840 brigada që mbjellin pambuk, 66 prej tyre morën mbi 15 kv për ha pambuk dhe 259 brigada të tjera realizuan nga 10-15 kv për ha.

Eksperiencia e fituar në kulturën e pambukut provoi edhe një herë se edhe në kushte të vështira të kohës, siç qenë ato të vitit 1972, plani mund të realizohet me sukses, kur punohet me disiplinë teknike, me organizim të shëndoshë e mbi të gjitha me bindje e qartësi të plotë politike.

Ajo që u bë vjet me pambukun, apo vitet e fundit me grurin, duhet të çohet edhe më përpara, me të gjitha kulturat e sidomos me misrin, me qëllim që të mos na shkaktohen më vështirësi në bilancet tona. Në mënyrë të veçantë duhet të merremi shumë më mirë se deri tani edhe me kulturën e orizit, fasuleve e patateve, sepse për to ka paqartësi, mungesë besimi e neglizhenca tepër të dëmshme. Pikërisht këtu qëndrojnë dhe arsyet që në shumë rrethe, kooperativa e ndërmarrje bujqësore planet e kulturave të lartpërmendura nuk realizohen nga viti në vit.

Detyra të mëdha dalin gjithashtu për zhvillimin e blegtorisë, ku kemi prapambetje në krahasim me bujqësinë dhe me nevojat e furnizimit të popullit me mish e vezë. Përveç dobësive organizative-teknike, në këtë drejtim ka ndikuar dhe ndikon puna e pamjaftueshme për fuqizimin e bazës ushqimore. Rrrethet e Lushnjës, Beratit, Shkodrës, Fierit, Tropojës e Mirditës, nevojat e ushqimit të bagëtive i kanë plotësuar vetëm në masën 70 për qind ose dhe më pak. Shumë keq paraqitet gjendja e bagëtive të imëta në rrrethet e Kukësit e të Dibrës, ku, nga mosrealizimi i detyrave për sigurimin e bazës ushqimore, është krijuar një gjendje shumë e vështirë për dimërimin e tyre, me pasoja të rënda për prodhimin e vitit të ardhshëm. Këtyre qëndrimeve duhet t'u jepet fund sa më parë. Rrugët për vënien e blegtorisë mbi baza të drejta janë përcaktuar dhe kudo janë krijuar kushtet e nevojshme për sigurimin e bazës ushqimore, krijimin e qendrave

të majmërisë dhe rritjen e peshës së bagëtive në kohën e dorëzimit.

Shqetësues është gjithashtu problemi i yndyrnave, ku gjatë vitit 1972 kemi pasur deficite të ndjeshme. Sipas planit, pjesën kryesore të tyre duhet ta sigurojmë nga lulja e diellit, por gjendja në këtë drejtim, deri më sot, nuk është e mirë. Nuk paraqitemi mirë edhe me prodhimtarinë e ullinjve, megjithëse me numrin e rrënjëve që kemi mund dhe duhet të sigurojmë një prodhim shumë më të madh e më të qëndrueshëm. Kjo vjen, sepse shërbimet e ullinjve janë lënë në dorë të fundit. Porosia e Partisë është që për çdo rrënjë ulliri në prodhim të planifikohen dhe të bëhen dy ditë-punë, ndërsa gjatë viteve 1970-1971, në Berat, Fier, Elbasan, Durrës, Tiranë e Krujë janë bërë afërsisht 0.2 deri 0.6 ditë-punë. Në këto kushte, ulliri nuk ka se si të prodhojë. Prandaj qysh tani ne duhet të fillojmë kudo aksione masive, për përmirësimin rrënjësor të gjendjes së ullinjve, në mënyrë që kultivimi i tyre të drejtohet sistematikisht, në bazë të një programi të detajuar. Sasia e plehut kimik që u është dhënë gjithë rretheve posaçërisht për ullinjtë, duhet të përdoret medoemos për këtë qëllim.

Shokë,

Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria kanë theksuar shpeshherë domosdoshmërinë e sistemimit të tokave bujqësore, si në fushë ashtu edhe në malësi. Shkenca dhe përvoja e përparuar në vendin tonë kanë provuar në mënyrën më bindëse se asnjë masë agroteknike nuk mund të japë efektin e saj të plotë, në rast se toka nuk është e sistemuar, domethënë e niveluar në sipërfaqe dhe e kulluar, ku rrjedhja e ujit të jetë e disiplinuar dhe ku të gjitha punimet bujqësore të bëhen në drejtime të caktuara.

Që në vitet e para pas Çlirimit, megjithëse mundësitë tona ekonomike ishin të kufizuara, ne nuk kemi kursyer asgjë për bonifikimet e mëdha, që përfshijnë fushat më të rëndësishme të vendit. Nga viti në vit këto punime morën përpjesëtime shumë të gjera. E njëjta gjë duhet thënë për sistemimet e mëdha e të vogla të ujitjes, që vitet e fundit u zgjeruan me përparësi edhe në zonat malore.

Nuk ka dyshim që ky ka qenë një orientim shumë i drejtë dhe me rëndësi vendimtare për zhvillimin e bujqësisë sonë. Mirëpo në këtë çështje Byroja Politike mendon të tërhiqet vëmendja për tri gjëra kryesore:

Së pari, për çështjen e mirëmbajtjes dhe plotësimit të veprave të kullimit e të ujitjes, sidomos të rrjetit të brendshëm në kooperativat dhe ndërmarrjet bujqësore. Me gjithë përparimet që

janë bërë, kjo detyrë nuk është marrë mirë në dorë nga komitetet ekzekutive dhe nga vetë ekonomitë bujqësore. Ndërsa gjendja e kanaleve kryesore, që pastrohen me mekanizma nga drejtoritë e ujërave, përmirësohet vazhdimisht (dhe gjatë vitit 1973 do të rregullohet përfundimisht), kanalet e dyta e të treta, që duhet të pastrohen me krahë nga vetë kooperativat dhe ndërmarrjet bujqësore, kanë mungesa të mëdha.

Dihet se kjo punë është e vështirë, por, kur merret mirë në dorë, mund të kryhet me sukses. Këtë e vërtetoi shembulli i Sarandës, i Lezhës e i Fierit, që dy vjetët e parafundit bënë nga 500-800 mijë metra kub lëvizje dheu, gjë që dha fryte të menjëhershme në rritjen e rendimentit. Kur vitin e kaluar Fieri e la përsëri këtë punë pas dore dhe realizoi vetëm 60 për qind të planit për pastrimin e rrjetit të kanaleve nga ekonomitë bujqësore, pati përfundime jo të mira në prodhimet bujqësore, patjetër si rrjedhim edhe i kësaj.

Gjatë dy vjetëve të fundit kooperativat e ndërmarrjet bujqësore janë çliruar nga detyra për të pastruar me krahë disa prej kanaleve më të vështira, sepse këtë punë po e bëjnë drejtoritë e ujërave. Por kjo nuk duhet në asnjë mënyrë të bëhet shkak që ekonomitë të rrinë në pritmëri e të kërkojnë që çdo gjë t'ua bëjë shteti. Përkundrazi, ato duhet të shumëfishojnë përpjekjet që të mbajnë në gjendje sa më të përsosur gjithë kanalet e dyta e të treta, si dhe sistemet ujitëse, që ato të shfrytëzohen me aftësi të plotë. Përveç kësaj është e nevojshme të tërhiqet vëmendja e tyre edhe për një sërë masash të posaçme që synojnë në zvogëlimin e mbushjes së kanaleve kulluese, si dhe në plotësimin e veprave të artit të kalimeve mbi kanale.

Së dyti, duhet të kujdesemi më shumë për veprat e mëdha të bonifikimit që kemi kryer, sepse edhe këto kanë probleme që duhen parë. Në përgjithësi, në shumicën e rasteve, në tokat e bonifikuara janë arritur dhe tejkaluar rendimentet e parashikuara nga projektet përkatëse, me përjashtim të zonave të krijuara si Durrësi e Hoxhara. Mirëpo, ndërsa një pjesë e tyre i plotësojnë kushtet e nevojshme për rritjen e mëtejshme të rendimenteve, një pjesë tjetër ka nevojë për plotësime e përmirësime. Në mënyrë të veçantë duhen riparë bonifikimet e zonave të ulëta, ku mungojnë veprat e artit, ku kullimi bëhet me vështirësi, ku zonat e ekspansionit janë të gjera, ku ka përmblytje dhe aftësia përcjellëse e kanaleve apo hidrovoreve nuk është llogaritur për sasinë e reshjeve që vërtetohen. Duhet studiuar gjithashtu fushat ku nuk është shtrirë bonifikimi dhe për të gjitha këto të caktohen masa konkrete, si për punimet që do të kryhen nga shteti ashtu edhe për ato që do të bëhen nga vetë ekonomitë bujqësore.

Së treti, një rëndësi të veçantë merr sidomos çështja e sis-

temimit të tokave, për të cilën është folur shumë, por në të vërtetë jemi akoma larg asaj që kjo detyrë të futet në rrugën e zgjidhjes. Dhe nuk ka si të zbatohet sistemimi e as mirëmbajtja e veprave të bonifikimit e të kullimit, kur në shumë raste agromomë e kooperativave, nuk kanë në duar e nuk njohin projektet e hartuara më parë, pa folur më për atë që nuk kanë studiuar e hartuar projektet e sistemimit të tokave. Nuk mjafton që vetëm të flitet për këto gjëra, as nuk mund të punohet pa objektiva konkretë dhe aq më tepër nuk mund të lejohet më që sistemimet të shtyhen nga viti në vit.

Rrethi i Durrësit ka zona të gjera të bonifikuara e të vaditura, ka kuadro dhe eksperiencë të mirë për shumë gjëra. Por megjithëkëtë për sistemimin e tokave nuk kishte shumë qartësi se çfarë duhej bërë, prandaj çështja i ishte lënë më shumë spontaneitetit. Kur, në zbatim të detyrave të Kongresit të 6-të, çështja u mor mirë në duar nga komiteti ekzekutiv dhe Ministria e Bujqësisë, u përpunuan dhe u zgjidhën problemet kryesore të sistemimit. Nga një studim i bërë në kooperativën e Shijakut për këtë qëllim, u fitua një eksperiencë shumë e vlefshme. Doli se «kushtet teknike» mbi hartimin e projekteve për sistemimin e tokave bujqësore, që u janë dërguar gjithë rretheve nga Ministria e Bujqësisë, janë plotësisht të mundshme për t'u zbatuar nga çdo kooperativë dhe ndërmarrje bujqësore. Kështu, deri më 28 shkurt, në Durrës, çdo kooperativë do të ketë përfunduar projektin e sistemimit për gjithë sipërfaqen fushore dhe për afro 4000 ha të zonës kodrinore.

Kjo është një punë shumë e mirë që duhet shpënë deri në fund nga gjithë rrethet pa përjashtim. Për këtë qëllim, nën drejtimin e Ministrisë së Bujqësisë, është e nevojshme të ndërmerret një aksion i madh e i organizuar mirë, në mënyrë që brenda vitit 1973, në shumicën e kooperativave dhe në të gjitha ndërmarrjet bujqësore, të përpilohen projektet e sistemimit. Paralel me këtë të fillojë puna për zbatimin e detyrave të sistemimit e të mirëmbajtjes, në bazë të planeve-grafikë që duhen hartuar, në përputhje me nevojat dhe mundësitë e vetë rretheve.

Në këtë mënyrë, çdo kooperativë dhe ndërmarrje bujqësore, krahas me hartat kadastrale, pedologjike-agrokimike, do të ketë edhe hartën me të dhënat për sistemimin e tokave, në të cilën për çdo ngastër duhet të shënohen gjendja ekzistuese, bashkë me detyrat për pastrimin e kanaleve kulluese dhe vaditëse, drejtimi i pjerrësisë dhe i punimeve, mënyra e ndërtimit të tokës etj. Eksperienca tregon se me mobilizimin e specialistëve të ekonomive bujqësore, nën drejtimin teknik të drejtorive të ujërave, këto punë, duke përfshirë edhe piketimin, mund të kryhen me forcat e veta.

T'i futemi, pra, kësaj pune me të gjitha forcat dhe ta kuro-

rëzohet atë me sukses, sepse kështu do të krijojmë një ndër kushtet kryesore nga varet fati i prodhimit bujqësor.

Më në fund, e shohim të nevojshme të ngremë edhe një çështje tjetër, që gjithashtu lidhet me zbatimin e detyrave të letrës së Komitetit Qendror për shndërrimin e kooperativave në ekonomi moderne. Në vazhdim të masave që janë marrë në këtë drejtim, **ne duhet të shpiem edhe më përpara punën e filluar për përqendrimin dhe specializimin e prodhimit bujqësor.**

Pas Letrës së Komitetit Qendror për bujqësinë, në shumë rrethe dhe në shumë kooperativa bujqësore ka filluar të bëhet një punë më e mirë, lidhur me përqendrimin dhe specializimin e kulturave, duke vendosur më drejt kulturat në brigada, duke luftuar mozaikun e tyre. Më mirë po përqendrohen kulturat dhe po specializohen ato. Aty ku kjo punë është kryer mirë, janë dukur edhe rezultatet e para. Edhe rrethet, në bazë të studimeve, kanë bërë lëvizjet e para të kulturave drejt përqendrimit dhe specializimit. Natyrisht ky është vetëm fillimi, ka akoma vend për një thellim të mëtejshëm dhe të shkallëzuar, me qëllim që nga këto veprime të kemi një rritje të prodhimit.

Studimi i kryer nga një grup specialistësh në kooperativën bujqësore të Plasës në rrethin e Korçës, për një shfrytëzim më të mirë të kësaj ekonomie bujqësore, nxori në dukje se ka akoma shumë punë për t'u bërë në këtë drejtim dhe detyrat e filluara duhet t'i shpiem gjer në fund me besim dhe optimizëm. Kjo do të jetë një bazë e mirë për shtimin e prodhimit bujqësor me ritme më të shpejta.

Është e nevojshme, pra, që rrethet t'i studiojnë më thellë këto probleme dhe brenda ekonomive, në radhë të parë, e brenda rrethit të gjejnë përqendrimin dhe specializimin më të përshtatshëm të kulturave që kanë në plan për të mbjellë.

Me kujdes të veçantë dhe kurdoherë në bazë të kushteve tona e të kulturave që i duhen ekonomisë, Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me rrethet lipset të vënë më drejt çështjet e renditjeve dhe të qarkullimit të kulturave bujqësore, gjë që duhet të sjellë një rritje të mëtejshme të prodhimit, duke kryer veprimet në këto drejtime në mënyrë të bazuar dhe shkencore. Të kihet gjithmonë parasysh se askujt nuk i lejohet që, nën pretekstin e qarkullimit apo renditjes së kulturave të bëjë ndryshimin e planeve të caktuara duke i ulur ato.

Siç e shohim, detyrat në lëmin e bujqësisë janë të mëdha e të vështira, por ato janë reale. Prandaj të ecim me guxim në rrugën e shënuar nga Partia dhe me besim në fitore të zbatohet deri në fund programet e hartuara për këtë qëllim. Kështu, ne do të mundemi ta nxjerrim bujqësinë nga gjendja ku është e të

garantojmë realizimin e planeve të aprovuara që kanë një rëndësi aq të madhe për gjithë ekonominë në përgjithësi dhe për furnizimin e popullit në veçanti.

3. FORCIMI I DISIPLINËS NË LIDHJEN DHE ZBATIMIN E KONTRATAVE PËR FURNIZIMIN MATERIALO-TEKNIK DHE TRANSPORTIN, HALLKË E RËNDËSISHME NË PLOTËSIMIN E DETYRAVE TË PLANIT

Qëllimi kryesor i prodhimit, i ndërtimit apo i transportit, është që produkti shoqëror të plotësojë në kohë e me cilësi nevojat e konsumatorëve, për të cilët destinohet.

Ky synim i rëndësishëm realizohet nëpërmjet gjithë sistemit kompleks të furnizimit materialo-teknik dhe transportit.

Furnizimi materialo-teknik dhe transporti në përgjithësi i kanë bërë ballë mirë kësaj kërkesë të rëndësishme të zhvillimit të harmonishëm të ekonomisë sonë popullore, nga viti në vit, nga pesëvjeçari në pesëvjeçar.

Megjithëkëtë duhet thënë se furnizimi materialo-teknik akoma nuk është bërë një prapavijë e fuqishme e prodhimit dhe e plotësimin të nevojave të popullit. Nga baza dhe deri në organet qendrore, problemet e furnizimit krijojnë shqetësime të shumta, angazhojnë kohë dhe forca të mëdha dhe në mjaft raste bëhen pengesë serioze në plotësimin e detyrave të planit. Duhet të jemi të ndërgjegjshëm që vështirësi dhe pengesa në këtë drejtim do të ketë, por në asnjë mënyrë këto nuk duhet të shërbejnë si justifikim për çdo mungesë dhe dobësi tjetër me karakter subjektiv. Vështirësitë në këtë fushë nuk janë të pakapërcyeshme. Nuk janë të pakta rastet e shumë ndërmarrjeve që kanë realizuar mirë detyrat e prodhimit në asortiment dhe cilësi, kanë respektuar në mënyrë të kënaqshme kontratat dhe shpërndarjen proporcionale të prodhimit dhe kanë siguruar kështu një bazë të qëndrueshme të furnizimit materialo-teknik. Vetëm disiplina në plotësimin e detyrave të prodhimit, të grumbullimit, të eksportit, të importit, të transportit në bazë të kontratave të lidhura, krijon premisa për sigurimin e realizimit ritmik të planit; çdo thyerje e devijim në këtë drejtim, qoftë edhe në një hallkë të vetme, sjell çrregullime serioze në degë të tjera të ekonomisë.

Organet e Partisë dhe veçanërisht ato shtetërore dhe ekonomike është e domosdoshme ta kuptojnë mirë këtë dhe të ndjekin me rigorozitet plotësimin e çdo detyre si në prodhim ashtu edhe në shpërndarje, në furnizim e në transport, për të mbajtur e për të garantuar lidhjet organike të vendosura në ekonominë tonë popullore mbi bazën e planifikimit.

Planet tona të zhvillimit ekonomik e kulturor janë të mbështetura në bazën materiale e teknike të nevojshme, jo vetëm për të garantuar detyrat e prodhimit apo të shërbimit, por edhe për të ripërtëritur e për të shtuar rezervat. Por në këtë çështje, ndërsa në planifikim vendosen në përgjithësi lidhje e përpjesëtime të drejta midis fazave të riprodhimit, në praktikë këto përpjesëtime shpeshherë prishen nga ndërmarrjet, rrethet dhe ministritë, duke u tërhequr pas interesave lokale apo dikasteriale dhe në dëm të interesit të përgjithshëm.

Një nga hallkat kryesore për të forcuar disiplinën në fushën e furnizimit materialo-teknik është përgatitja dhe lidhja në kohë e kontratave si dhe respektimi i tyre. Kontratat janë nyje që zbërthejnë më tej detyrat e planit, u japin atyre formën e një akti juridik të rëndësishëm ku përcaktohen marrëdhëniet dhe detyrimet reciproke ndërmjet ndërmarrjeve dhe organizatave tona socialiste. Zbatimi i tyre krijon kushtet për realizimin me sukses të planit.

Por në kushtet e tanishme kjo çështje a kuptohet dhe trajtohet nga të gjithë si e tillë? Mund të themi se jo. Bile duhet pranuar se vitet e fundit në këtë drejtim kemi pasur një zbutje dhe dobësim të disiplinës kontraktuale. Kjo ndodh sepse në marrëdhëniet ndërmjet ndërmarrjeve ka liberalizëm dhe qëndrime të palejueshme, që shfaqen në pajtimin me të metat e njëri-tjetrit, në lëshimet reciproke, në konceptet «të mos ashpërsojmë marrëdhëniet se mund të na pritët furnizimi» etj.

Duhet thënë se, pas shkrirjes së organeve të arbitrazhit, një ndikim negativ krijoi edhe moskuptimi i thellë i detyrës dhe i përgjegjësisë nga organet e drejtësisë për gjykimin dhe dhënien e drejtësisë mbi mosmarrëveshjet e lindura midis ndërmarrjeve të ndryshme. Tani që organet e arbitrazhit u krijuan nga qendra deri në bazë, ato duhet të vihen në lëvizje e aktivitet, në mënyrë që të bëhen një mbështetje e fuqishme për forcimin e disiplinës kontraktuale. Gjithashtu, roli dhe detyrat e aparateve qendrore dhe të rretheve në drejtim të furnizimit materialo-teknik dhe të kontratave janë dobësuar nga keqkuptimi i kompetencave që u janë dhënë organeve të ndryshme. Dihet se kompetencat janë caktuar dhe duhen zbatuar drejt nga secili në përputhje me orientimet dhe porositë e dhëna nga Komiteti Qendror e Qeveria. Nga organet më të larta duhet të ushtrohet kontroll mbi zbatimin e këtyre kompetencave, sidomos për shpërndarjen e prodhimit dhe në zbatimin e kontratave. Nuk është e lejueshme që të shpërdorohen kompetencat për të përfituar fonde dhe burime materiale në kurriz të të tjerëve duke bërë shpërndarje në bazë njohjesh e jashtë ligjeve, siç ndodh nga shumë ndërmarrje dhe seksione të komiteteve ekzekutive, ndërsa organet më të larta të tyre në vend që të ndërhyjnë e të marrin masa qëndrojnë indiferente dhe le-

galizojnë në këtë mënyrë thyerjen e disiplinës së planit, thyerjen e kushteve kontraktuale.

Shkeljet dhe çrregullimet fillojnë që në punën për përgatitjen dhe lidhjen e kontratave. Shpeshherë ato lidhen me vonesë dhe me të meta të rëndësishme. Veç kësaj, vihet re se pothuaj çdo vit plani i shtetit, i aprovuar në kohë nga ana e Këshillit të Ministrave, u dërgohet me vonesë komiteteve ekzekutive dhe ndërmarrjeve nga ana e ministrive përkatëse. Edhe për vitin 1973 dikasteret vonuan dërgimin poshtë në kohë të planeve dhe lidhjen me kohë të kontratave. Kjo shqetëson me të drejtë kolektivat punonjës të mjaft ndërmarrjeve, të cilët me fillimin e vitit të ri nuk i kanë të qarta burimet e furnizimit me materiale, ose shpërndarjen e prodhimit të tyre. Një gjë e tillë nuk ka si të mos influencojë për keq në realizimin e planit dhe në gjithë marrëdhëniet kontraktuale mbi bazën e të cilave zberthehet e konkretizohet plani në treguesit e tij të shumtë. Një e metë e tillë duhet ndrequr sa më parë.

Por më të theksuara janë të metat që vërtetohen gjatë zbatimit të kontratave. Shembujt për këtë janë të shumtë. Fabrika e Çimentos në Vlorë nuk plotëson detyrimet kontraktuale ndaj 157 ndërmarrjeve, nga të cilat 126 janë jashtë rrethit dhe kryesisht në rrethe të vogla dhe të thella. Ndërmarrjet ushqimore në Fier e Vlorë, furnizojnë me precedencë me bërsi për kafshët dhe me vaj luledielli ndërmarrjet e kooperativat e rrethit të tyre, në kurriz të sasive të kontraktuara me ndërmarrjet e rretheve të tjera. Komiteti Ekzekutiv i Elbasanit urdhëron uzinën mekanike të prodhojë vinça për nevojat e veta, duke lënë pa prodhuar ashensorët e planifikuar për ndërmarrjet e tjera të ndërtimit etj. Qëndrime të tilla, që shkelin rëndë disiplinën e planit, janë të papajtueshme me kriteret themelore të drejtimit me plan të ekonomisë dhe në asnjë mënyrë nuk duhen lejuar.

Në kuadrin e realizimit të detyrave të planit dhe të kontratave një rol të rëndësishëm kanë organet e tregtisë së jashtme. Furnizimet nga importi me makineri, pjesë këmbimi, lëndë të para dhe materiale të tjera zënë një peshë të rëndësishme në furnizimin materialo-teknik. Me gjithë vështirësitë e njohura që hasen në marrëdhëniet tregtare me shtetet e tjera dhe përpjekjet tona për t'iu përgjigjur nevojave të zhvillimit të ekonomisë, përsëri vihen re të meta e luhajtje në sigurimin e materialeve, pajisjeve e makinerive në kohën, në sasinë, në llojet dhe në cilësitë e kërkuara.

Ndërmarrjet e tregtisë së jashtme të metat e tyre subjektive në disa raste i justifikojnë me pretekstin e vështirësive objektive, duke mos e konsideruar kështu veten të angazhuar plotësisht ndaj ndërmarrjeve përdoruese. Ato jo gjithmonë i kontratojnë me kohë mallrat me furnitorët e jashtëm, nuk i sigurojnë dhe nuk i sjellin

në tërë llojshmërinë e tyre. Mbi 100 lloje çeliqesh për prodhimin e pjesëve të këmbimit nuk kanë ardhur fare gjatë vitit 1972, po kështu gjatë vitit ka qenë mjaft i çrregullt furnizimi me lëkurë, bojra, tuba, koks dhe disa kimikate të tjera për industrinë, hekur-beton dhe azbest për ndërtimet etj. Por edhe ndërmarrjet dhe ministratë përkatëse bëjnë shpeshherë porosi të tepërta ose edhe të panevojshme, për pajisje, makineri dhe materiale nga importi, bile disa herë kërkohet me urgjencë prurja e tyre, ndërsa kur vijnë, qëndrojnë ditë e muaj të tërë në portet dhe stacionet hekurudhore dhe dëmtohen. Ky është një qëndrim pa përgjegjësi dhe i palejueshëm.

Duhet theksuar gjithashtu ajo që vazhdimisht ka porositur Partia, se nuk mund të ketë import pa realizuar më përpara detyrat e caktuara për eksportin. Plotësimi i detyrave në këtë drejtim për vitin 1972 është jo i kënaqshëm. Ndaj planit mbetën pa u dorëzuar për eksport mallra me një vlefte prej 6.6 milionë rubla. Ndërsa sipas artikujve plani u plotësua tërësisht vetëm në rreth 50 për qind të tyre, duke qenë kjo më e theksuar sidomos në mineralet dhe prodhimet bujqësore. Por a ka pasur mundësi dhe rezerva për plotësimin më të mirë të eksportit dhe për ta rritur atë më tej? Duhet të jemi të ndërgjegjshëm se mundësitë për këtë nuk shfrytëzohen sa duhet dhe përpjekjet nuk bëhen në të gjitha drejtimet. Patjetër duhen shtuar përpjekjet për të realizuar detyrat për eksportin e mineralit të kromit, të hekur-nikelit, të naftës, të bitumit, të duhanit, të tekstileve etj., por duhet të mos nënvleftësohen mundësitë që ekzistojnë për grumbullimin, prodhimin e gjetjen e tregjeve për një gamë të gjerë artikujsh të ashtuquajtur të vegjël, duke filluar që nga prodhimet artistike dhe shumë lloje mallrash të tjera. Kjo kërkon vlerësim dhe kujdes më të madh nga prodhuesit si dhe rritjen e aftësive vepruese të organeve të tregtisë së jashtme për sigurimin e tregjeve dhe ndikimin mbi prodhuesit për t'i konkretizuar këto.

Është e nevojshme që për të gjitha këto probleme të rëndësishme dhe preokupante të importit dhe të eksportit ministri i Tregtisë të marrë masa serioze. Gjithashtu organet shtetërore të ekonomisë, që nga baza e deri në qendër, të thellohen më shumë në problemet e importit dhe të eksportit, të zbatojnë më mirë disiplinën shtetërore në përdorimin e fondeve që u janë vënë në dispozicion dhe të përgjigjen plotësisht për realizimin e planit të eksportit dhe rritjen e vazhdueshme të tij.

Në zbatimin e detyrave kontraktuale midis prodhuesve dhe përdoruesve një ndikim të rëndësishëm ka edhe plotësimi i detyrave nga ana e transportit. Me gjithë përparimet e shënuara, nuk janë transportuar mjaft nga mallrat e kontraktuara, ndër të cilat edhe mallra të tilla të rëndësishme, si lëndë druri, drutë e zjarrit, disa minerale etj. Kjo ka lidhje patjetër me plotësimin e de-

tyrave të gatishmërisë teknike të mjeteve, përdorimit dhe rendimentit të tyre, të cilat për vitin 1972, u realizuan dobët. Për këtë mban përgjegjësi të madhe Ministria e Komunikacioneve.

Për të mos penguar plotësimin e detyrave të furnizimit dhe të prodhimit dhe për të siguruar transportimin ritmik të të gjitha mallrave të kontraktuara është e domosdoshme që organet përkatëse të transportit, sidomos ato të transportit automobilistik, të marrin masa serioze për të realizuar patjetër treguesit e planifikuar, duke zbatuar më mirë eksperiencën e përparuar, duke shfrytëzuar më me efektivitet transportin hekurudhor për të mënjeluar në maksimum qarkullimet paralele dhe duke rritur sidomos gatishmërinë teknike të automjeteve, shfrytëzimin me dy ndërresa të tyre dhe shfrytëzimin më të mirë të rimorkiove. Lufta kryesore e punonjësve të transportit duhet të përqendrohet kryesisht në realizimin e të gjitha kontratave të lidhura.

Por, realizimi i kontratave të transportit kërkon njëkohësisht që dërguesit dhe pritësit e mallrave të marrin masa më të mira për të siguruar mallrat ritmiksht dhe për të shkurtuar kohën e ngarkim-shkarkimit të mjeteve, ndërsa ndërmarrjet prodhuese të pjesëve të këmbimit dhe ato të importit të mënjanojnë çrregullimet e mëdha që kanë ndodhur në furnizimin me pjesë këmbimi gjatë vitit të kaluar dhe t'i sigurojnë ato në kohë, në sasi dhe në llojet e kontraktuara.

Duke vlerësuar rëndësinë që kanë në gjendjen e tanishme problemet e furnizimit materialo-teknik dhe të transportit dhe për kapërcimin e vështirësive që ndeshen në këtë drejtim është e domosdoshme që organizatat e Partisë dhe organet ekonomike e shtetërore të kthejnë shumë më tepër vëmendjen e tyre ndaj problemeve të kontraktiveve, të shpërndarjes dhe të transportit, duke mos i kuptuar dhe trajtuar këto si çështje që duhet të zgjidhen vetëm në rrugë administrative. Organizatat e Partisë duhet të luftojnë më mirë kundër kuptimeve dhe koncepteve jo të drejta që vërehen në këto çështje, kurse organet shtetërore, duke i trajtuar dhe duke i zbatuar këto probleme me një frymë të lartë partishmërie, të zbatojnë të gjitha rregullat dhe sanksionet e caktuara me ligj, të vendosin kontroll të fortë shtetëror, të vënë para përgjegjësisë disiplinore e penale shkaktarët dhe t'i ndëshkojnë ata pa bërë lëshime. Organizatat e masave, gjithashtu, është e nevojshme të tërheqin më mirë vëmendjen e kolektivave punonjës dhe të forcojnë më shumë kontrollin punëtor në drejtim të forcimit të disiplinës për problemet e furnizimit material e teknik.

Partia dhe Qeveria kanë përcaktuar drejt problemet themelore dhe masat për përsosjen e mëtejshme të furnizimit materialo-teknik. Këto masa u zbatuan në tërë kompleksin e tyre në vitin 1972. Është e vështirë që vetëm nga përvoja e kësaj periudhe të

shkurtër të nxirren konkluzione të plota për efektivitetin e këtyre masave, aq më tepër kur disa nga dispozitat e vendosura, për vështirësitë e hasura dhe për mungesën e eksperiencës, nuk janë zbatuar plotësisht dhe në tërë hallkën e tyre. Shtrohet detyra për të gjitha organet shtetërore e ekonomike që t'i kushtojnë kujdesin e duhur, sidomos gjatë realizimit të planit të vitit 1973 dhe përgatitjes për vitin 1974, vënies në jetë të të gjitha dispozitave që rregullojnë furnizimin materialo-teknik. Në të njëjtën kohë, nga dikasteret dhe Këshilli i Ministrave të studiohen me vëmendje të gjitha sugjerimet që janë shprehur sidomos gjatë punimit të fjalimit të shokut Enver në Plenumin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Matit dhe të përmirësohen ato dispozita apo forma organizimi për të cilat jeta vërteton se duhen ndrequr.

4. TË PËRSOSIM NË MËNYRË TË PANDËRPRERË ORGANIZIMIN SOCIALIST TË PUNËS E TË SHPËRBLIMIT

Problemet e organizimit socialist të punës e të shpërblimit të saj kanë një përmbajtje të thellë ideologjike, politike, ekonomike dhe shoqërore. Si të tilla ato lidhen ngushtë me zhvillimin aktual e në perspektivë të ekonomisë popullore, shtyjnë përpara prodhimin dhe ndikojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të nivelit të jetesës së masave punonjëse.

Karakteristikë dalluese e rendit tonë socialist është zhvillimi i pareshtur sasior e cilësor i të gjitha sferave të jetës shoqërore. Sigurisht që në këtë proces të gjerë e të shumanshëm janë shfaqur dhe shfaqen edhe shpërpjesëtime në zbatimin praktik të sistemit të pagave ndërmjet degëve të ekonomisë dhe brenda së njëjtës degë që duhet të tërheqin vëmendjen tonë. Vitin e kaluar u krye një studim i posaçëm mbi disa probleme të punës e të pagave, i cili u mor në shqyrtim nga Këshilli i Ministrave dhe nga Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH. Konkluzionet e Byrosë Politike pas shqyrtimit të këtij studimi dhe, në mënyrë të veçantë, fjala e mbajtur nga shoku Enver rreth problemeve të organizimit të punës e të pagave dhe të ngritjes së nivelit të jetesës së masave punonjëse, janë direktiva të rëndësishme pune në këtë fushë, me qëllim që të zgjidhen disa çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me zhvillimin tonë të tanishëm, ashtu edhe për perspektivën.

Sistemi ynë i pagave dhe i shpërblimeve sipas punës, në përgjithësi ka qenë dhe mbetet i drejtë, ai është i ndërtuar në bazë të parimeve marksiste-leniniste mbi çështjet e punës e të shpërblimeve dhe brenda kushteve e mundësive të ekonomisë sonë popullore. Ai ka synuar dhe do të synojë edhe në të ardhmen, në radhë të parë, në rritjen e pagës reale të popullsisë, si rruga më

e rëndësishme dhe e drejtë që lidhet më mirë me shpërndarjen e të ardhurave kombëtare dhe në mundësitë e vendit. Megjithatë, siç vërtetuan edhe studimet e bëra, në sistemin e kategorizimit të punës, të pagave e të shpërblimeve vërehen edhe dobësi, kanë dalë e do të dalin edhe probleme të reja.

Në lidhje me këto çështje Byroja Politike i rekomandoi Këshillit të Ministrave që të merren masa për të bërë studime akoma më të thella në drejtim të organizimit të punës e të pagave, veçanërisht për të studiuar e përcaktuar mbi baza më shkencore pagën minimale të punonjësve, pagat e ulëta e të mesme që përbëjnë pagat më masive, shkallëzimet e tanishme të pagave dhe perspektivat e ngushtimit të tyre, pa kaluar në barazim pagash e shpërblimesh; për të studiuar përmirësimin e librave të kategorizimit, të cilët duhet t'i përgjigjen më mirë stadi të tanishëm të zhvillimit të ekonomisë; për vendosjen e atestimit kulturor-profesional të punonjësve të kategorive të ndryshme dhe për të gjetur e përcaktuar rrugët e mëtejshme më racionale të ngushtimit të dallimeve midis qytetit e fshatit etj.

Këshilli i Ministrave, në bazë të rekomandimeve të Byrosë Politike ka hartuar një program pune të hollësishëm studimesh me etapa, me qëllim që të qartësohen këto probleme të rëndësishme dhe të vendoset për zbatimin e tyre.

Byroja Politike mendon se një nga shkaqet kryesore që aktualisht ka krijuar disproporcione në pagat e punonjësve në mes degëve të ndryshme të ekonomisë, janë të metat serioze në vendosjen, kontrollin dhe rivendosjen e normave të punës. Prandaj çështja e rishikimit të normave dhe kalimi në normat teknike, unifikimi i normave në ndërmarrje e sektorë të njëjtë, mbajtja parasysh e tarifave të pagave të çdo dege gjatë zbatimit të normave dhe forcimi i kontrollit të cilësisë së punës e të prodhimit, janë probleme të mëdha të kohës që duhet t'i kapërcejmë patjetër, t'u japim rrugëzgjdhje të shpejtë.

Problemet e normimit të punës, në kuadrin e përsosjes së organizimit socialist të punës e të shpërblimit, duhet të zënë një vend të rëndësishëm në punën tonë të përditshme. Kjo sepse nuk mund të sigurohet përdorimi racional i kohës së punës, ngritja e pandërprerë e rendimentit dhe mbajtja e përpjesëtimeve të drejta në sistemin e pagave të punëtorëve pa zbatuar një normim pune të saktë mbi baza shkencore. E theksojmë këtë se, ndërsa sistemi tarifor është i ndërtuar drejt, është i stabilizuar dhe i përqendruar, normimi i punës, ndonëse është një nga elementët bazë të sistemit të pagave, është i shpërqendruar në dikasteret qendrore, në komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve dhe në vetë ndërmarrjet dhe, nga ana tjetër, ai është një element i lëvizshëm.

Normimi i punës, me gjithë hapat konstruktivë dhe përpje-

kjet më të mira se në të kaluarën që po bëjnë organet e Partisë e të pushtetit në rrethe, duhet thënë se është akoma një fushë relativisht e prapambetur në veprimtarinë organizuese, edukuese dhe drejtuese të organizatave të Partisë dhe drejtuesve të ekonomisë në bazë e në mënyrë të veçantë të ministrive në qendër. E vërteta është se nuk bëhet një punë e mjaftueshme, në nivelin e duhur, për shtrirjen e normave, për rishikimin e tyre mbi bazën e mesatares progresive dhe, veçanërisht, për studimin dhe shtrirjen e normave teknike. Të tërheq vëmendjen fakti se në ndërmarrjet e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave, të Ministrisë së Komunikacioneve dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Ekonomisë Komunale numri i punëtorëve që punojnë pa normë është i madh dhe arrin mesatarisht 30-35 për qind. Në degët kryesore të ekonomisë popullore rreth 25 për qind e punëtorëve që punojnë me normë i tejkalojnë ato 11-20 për qind, ndërsa 20 për qind e tyre i tejkalojnë ato mbi 21 për qind.

Tejkalime të tilla të larta të normave të punës nuk ka si të mos sjellin shpërpjesëtime në raportet e pagave të punëtorëve, në krahasim me ato të vendosura në sistemin tarifor. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 1972, në Ndërmarrjen e Shpim-Shfrytëzimit në Patos normat u tejkaluan mesatarisht 26 për qind; në Kombinatin e Drurit në Elbasan ato u tejkaluan 21 për qind; në ndërmarrjen e transportit të Korçës 28 për qind. Fenomene të kësaj natyre vërehen edhe ndërmjet degëve të ekonomisë, sidomos në disa degë. Në qoftë se këtë çështje do ta shikojmë për individë të veçantë, del se nuk janë të pakta rastet kur është marrë një pagë edhe 2-3 herë më e madhe se ajo e caktuar në sistemin tarifor të pagave.

Të gjitha këto tregojnë se nuk ka një kuptim të drejtë për rolin që duhet të luajnë normat në organizimin dhe shpërblimin e punës së punonjësve. Në mjaft raste normat trajtohen më shumë si masë shpërblimi, si rregullator page dhe jo si mjet efektiv për të përcaktuar drejt harxhimin e punës në prodhimin shoqëror, për të siguruar rritjen e pandërprerë të rendimentit të punës, për të pakësuar vazhdimisht shpenzimet e prodhimit e të qarkullimit, për të siguruar shtimin me ritme më të larta të të ardhurave kombëtare dhe shpërndarjen e drejtë të fondeve të konsumit individual, në bazë të sasisë e të cilësisë së punës së kryer nga secili. Përveç të tjerave, në këtë drejtim kanë ndikuar dhe ndikojnë edhe konceptet e gabuara dhe gjykimet joparimore, se gjoja në disa sektorë ndihmës e të shërbimit, ku mungon prodhimi në seri, ose ku puna ka karakter riparimi, nuk ka mundësi të vendosen norma pune, se normat teknike duhet të jenë «të përkryera», se ato duhet të vendosen në kushtet e përdorimit «të një teknike të lartë» etj.

Këtej del nevoja që organizatat e Partisë, organet e push-

tetit e të ekonomisë të bëjnë një punë edukative bindëse më të organizuar, më të madhe e më efektive për të luftuar konceptet e qëndrimet liberale e konservatore, të cilat bëhen pengesë për zgjerimin e punës me normë, për të vendosur e për të zbatuar norma të studiuara e në radhë të parë norma teknike. Është e domosdoshme të bëhet e qartë për të gjithë se shoqëria, në përshtatje me llojin, kushtet e punës dhe mundësitë ekonomike, ka caktuar tarifa të veçanta page të studiuara për secilën degë të ekonomisë, të cilat duhet të zbatohen në mënyrë të rreptë, duke siguruar një përdorim sa më të plotë dhe sa më efektiv të kohës së punës.

Plotësimi me sukses i detyrave për ngritjen e rendimentit dhe për shtimin e prodhimit shtron si nevojë objektive që të zgjidhet përfundimisht e sa më parë problemi i shtrirjes së mëtejshme të punës me norma. Byroja Politike është e mendimit që brenda vitit 1973 duhet të zgjerohet në mënyrë të dukshme normimi i punës, me qëllim që të vendosen e të zbatohen norma pune kudo që punohet e që prodhohet. Kjo detyrë nuk mund të zgjidhet vetvetiu. Përkundrazi, ajo kërkon jo vetëm punë organizuese dhe edukative me punonjësit, por edhe kryerjen e studimeve të veçanta nga ana e ndërmarrjeve dhe e institucioneve të tjera në bazë e në qendër, si edhe marrjen e masave ekonomike, teknike e organizative përkatëse që lejojnë zbatimin e plotë të punës me normë.

Drejtimi kryesor për përsosjen e normimit të punës duhet të jetë rishikimi sistematik i normave në të gjitha proceset e punës, duke vënë domosdo në themel të kësaj pune përvojën e punëtorëve të përparuar. E gjithë puna ideopolitike dhe organizative duhet të synojë dhe të bëjë të mundur që të vendosen norma pune sa më mobilizuese, mbi bazën e mesatares progresive. Për organizatën e Partisë, për atë të bashkimeve profesionale si dhe për administratën e ndërmarrjes duhet të bëhet problem shqetësues, sa herë që normat statistikore në shkallë ndërmarrjeje, reparti apo sektori plotësohen mesatarisht mbi 110 për qind.

E njëjta gjë duhet thënë edhe për studimin dhe shtrirjen e mëtejshme të punës me norma unike, në të gjitha ndërmarrjet dhe veprimtarinë e së njëjtës degë. Ministrinë, institucionet e tjera qendrore dhe komitetet ekzekutive të rretheve duhet patjetër të merren më mirë se deri sot me këtë problem.

Zhvillimi i vrullshëm i ekonomisë dhe thellimi i pandërprerë i përparimit tekniko-shkencor kanë krijuar kushte të përshtatshme për të bërë një hop të ri cilësor në shtrirjen e normave teknike në shkallë të gjerë.

Në ato degë e sektorë të ekonomisë, ku prodhimi është i organizuar në seri e në linjë zinxhir është e domosdoshme të

merren masa për të kaluar kudo me norma teknike, duke vepruar në mënyrë të programuar dhe sipas afateve të caktuara jo të largëta. Në ata sektorë e vende pune ku sot ka tejkalime të theksuara të normave të punës, të rishikohen ato në drejtim të ngritjes së tyre në bazë të mesatares progresive.

Rishikimi sistematik i normave mbi bazën e mesatares progresive dhe zgjerimi i punës me norma teknike kërkon njëkohësisht që të merren një sërë masash të tjera lidhur me përsosjen e teknikës e të teknologjisë së prodhimit, me përmirësimin e organizimit «të vogël» të punës, me forcimin e disiplinës së planit dhe sidomos me forcimin e kontrollit të cilësisë së prodhimeve, me furnizimin materialo-teknik, si dhe me ngritjen në një shkallë të re dhe më të lartë të të gjithë punës për përgatitjen dhe kualifikimin e punëtorëve. Të mos i nënvleftësojmë asnjëherë këto masa, sepse, përndryshe, detyra dhe kërkesa për përsosjen e normimit të punës do të merrnin karakter administrativ.

Ruajtja e përpjesëtimeve të drejta në shpërndarjen sipas punës është e lidhur ngushtë edhe me forcimin e kërkesave për kategorizimin e proceseve të punës e të kualifikimit të punëtorëve. Byroja Politike, duke u mbështetur në analizën e përvojës së derisotme në këtë fushë, arriti në përfundimin se shpërblimi i punëtorëve duhet të mbështetet kurdoherë në vëllimin e punës së matur e të kontrolluar si sasi e cilësi ose në kohën efektive të punës së kryer dhe në kategorinë e procesit ose të vendit të punës. Zbatimi i drejtë i këtij kriteri themelor në shpërndarjen sipas punës shtron gjithashtu si të domosdoshme kërkesën për ta përsosur në tërësi sistemin e kategorizimit të vendeve apo të proceseve të punës, me qëllim që ai të pasqyrojë me saktësi ndryshimet që kanë ndodhur në kushtet e punës e të prodhimit, si rezultat i zhvillimit të bazës materialo-teknike dhe i thellimit të revolucionit tekniko-shkencor. Për këtë qëllim është vënë detyra që brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 1973 të përfundojë puna e filluar për rishikimin e librave të kategorizimit të proceseve ose të vendeve të punës. Kjo gjë duhet studiuar mirë, në mënyrë objektive, mbi baza e kriteresh shkencore, me vëmendje të veçantë dhe punë të programuar e të drejtuar me përgjegjësi në të gjitha hallkat e drejtimit të ekonomisë, nga qendra në bazë.

Rishikimi dhe caktimi sa më i drejtë i kategorive të proceseve e të vendeve të punës, si dhe hartimi i librave të rinj të kategorizimit, kërkon si kusht të domosdoshëm që të përmirësohen, të forcohen e të shtohen kërkesat për ngritjen e nivelit arsimor e tekniko-profesional të punëtorëve. **Pikërisht lidhur me këtë Byroja Politike arriti në përfundimin se ka ardhur koha që nocioni «kategorit personale» si matës i kualifikimit e i shpërblimit të zëvendësohet me një nocion të ri e më të gjerë, me atësimin kulturor e profesional të punëtorëve, çështje kjo që duhet**

të studiohet me kujdes e në mënyrë të veçantë, sepse nuk është dhe nuk mund të jetë një zëvendësim i thjeshtë dhe as formal i kategorisë së sotme personale, por një shprehës e matës më i gjerë i dijeve teorike e praktike të punëtorit në profesionin përkatës.

Duke shtruar këto probleme në këtë Plenum të Komitetit Qendror, Byroja Politike thekson edhe një herë në mënyrë të posaçme nevojën e rritjes së kujdesit dhe të përgjegjësisë së organizatave të Partisë e të bashkimeve profesionale, të organeve shtetërore e të ekonomisë, si dhe të të gjithë punonjësve për përsosjen e mëtejshme të organizimit socialist të punës e të shpërblimit të saj.

Sikurse ka vënë në dukje shoku Enver, problemet e punës e të pagave kanë rëndësi të dorës së parë. Ndaj këtyre problemeve nuk duhet lejuar asnjë shkujdesje, asnjë qëndrim pasiv e veprim spontan. Ato duhet t'i njohim e t'i trajtojmë në mënyrë të vetëdijshme, t'i zgjidhim drejt, në mënyrë shkencore dhe në kohë, duke përgatitur me punën tonë dhe gradualisht kushtet objektive e subjektive për të vënë në jetë masat për ngritjen e mëtejshme të nivelit të jetesës së punonjësve. Duhet të jetë e qartë për të gjithë se shoqëria jonë socialiste e ka bërë dhe e bën shpërndarjen individuale të të mirave materiale kurdoherë mbi bazën e mundësive objektive të çdo etape të zhvillimit tonë socialist. Këto mundësi shtohen vazhdimisht vetëm me punën dhe djersën e popullit tonë punonjës, nën udhëheqjen e Partisë.

*
*
*

Shokë,

Këto ishin disa nga problemet që Byroja Politike i pa të nevojshme të shtroheshin në këtë Plenum të Komitetit Qendror të Partisë dhe që duhet të jenë në qendër të vëmendjes së Partisë, organeve ekonomike dhe shtetërore për zbatimin e detyrave të planit të vitit 1973 dhe të pesëvjeçarit të pestë në tërësi. Analiza e tyre me një frymë të lartë partishmërie duhet të na shërbejë për të organizuar më mirë punën tonë për drejtimin e ekonomisë, për të shtuar vazhdimisht sukseset dhe realizimet tona.

U ndalëm posaçërisht në analizën e të metave e të disa vështirësive që kanë dalë në zbatimin e detyrave të planit. Por kjo nuk do të thotë se karakteristikë e zhvillimit tonë janë kryesisht të metat dhe dobësitë në punë. Tabloja e përgjithshme e zhvillimit tonë është optimiste. Ajo që është karakteristikë themelore e rendit tonë është entuziazmi revolucionar i klasës punëtore dhe i masave të tjera punonjëse, gatishmëria e tyre për të vënë në jetë me çdo kusht e në çdo rrethanë programin e Partisë.

Si kurdoherë faktor kryesor që do të bëjë të mundur vënien në jetë të këtyre detyrave është ngritja e nivelit të përgjithshëm dhe e aktivitetit revolucionar të masave punonjëse. Duhet punuar pra në mënyrë më të organizuar për të ngritur ndërgjegjen politike të njerëzve, për të rrënjësuar thellë në mendjen dhe në zemrën e çdo punonjësi bindjen e plotë se detyrat e vëna në plan u përgjigjen interesave themelore të punonjësve tanë, se këto detyra janë plotësisht të mundshme për t'u realizuar. Kjo është kryesorja, sepse, sikurse na mëson shoku Enver, vetëm bindjet e rrënjësura ideologjike mund të bëjnë çudira. Kjo do të bëjë të mundur që emulacioni socialist të ngrihet në një shkallë më të lartë, duke e bërë vitin 1973 vit vendimtar për realizimin e planit të pestë pesëvjeçar. Nëpërmjet emulacionit socialist edukohet e kalitet ndërgjegjja, njihet dhe përhapet përvoja e përparuar.

Plotësimi i detyrave që kemi përpara, zgjidhja e problemeve të shumta e më të ndërlikuara kërkojnë disiplinë më të fortë, përgjegjësi më të madhe, vetëveprim dhe kontroll të gjithanshëm partie, shtetëror e shoqëror. Të gjitha këto lidhen ngushtë me përsosjen e metodës e të stilit të drejtimit të ekonomisë, ku duhet të spikatin më shumë partishmëria në punë, vija e masave, metoda e aksionit dhe shpirti praktik krijues.

Në këtë kuadër problemet e organizimit e të drejtimit të prodhimit shoqëror marrin rëndësi të veçantë. Mbi bazën e analizës dhe të përgjithësimit të përvojës sonë, kohët e fundit Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH dhe Këshilli i Ministrave dhanë orientime të rëndësishme lidhur me kriteret kryesore të organizimit të ndërmarrjeve ekonomike dhe aprovuan disa masa konkrete për përsosjen e formave të organizimit e të drejtimit të prodhimit në periudhën e tanishme dhe për një perspektivë të afërt.

Në përsosjen e strukturave të drejtimit një masë e rëndësishme ishte edhe krijimi i Ministrisë së Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore duke përqendruar në një dikaster të gjithë prodhimin e mallrave të konsumit të gjerë, bashkë me grumbullimin e lëndëve të para bujqësore e blegtorale. Me përpjesëtimet që ka marrë prodhimi shoqëror, ku po rritet me ritme të shpejta prodhimi i mjeteve të prodhimit dhe po zgjerohet industria e rëndë përpunuese, kur kërkesat për sasinë, asortimentin dhe cilësinë e mallrave të konsumit të gjerë sa vijnë e po shtohen, Byroja Politike mendon se zbatimi i një mase të tillë është plotësisht i justifikuar dhe i drejtë. Ajo do t'i japë një impuls të mëtejshëm prodhimit të mallrave të konsumit të gjerë, do të bëjë të mundur që prodhimi i mjeteve të prodhimit të përqendrohet në Ministrinë e Industrisë e të Minierave dhe do të lirojë Ministrinë e Tregtisë nga aktiviteti industrial dhe i grumbullimit, për t'iu

kushtuar tërësisht zbatimit të detyrave të mëdha në fushën e tregtisë së brendshme dhe të jashtme.

... Masat e mësipërme pasqyrojnë nivelin e arritur në zhvillimin e forcave prodhuese dhe të marrëdhënieve socialiste në prodhim. Por ato nuk janë veçse një fillim i zbatimit të detyrave të mëdha që shtrou në këtë lëmë Kongresi i 6-të i Partisë dhe që duhen çuar më tej. Prandaj, në të ardhmen ato duhet të jenë objekt i rëndësishëm kërkimesh e studimesh për organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, për institucionet kërkimore-shkencore.

Një çështje e rëndësishme në fushën e organizimit e të drejtimit të prodhimit qëndron gjithashtu kuptimi dhe zbatimi i drejtë i kompetencave. Rishikimi dhe zgjerimi i kompetencave që bëme dy vjet më parë, kryesisht për organet e bazës, ishte një punë e mirë që në përgjithësi ka filluar të japë rezultatet e saj të mira, sidomos në rritjen e përgjegjësisë dhe të vetëveprimit. Kushdo ka tani të përcaktuara më qartë detyrat dhe të drejtat e veta dhe brenda tyre duhet të veprojë me iniciativë, në mënyrë krijuese dhe me përgjegjësi sepse nuk është e drejtë dhe as parimore që për të gjitha gjërat të përgjigjet një njeri, vetëm ministri, kryetari i komitetit ekzekutiv, drejtori i ndërmarrjes apo kryetari i kooperativës bujqësore. Pa dyshim këta mbajnë dhe duhet të mbajnë përgjegjësinë kryesore të drejtpërdrejtë për plotësimin e detyrave të planit. Por në masën përkatëse dhe për sektorët që mbulojnë, duhet të përgjigjen drejtpërdrejt dhe deri në fund të gjithë punonjësit e tjerë të ministrive, të komiteteve ekzekutive, të ndërmarrjeve e të institucioneve të ndryshme. Vetëm kështu do të forcohet përgjegjësia individuale, si kusht i domosdoshëm për të forcuar edhe përgjegjësinë kolektive. Në këtë mënyrë do të ngrihet në një nivel më të lartë shkencor drejtimi i ekonomisë popullore.

Ne po i futemi zbatimit të detyrave të planit të vitit 1973 me një bazë materialo-teknike më të fuqishme, me një përvojë më të madhe, me një shkallë më të lartë të ndërgjegjes socialiste dhe me pikësnyime të qarta. Kjo përbën një garanci të sigurt për të plotësuar me sukses detyrat e vitit 1973 dhe ato të planit të pestë pesëvjeçar në tërësi; prandaj me të gjitha forcat, duke mobilizuar dhe shfrytëzuar të gjitha mundësitë dhe rezervat e brendshme, ta kthejmë këtë vit në një vit përpjekjesh e lufte të madhe në të gjitha frontet e prodhimit dhe të shërbimit dhe duke kapërcyer çdo pengesë e vështirësi të realizojmë me sukses dhe para afatit detyrat e planit të vitit 1973.

Botohet për herë të parë, me ndonjë shkurtrim, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI PLOTËSIMIN E PLANIT TË VITIT 1972, DETYRAT KRYESORE PËR VITIN 1973 DHE DISA PROBLEME PËR PËRSOSJEN E MËTEJSHME TË DREJTIMIT TË EKONOMISË»

6 shkurt 1973

Plenumi i 3-të i Komitetit Qendror të PPSH në mbledhjen e tij të datës 5 e 6 shkurt 1973, pasi dëgjoji dhe diskutoi gjerësisht raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi plotësimin e planit të vitit 1972, detyrat kryesore për vitin 1973 dhe disa probleme për përsosjen e mëtejshme të drejtimit të ekonomisë», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave, shoku Adil Çarçani,

Vendosi:

1. — Të aprovojë plotësisht raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH.

2. — T'u rekomandojë organizatave të Partisë, organeve shtetërore dhe ekonomike, si dhe organizatave të masave që në tërë punën dhe luftën e tyre për zbatimin e detyrave të planit për vitin 1973, si dhe për përsosjen e mëtejshme të drejtimit të ekonomisë të udhëhiqen nga materialet e rëndësishme të këtij Plenumi.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PROTOKOLL

I BYROSË POLITIKE TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI KRITERET THEMELORE TË KUALIFIKIMIT DHE TË SIGURIMIT TË KUADRIT NË SHKOLLAT E LARTA DHE NË INSTITUCIONET SHKENCORE»

25 prill 1973

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 25 prill 1973, pasi shqyrtoi raportin e paraqitur nga Komisioni Qendror për Arsimin «Mbi kriteret themelore të kualifikimit dhe të sigurimit të kuadrit në shkollat e larta dhe në institucionet shkencore», arriti në këto përfundime:

Universiteti, shkollat e tjera të larta dhe institucionet shkencore në përgjithësi kanë arritur rezultate të mira në zbatimin e detyrave të shtruar nga Partia për përgatitjen e kuadrit të ri, për zgjerimin e zhvillimin e mëtejshëm të punës shkencore, për përmirësimin e punës mësimore-educative, për hartimin e teksteve të reja etj. Kuadrot e përgatitur në universitet e në shkollat e tjera të larta, kudo që janë dërguar, kanë punuar përgjithësisht mirë. Ata kanë punuar me vullnet, me frymë revolucionare e pjekuri shkencore dhe kanë mbajtur mbi supe detyra të rëndësishme.

Megjithëkëtë Byroja Politike konstaton se puna e zhvilluar gjer tani për kualifikimin e kuadrit në shkollat e larta e në institucionet shkencore për zbatimin e detyrave që janë shtruar në këtë fushë vitet e fundit në vendimet përkatëse të KQ të Partisë e të Këshillit të Ministrave, është e pakënaqshme. Detyrat e ngarkuara nuk janë ndjekur me kujdes dhe zbatimimi i tyre nuk është shoqëruar me masa të rëndësishme organizative, si nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës ashtu edhe nga drejtuesit e shkollave të larta e institucionet shkencore. Si rrjedhim kualifikimi i kuadrit bëhet me boshllëqe, dhënia e titujve shkencorë bëhet në bazë të kërkesave të pakta e me mjaft formalizëm. Këta tituj, fare pak, u janë dhënë specialistëve që punojnë jashtë

shkollave të larta e institucioneve shkencore, sidomos atyre që punojnë drejtpërsëdrejti në prodhim.

Duke teorizuar në emër të specifikës së shkollave të larta, nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, nga drejtuesit e universitetit e të institucioneve shkencore, si dhe nga Sektori i shkollave pranë Komitetit Qendror, nuk janë zbatuar si duhet orientimet e vendimet e Partisë e të Qeverisë lidhur me revolucionarizimin e vazhdueshëm të kuadrit, që punon në shkollat e larta e institucionet shkencore, janë bërë lëshime e nuk janë zbatuar orientimet e Partisë për qarkullimin sistematik e të planifikuar të kuadrit pedagogjik-shkencor.

Ka pasur prirje të theksuar, sidomos në universitet, për të mbajtur më shumë studentë që sapo diplomoheshin si pedagogë e punonjës shkencorë, jashtë kritereve të caktuara nga Byroja Politike. Nuk janë tërhequr në masë të mjaftueshme specialistë të jashtëm, sidomos drejtpërsëdrejti nga prodhimi, për të dhënë mësim në universitet.

Byroja Politike e KQ duke u nisur nga nevoja e përmirësimit të mëtejshëm të punës për kualifikimin, zgjedhjen, edukimin dhe kalitjen e kuadrit në shkollat e larta e në institucionet shkencore, si dhe me qëllim që të ndreqen dobësitë e sipërme, porosit:

I

Të aprovohet në parim sistemi i kualifikimit të kuadrit të shkollave të larta dhe të institucioneve shkencore dhe për dhënien e titujve shkencorë në bazë të raportit që paraqiti Komisioni Qendror i Arsimit duke pasur parasysh kriteret e mëposhtme:

1. — Sistemi i gradave e i titujve shkencorë të jetë sipas këtij shkallëzimi: kandidat i shkencave, docent ose bashkëpunëtor i vjetër shkencor, doktor i shkencave, profesor.

a) Gradat shkencore, kandidat i shkencave dhe doktor i shkencave t'u jepen si punonjësve të shkollave të larta e institucioneve shkencore, ashtu edhe kuadrove që punojnë në sektorë të ndryshëm, sidomos atyre të prodhimit dhe administratës.

b) Titujt shkencorë docent (bashkëpunëtor i vjetër shkencor) dhe profesor, t'u jepen në radhë të parë punonjësve të shkollave të larta e institucioneve shkencore, si dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm të tyre, që punojnë në prodhim apo në sektorë të tjerë të shërbimit e të administratës.

c) I rekomandohet Këshillit të Ministrave që të bëjë ndryshimet e nevojshme në vendimet përkatëse, në mënyrë që kualifikimi e rikualifikimi i kuadrove pedagogjiko-shkencorë dhe i specialistëve të tjerë që inkludohen në këtë veprimtari, të mbajë

parasysh edhe shkallëzimin e mësipërm të gradave e titujve shkencorë. Gjithashtu të studiojë mundësinë e krijimit të titujve të veçantë për specialistët e prodhimit, në vartësi nga sektori i punës e i specialitetit që kanë.

2. — Në përshtatje me këtë sistem të ri të gradave e titujve shkencorë të përcaktohen edhe shkallëzimet e vendeve të punës të personelit pedagogjiko-shkencor të shkollave të larta dhe të institucioneve shkencore:

- Asistent (bashkëpunëtor tekniko-shkencor);
- pedagog (bashkëpunëtor shkencor), duke synuar që në të ardhmen të jetë edhe kandidat i shkencave;
- docent (bashkëpunëtor i vjetër shkencor);
- doktor i shkencave;
- profesor.

3. — Në përshtatje me këtë shkallëzim i rekomandohet Këshillit të Ministrave të përcaktojnë kërkesat për çdo gradë e titull, kushtet për të kaluar nga njëra shkallë te tjetra, si dhe diferencimet e nevojshme në pagat, duke ruajtur kufijtë e sotëm (pagën e asistentit ose bashkëpunëtorit tekniko-shkencor si kufi minimal dhe atë të profesorit si kufi maksimal).

4. — Kujdes i veçantë t'i kushtohet organizimit të punës për marrjen e titujve pedagogjiko-shkencorë, e sidomos organizimit të shkallës së parë të kualifikimit për fitimin e gradës shkencore kandidat i shkencave. Për këtë qëllim:

a) Në radhë të parë të krijohen koncepte të drejta, si tek ata që punojnë për t'i fituar, ashtu dhe tek ata që janë autorizuar t'i japin, se titujt e gradat shkencore duhet të vijnë si rezultat i një pune këmbëngulëse, se kjo lidhet me detyrën e ngritjes së vazhdueshme të nivelit të punës mësimore e shkencore në shkollat e larta e institucionet shkencore dhe jo për të siguruar një titull si qëllim në vetvete, një rrogë më të madhe apo një vend në një institucion mësimor-shkencor.

b) Kualifikimi i kuadrit pedagogjiko-shkencor të bëhet në përgjithësi pa shkëputje nga puna. Vetëm me autorizim të organeve drejtuese të shkollave të larta apo të Akademisë së Shkencave, dhe vetëm për marrjen e gradës shkencore kandidat i shkencave mund të lejohet në ndonjë rast shkëputja e pjesshme nga puna. Ndërsa, për analogji me rregullat që janë në fuqi, të përcaktohen nga Këshilli i Ministrave lehtësitë e nevojshme për kohën e dhënies së provimeve apo mbrojtjes së dizertacioneve, me ose pa shkëputje nga puna.

Ka rëndësi të kuptohet drejt se për kualifikimin e mëtejshëm duhet pasion i madh për të mësuar, për t'u njohur me të rejat e shkencës, për të rritur njohuritë shkencore. Çdo pedagog apo punonjës shkencor këtë duhet ta konsiderojë si një nevojë të domosdoshme për t'i shërbyer më mirë shoqërisë, përparimit të arsimit

e të shkencës sonë socialiste. Për këtë qëllim nga secili kërkohet një punë këmbëngulëse dhe e vazhdueshme, duke bërë edhe sakrificë, sepse paralelisht çdo kuadri do t'i duhet të kryejë edhe punën për të cilën është ngarkuar me normë e cilësi të lartë, edhe të studiojë e të eksperimentojë për kualifikimin e tij.

c) Të drejtën për të konkurruar për tituj e grada shkencore e kanë si kuadrot e institucioneve mësimore-shkencore ashtu edhe ata të prodhimit e të administratës.

c) Sistemi i kualifikimit të lartë shkencor, i ndërtuar mbi bazën e këtyre orientimeve, të bëhet gradualisht krahas me krijimin e mundësive për organizimin e kësaj përgatitjeje, duke filluar atje ku kemi më shumë nevojë e më shumë kushte dhe duke e shtrirë e zgjeruar vit pas viti. Për të gjitha rastet duhet të rriten kërkesat dhe tematika e punimeve shkencore të jetë e lidhur ngushtë me nevojat që kanë sektorët e ndryshëm të ekonomisë, të ndërtimit apo të arsim-kulturës. Vlerësimi i tyre të bëhet me diskutime e mbrojtje publike.

5. — Ministria e Arsimit dhe e Kulturës dhe vetë institucionet mësimore-shkencore të marrin masa serioze për organizimin gradual të kualifikimit e rikualifikimit të kuadrit, duke pasur parasysh:

a) Që kjo punë nuk duron globalizmin, ajo nuk mund të kapet menjëherë në front të gjerë. Duhet përcaktuar, në bazë të kushteve dhe nevojave, nga cilat shkenca të fillohet, cilat të jenë kërkesat për kualifikim, kush do të jenë udhëheqësit e kualifikimit, me ç'ritme do të ecet etj. Ka rëndësi të veçantë zgjedhja e kujdesshme e kuadrove që do të udhëheqin kualifikimin. Këta pa dyshim duhet të jenë nga profesorët e shkencëtarët tanë më të shquar, të cilët do të jetë e nevojshme të lehtësohen nga punët që kryejnë, në mënyrë që t'i kushtohen seriozisht detyrës së kualifikimit shkencor të kuadrit.

b) Kuadrot pa tituj e grada shkencore që sot punojnë në shkollat e larta e institucionet shkencore si pedagogë ose si bashkëpunëtorë shkencorë e që nuk e kanë mbushur moshën 40 vjeç (në kohën e aprovimit të dispozitave të reja për grada e tituj shkencorë), të futen në shkallën e parë të kualifikimit për marrjen e gradës kandidat i shkencave. Kurse ata që janë mbi moshën 40 vjeç, mund të mbeten si pedagogë e bashkëpunëtorë shkencorë edhe pa marrë gradën e kandidatit të shkencave, por duke iu nënshtruar atestimit përkatës periodik (në çdo 3-4 vjet). Kushtet konkrete për të fituar atestimin duhen përcaktuar me rregullore të veçantë. Ky atestim të fillojë që nga viti shkollor 1973-1974. Atestimi i rregullt periodik duhet të bëhet edhe për kuadrot e tjerë, pavarësisht nga moshë, duke filluar me asistentët (bashkëpunëtorët tekniko-shkencorë) e gjer te docentët (bashkëpunëtorët e vjetër shkencorë).

6. — Të forcohet kontrolli sistematik mbi punën e personelit pedagogjiko-shkencor të shkollave të larta e të institucioneve shkencore, si kontrolli gjithëvjetor ashtu edhe ai në fund të vitit, duke ngarkuar për këtë qëllim dekanatet e katedrat, si dhe duke aktivizuar edhe kontrollin nga poshtë, nga punëtorët e studentët.

Të gjithë ata pedagogë e punonjës shkencorë, qofshin edhe me tituj ose grada shkencore, që nga këto kontrolle rezultojnë të paaftë, ose edhe ata që nuk do të fitojnë në të ardhmen atestimin, duhet të zëvendësohen me kuadro të aftë. Largimi i tyre nga shkollat e larta e institucionet shkencore është i nevojshëm në mënyrë që të luftohen si pikëpamjet e gabuara se vendi i punës në këto institucione është i përjetshëm, ashtu edhe hatëret apo sentimentalizmat e sëmura, që dëmtojnë, në radhë të parë, interesin e madh të ngritjes së nivelit shkencor të shkollave të larta e institucioneve shkencore.

II

T'u kushtohet kujdes i veçantë zgjedhjes, vendosjes dhe kualifikimit të kuadrove në shkollat e larta dhe institucionet shkencore, duke pasur parasysh udhëzimet që ka dhënë Partia për këtë qëllim.

1. — Kurdoherë në zgjedhjen e kuadrove që do të punojnë në këto institucione, në radhë të parë, të mbahen parasysh si ana politike dhe figura morale, ashtu edhe aftësia për të kryer më së miri një detyrë të tillë me rëndësi siç është ajo e edukatorit dhe e shkencëtarit.

2. — Byroja Politike rithekson se plotësimi i kuadrit në shkollat e larta e në institucionet shkencore të bëhet kryesisht nga radhët e kuadrove që punojnë në prodhim, që kanë një stazh pune të paktën prej 5 vjetësh, që janë dalluar në punë dhe kanë bërë e bëjnë përpjekje për ngritjen e nivelit të tyre ideopolitik e shkencor, që kanë fituar ose punojnë për të fituar gradën shkencore të kandidatit të shkencave. Tërheqja e tyre të bëhet duke respektuar të gjitha normat e partisë e nomenklaturat që janë në fuqi.

3. — Në rastet kur është e domosdoshme dhe nevojat nuk plotësohen me kuadrot që kanë eksperiencën e bazës, mund të mbahen në shkolla dhe në institucionet shkencore disa nga kuadrot më të talentuar që sapo mbarojnë studimet, të cilët të zgjidhen me shumë kujdes si për qëndrimin politik, për jetën aktive revolucionare që kanë bërë në shkollë si anëtarë të BRPSH, ashtu dhe nga rezultatet në mësim. Kjo është e lejueshme vetëm për disa degë të shkencave të karakterit teorik dhe vetëm në masën 5 për qind të kontingjentit që diplomohet për degën përkatëse.

4. — Sidomos në shkollat e larta të tërhiqen më me guxim e në sasi më të madhe se deri tani, si kuadro të jashtëm, sa më shumë specialistë të prodhimit e punonjës shkencorë. Çdo fakultet e çdo katedër duhet të studiojë me kujdes e të përcaktojë për cilat lëndë, leksione apo tema të veçanta do të tërheqë kandidatë të jashtëm nga Tirana apo nga rrethet e tjera. Porositen dikasteret e organizatat qendrore, si dhe organet e Partisë e të pushtetit në rrethe që të ndihmojnë shkollat e larta në zgjidhjen e kësaj çështjeje, duke pasur parasysh se një masë e tillë jo vetëm përbën një rezervë të madhe për të mos grumbulluar shumë kuadro në organikën e shkollave të larta, por ajo do t'i shërbejë edhe ngritjes së nivelit shkencor e mësimor, sidomos të lidhjes së teorisë me jetën. Kjo do të jetë edhe për vetë kuadrot e prodhimit një nxitje për të përpunuar shkencërisht edhe eksperiencën e prodhimit.

III

Në shkollat e larta e në institucionet shkencore, të punohet për të zbatuar me vendosmëri masat që ka caktuar Partia për revolucionarizimin e vazhdueshëm të kuadrove, sidomos ato që kanë të bëjnë me qarkullimin dhe punën drejtpërdrejt në prodhim të kuadrit pedagogjiko-shkencor.

1. — Duke hedhur poshtë pikëpamjet e gabuara, se gjoja qarkullimi dëmton apo pengon procesin mësimor e punën shkencore, apo se gjoja kuadrot po të shkojnë në bazë skualifikohen, organizatat e Partisë dhe organet drejtuese të shkollave të larta e të institucioneve shkencore duhet të kenë parasysh se orientimet e Partisë për qarkullimin e kuadrove dhe punën drejtpërdrejt të tyre në prodhim, janë të domosdoshme të zbatohen, pikërisht për vetë specifikën e këtyre sektorëve. Kuadrot e këtyre sektorëve, më tepër se kushdo tjetër, kanë nevojë të lidhen me jetën, të punojnë e të jetojnë bashkë me masat, të kaliten, të luftojnë intelektualizmin e teknokratizmin që më lehtë mund të gjejnë terren në punonjësit e zyrave, të shkollave apo të institucioneve shkencore.

2. — Organet drejtuese të institucioneve shkencore e të shkollave të larta, duke filluar që nga ky vit shkollor, të zbatojnë, në bazë të një plani të studiuar me kujdes, orientimet e Partisë për qarkullimin e kuadrit. Për këtë të kenë parasysh:

a) Qarkullimi të bëhet në mënyrë graduale e të planifikuar në mënyrë që të mos dëmtohen zhvillimi i procesit mësimor apo programet shkencore. Por duke theksuar këtë çështje, duke mbrojtur interesat e institucioneve, të mësimit e të zhvillimit të shkencës, në asnjë mënyrë nuk duhet të lihet pas dore zbatimi i

direktivës së Partisë dhe aq më pak të mbrohen arrivistët dhe ata që nuk e vlerësojnë nevojën e qarkullimit.

b) Shkollat e larta dhe institucionet shkencore duke marrë masat për qarkullimin, të plotësojnë nevojat goftë duke tërhequr në vend të tyre kuadro të tjerë, sipas kritereve që u theksuan më sipër, goftë duke shfrytëzuar rezervat që mund të kenë lidhur me zbatimin e drejtë të normave të mësimdhënies e të punës shkencore, që duhet të studiohet mirë.

c) Kuadrot që do të qarkullojnë të caktohen me punë në prodhim e në bazë sipas profilit që kanë, në mënyrë që gjatë punës në prodhim të plotësojnë e të pasurojnë më tej dijenitë e tyre.

IV

Në bazë të kritereve të sipërme të aprovohen nga Këshilli i Ministrave ndryshimet që eventualisht duhen bërë në rregulloret e dispozitat ekzistuese për sigurimin e kualifikimin e kuadrit në shkollat e larta e në institucionet shkencore.

Gjithashtu Këshilli i Ministrave të studiojë, në bazë të orientimeve të vazhdueshme të Partisë, vendimeve të Qeverisë si dhe të kritereve që mban ky protokoll, organizimin e kualifikimit dhe rikualifikimit të kuadrit të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë e kulturës, duke u dhënë përparësi atyre sektorëve e specialiteteve ku nevojat janë më të mëdha e më urgjente dhe ku mundësitë për organizimin e kësaj pune ekzistojnë.

*
* *

Byroja Politike shpreh bindjen se organizata e Partisë në shkollat e larta dhe në institucionet kërkimore, gjithë punonjësit dhe drejtuesit e këtyre institucioneve do të vënë të gjitha forcat për edukimin ideopolitik e tekniko-profesional të kuadrove dhe për revolucionarizimin e mëtejshëm e të vazhdueshëm të tyre.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PLENUMI I 4-T I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 26-28 qershor 1973

K O M U N I K A T E

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Nga data 26 deri 28 qershor 1973, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi i 4-t i Komitetit Qendror të PPSH, i cili dëgjoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja dhe qëndrimeve liberale ndaj tyre», mbajtur nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha.

Plenumi diskutoi gjerësisht rreth raportit dhe e aprovoi atë njëzëri.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

RAPORT I MBAJTUR NGA SEKRETARI I PARË I KQ TË PPSH, SHOKU ENVER HOXHA, «TË THELLOJMË LUFTËN IDEOLOGJIKE KUNDËR SHFAQJEVE TË HUAJA E QËNDRIMEVE LIBERALE NDAJ TYRE»

26 qershor 1973

Shokë dhe shoqe,

Ky Plenum i Komitetit Qendror i kushtohet një problemi të madh e jetik për Partinë dhe çështjen e ndërtimit socialist, problemit të luftës kundër ndikimeve të ideologjisë së huaj borgjeze e revizioniste, për rrënjosjen e ideologjisë proletare në të gjitha frontet, në çdo kohë dhe veçanërisht në kushtet e tanishme të rrethimit armiqësor imperialisto-revizionist të vendit.

Këto probleme, me të cilat ne jemi ndeshur vazhdimisht, kohët e fundit janë bërë më të mprehta, prandaj edhe kanë tërhequr në mënyrë të veçantë vëmendjen e Partisë dhe të të gjitha masave punonjëse. Partia kritikoi me guxim e me principialitet marksist-leninist mjaft shfaqje të huaja, që ishin dukur në disa sfera të jetës sonë shoqërore, si rezultat i ndikimeve të shoqërisë së vjetër e sidomos i presionit të botës kapitaliste e revizioniste. Masat që janë marrë për të luftuar këto fenomene negative, përbëjnë një hap të mëtejshëm me rëndësi në thellimin e procesit të revolucionarizimit të të gjithë jetës së vendit.

Megjithëse ka kaluar një kohë relativisht e shkurtër, që kur Partia i ngriti përpara gjithë popullit këto probleme, vërehet me kënaqësi se është bërë një punë e madhe dhe janë arritur rezultate mjaft pozitive në të gjitha fushat. Në radhë të parë, duhet vënë në dukje kuptimi i thellë, aprovimi unanim dhe gatishmëria që shprehën me këtë rast komunistët, klasa punëtore, rinia dhe të gjithë punonjësit. Tani kudo është krijuar një atmosferë e gjallë

debati e ballafaqimi për të kritikuar të metat, për të zbuluar dobësitë e shfaqjet e huaja në qendrat e punës, në institucionet kulturore-artistike, në shkolla e në familje, për të përcaktuar rrugët efektive të kapërcimit të tyre. Në qytet e në fshat po krijohet një frymë e shëndoshë mobilizimi për realizimin e planit e për kryerjen e detyrave, për forcimin e disiplinës proletare në punë dhe për mbrojtjen e pasurisë së popullit. Është ngritur në një shkallë të re më të lartë vigjilenca ideologjike e politike ndaj armiqve të brendshëm e të jashtëm dhe përgatitja luftarake për mbrojtjen e atdheut.

Në këtë atmosferë revolucionare kanë shpërthyer një varg iniciativash të vlefshme në sferën e prodhimit, të ideologjisë e të kulturës etj. Ato janë një shprehje konkrete e kuptimit të drejtë të situatave të brendshme e të jashtme në të cilat jetojmë, e vetive të larta morale që ka rrënjësuar Partia në popullin punonjës, e unitetit të çeliktë të tij rreth Partisë dhe vijës së saj të drejtë marksiste-leniniste.

Të gjitha këto janë një premisë dhe garanci për suksese edhe më të mëdha në të ardhmen. Por ne nuk mund të kënaqemi me këtë që është arritur dhe as mund të mendojmë se problemet e ngritura kohët e fundit nga Partia tanimë janë zgjidhur plotësisht. Përkundrazi, është e domosdoshme të ndalemi e të thellohemi akoma më tej në disa drejtime të rëndësishme të luftës klasore për të shkatërruar të gjitha ndikimet e ideologjisë së huaj, të së kaluarës dhe të sotme, borgjeze e revizioniste, për të forcuar edhe më shumë diktaturën e proletariatit, për të çuar përpara pa ndërprerje revolucionin dhe ndërtimin tonë socialist.

Shokë,

Lufta kundër ideologjisë së huaj për rrënjësuar e ideologjisë socialiste në të gjithë punonjësit e në të gjitha frontet ka qenë kurdoherë një ndër preokupacionet kryesore në tërë veprimtarinë e Partisë. Këtë luftë ajo e ka parë gjithnjë si një ndër kushtet themelore për zhvillimin e pandërprerë të revolucionit dhe ndërtimin e socializmit, për formimin dhe për kalitjen e njeriut të ri të shoqërisë së re. Ajo e ka parë këtë, gjithashtu, si një kusht të domosdoshëm për vetë ekzistencën dhe zhvillimin e saj si parti marksiste-leniniste, për të qenë e aftë të kryejë qoftë detyrën e saj kombëtare, ashtu edhe detyrën e saj internacionaliste.

Lindja dhe ardhja në fuqi e revizionizmit në Bashkimin Sovjetik e në disa vende të tjera, ku nënvleftësimi i luftës kundër ndikimeve të ideologjisë borgjeze u bë një ndër shkaqet e rëndësishme të degjenerimit të rendit socialist dhe të vetë partisë, na e forcon edhe më tepër bindjen tonë të drejtë se pa një luftë

këmbëngulëse për çrrënjësuar e ndikimeve të ideologjive të huaja, qoftë të vjetra feudale e mikroborgjeze, qoftë të sotme borgjeze e revizioniste, pa arritur fitoren vendimtare të revolucionit socialist edhe në frontin ideologjik, nuk mund të jenë të sigurta fitoret e tij as në frontin ekonomik e politik.

Të gjithë ne jemi dëshmitarë për sukseset e mëdha e me rëndësi historike që janë arritur në luftën e vendosur që Partia, në krye të masave punonjëse, ka zhvilluar kundër ideologjisë borgjeze e revizioniste, ideologjisë fetare, patriarkale e feudale. U krye një hop i madh cilësor për emancipimin e plotë të gruas, u morën masa të rëndësishme për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës, për çrrënjësuar e burokratizmit etj. Rezultate të mëdha janë arritur në edukimin revolucionar të njeriut të ri, janë krijuar te punonjësit bindje të thella ideologjike socialiste lidhur me punën, me pronën, me shoqërinë, me familjen. Parulla e Partisë «të mendojmë, të punojmë, të luftojmë e të jetojmë si revolucionarë» frymëzon e mobilizon të gjithë njerëzit tanë.

Kongresi i 6-të i Partisë, duke e thelluar më tej këtë proces revolucionarizimi, e vuri theksin më me forcë te nevoja e një lufte frontale jo vetëm kundër mbeturinave e gjurmëve konservatore të së kaluarës, por sidomos edhe kundër ndikimeve të rrezikshme të ideologjisë së sotme borgjeze, revizioniste e liberale, e cila ushtron pa ndërprerje e intensivisht presionin e saj mbi ne. Këtë luftë në dy fronte me shumë të drejtë ai e quajti si një kusht vendimtar për të siguruar fitore të qëndrueshme në luftën kundër ideologjive të huaja.

Fitoret e arritura në luftën kundër shfaqjeve e ndikimeve të huaja janë të mëdha. Por ne nuk mund të mos mbajmë parasysh se, në kushtet aktuale të rrethimit dhe të një presioni të gjithanshëm imperialisto-revizionist, jemi shumë larg asaj që të mendojmë se jemi të imunizuar nga rreziqet. Sukseset që ka arritur Partia jonë në luftën për demaskimin e imperializmit dhe të revizionizmit në plan politik e teorik, sidomos në polemikën e madhe me revizionizmin modern, nuk duhet të na çojnë të mendojmë në asnjë rast se ato përbëjnë në të njëjtën kohë edhe një barrierë të pakapërcyeshme për depërtimin e ideologjisë së huaj në fusha të ndryshme të jetës së vendit dhe në ndërgjegjen e njerëzve tanë. Fakt është se armiqtë nuk e kanë pushuar aspak luftën që bëjnë kundër nesh. Ata kanë ndryshuar vetëm taktikën, duke i përqendruar përpjekjet e tyre sidomos në frontin ideologjik. Për t'i hapur rrugën degjenerimit të njerëzve e të rendit tonë socialist, më shpesh dhe me më shumë dëshirë, ata shfrytëzojnë vatrat dhe gjurmët e ideologjive të vjetra në ndërgjegjen e punonjësve, veçanërisht konceptet e shprehita individualiste mikroborgjeze. Armiqtë e brendshëm e të jashtëm inkurajojnë e përkrahin njëri-tjetrin në rrugë e forma të ndryshme, bashkë-

rendojnë veprimtarinë e tyre kundër pushtetit popullor e socializmit.

Nga ana tjetër, ka situata në botë që vetvetiu të shtyjnë drejt një mobilizimi të madh për të rritur vigjilencën e për t'i grumbulluar të gjitha forcat kundër ideologjisë e politikës, qëndrimeve e veprimeve të armikut.

Një erë pacifiste e kapitullimit po mbyllet atmosferën. Një frymë pajtimi e kompromisi përpiqen imperialistët amerikanë e revizionistët sovjetikë të përhapin në Evropë e në Azi, në Afrikë e në Amerikë. Tani po përfundon lufta në Vietnam, po flitet se edhe gjendja në Lindjen e Mesme mund të rregullohet në mënyrë paqësore, po bëhet fjalë për njëfarë sigurimi e pakësimi trupash në Evropë, po reklamohen gjerësisht rezultatet e përmirësimit të marrëdhënieve midis fuqive të mëdha dhe po propagandohen shumë takimet e bisedimet e shpeshta midis burrave të shtetit etj. Këto situata mund të krijojnë një frymë çmobilizimi, mund të krijojnë opinionin se lufta është larg, se «bota po qetësohet».

Taktika e përhapjes së kësaj psikoze paqësore të rreme, si mjet për të përçarur më mirë agresionin ushtarak e ideologjik, mbështetet tani nga një mori teorish e doktrinash, që imperialistët e revizionistët i kanë krijuar posaçërisht për këtë punë. Ata flasin shumë për «bashkekzistencë paqësore», për «ulje tensioni», për «bisedime» etj. Të gjitha këto nuk janë parulla të thjeshta propagandistike, por edhe mekanizma ideologjikë, mjete për krijimin e një psikologjie të përgjithshme fataliteti ndaj ngjarjeve që ndodhin në botë, janë përpjekje për t'i përgatitur popujt edhe ideologjikisht që të pranojnë arbitraritetin e super të mëdhenjve dhe fatin që u caktojnë ata.

Këtë frymë pacifiste imperialistët e revizionistët orvaten ta futin edhe te ne me anë të lajkave, të propozimeve për «marrëdhënie normale», duke u përpjekur të na mbushin mendjen se asnjë rrezik s'na kërcënon dhe se mund të jetojmë të çmobilizuar e të shkujdesur. Kjo taktikë djallëzore e shumë e rrezikshme synon të na mbyllë vigjilencën dhe të nxitë e të inkurajojë liberalizmin e shturjen. Për ne duhet të jetë e qartë se edhe në qoftë se aktualisht ekziston njëfarë ulje tensioni, kjo mund të jetë e vërtetë vetëm midis superfuqive imperialiste, por nuk ka e nuk do të ketë ulje tensioni midis atyre e nesh, midis popujve nga njëra anë dhe imperialistëve e socialimperialistëve nga ana tjetër. Ne e kemi krejtësisht të qartë se strategjia imperialisto-revizioniste për të shuar luftërat e lëvizjet revolucionare, çdo rezistencë kundër hegjemonisë së tyre, për të shkatërruar e për të shtypur çdo forcë, shtet apo parti që kundërshton sundimin e tyre, ka mbetur e pandryshuar. Kanë ndryshuar vetëm taktikat si dhe mjetet që përdorin, të cilat janë bërë më të shumta e më të përsosura.

Marrëveshjet e bashkëpunimi midis fuqive të mëdha, para

së gjithash midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës e Bashkimit Sovjetik, të cilat sapo vijnë e zgjerohen, nuk mund të mos shprehën dhe të mos përfundojnë në një rritje të presionit të tyre ndaj vendeve të vogla të pavarura, në shtimin e përpjekjeve për të ndërhyrë në punët e brendshme të vendeve sovraane, në intensifikimin e luftës për t'i detyruar të tjerët të pranojnë diktatin e tyre në çështjet e marrëdhënieve ndërkombëtare, në zgjerimin e veprimtarisë për t'u imponuar popujve e kombeve mënyrën e tyre të të menduarit e të të jetuarit. Është e natyrshme që në këtë situatë të re të bëhet edhe më i madh presioni i gjithanshëm ekonomik, politik e ushtarak imperialisto-revizionist mbi vendin tonë, me qëllim që të mbyllë të vetmin zë në Evropë që ngrihet me guxim kundër politikës së tyre agresive ekspansioniste, që u çjerr maskën me guxim planeve të errëta, demagogjisë e mashtrimeve të superfuqive kundër popujve e revolucionit.

Imperialistët e revizionistët kanë dashur e duan likuidimin e socializmit në Shqipëri. Këtë ne e dimë. Por ajo që duhet të mbajmë më mirë parasysh është se për ne nuk ekziston vetëm rreziku i drejtpërdrejtë ushtarak, por edhe agresioni ideologjik. Për më tepër, presioni dhe lufta ideologjike që na bën armiku është parapërgatitje e pararendëse edhe për një sulm të mundshëm ushtarak. Ne nuk duhet të harrojmë për asnjë çast se jemi një vend i vogël dhe, për shkak të qëndrimeve parimore revolucionare, ndodhemi në qendër të presioneve të gjithanshme ideologjike të botës kapitaliste e revizioniste. Nga ana tjetër, ne nuk mund të jetojmë të izoluar nga bota e jashtme, ndikimet e së cilës me anën e mjeteve të ndryshme të informacionit e të propagandës, që sot janë masivizuar e përsosur si asnjëherë më parë, si dhe nëpërmjet kontakteve, që s'mund të shmangen, depërtojnë në vendin e në njerëzit tanë nëpër shumë kanale. Prandaj, Partia e ka theksuar shumë herë se krahas përgatitjes serioze ushtarake dhe ekonomike për çdo të papritur, duhet të merren të gjitha masat e të mobilizohen të gjitha forcat për të shpartalluar edhe agresionin ideologjik të armikut. Në këtë luftë për jetë a për vdekje ne duhet të mbajmë parasysh se presioni ideologjik është i përhershëm, se kundër tij nuk luftohet e fitohet vetëm një herë, por kundër tij duhet luftuar e duhet fituar çdo ditë, çdo muaj, çdo vit.

Thelbi i këtij agresioni ideologjik dhe synimi kryesor i armikut të klasës në kushtet e sotme për degjenerimin e rendit socialist, të politikës së brendshme e të jashtme të Partisë e të shtetit tonë, është nxitja e liberalizmit në të gjithë frontin.

Është pikërisht kjo rruga nëpër të cilën në Bashkimin Sovjetik e në disa vende të tjera u arritën ato rezultate kundërrevolucionare, që imperializmi nuk kishte mundur t'i arrinte as me intervencionin e armatosur e as me anën e agresionit fashist. Nën

parullën e liberalizmit u hodh baltë mbi Stalinin e veprën e tij dhe u shkatërrua diktatura e proletariatit. Nën këtë parullë u hap rruga për reformat ekonomike revizioniste, që çuan në likuidimin e marrëdhënieve socialiste në prodhim e në zëvendësimin e tyre me marrëdhënie të reja kapitaliste. Në jetën shpirtërore liberalizmi u bë kyçi që hapi dyert për vërshimin e kulturës e të mënyrës së degjeneruar perëndimore të jetesës. Dhe përsëri po nën këtë parullë u hodh poshtë vija e luftës së vendosur kundër imperializmit, vendin e së cilës e zuri politika hrushoviane e hapjes drejt Perëndimit dhe e bashkëpunimit të gjithanshëm me imperializmin amerikan.

Liberalizmi mund të shfaqet në fushat e në format më të ndryshme. Por sido e kudo që të paraqitet, ai është në thelb shprehje e oportunitetit ideologjik e politik, heqje dorë nga lufta klasore konsekuente kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, kundër njollave të shoqërisë së vjetër dhe ndikimeve të sotme të ideologjisë së huaj, është pranim i bashkëjetesës paqësore me ideologjinë armike. Duke nxitur liberalizmin, armiqtë kërkojnë që ne të heqim dorë nga qëndrimet e lufta jonë parimore kundër revizionizmit modern, të heqim dorë nga lufta e vendosur kundër imperializmit dhe të hapim kufijtë «për qarkullimin e lirë të njerëzve, të ideve e të kulturave». Ata duan të përhapin një kuptim liberal e anarkist të demokracisë socialiste, me qëllim që të shtuhin disiplinën proletare në punë, të minojnë diktaturën e proletariatit. Ata dëshirojnë që njerëzit tanë të kulturës e të arteve të braktisin partishmërinë proletare për t'i hapur rrugën lulëzimit të gjithfarë rrymave dekadente borgjeze e revizioniste. Ata kërkojnë që njerëzit tanë, rinia e të gjithë punonjësit, të përqafojnë mënyrat e degjeneruara të sjelljes, të shijes e të jetesës së botës së kalbur borgjezo-revizioniste.

Karakteristikë e diversionit të sotëm ideologjik të borgjezisë e të revizionizmit kundër socializmit është bashkimi në një front të vetëm i rrymave themelore kundërrevolucionare, që nga ideologjia e mirëfilltë borgjeze me karakter të hapët antikomunist e deri tek oportunitizmi i vjetër tradicional, që nga revizionistët modernë e deri te rrymat e sotme oportuniste të ashtuquajtura të majta. Të gjithë këta, pavarësisht nga ç'pozitë e goditin mark-sizëm-leninizmin e socializmin, pavarësisht me ç'parulla e «argumente» dalin kundër tyre, bashkohen në synimin kryesor, në qëllimin për të treguar se kapitalizmi i ka kapërcyer kontradiktat e tij, se shoqëria borgjeze është përmirësuar, se tanimë kapitalizmi e socializmi po konvergojnë drejt një shoqërie të njëjtë, se s'ka më vend për luftë klasore, s'ka më vend për përmbyse revolucionare, s'ka më vend për ideale komuniste etj.

Për të propaganduar këtë tezë thellësisht reaksionare, për të trullësuar mendjen e njerëzve, për të çoroditur psikikën e tyre

dhe për të futur degjenerimin, borgjezia dhe revizionistët kanë ngritur në këmbë një industri tepër të fuqishme të helmimit të opinionit publik, e cila, për nga kapitalet e vëna dhe njerëzit e zënë në të, i kalon edhe degët më të mëdha të ekonomisë. Në dispozicion të tyre ndodhen mjete të shumta të komunikimit masiv, me ta janë të lidhura ngushtë letërsia dhe arti, moda e reklama, shtypi e radioja, televizioni dhe filmi.

Kjo valë e madhe propagandistike përplasat edhe në brigjet tona. Ajo plekset ngushtë me shumë njolla të së kaluarës në ndër-gjegjen e punonjësve, veçanërisht me shfaqjet e individualizmit mikroborgjez. Këto dy anë ushqejnë njëra-tjetrën, e vjetra dhe modernistja shkrihen në një front të vetëm luftime kundër socializmit e diktaturës së proletariatit. Për pasojë, edhe lufta jonë kundër këtyre dy të këqijave përbën një front të vetëm kompleks e të pandarë. Detyra jonë është që ta përballojmë me të gjitha forcat e mjetet presionin e ndikimeve të huaja ideologjike, që ushtrohet pikërisht në këto rrethana të reja të jashtme e të brendshme dhe të kundërsulmojmë aktivisht. Këtë luftë duhet ta konsiderojmë si një nga aspektet më të rëndësishme të luftës klasore për fitoren e rrugës socialiste mbi atë kapitaliste.

Diskutimi i gjerë në Parti e në masa për luftën kundër ndikimeve të huaja e shfaqjeve liberale vërtetoi se shqetësimet e Partisë dhe ato të punonjësve ishin plotësisht me vend. Gjatë këtij diskutimi dolën mjaft probleme të karakterit ideologjik që kanë të bëjnë me zhvillimin në rrugë të drejtë të artit e të letërsisë, të arsimit e të kulturës, me edukimin e rinisë, me forcimin e disiplinës, që kanë të bëjnë me përmirësimin e mëtejshëm të vepërmirësimit të vetë Partisë dhe me rritjen e rolit udhëheqës të saj. Të gjitha këto probleme ne duhet t'i analizojmë në këtë Plenum në frymë kritike e autokritike dhe të përcaktojmë rrugët e masat për ta mbajtur gjallë atmosferën revolucionare që është krijuar dhe për ta çuar akoma më përpara luftën e Partisë në të gjitha frontet.

FORCIMI I PARTISHMËRISË PROLETARE KUSHT I DOMOSDOSHËM PËR ZHVILLIMIN NË RRUGË TË DREJTË TË LETËRSISË E TË ARTEVE

Partia ka treguar një kujdes të vazhdueshëm për zhvillimin në rrugë të drejtë të letërsisë e të arteve dhe i ka konsideruar ato gjithmonë si mjete të fuqishme për edukimin komunist të masave, veçanërisht për formimin ideestetik të tyre. Letërsia dhe artet kanë ecur në një hap me tërë zhvillimin e jetës së vendit, me thellimin e revolucionit ideologjik e kulturor dhe kanë

dhënë një kontribut të madh për formimin e edukimin e njeriut të ri, për ngritjen në një shkallë më të lartë të kulturës sonë të re socialiste.

Shkrimtarët dhe artistët tanë, të udhëhequr nga mësimet e Partisë, besnikë ndaj marksizëm-leninizmit, kanë krijuar vepra të frymëzuara dhe me brendi të shëndoshë. Arti ynë me përmbajtje socialiste dhe revolucionare ka vulën kombëtare, shpreh ndërgjegjen e popullit tonë në momentet e mëdha historike që kemi kaluar dhe po kalojmë. Ky art pëlqehet nga masat dhe është një ushqim shpirtëror për to. Populli i do dhe i respekton shkrimtarët dhe artistët e vet.

Sukseset e letërsisë e të artit flasin qartë për gjallërimin e metodës së realizmit socialist, të parimit të saj themelor të partishmërisë proletare, për harmonizimin e saj me frymën popullore e kombëtare dhe traditën e shëndoshë realiste. Zhvillimi i arteve, ashtu si ai i gjithë jetës shpirtërore të shoqërisë sonë, është bërë në luftë me ndikimet e huaja ideologjike të vjetra e të reja, konservatore e moderniste, sidomos me ato borgjezo-revizioniste. Një rëndësi të veçantë në këtë luftë kanë pasur orientimet e Plenumit të 15-të të vitit 1965 të Komitetit Qendror.

Por vitet e fundit, si rezultat i presionit të ideologjisë së huaj, e sidomos i dobësive të karakterit subjektiv, në letërsi, në art e në kulturë janë vënë re disa ndikime të hapëta të ideologjisë borgjeze e revizioniste, janë mbajtur qëndrime liberale ndaj tyre. Ato i kanë sjellë dëm zhvillimit të letërsisë e të arteve tona. Në të gjitha diskutimet që janë zhvilluar është vënë në dukje rreziku që përbëjnë këto ndikime të huaja, si mjet i diversionit ideologjik imperialisto-revizionist, për t'i larguar letërsinë e artin nga rruga e drejtë revolucionare e realizmit socialist dhe nga tabani i shëndoshë kombëtar, për t'i shmangur ata nga vija e Partisë dhe nga orientimet e saj të drejta.

Në përhapjen e këtyre ndikimeve një rol të dorës së parë kanë luajtur imitimet e modeleve të huaja, të rrymave të vjetra e të reja dekadente e moderniste, kopjimet e hapëta e mekanike të modës së sotme artistike borgjeze e revizioniste, si dhe konceptimet e gabuara të proceseve të zhvillimit tonë të brendshëm, të cilat e kanë burimin edhe te boshllëqet në formimin politik, ideologjik e profesional të disa krijuesve.

Në disa vepra të letërsisë e të artit, drama, poezi e poema, tregime e novela, në ndonjë film etj., është shtrembëruar realiteti. Kontradiktat e ndryshme dhe lufta që zhvillojnë Partia e populli kundër fenomeneve negative, pengesave e vështirësive janë pasqyruar jo nga pozitat e Partisë, por nga pozita të kundërta me to. Kështu, në mjaft raste lufta kundër burokratizmit jepet e gabuar në thelbin e saj, organet e pushtetit tonë paraqiten të mbytura nga burokratizmi dhe masat punonjëse krejt të pafuqi-

shme në luftën kundër burokratëve. Në disa drama e vepra të tjera letrare kontradiktat në gjirin e popullit trajtohen gjithashtu shtrembër. Në emër të «së resë», synohet të mohohet e sotmja dhe lufta midis së vjetrës e së resë paraqitet si luftë e pashmangshme midis brezave. Ndikimet e huaja kanë çuar deri atje sa në ndonjë tregim të errësohen madhështia e Luftës Nacionalçlirimtare e heroizmi partizan.

Pasojë e ndikimeve të huaja është edhe kapja e tepruar pas temave të vogla intime, largimi nga problemet e mëdha shoqërore, tema e vetmisë së njeriut, kur ky na u shndërruak në kërmill, fik deti e absurditete të tjera, fenomene që janë të lidhura me ndikimin e filozofisë e të estetikës ekzistencialiste, si dhe të rrymave letrare, si simbolizmi etj. Këto fenomene që janë vërejtur në disa poezi e tregime, në tekste këngësh, në disa piktura etj., janë në kundërshtim me frymën militante revolucionare të letërsisë e të artit tonë, me patosin qytetar dhe me karakterin epik të tyre.

Në poezi është shfaqur prirja e përdorimit të një figuracioni të errët në kundërshtim me traditën e poezisë aq të qartë shqipe. Disa të paktë poetë të rinj filluan të adoptonin në poezitë e tyre hermetizmin. Kjo është fare e huaj për letërsinë tonë, për njerëzit tanë të një vendi socialist me një demokraci proletare. Shkrimet e errëta nga brendia e forma janë pjellë e mendimit dhe e ndjenjave të çoroditura të njerëzve ku sundon regjimi i kapitalit, i shtypjes dhe i shfrytëzimit të njeriut, i shtypjes kombëtare dhe i mungesës së lirisë së shprehjes së mendimeve.

Fenomene të kësaj natyre janë vënë re edhe në muzikën e lehtë, sidomos në atë ritmike, ku ka pasur deformime të vijës së qartë melodike dhe u është hapur rrugë ritmeve të shfrenuara. Kjo u duk sidomos në Festivalin e 11-të në Radiotelevizion. I tërë opinioni ynë shoqëror i refuzoi me indinjatë atë muzikë vulgare, ato këngë të përçmuara dhe atë paraqitje snobiste që ky festival na nxori në skenë. Ai me të drejtë e konsideron dhe e dënon atë si një ofendim që u bëhet traditës më të mirë kombëtare, frymës popullore dhe partishmërisë së artit tonë.

Shfaqje të tilla të huaja janë dukur edhe në disa piktura, në paraqitjen skenike të ndonjë vepre teatrale e operistike, në kopertinat e librave etj. Shmangie të tilla kanë ndikuar drejtpërsëdrejti si në formën, ashtu edhe në brendinë e letërsisë e të artit tonë.

Këto prirje të shtrembra janë në kundërshtim me partishmërinë e letërsisë e të artit, me rolin formues dhe edukues, me karakterin popullor e kombëtar të tyre. Ato vënë një barrierë midis artit dhe popullit, zbehin natyrën demokratike që duhet të ketë arti ynë, prishin shijet e masave punonjëse.

Shkaku themelor i përhapjes së këtyre ndikimeve të huaja

është moszbatimi me konsekuencë dhe largimi nga orientimi i drejtë i Partisë për zhvillimin e një lufte ideologjike frontale, në të dy krahët, si kundër konservatorizmit, ashtu edhe kundër liberalizmit. Nga disa punonjës e kuadro drejtues të sektorit të kulturës, të letërsisë e të arteve është nënvleftësuar rreziku i ndikimeve të sotme të ideologjisë borgjeze e revizioniste. Si i vetmi rrezik aktual në praktikë janë konsideruar vetëm disa shfaqje e tradita të vjetra të karakterit konservator, kurse ai liberal është parë vetëm si mundësi. Thjeshtëzimi i rrezikut të ndikimeve borgjezo-revizioniste, sidomos kur kjo bëhet nga njerëzit «e mësuar» intelektualë, nuk është një harresë, por një prirje, një tendencë që, po nuk u luftua, trashet e bëhet e rrezikshme. Ndikimi shturës liberalo-modernist nuk është një rrezik në potencë, por një rrezik real.

Disa elementë, të infektuar nga modernizmi dekadent, duke e hequr veten si njerëz «kompetentë», nën maskën e luftës kundër konservatorizmit, u përpoqën t'u hapnin dyert liberalizmit antiproletar, rrymave të huaja borgjezo-revizioniste. Këta me trup ishin këtu, por mendjen e zemrën i kishin jashtë. Jetën dhe zhvillimin e vendit tonë ata i shikonin së prapthi dhe rrymat dekadente kërkonin t'ia përshtatnin gjendjes sonë. Këta elementë hodhën tezën përçarëse se letërsia e vërtetë fillon gjoja me vitet 60-të, duke denigruar e duke mohuar kështu krijimtarinë artistike të mëparshme. Në emër të kritikës kundër konservatorizmit e zhvendosën tehun e luftës kundër disa krijuesve si persona, sidomos kundër më të vjetërve, duke dëmtuar rëndë atmosferën shoqërore në rrethet letraro-artistike.

Teorizimet kundër të ashtuquajturit konservatorizëm, në gjinjtë e ndryshme të artit janë shfaqur në forma të ndryshme. Në artet figurative shpesh me parullat e luftës kundër shkollarizmit, akademizmit, natyralizmit etj., jo vetëm përligjeshin, por merreshin edhe si modele guximi krijues e novatorizmi vepra me ndikime të huaja moderniste, të vjetra e të reja, bile edhe me huazime nga impresionizmi e kubizmi. Në muzikë është quajtur shfaqje konservatorizmi mbizotërimi i melodisë, ashtu siç është quajtur arkaizëm e folklorizëm mbështetja në krijimtarinë muzikore të popullit. Ky i ashtuquajtur folklorizëm shpesh është paraqitur si një gogol dhe si pengesë kryesore për zhvillimin e muzikës së kultivuar.

Vitet e fundit është ndier një nënvleftësim i traditave më të mira të muzikës popullore, gjë që duket edhe në ekzekutimin e pamjaftueshëm të saj nga artistët më të mirë e veçanërisht në mungesën e një pune serioze për përgatitjen e talenteve të reja. Ky nënvleftësim nuk mund të merret i shkëputur nga një preferim që kanë pasur disa njerëz për të ashtuquajturën muzikë dinamike e ritmike, e cila gjoja na qenka muzika moderne e fjalës

së fundit, e vetmja që iu përgjigjka «kërkesave të kohës e të rinisë». Jo, neve nuk na duhet një muzikë e tillë. Ajo u duhet vetëm borgjezisë e revizionistëve si një narkotik për t'i trullësuar masat, veçanërisht të rinjtë. Rinia jonë ka nevojë për një ushqim shpirtëror të pastër, vërtetë të kohës, por të mburrur me ideale të larta e frymë të shëndoshë. Dhe kompozitorët tanë të talentuar kanë krijuar shumë vepra të bukura e origjinale me frymë revolucionare, kombëtare dhe të kohës. Ata u këndojnë me frymëzim e dashuri atdheut e popullit, natyrës shqiptare, jetës socialiste dhe ndjenjave të pastra të njerëzve tanë.

Në spekulimet rreth arkaizmit, folklorizmit etj., kemi të bëjmë me një qëndrim të hapët përbuzës përgjithësisht ndaj folklorit, ndaj vlerave të mëdha artistike e shoqërore të tij, ndaj raportit të tij me artin e kultivuar. Pikërisht qëndrime e teorizime të tilla kanë qenë një nga shkaqet e largimeve nga tabani i shëndoshë kombëtar dhe kanë shërbyer si argumente për t'i përligjur këto largime. Çdo gjëje të mirë e të bukur popullore këta pseudo-teoricienë i ngjisin etiketa përçmuese, shumë herë të pakuptueshme edhe nga ata vetë, pse ishin terma e korente borgjeze në literaturë e në art, që vetë rrjedha e kohës i kishte hedhur në kanale. Këta të ashtuquajtur estetë modernë i vinin rëndësi formës dhe aspekt ideologjisë, politikës, brendisë.

Elementët me prirje liberale shpeshherë e kanë identifikuar konservatorizmin me traditën. Ata në mënyrë mekanike fenomenet e sotme letraro-artistike i ndanin në «tradicionale» ose «novatore». Konfondime dhe ndarje të tilla i hapin rrugën mohimit të traditës, anëve të shëndosha të saj. Mbi këtë shtrat u përhapën më lehtë ndikimet e huaja. Këta njerëz natyrisht nuk mund të mbështeteshin në traditën, që e quanin regres, por në të ashtuquajturin novatorizëm, të cilin e quanin progres.

Partia ka theksuar vazhdimisht nevojën që të mbështetemi në traditat e shëndosha e t'i kultivojmë ato më tej. Ajo ka nxjerrë në pah vlerat e mëdha të traditave më të mira kulturore, frymën patriotike e demokratike popullore të tyre. Por për ne traditë nuk është vetëm tradita e fuqishme e letërsisë patriotike të Rilindjes Kombëtare, e letërsisë përparimtare demokratike e revolucionare të paraqirimit, por edhe tradita tashmë tridhjetëvjeçare shumë e pasur dhe e larmishme e letërsisë dhe e artit tonë të realizmit socialist.

A nuk shërbejnë krijimet e çmuara të poetëve tanë më të njohur, që nga këngët e Luftës Nacionalçlirimtare, «Epopeja e Ballit Kombëtar», e Shevqet Musarajit, poezitë e Lllazar Siliqit etj., ashtu si edhe krijimtaria e pasur dhe e shëndoshë e shumë poetëve të rinj, si një shembull i qartë kundërvënije ndaj çoroditjeve që janë vërejtur kohët e fundit në poezi e që me të drejtë po i kritikojmë me forcë? Sa shumë ia kanë rritur vlerën

poetët tanë fjalës gjithmonë të fuqishme e të mrekullueshme të poezisë më të mirë shqipe! Nuk ka shumë kohë që kam lexuar përmbledhjen e fundit të krijimtarisë poetike të Dritëro Agollit. A nuk është krijimtaria e këtij poeti një traditë e re, një shembull i harmonizimit të frymës socialiste revolucionare me frymën popullore kombëtare, të brendisë së pasur e të formës së qartë, të partishmërisë e të mjeshtërisë së lartë artistike?

Shumë vepra të tjera të shquara letraro-artistike janë krijuar gjatë periudhës së fundit. Në romanet më të mira të Sterjo Spasses e të Ismail Kadaresë, të Fatmir Gjatës e të Jakov Xoxes, si dhe të prozatorëve të tjerë, pasqyrohet me një madhësi të vërtetë epike lufta e popullit për çlirimin nga shtypja e të huajve e shfrytëzimi shekullor, për ndërtimin e shoqërisë së re socialiste, për formimin dhe për edukimin e njeriut të ri. Edhe dramaturgët e kineastët, bashkë me artistët e talentuar të skenës e të ekranit, i kanë pasqyruar shumë bukur këto transformime kolosale në dramata, filmat e shfaqjet e tyre më të mira. Këtë madhësi dhe këtë frymë heroike luftë e shohim edhe në veprat më të shquara të skulptorëve e të piktorëve tanë të talentuar, si Odise Paskali, Kristaq Rama, Guri Madhi etj. Vepra shumë të bukura të gjinive më të ndryshme muzikore të mëdha e të vogla me brendi të shëndoshë, me vlera edukative, me nivel të lartë profesional kanë dhënë edhe kompozitorët si Çesk Zadeja, Tish Daija, Fehim Ibrahimimi etj. Ne kemi të drejtë të krenohemi me krijimet e mira të letërsisë e të artit tonë që shquhen si për frymën militante, ashtu edhe për një mjeshtëri me të vërtetë të lartë artistike.

Duke theksuar këto arritje të mëdha në këto fusha nuk mund të mos pranojmë se kritika dhe shkenca jonë letraro-artistike janë borxhli ndaj përgjithësimit të kësaj përvoje të re të kulturës artistike socialiste, të këtyre sukseseve e traditave të reja të fuqishme të letërsisë dhe të artit të realizmit socialist. Ne duhet të luftojmë që kjo traditë të bëhet pronë e krijuesve të rinj dhe e masave të gjera artdashëse, që ajo të popullarizohet me botime e ribotime, me incizime, riprodhime etj. Krijuesit e rinj duhet të mësohen e të edukohen që të mbështeten në rezultatet e në përvojën tonë të re, që të ndjekin këtë traditë të pasur socialiste. Mënjanimi i boshllëqeve dhe i nënvleftësimeve në këtë fushë është edhe një mjet për t'i mbyllur shtigjet përhapjes së ndikimeve dhe imitimeve të huaja.

Partia ka qenë dhe është për një art novator, që të mbështetet fort në traditën e shëndoshë të vjetër e të re dhe në partishmërinë proletare. Por edhe në këtë çështje ka pasur shtrembërimi e teorizime të karakterit liberal. Shpesh, në mënyrë mekanike, çdo gjë që del si e re, pa e analizuar në prizmin klasor dhe në mënyrë shkencore se ç'përfaqëson, është quajtur novatore, duke krijuar edhe pështjellime teorike, siç ndodhi me një «të

famshëm» diskutim për heroin pozitiv në letërsi, të zhvilluar në gazetën «Drita». Disa herë novatorizmi është konsideruar si pronë vetëm e të rinjve në moshë. Herë të tjera ai nuk është shikuar kryesisht e në radhë të parë në përmbajtje, por vetëm në formë. Pikërisht në emër të një «novatorizmi» të tillë janë përligjur edhe ato krijime formaliste e moderniste në poezi, në muzikën e lehtë, në pikturë, në regjisurë, në skenografi etj., për të cilat fola më sipër. Në mënyrë të veçantë është spekuluar në emër të përkrahjes së të rinjve, gjoja të mbajtjes së një qëndrimi dashamirës e me takt ndaj tyre. Një qëndrim i tillë u ka sjellë vetëm dëm të rinjve, pasi në të vërtetë këta ndihmohen jo duke i përkëdhelur, por duke i inkurajuar kur duhet dhe duke i kritikuar, kur kjo është e domosdoshme.

Për ne, marksistë-leninistët, e re është ajo që i shërben shkatërrimit të çdo gjëje të vjetruar, regresive e reaksionare, të çdo gjëje të huaj për shoqërinë dhe ideologjinë tonë, është ajo që i shërben afirmimit të çdo gjëje progresive e revolucionare, zhvillimit të shoqërisë socialiste, të bazës e të superstrukturës së saj, të prodhimit e të jetës shpirtërore. Të renë ne e shohim gjithmonë në radhë të parë në brendi e pastaj në formë. Kështu e shohim atë edhe në letërsi e në art.

Partia jonë, që është një novatore e madhe dhe e guximshme, një revolucionare sypatrembur, që ka shkallmuar e vazhdon të shkallmojë vjetërsirë pas vjetërsire, që udhëheq një revolucion të pashembullt në jetën materiale e shpirtërore të shoqërisë, nuk do t'ia lejojë kurrë vetes që të mashtrohet nga novatorizmi i rremë, nga cipa e bukurisë së jashtme të artit e të kulturës borgjeze e revizioniste, me të cilën ata e veshin helmin e ideve të tyre reaksionare, nga reklama e bujshme që ata u bëjnë të ashtuquajturave novacione të kësaj kulture. Partia jonë është për një zhvillim me të vërtetë modern të të gjithë jetës sonë shoqërore, të ekonomisë e të kulturës, të letërsisë e të artit. Por kjo nuk ka asgjë të përbashkët me modernizmin çoroditës të botës së sotme kapitaliste e revizioniste.

Shumë shmangie që po kritikojmë kanë ardhur nga largimi prej frymës kombëtare, nga injorimi e mohimi i saj. Në emër të së resë, të kërkesave të kohës, të asaj që jetojmë në Evropë, përkrahësit e liberalizmit filluan të shtrembërojnë orientimet e Partisë për qëndrimin e diferencuar kritik ndaj kulturës së huaj dhe të na servirin si të reja e novatore shëmtirat e kulturës së sotme dekadente e moderniste borgjezo-revizioniste.

Përmes shumë rrebeshesh të kohës, betejash të ashpra e pa mbarim populli ynë krijoi një kulturë e art me fizionomi të qartë kombëtare që përbën një pasuri të paçmueshme. Këto vlera të artit përparimtar të kombit tonë janë për ne objekt i një krenarie të ligjshme, janë kontributi ynë në thesarin e kulturës botërore

përparimtare. Nëse në shekuj populli ynë ruajti e zhvilloi më tej këtë kulturë, atëherë neve, brezave të shoqërisë socialiste, na bie barra të luftojmë me pasionin e militantit komunist, për ta ruajtur të pastër atë dhe për ta zhvilluar më tej.

Borgjezia imperialiste gjithnjë është përpjekur të denigrojë apo të zhdukë traditat kulturore të popujve të vegjël, frymën kombëtare të artit e të kulturës së tyre. Kjo është një nga rrugët për realizimin e agresionit të saj kulturor e të nënshtimit të popujve. Koncepti reaksionar borgjez mbi «ndërkombëtarizimin» e kulturës e të artit, mendimet se «tanimë u kapërcye faza e shkollave kombëtare», kanë për qëllim zhdukjen e kulturave të popujve të tjerë. Në këto kushte për ne bëhet edhe më imperative lufta për të ruajtur fizionominë kombëtare të artit, pasurinë kulturore të popullit.

Duke luftuar për mbrojtjen e frymës kombëtare të letërsisë e të artit, ne gjithmonë theksojmë me forcë karakterin e tyre revolucionar e socialist. Brenda socialiste është tipari dallues e më esencial i letërsisë dhe i artit tonë. Kjo brendi ka një karakter të qartë klasor proletar. Si e tillë ajo duhet të realizohet në unitet me formën kombëtare, gjë që e shohim edhe në praktikën e krijimtarisë sonë letraro-artistike.

Edhe herë të tjera Partia ka folur për qëndrimin tonë kritik revolucionar ndaj kulturës së huaj, si ndaj asaj të së kaluarës, ashtu edhe ndaj kulturës së sotme. Detyrohemi t'i kthehemi përsëri këtij problemi, sepse në praktikë, me gjithë orientimet e drejta të Partisë, ka pasur keqkuptime e shtrembërime, të cilat kanë qenë një nga shkaqet e gjallërimit të ndikimeve të huaja.

Sot fenomenet e kalbëzimit e të degjenerimit të kulturës borgjeze bëhen gjithnjë e më të theksuara. «Izmat» e saj, që mbijnë si kërpudhat, janë shenja më e qartë e këtij kalbëzimi. Çdo ditë dalin shkolla e shkollëza «të reja» që u përngjasin sekteve e herezive të panumërta fetare. Megjithëkëtë, ato kanë një bazë të përbashkët filozofike që është idealizmi me të gjitha stërhollimet e pafund të tij. Ky është thelbi edhe i atyre rrymave që në pamje të parë dalin gjoja si protesta të majta, radikale, kundër shoqërisë zyrtare borgjeze, kundër kulturës dhe moralit të saj.

Nën maskën e një arti, i cili goja nuk njuh paragjykimet sociale e angazhime ideologjike, krijohet kulti i brendisë boshe e i formës së shëmtuar, i së ultës dhe së llahtarshmes. Temat dhe heronjtë kryesorë të artit dekadent modernist janë vrasësit, prostitutat, imoraliteti, patologjia sociale. Flamuri i tij është irracionalizmi, çlirimi i tij nga «arsyeja». Ideali i tij është primitivizmi i njeriut të shpellave.

Pikërisht kjo kulturë e veshur me një shkëlqim të jashtëm, e shoqëruar me një reklamë të bujshme, e trajtuar në mënyrën më komerciale dhe që përkrahet e financohet nga borgjezia,

vërshon në ekranin e kinemasë e të televizionit, në revista, në gazeta e në radio, në të gjitha mjetet e informacionit e të propagandës masive. Qëllimi i saj është ta kthejë njeriun e thjeshtë në një konsumator pasiv të ideve të helmatisura borgjeze, t'ia bëjë këtë konsum një nevojë e zakon. Nga kjo kulturë ne jo vetëm që nuk kemi ç'të mësojmë, me të ne jo vetëm nuk kemi pse t'i njohim masat dhe rininë, por atë duhet ta flakim me përbuzje dhe ta luftojmë me vendosmëri.

Ne kemi vlerësuar e vlerësojmë vetëm artin revolucionar, përparimtar e demokratik të huaj, qoftë ky i së kaluarës ose i shekullit tonë. Ne do ta shfrytëzojmë atë edhe në të ardhmen në mënyrë kritike, sepse kjo është e nevojshme për zhvillimin kulturor të masave, për edukimin ideoestetik të tyre, si dhe për formimin e atyre shijeve që i rezistojnë ndikimit degjenerues e vulgar borgjezo-revizionist.

E tërë kjo kërkon një punë të kujdesshme nga ana jonë, të pjekur dhe të shkallëzuar, kërkon mënjanimin e qëndrimeve ekstreme që kanë për bazë ksenomaninë ose ksenofobinë, liberalizmin ose sektarizmin, mungesën e qëndrimit kritik ose të të qenit brenda.

Partia ka qenë gjithnjë kundër çdo lloj shtrembërimit e nënvleftësimit të orientimeve të saj për një luftë ideologjike e konsekuente në të dy krahët, si kundër liberalizmit, ashtu edhe kundër konservatorizmit. Ajo ka qenë dhe është kundër çdo lloj spekulimi që, në emër të luftës kundër njërit krah, të lihet pas dore ose të harrohet lufta kundër krahut tjetër. Prandaj do të ishte shumë e gabuar në qoftë se sot ndokush do të mendonte se kritikën e drejta që janë bërë kundër shfaqjeve të konservatorizmit nuk qëndrojnë dhe se konservatorizmi nuk përbën më ndonjë problem për letërsinë dhe për artet. Në fakt, letërsia dhe arti në rrugën e zhvillimit të tyre, krahas ndikimeve të ideologjisë së sotme borgjeze e revizioniste, janë ndeshur e ndeshen edhe me trashëgime e prirje të ndryshme të karakterit frenues konservator, të cilat shfaqen si në brendi, ashtu edhe në formën e tyre. Karakteri konservator ose përparimtar, regresiv ose reaksionar i një vepre letrare e artistike varet, në radhë të parë, nga tendencioziteti i saj klasor, nga idetë që ajo bart, nga idealet për të cilat millton. Konservatorizmi në këtë fushë ka specifikën e vet dhe shfaqet në forma e në mënyra të ndryshme, të cilat mendimi kritik, teorik e historiko-letrar duhet t'i zbulojë e t'i luftojë pandërprerë.

Partia ka treguar vazhdimisht bazën e gjerë politike, sociale dhe ideologjike të konservatorizmit. Për ne qëndrim konservator është ai që justifikon, mbështet e mbron çdo gjë të vjetruar, që është kundër ndryshimeve progresive, kundër së resë, që frenon hovin revolucionar të masave, emancipimin e gjithanshëm të tyre, që pengon ecjen tonë përpara në rrugën e socia-

lizmit. Nga pozita e një kuptimi të tillë klasor revolucionar, në vështrimin më të gjerë politik e social, karakter konservator kanë jo vetëm ideologjitë e vjetra që vijnë nga thellësitë e shekujve, por edhe ideologjia e kultura e sotme e degjeneruar borgjeze e revizioniste, i gjithë liberalizmi e modernizmi i tyre.

Një rol shumë të madh në zhvillimin e drejtë të letërsisë e të arteve luan kritika letraro-artistike, zhvillimi i një debati serioz e shkencor për problemet themelore ideoestetike. Por kritika jonë letraro-artistike nuk ka mbajtur kurdoherë qëndrime të qarta për këto probleme, ajo nuk ka zbuluar dhe nuk ka goditur me kohë fenomenet negative, sidomos ndikimet formaliste e moderniste dhe në ndonjë rast është përpjekur t'u vërë edhe bazë teorike këtyre shfaqjeve të huaja. Në të njëjtën kohë do theksuar se nuk ka ekzistuar gjithmonë edhe atmosfera e përshtatshme që kritika letraro-artistike ta thotë lirshëm fjalën e saj.

Ne kemi nevojë për një kritikë shkencore e të kualifikuar, e cila ka brenda edhe patosin e domosdoshëm revolucionar, aq të nevojshëm për zbulimin e vlerave të shquara të letërsisë e të artit, edhe frymën e papajtueshmërisë me asnjë shtrembërim, me asnjë shfaqje të huaj në zhvillimin e tyre. Ne kemi nevojë për një kritikë të atillë, e cila ta thotë me guxim e me kompetencë fjalën e vet për çdo fenomen letrar e artistik. Por kritika letrare profesionale nuk është i vetmi gjykes i veprimtarisë letraro-artistike. Mendimi i lexuesve, i publikut, i gjithë opinionit shoqëror në fund të fundit është gjykatësi më i drejtë i kësaj krijimtarië. Këtë të vërtetë duhet ta mbajnë kurdoherë parasysh si krijuesit, ashtu edhe kritikët.

Për zhvillimin e mendimit kritik e ideoestetik është e nevojshme të merren masa për zgjerimin e punës kërkimore-shkencore në lëmin e teorisë e të historisë së letërsisë e të arteve, të estetikës, duke forcuar bërthamat ekzistuese, si dhe duke krijuar bërthama të reja. Kjo punë nuk mund të kryhet me sukses pa marrë masa të shpejta për përgatitjen sistematike të kuadrove të rinj shkencorë për estetikë, teori e histori të letërsisë e të arteve, kritikë letrare e artistike.

Kritika, si dhe letërsia e gjithë arti ynë, duhet të udhëhiqen kurdoherë nga parimet e metodës së realizmit socialist, të cilat kanë lindur nga përvoja botërore e artit revolucionar të proletariatit, janë përpunuar nga estetika marksiste-leniniste dhe janë konfirmuar edhe nga praktika letrare e artistike e vendit tonë. Këto parime janë të patundshme dhe besnikëria ndaj tyre është e domosdoshme, sepse ndryshe biem në ndikime të huaja dhe largohemi nga traditat revolucionare. Novatorizmi nuk ka të bëjë me shkeljen e parimeve, por me zbatimin e tyre të drejtë.

Zhvillimi krijues i realizmit socialist ka ndeshur edhe në disa interpretime të gabuara e teorizime me prejardhje të ndrysh-

me. Sidomos këto janë shfaqur në trajtimin e problemit të kontradiktave e të heroit në art. Ka ndodhur që kontradiktat e shoqërisë sonë janë paraqitur pa rrugëdalje, me një ndjenjë të errët pesimizmi, që është tipike për konceptimet borgjezo-revizioniste. Nuk është treguar kurdoherë si duhet epërsia e forcave dhe e idealit socialist. Ka pasur edhe raste të konfondimit të kontradiktave në gjirin e popullit me kontradiktat midis nesh e armiqve tanë. Kjo të çon në gabime të rënda parimore, ku përpiquej ta fuste artin tonë Fadil Paçrami, kur thoshte se mjaft jemi marrë deri tani me luftën midis «nesh dhe armiqve» e se këtej e tutje duhet të flasin kryesisht për luftën «midis nesh». Pra, t'i lëmë të qetë armiqtë dhe të trajtojmë si të tillë njerëzit tanë.

Partia ka theksuar se zbulimi i kontradiktave e pasqyrimi i tyre në art, duke përfshirë këtu edhe kritikën e fenomeneve negative, duhet bërë drejt, nga pozitativ e partishmërisë proletare, nga qëllimi që ato të kapërcehen dhe shoqëria të shkojë përpara dhe jo të mbetet në darën e kontradiktave.

Nga ana tjetër ato teorizime që janë bërë për heroin pozitiv, për copëzimin e tij, për identifikimin e tij me gjithçka, për ndarjen artificiale në «hero tradicional» dhe «hero novator» etj., nuk janë një gjë tjetër veçse pikëpamje që të shpien te deheroizimi në letërsi e në art, te largimi nga jeta dhe nga njeriu. Edhe teorizimet skematike për heroin, të konceptuar në mënyrë idilike dhe sentimentale, janë gjithashtu të dëmshme dhe e largojnë artin nga vërtetësia dhe nga realizmi. Duke kritikuar kuptimin skematik të një heroit të idealizuar në mënyrë libeske pa u mbështetur në realitetin tonë, në të njëjtën kohë ne nuk mund të pranojmë në asnjë mënyrë skemën e re për një hero të lëkundur, e cila në fakt është një ndikim i hapët borgjezo-revizionist. Këto pikëpamje e qëndrime nuk kanë asgjë të përbashkët me parimet tona, ato tregojnë një konfuzion teorik.

*
* *

Këto ishin disa probleme që kanë shqetësuar Partinë, punonjësit e gjithë krijuesit, lidhur me zhvillimin në rrugë të drejtë të letërsisë e të arteve tona, në luftë kundër ndikimeve të ideologjisë së huaj. Në diskutimet që janë zhvilluar kohët e fundit midis punonjësve të letërsisë e të artit, në frymën e një kritike e autokritike të shëndoshë, është shprehur me forcë bindja dhe vendosmëria për kapërcimin e të metave e të dobësive që janë konstatuar. Detyra e Partisë është të ndihmojë shkrimtarët e artistët që të kryejnë me nder detyrat e larta fisnike që kanë përpara popullit.

Duhet pranuar se mosinteresimi sa duhet i komiteteve të Partisë dhe i organizatave-bazë për këto fusha të rëndësishme, siç janë artet e letërsia, është edhe një nga shkaqet që kundër ndikimeve të huaja nuk është luftuar që në fillim me forcën dhe konsekuencën e duhur. Organizatat e Partisë nuk merren me problemet e kulturës, me edukimin e gjithanshëm të punonjësve të letërsisë e të arteve në atë shkallë, siç merren me fusha të tjera të jetës shoqërore e ekonomike. Ato duhet të mbajnë gjithnjë parasysh se letërsia dhe artet vërtet nuk japin drejtpërsëdrejti të mira materiale, por ndikimi i tyre mbi masat është i madh dhe pasqyrohet fuqimisht jo vetëm në gjendjen shpirtërore të punonjësve, por edhe në punë e në prodhim.

Nuk kanë luftuar me këmbëngulje e konsekuencë edhe ato organizma që janë ngarkuar posaçërisht të merren me zbatimin e vijës së Partisë në fushën e arteve e të letërsisë. Sektorët ideologjikë të aparatit të Komitetit Qendror nuk kanë ndihmuar sa duhet që letërsia dhe artet t'u bënin ballë ndikimeve të huaja. Ata, në njëfarë mase, u janë nënshtruar presioneve e teorizimeve liberale dhe nuk kanë reaguar me forcën e nevojshme kundër shmangieve nga vija e orientimet e Partisë.

Shkarjet në letërsi e në art kanë lidhje edhe me punën e pamjaftueshme të Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës, ku militojnë shumica e shkrimtarëve dhe e artistëve dhe ndodhen institucionet kryesore artistike të vendit, në të cilat, më shumë se kudo, ishte përhapur fryma e liberalizmit. Në këtë drejtim ka ndikuar në mënyrë shumë të dëmshme veçanërisht ish-sekretari për propagandën, Fadil Paçrami, i cili, për problemet e letërsisë, të arteve dhe të institucioneve artistike të qytetit, kishte arritur t'i imponohej Komitetit të Partisë të Tiranës.

Fadil Paçrami për këto probleme ka pasur pikëpamje të huaja, në kundërshtim me vijën e Partisë, të cilat janë shfaqur edhe në krijimtarinë e tij letrare. Me predispozicionet e tij të theksuara liberale, me teorizimet e huaja, ai i mohonte dhe i luftonte traditat e shëndosha të letërsisë e të artit, nxiste ndarjen artificiale midis brezave të krijuesve dhe predikonte luftën midis tyre, inkurajonte dhe përkrahte përhapjen e ndikimeve e të shfaqjeve të huaja moderniste. Me prirjet e tij liberalo-anarkiste, të shprehura në konceptimet e djathta të problemeve dhe në përdorimin e metodave agresive, të zbatuara me mendjemadhësi e arrogancë, ai ka ushtruar një ndikim shumë negativ në Lidhjen e Shkrimtarëve e të Artistëve dhe në jetën letraro-artistike të kryeqytetit. Pikëpamjet antiparti të Fadil Paçramit janë shfaqur jo vetëm në moszbatimin e vijës së Partisë për luftën në të dy krahët, por edhe në kundërshtimin e hapur të saj, duke luftuar nga pozita të huaja vetëm kundër konservatorizmit. Në fakt, si deviator i djathtë, ai ka luftuar për t'i hapur rrugën liberaliz-

mit. Në punën e tij ai ka shkelur normat e Partisë. Kritikkat që i janë bërë herë pas here nga komunistë, nga aparati dhe Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë, ai me fodullëk nuk i ka marrë parasysh. Duke qenë kundër vijës së Partisë dhe kundër vetë Partisë, ai ka spostuar organizatat-bazë të sferës së kulturës dhe ka zbatuar një politikë personale kuadri, duke synuar që drejtimi këtu të kryhej jo nga Partia, por nga njerëzit që i shkonin atij për shtat. Fadil Paçrami e Todi Lubonja, si elementë antiparti, në fakt kanë pasur qëllime të njëjta dhe kanë ndjekur një rrugë për të goditur Partinë e udhëheqjen e saj.

Një përgjegjësi të madhe për shkarjet nga vija e Partisë në art e në letërsi mban Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, sepse e ka nënvleftësuar rrezikun e liberalizmit dhe është tërhequr para presioneve liberale. Prandaj, ajo duhet ta rishikojë punën e saj në këtë drejtim dhe të marrë masa për zbatimin e plotë e të saktë të detyrave të ngarkuara për drejtimin e gjithë jetës kulturore e artistike të vendit, pa bërë asnjë lëshim ndaj kujtdo që shkel vijën e Partisë në çështjet e letërsisë, të artit e të kulturës sonë socialiste.

Veçanërisht përgjegjësi të madhe për shkarjet nga vija e Partisë në lëmin e arteve e të letërsisë mban Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve, mbajnë shokët kryesorë drejtues të saj. Shumë koncepte e teorizime që u kritikuan më lart kanë gjetur strehë në veprimtarinë e lidhjes, në organet e shtypit të saj, veçanërisht në gazetën «Drita». Duke pretenduar se vetëm ata i njohin problemet e letërsisë e të artit e specifikën e tyre, shokët drejtues të lidhjes jo vetëm nuk kanë luftuar kundër ndikimeve të huaja, por shpesh, me qëndrimet e tyre, i kanë ushqyer ato.

Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve duhet të analizojë thellë punën e vet, të zbulojë çdo shtrembërim të vijës së Partisë në letërsi e në art, të marrë masa serioze e me përgjegjësi për të mos lejuar më shfaqje të ideologjisë borgjeze e revizioniste në sferën e veprimtarisë së saj.

Për të luftuar me sukses kundër ndikimeve e shfaqjeve të huaja, Partia duhet të bëjë një punë të madhe me shkrimtarët e artistët jo vetëm për ngritjen e mëtejshme ideestetike të tyre, por edhe që ata të bëjnë një jetë ideologjike intensive, që të jetojnë afër masave, të lidhen ngushtë me shqetësimet e luftën e tyre, të marrin pjesë aktive në aksionet e mëdha ekonomiko-shoqërore të punonjësve. Kontaktet me masat janë absolutisht të domosdoshme për njerëzit e artit e të kulturës, por këto nuk duhet të kuptohen si slogane, si letërsi, si shëtitje, por si punë ku ata do të bazojnë krijimtarinë e tyre, e cila duhet të jetë pozitive, brenda vijës së Partisë, brenda normave. Në këtë proces bëhet edhe edukimi e kalitja revolucionare e krijuesve, luf-

tohen intelektualizmi e megalomania, individualizmi e sedra mikroborgjeze, mendimet e gabuara që «ne jemi mbi të tjerët», se «jemi të lirë të krijojmë ç'të duam dhe kur të duam», jashtë çdo kërkese e disipline shoqërore, jashtë çdo kontrolli, jashtë çdo norme. Në këtë mënyrë edhe gabimet ndreqen jo vetëm me fjalë, jo vetëm me autokritikë, por me krijimtari, me punë, me vullnet dhe me besim të shumëfishuar në forcat e veta dhe në drejtësinë e vijës së Partisë.

Organizatata e Partisë duhet të bëjnë një punë serioze për të krijuar një atmosferë të shëndoshë veprimtarie dhe marrëdhëniesh shoqërore në gjirin e punonjësve të letërsisë e të arteve. Ato dhe vetë shkrimtarët e artistët duhet të luftojnë me vendosmëri kundër pasioneve të sëmura, njëanshmërisë në gjykimin e krijimtarisë së njerit apo të tjetrit, që çojnë në thashetheme, në ndarje e grupime të dëmshme të krijesve. Nuk duhet të lejohet ndarja në «të rinj» e në «të vjetër», ashtu si nuk duhet lejuar që tani të përhapen mendimet: «Ju keni gabuar, ne nuk kemi gabuar», «ju na keni akuzuar si konservatorë dhe tash ne ju akuzojmë si liberalë». Natyrisht, gabimet e të metat duhen zbuluar dhe duhen njohur, ato duhen kritikuar. Por, siç na mëson Partia, është e domosdoshme që kritika të jetë gjithnjë e drejtë, konstruktive dhe asnjëherë denigruese. Gabimet, kudo ku janë shfaqur, duhet të shikohen kurdoherë me sy partie dhe të ndreqen me përpjekje të përbashkëta. Ne, komunistët, gabimet nuk i ndreqim duke u hakmarrë e me inat mikroborgjez, por në frymën e partishmërisë e të principialitetit komunist. Njerëzit duhen ndihmuar e duhen inkurajuar, veçanërisht krijuesit e rinj, ndaj të cilëve duhet treguar ngrohtësi, takt e kujdes në rrugë të drejtë partie.

Partia kërkon shumë në këtë drejtim, sidomos nga shkrimtarët dhe artistët komunistë, të cilët duhet të jenë shembull partishmërie, principialiteti, etike komuniste e disipline shoqërore. Për komunistët nuk ka dy lloj qëndrimesh, një në organizatën-bazë dhe një tjetër jashtë saj. Normat e Partisë në vijë, në punë, në jetë janë të domosdoshme për të gjithë dhe askujt nuk mund t'i lejohet t'i shkelë ose t'u bëjë bisht atyre.

Ne kemi besim të plotë se shkrimtarët dhe artistët tanë, të gjithë krijuesit e punonjësit e kulturës e të artit, duke luftuar kundër ndikimeve të huaja, si kurdoherë, do t'i shtrëngojnë akoma më shumë radhët e tyre rreth Partisë, me të cilën ata janë të lidhur si mishi me kockën. Me ndihmën e Partisë dhe me përpjekjet e tyre revolucionare ata do të pastrojnë ato barëra të këqija, që janë dukur në jetën tonë letrar-artistike e kulturore dhe do ta çojnë përpara me guxim çështjen e madhe të kulturës, të letërsisë e të artit tonë socialist.

Duke trajtuar në këtë Plenum ndikimet e huaja ideologjike

dhe shfaqjet e tyre në letërsi e në art, është e domosdoshme të theksojmë edhe një herë se përgjithësisht trupi i letërsisë e i artit tonë është i shëndoshë, se ata janë zhvilluar në rrugë të drejtë, janë frymëzuar nga vija e Partisë e interesat e popullit e të socializmit. Këtë e vërteton realiteti i gjallë i zhvillimit të letërsisë e të arteve tona në përgjithësi e konkretisht edhe gjatë periudhës së fundit.

Veprat e mira të shkrimtarëve e të artistëve tanë pëlqehen shumë dhe ndiqen me interesim të madh nga masat, ato kanë dhënë e japin një kontribut të çmuar në edukimin e përgjithshëm të rinisë e të mbarë popullit. Këto vepra, që kanë rritur fondin e artë të kulturës së re socialiste, janë një pasqyrim tepër i vlefshëm i krijimtarisë shpirtërore të popullit shqiptar, i përmbajtjes së saj patriotike, përparimtare e demokratike. Duke pasqyruar epokën e lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare, të transformimeve të mëdha revolucionare dhe të ndërtimit të socializmit, duke qenë pjesëmarrëse aktive në këto beteja madhështore, letërsia dhe arti ynë i tanishëm do të jenë me siguri burim frymëzimi për brezat e rinj dhe për ata që do të vijjnë pas.

Ne jemi të sigurt se ashtu si deri tani, edhe në të ardhmen, veprimtaria krijuese e shkrimtarëve dhe e artistëve tanë do të frymëzohet nga realiteti ynë i mrekullueshëm socialist, nga lufta heroike e popullit tonë, e klasës punëtore dhe e fshatarësisë punonjëse, nga idealet e larta revolucionare të Partisë. Ajo do të marrë kurdoherë vlagë nga lufta shekullore e popullit tonë për liri e dritë, nga tradita e tij e fuqishme demokratike e përparimtare, nga gurra e-pashtershme e përvojës dhe e gjenisë së tij artistike. Të udhëhequr nga parimi i madh i partishmërisë komuniste, shkrimtarët dhe artistët do të na japin me siguri vepra edhe më të denja për këtë luftë heroike që bëjnë sot Partia e populli ynë për çështjen e revolucionit e të socializmit, vepra të qarta e të kuptueshme për masat, me ide të larta komuniste, me një fytyrë të qartë kombëtare, me një nivel artistik gjithnjë e më të përsosur.

TË FORCOJMË KONCEPTE REVOLUCIONARE PËR SHIJEN, SJELLJEN DHE MËNYRËN E JETESËS

Revolucioni socialist ka sjellë shndërrime rrënjësore në jetën shpirtërore të shoqërisë e të njerëzve tanë, në ndërgjegjen, në psikologjinë dhe në mënyrën e jetesës së tyre. Partia u ka kushtuar një kujdes të vazhdueshëm formimit dhe kalitjes së njeriut të ri me botëkuptimin marksist-leninist, me frymën e lartë të patriotizmit e të internacionalizmit proletar, të kolektivizmit socialist, me shpirtin e sakrificës e të heroizmit, me koncepte të reja për pu-

nën, për jetën, me ideale të larta revolucionare. Ne mund të flasim sot për një jetë shpirtërore të pasur të popullit, një jetë që zhvillohet e pastër, e vrullshme, në të cilën spikatin devocioni ndaj çështjes së revolucionit e të socializmit, aktet heroike, virtytet e larta morale, shijet e shëndosha. Ky është një proces i ndërlikuar dhe i pandërprerë që zhvillohet nëpërmjet një lufte klasore ideologjike kundër çdo ndikimi të huaj. Partia jonë ka luftuar gjithmonë dhe frontalisht kundër të gjitha ideologjive të klasave shfrytëzuese.

Por vitet e fundit, kur iu dha një goditje e fortë koncepteve e paragjyqimeve të vjetra fetare, feudale e patriarkale-konservatore, u la disi pas dore dhe u nënvleftësua lufta kundër ndikimeve të sotme të ideologjisë borgjeze e revizioniste, kundër shfaqjeve të tyre në jetën tonë. U dukën koncepte e qëndrime liberale, që u hapën rrugën disa fenomeneve të dëmshme që filluan të shfaqen në disa njerëz e sidomos në disa të rinj.

Ato ndikime, për të cilat folëm në letërsi e në art, nuk mund t'i shohim të shkëputura nga disa shfaqje të huaja, që janë vërejtur në shijet e disa të rinjve, në sjelljet dhe në veprimet e pahijshme të tyre. Këto, si dhe presioni i vazhdueshëm i jashtëm, janë shkaqet themelore të përhapjes së disa shijeve të huaja e vulgare për muzikën dhe për artin, të ndjekjes së modave ekstravagante e të shëmtuara, të sjelljeve të papëlqyeshme në kundërshtim me etikën socialiste dhe traditat pozitive të popullit. Me të drejtë opinioni ynë shoqëror goditi me forcë «importimet» e bastarduara të flokëve të gjatë, të veshjeve ekstravagante, të britmave të muzikës së xhunglës, të harbutllëqeve, të sjelljes pa cipë etj. Po të mos luftohen që në embrion ndikimet e shfaqjet e mënyrës së jetesës borgjezo-revizioniste, ato u hapin shtegun shthurjes e degjenerimit të njerëzve, që janë aq të rrezikshme për çështjen e socializmit.

Zhvillimi i gjithanshëm shpirtëror e figura morale e njeriut tonë të ri nuk mund të kuptohen pa formimin e shijeve ideestetike të shëndosha për të bukurën në art, në natyrë, në punë e në jetë. Çështja e shijeve nuk është një çështje thjesht personale e individëve, për të cilën gjoja as që mund të diskutohet. Me gjithë praninë e elementit individual në to, shijet kanë gjithmonë karakter shoqëror, formohen nën ndikimin e drejtpërdrejtë të marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore, të ideologjisë e të kulturës, të psikologjisë shoqërore. Këtej del i qartë edhe karakteri klasor që kanë ato. Prandaj, shijet tona në thelbin e vet janë krejtësisht të kundërta me ato borgjezo-revizioniste. Shija jonë komuniste është e mburjtur me idealin revolucionar, me thjeshtësinë proletare, me ndjenja të larta fisnike, me virtyte morale të pastra.

Duke luftuar kundër depërtimit të shijeve të ulëta e banale borgjezo-revizioniste, në të njëjtën kohë ne kemi luftuar e vazh-

dojmë të luftojmë kundër shijeve të vjetruara e anakronike të lëna trashëgim nga pushtimet e huaja dhe nga shoqëria e vjetër feudalo-borgjeze, të pleksura me mënyrën e vjetër të jetesës dhe me zakonet e me traditat patriarkale e prapanike. Ne jemi përkrahës të çdo evoluimi të natyrshëm të shijeve në kushtet e zhvillimit të vrullshëm socialist, të kërkesave të reja që shtron ky zhvillim, në frymën e ideologjisë sonë marksiste-leniniste e të traditave tona të shëndosha kombëtare. Ne jemi kundër atyre qëndrimeve konservatore që nuk e kuptojnë këtë proces dhe që e shikojnë atë si fenomen negativ e ndikim të huaj.

Formimi i shijeve të shëndosha me brendi të qartë socialiste kërkon edhe një zhvillim të gjithanshëm kulturor të njeriut të ri, sidomos një punë sistematike për edukimin ideoestetik të tij. Këto pikësynime arrihen edhe nëpërmjet një lufte të vazhdueshme kundër cektësisë e horizontit të ngushtë kulturor, për një njohje më të thellë të vlerave të shquara të kulturës kombëtare e botërore.

Te ne sot janë krijuar mundësi të mëdha për ngritjen e vazhdueshme të nivelit kulturor dhe ideoestetik të të gjitha masave punonjëse, e veçanërisht të rinisë. Krahas shkollës, janë shtuar e fuqizuar shumë si institucionet e posaçme kulturore-artistike, ashtu edhe mjetet e tjera të propagandës masive, që luajnë një rol të dorës së parë në këtë proces. Por këto mjete, që janë përhapur në të gjithë vendin deri në skajet më të largëta të tij, nuk shfrytëzohen në mënyrë intensive e të kualifikuar.

Komitetet e Partisë dhe organet e pushtetit duhet të bëjnë përpjekje për të ngritur vazhdimisht nivelin ideor e artistik të veprimtarisë së institucioneve kulturore dhe të luftojnë kundër çdo prirjeje për ta parë këtë veprimtari si një mjet thjesht zbatimës, duke u larguar nga qëllimi themelor edukativ i tyre.

Gjithashtu duhet të tërheqim këtu vëmendjen se shfaqje të huaja kanë depërtuar sidomos në institucionet kulturore e artistike. Ndikimet e huaja liberalo-moderniste nga krijimtaria letraro-artistike kanë kaluar edhe në skenat e teatrove e të estradave, në ekranet e kinemasë e të televizionit, në aktivitetet e ndryshme të klubeve, shtëpive e vatrave të kulturës. Në mjaft institucione kulturore që shtrihen edhe në bazë është vërejtur, gjithashtu, prirja e nënvleftësimit të mbështetjes në traditat e shëndosha kombëtare e popullore në aktivitetin kulturor.

Puna e filluar për spastrimin e programeve nga ndikimet e huaja, për gjallërimin dhe intensifikimin e veprimtarisë së institucioneve kulturore-artistike duhet të jetë e vazhdueshme dhe në ngjitje. Është e domosdoshme të rriten kërkesat ndaj zgjerimit dhe përmirësimit të cilësisë së gjithë punës kulturore masive, për ta vënë atë më mirë në shërbim të edukimit komunist të masave.

Fenomene shqetësuese kemi pasur edhe në mënyrën e sje-

Iljes e të jetesës. Janë vënë re mjaft shkelje të disiplinës shoqërore në punë e në shkollë, mospërfillje të normave të moralit socialist dhe të ligjeve të shtetit, cenime të rendit publik dhe të personit, shfaqje imoraliteti, injorime të detyrimeve shoqërore që kanë njerëzit si punonjës, si qytetarë, si prindër e familjarë. Veçanërisht në një numër të rinjsh filluan të duken disa fenomene shumë negative, si braktisja e shkollës, qëndrimi pa punë, rrugaçëria, vjedhjet etj. Të gjitha këto ushqyen prirjet e parazitizmit, prirjet individualiste e zvatëse në kurriz të shoqërisë, si dhe pretendimet e padrejta. Bartësit e këtyre shfaqjeve të huaja, që bënin një jetë jashtë luftës së popullit, kanë qenë kontingjenti më i predispozuar për aktet e vagabondazhit e krimet, pasi dihet që parazitizmi dhe prirjet zvatëse janë një burim i degjenerimit moral të njerëzve.

Natyrisht, po të kemi parasysh se ç'ndodh në botën kapitaliste e revizioniste, këto fenomene të ne janë mjaft të kufizuara. Por shoqërinë tonë të shëndoshë e shqetësojnë dhe duhet ta shqetësojnë gjithnjë fenomene të tilla, edhe sikur këto të jenë fare të pakta, qoftë edhe në individë të veçuar, për arsye se ne luftojmë që të ruajmë të pastër e të shëndoshë ndërgjegjen dhe figurën morale të çdo punonjësi, për të ruajtur të pastër tërë shoqërinë tonë socialiste.

Në gjallërimin e këtyre shfaqjeve një rol negativ kanë luajtur disa teorizime të shtrembra të një karakteri të hapur liberal. Thelbi i tyre është kuptimi i njëanshëm krejtësisht i gabuar nga pozita borgjezo-revizioniste i demokracisë së gjerë që ekziston në shoqërinë tonë socialiste, i luftës për emancipimin e njerëzve e sidomos të grave, i raportit midis të drejtave dhe detyrave, midis lirisë së personit dhe disiplinës shoqërore.

Për ne, marksistë-leninistë, mënyra e jetesës është një pjesë e pandarë e tërë jetës shoqërore socialiste, që zhvillohet në lidhje të ngushtë me gjithë revolucionin tonë, në përshtatje me ideologjinë socialiste e me normat e moralit komunist. Kështu e kuptojmë ne edhe mirëqenien materiale e botën shpirtërore të njeriut, edhe afirmimin e individualitetit të tij, edhe emancipimin e lumturinë personale, edhe jetën familjare. Ideali revolucionar komunist është një dhe i vetëm dhe ai na udhëheq në gjithë veprimtarinë e jetën tonë. Për ne është krejtësisht i huaj kuptimi borgjezo-revizionist i jetës, shfaqjet më tipike të të cilit janë individualizmi e egoizmi i shfrenuar, boshllëku e vaniteti, rendja pas luksit dhe plotësimit të gjithfarë tekesh, shthurja e degjenerimi, parazitizmi e kriminaliteti, që janë bërë plagë të pashërueshme morale e sociale të shoqërisë së sotme kapitaliste e revizioniste.

Edhe mënyrën e jetesës ne e shohim në zhvillim të pandër-

prerë, të kushtëzuar nga të gjitha transformimet shoqërore, ekonomike e kulturore, nga rritja e mirëqenies së përgjithshme. Sidomos transformimet e vrullshme socialdemografike, rritja e qyteteve e krijimi i qendrave të reja të banimit, shtimi i klasës punëtore, zhvillimi i gjithanshëm, veçanërisht socialkulturore i fshatit, shpërbërja e familjes patriarkale, zhvillimi i madh i arsimit e i kulturës, evolucioni i psikologjisë shoqërore kanë çuar në ndryshime rrënjësore në mënyrën e jetesës.

Një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim kanë luajtur aksionet e mëdha ideologjike kundër fesë, zakoneve prapanike e traditave të vjetruara, të cilat kanë goditur rëndë shumë koncepte e praktika anakronike. Këto zhvillime pozitive e revolucionare janë shoqëruar edhe me lindjen e problemeve të reja, me rritjen e kërkesave të masave në jetën materiale e shpirtërore, sidomos për kulturë dhe edukim. Për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave e për t'iu plotësuar ato gradualisht, sipas kushteve e mundësive reale, është e domosdoshme të zgjerojmë kuptimin tonë për jetën e kulturore, në të gjitha pamjet e saj, që nga zhvillimi intelektual i njeriut e deri tek ambientet ku ai jeton e punon.

Nga ana tjetër, Partia godit ashpër të gjitha ato synime e përpjekje që, në emër të luftës kundër konservatorizmit, të kërkesave të kohës e të rinisë, të lirisë e të demokracisë, duan të sjellin te ne frymën e korrupsionit e të degjenerimit borgjez. Tani masat punonjëse dhe rinia janë hedhur në luftë kundër këtij ndikimi korruptues, kundër çdo qëndrimi liberal që i hap shtigjet depërtimit të tij. Kjo luftë po bëhet duke revolucionarizuar opinionin shoqëror, duke rritur vigjilencën e ndieshmërinë e tij. Qëndrimet liberale ndaj ndikimeve të huaja nuk mund të mënjanohen pa luftuar kundër shfaqjeve të indiferentizmit në opinionin shoqëror, kundër pasivitetit, tolerancës, neglizhimit. Këto të fundit janë qëndrime të hapëta e tipike mikroborgjeze dhe nuk kanë asgjë të përbashkët me frymën revolucionare të papajtuëshmërisë komuniste ndaj çdo fenomeni negativ e shfaqjeve të huaj.

Por fakt është se ne ndeshim indiferentizëm jo vetëm në radhët e punonjësve, por edhe të komunistëve e të kuadrove. Si mund të heshtin e të bëjnë sehir njerëzit tanë kur shohin se shkelen normat e moralit komunist e ligjet e shtetit, dëmtohet e shpërdorohet pasuria e popullit, kur shohin se disa të rinj pa punuar kërkojnë të jetojnë në kurriz të familjes e të shoqërisë, kur vënë re akte rrugaçërie, imoraliteti e vagabondazhi, shfaqje të modës e të mënyrës së huaj të jetesës? Konceptet se «ka kush merret me këto punë», se «ç'më duhet mua», «pse të prishem me shokun apo komshiun», janë krejt të huaja dhe duhen luftuar fort.

Ne duhet të krijojmë një atmosferë mbytëse kundër çdo shkeljeje të ideologjisë, të moralit, të legjislacionit tonë, të krijoj-

më një front unik edukimi, ku të shkrihen në një të vetme përpjekjet e përbashkëta të shkollës, të të gjitha mjeteve të kulturës e të propagandës masive, të organizatave shoqërore, të familjes, të mbarë opinionit shoqëror.

Rezultatet e arritura në luftën që po bëjnë tani Partia dhe masat kundër ndikimeve dhe shfaqjeve të huaja, janë një hap i rëndësishëm përpara. Por detyra e Partisë është që, duke u mbështetur në këto rezultate, të vazhdojë luftën kundër liberalizmit në të gjitha frontet, të rrënojë thellë në ndërgjegjen e masave konceptet revolucionare, t'i bëjë ato pjesë të botëkuptimit të tyre.

Punën për edukimin komunist të punonjësve, për formimin e shijeve dhe të sjelljeve të tyre komuniste, për fitoren e moralit socialist dhe të mënyrës së re të jetesës, ne e shohim dhe duhet ta shohim gjithmonë si një aspekt shumë të rëndësishëm të luftës së klasave në frontin ideologjik. Nga ky prizëm duhet të vlerësojmë gjithë veprimtarinë edukative që zhvillohet nën drejtimin e Partisë, gjithë aktivitetin e levave të saj e të mjeteve të ndryshme edukative e kulturore.

Për edukimin komunist të masave një rol veçanërisht të madh luajnë shtypi dhe Radiotelevizioni, që kanë dhënë një kontribut të shquar në edukimin politik, ideologjik e kulturor të masave dhe për organizimin e mobilizimin e tyre në luftën për ndërtimin socialist të vendit.

Pastërtia ideologjike ka qenë dhe mbetet parimi bazë i shtypit tonë popullor e të partishëm. Por kohët e fundit në disa organe, si në gazetën «Drita» e «Zëri i rinisë», në revistën «Nëntori» e «Ylli», në disa botime të shtëpisë botuese «Naim Frashëri» kanë dalë një sërë krijimesh letraro-artistike e shkrimesh kritike me ide, koncepte e teorizime të huaja, me prirje liberale moderniste e dukuri të tjera dekadente, të papajtueshme me ideologjinë dhe kulturën tonë. Këto kanë krijuar pështjellim në mendjet, ndjenjat e shijet e masave punonjëse e sidomos të rinisë. Lëshimet që janë bërë në organet e ndryshme të shtypit sjellin një dëm shumë të madh, sepse mëpërmjet tyre ndikimet e huaja borgjezo-revizioniste të futura kontrabandë, jo vetëm që fitojnë, si të thuash, «të drejtën e qytetarisë», po përhapen në mënyrë të shpejtë e masive në të gjitha kategoritë e popullsisë.

Në organet e shtypit duhet të zbatohen me intransigjencë dhe konsekuencë vija dhe direktivat e Partisë. Çdo shkrim, çdo material i botuar në faqet e gazetave, të revistave e të librave duhet të përshkohet nga ideologjia marksiste-leniniste, t'i shërbejë edukimit të gjithanshëm komunist të masave, formimit të njeriut të ri të shoqërisë socialiste. Shtypi, ashtu si deri sot, duhet të frymëzojë masat për qëllimet e larta të ndërtimit të socializmit dhe mbrojtjes së atdheut. Ai duhet të rritë frymën militante revolucionare dhe të goditë me forcë ndikimet e huaja të çfarë-

dolloji dhe nga çdo krah që të vijnë ato. Ai duhet të demaskojë rendin borgjez e revizionist, politikën e tyre antipopullore e agresive, ideologjinë e kulturën e tyre dekadente, të zbulojë plagët sociale dhe të tregojë kalbëzimin e gjithanshëm të sistemit të tyre.

Njihet vendi i posaçëm që zë radioja dhe televizioni në sistemin e propagandës së Partisë. Radiotelevizioni ynë, i udhëhequr nga Partia, ka bërë nga viti në vit përparime të dukshme. Në tërësinë e vet puna e tij është karakterizuar nga përpjekjet e komunistëve dhe të të gjithë punonjësve për rritjen e rolit të këtij institucioni në jetën politike, kulturore e artistike të vendit për propagandimin e vijës e të qëndrimeve marksiste-leniniste të Partisë, të përparimeve të Shqipërisë socialiste.

Megjithëkëtë, duhet vënë në dukje se vitin e fundit sidomos, në programet muzikore, kulturore e artistike të Radiotelevizionit u dobësua dalngadalë fryma revolucionare, brendia socialiste dhe karakteri kombëtar. Këto shmangie u pasqyruan në kopjimin e mënyrave dhe të formave të huaja të ndërtimit e të paraqitjes së programeve të ndryshme televizive, në transmetimin pa kriter politik e ideoestetik të këngëve të huaja, në inkurajimin e krijimit dhe në propagandimin e këngëve moderniste, që imitonin muzikën perëndimore. Kështu programet e Radiotelevizionit filluan të shkëputeshin nga kërkesat shpirtërore të masave të gjera punonjëse, sidomos të rinisë dhe të bëheshin përçuese të shijeve dhe të një morali të huaj, që u pëlqenin vetëm një kategorie snobistësh. Ky produkt i huaj për jetën, për ideologjinë e kulturën tonë u shpreh në mënyrë të sintetizuar në Festivalin e 11-të të Radiotelevizionit.

Një përgjegjësi të madhe për këto shmangie nga vija e Partisë në Radiotelevizion mban Todi Lubonja, ish-drejtor i këtij institucioni, i cili si deviator i djathtë ka manifestuar dhe ka përkrahur pikëpamje të theksuara liberale oportuniste, shije estetike moderniste dhe ka zbatuar metoda të huaja drejtimi. Ai u orvat t'i jepte Radiotelevizionit një drejtim thjesht informativ e kulturor-argëtues, drejtim ky që ishte në kundërshtim me orientimet e Komitetit Qendror të Partisë, mbi karakterin politik, ideologjik e kulturor-edukativ të tij. Todi Lubonja edhe si ish-sekretar i Komitetit të Partisë në rrethin e Korçës, dhe si drejtor i Radiotelevizionit është karakterizuar nga mendjemadhësia. Ai, duke qenë në të njëjtën rrugë antiparti si Fadil Paçrami dhe duke ndjekur të njëjtat qëllime kundër Partisë, ka qenë kundër vijës së Partisë dhe ka punuar për shtrembërimin e saj. Ai ka mënjeluar organizatën-bazë të Radiotelevizionit nga udhëheqja ideologjike, politike e organizative e këtij institucioni, ka ndjekur një politikë personale kuadri duke grumbulluar rreth vetes njerëz që vetë gjykonte se ishin të përshtatshëm për zbatimin e pikëpamjeve dhe të shijeve të tij. Në këtë mënyrë ai dëmtoi rëndë veprimta-

rinë e këtij institucioni të rëndësishëm dhe përgjithësisht punën e Partisë për edukimin ideoestetik të masave, veçanërisht të rinisë.

Partia ka marrë masa për zhdukjen e ndikimeve të huaja në Radiotelevizion. Gjendja atje është përmirësuar, por mbetet akoma shumë për të bërë që radioja e sidomos televizioni të zbatojnë plotësisht detyrat e mëdha që i ka besuar Partia kësaj qendre të madhe propagandistike e kulturore për edukimin e gjithanshëm të masave dhe formimin e tipareve të tij si një televizion revolucionar, socialist e shqiptar.

Këto tipare televizioni ynë i ri do t'i krijojë jo duke imituar e duke kopjuar programet dhe format e paraqitjes së televizioneve të huaja. Një vijë e qartë demarkacioni duhet të ndajë televizionin tonë nga ai i vendeve borgjezo-revizioniste. Rruga e zhvillimit të tij është ajo e Partisë, e popullit, e socializmit dhe e revolucionit.

Partia dhe Qeveria do të përkrahin e do të inkurajojnë si kurdoherë përpjekjet e punonjësve të Radiotelevizionit për të rënë, për të bukurën, të larmishmen, për programe që të pasqyrojnë me të vërtetë zhvillimin e vrullshëm dinamik të shoqërisë sonë, për programe që t'u përgjigjen kërkesave arsimore-kulturore e shijeve estetike gjithnjë në rritje të masave punonjëse e sidomos të rinisë.

Përmirësimi i gjithanshëm i edukimit komunist të brezit të ri lidhet ngushtë edhe me punën e shkollës, të mësuesve dhe të pedagogëve. Këto vitet e fundit, duke luftuar për zbatimin e orientimeve të Partisë për revolucionarizimin e mëtejshëm të saj, shkolla jonë ka bërë hapa të rëndësishëm përpara. Krahas një masivizimi të paparë të arsimit, po duken gjithnjë e më qartë përpjekjet për realizimin e boshtit ideologjik marksist-leninist në gjithë punën mësimore-edukative, për zbatimin në unitet të mësimi me punën prodhuese dhe edukimin fizik e ushtarak, për revolucionarizimin e metodave të mësimi e të edukimit, për demokratizimin e mëtejshëm të jetës shkollore. Një punë me të vërtetë e madhe është bërë e vazhdon të bëhet për hartimin e për përsosjen e teksteve të reja shkollore.

Megjithatë rendimenti i përgjithshëm i punës mësimore-edukative të shkollës nuk i përmbush akoma kërkesat tona. Në shkolla dhe në universitet ka dobësi të theksuara, si nga ana e trupit mësimor, ashtu edhe nga nxënësit e studentët. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës nuk e ka kryer si duhet detyrën e vet në këtë drejtim. Ajo, duke qenë e ngarkuar shumë me punën e madhe që kërkonte riorganizimi i shkollës, sipas vendimeve të Komitetit Qendror të Partisë, harroi dhe nuk ndoqi si duhet gjë-në kryesore të këtij riorganizimi, forcimin e anës edukative të shkollës. Në veprimtarinë e shkollës ka akoma mjaft formalizëm dhe kjo e metë bie në sy veçanërisht në aktivitetin edukativ të saj.

Formimi ideoestetik dhe etiko-moral i nxënësve dhe i studentëve është një nga ato aspekte themelore të edukimit komunist që po realizohet më dobët në shkollën tonë. Këtu nuk është fjala vetëm për ato dobësi që vërehen në këtë fushë në mësimin e lëndëve përkatëse, por sidomos për punën e pamjaftueshme që zhvillohet brenda e jashtë mësimi për zhvillimin e zgjerimin e horizontit kulturor të nxënësve e të studentëve, për formimin e shijeve të tyre ideoestetike, të qëndrimit kritik ndaj vlerave të ndryshme kulturore, për formimin e vetive të reja morale dhe edukatës qytetare.

Nuk mund të mos vërejmë se lufta për demokratizimin e jetës shkollore, për aktivizimin më të madh të nxënësve e të studentëve, për marrëdhënie të drejta mësues-nxënës nuk është bërë e lidhur ngushtë me forcimin e disiplinës proletare në jetën e shkollës. Këtu ka pasur shumë lëshime, një frymë të theksuar mungese përgjegjësie e liberalizmi. Organizatat e rinisë shpesh e kanë vënë theksin në mënyrë të njëanshme të «të drejtat» e të rinjve, pa i parë ato në unitet me detyrat. Organet e arsimit gjithashtu dobësuan shumë kërkesat e drejta të rregulloreve shkollore e shumë mësues e pedagogë mbajtën qëndrime pasive e konformiste. Duke e vënë theksin në mënyrë të njëanshme në luftimin e prirjeve të konservatorizmit në metodat e punës edukative, nuk u luftuan me forcën e duhur qëndrimet indiferente e liberale. Janë të gjitha këto arsye serioze që ndikojnë në disiplinën akoma të ulët shkencore e pedagogjike të punës në shkollë.

Tani në shkolla po luftohet kundër këtyre të metave e dobësive. Por nuk duhet kurrësi të kënaqemi me ato masa të drejta që janë marrë për rregullimin imediat të gjendjes. Për më tepër, duhet të ruhem i që këto masa të mos marrin vetëm karakter të thjeshtëzuar administrativ. Pa hequr dorë nga masat e drejta organizative e administrative për forcimin e rregullit e të disiplinës në shkolla, bile duke luftuar me këmbëngulje për zbatimin e plotë të tyre, është e domosdoshme të punohet edhe për një zgjidhje më të thelluar e perspektive të këtyre problemeve. Programi i Partisë për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës nuk mund të realizohet plotësisht pa intensifikuar luftën për ngritjen e rendimentit e të cilësisë së gjithë veprimtarisë së saj, pa përmirësimin rrënjësor të të gjithë sistemit të punës së saj edukative. Nga problemet më të mprehta e më aktuale të kësaj sfere janë forcimi i edukimit ideoestetik, i edukatës qytetare, i shijeve e i sjelljeve komuniste, i frymës së disiplinës shoqërore komuniste.

Dëshiroj të ndalem pak më gjerë në punën e organizatës së rinisë. Ajo, si levë e rezervë luftarake e Partisë, gjatë gjithë jetës së saj ka luajtur një rol shumë të madh në edukimin dhe mobilizimin e brezit të ri për ndërtimin e mbrojtjen e

atdheut. Partia gjithmonë i ka besuar organizatës së rinisë detyra me përgjegjësi dhe ajo e ka justifikuar kurdoherë plotësisht këtë besim me luftën e punën e saj të palodhur në shërbim të popullit e të revolucionit.

Megjithëkëtë, nuk na lejohet të mos shohim të metat në punën e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, shtrembërimet e gabimet që janë vërtetuar sidomos këto vitet e fundit e që lidhen drejtpërsëdrejti me ato shfaqje e fenomene të huaja liberale moderniste që kritikon sot Partia.

Organizatat e rinisë, posaçërisht në shkolla, por edhe në fshatra e qendra pune, nuk kanë qenë si duhet në krye të situatës, për dobësi të udhëheqjes së rinisë, ndër ta edhe të Agim Meros, kur ishte sekretar i parë i Komitetit Qendror të Rinisë. Agimi është një kuadër i ri, që rrëshqiti në liberalizëm, që iu rrit mendja dhe krijoi pikëpamje jo të drejta për rininë, që dobësoi normat që udhëhiqnin jetën organizative të organizatës së saj. Edhe mbasi vajti në universitet, ai ruajti disa koncepte të gabuara liberale për sa u përket të drejtave të studentëve, pa vënë theksin siç duhet edhe në detyrat e tyre¹.

Zbulimi dhe autokritika që bënë organizatat e rinisë për gabimet e vërtetuara janë një shenjë mjaft e mirë që tregojnë se ato, nën drejtimin e Partisë, do të shëndoshin shpejt gjendjen e tyre dhe do të qëndrojnë në krye të vrullit të rinisë si reparte luftarake të saj. Por nga ato gabime që janë vërtetuar gjithë Partia dhe kuadrot e militantët e rinisë duhet të nxjerrin mësim që të mos i lejojnë më të përsëriten.

Udhëheqja e rinisë nuk e kuptoi dhe nuk e zbatoi drejt direktivën e Partisë për të luftuar njëkohësisht në të dy krahët. Ky ishte burimi i shumë gabimeve në punën e organizatës së rinisë. Duke luftuar me të drejtë kundër patriarkalizmit e konservatorizmit, që ndrydhin e frenojnë zhvillimin e energjive krijuese të rinisë, nuk u vlerësua si duhet edhe rreziku i ndikimeve të ideologjisë borgjeze e revizioniste. Bile shumë shfaqje e fenomene të këqija janë justifikuar e janë minimizuar, duke thënë se «nuk ka gjë për t'u shqetësuar» dhe se «ato janë kalimtare e që lidhen me moshën e rinisë». Megjithëse thuhet që «nuk duhet parë guna, por puna», udhëheqjen e rinisë nuk e kanë shqetësuar rezultatet e dobëta mësimore në shkolla, fakti që mijëra të rinj përsëritnin vitin ose braktisnin shkollën, që të rinjtë punëtorë e kooperativistë bënë shumë mungesa në punë, që krimet nga të rinjtë vazhdonin të rriteshin etj.

¹ Faktet treguan se edhe më vonë Agim Meroja mbajti qëndrim negativ ndaj gabimeve e fajeve të tij të rënda. Prandaj në vitin 1976 Plenumi i 9-të i KQ të PPSH e përjashtoi nga radhët e tij si kandidat, si edhe nga Partia.

Në udhëheqjen e rinisë ka pasur një prirje për t'u marrë më tepër me të drejtat e kërkesat e rinisë, të cilat gjithnjë Partia ka porositur të shihen me kujdes. Po, në të njëjtën kohë, nuk shikohej e nuk theksohej se rinia duhet të kryejë me përpikëri edhe detyrat në mësim e në punë, se çdo gjë ajo nuk duhet ta kërkojë të gatshme, por duhet të punojë e të lodhet shumë edhe vetë për të krijuar kushtet për një jetë të gjallë kulturore, sportive e argëtuese, se ajo duhet t'i ruajë dhe të përpiqet t'i shfrytëzojë mjetet që ka vënë shteti në dispozicion të saj.

Rinia duhet të edukohet që ajo vetë, në radhë të parë, të jetë aktive dhe luftarake dhe të mos ndodhë që për dobësitë e saj në mësim, për shembull, t'ua hedhë fajin «paftësisë së pedagogëve», që, për mosplotësimin e planeve në aksione, fajin t'ua ngarkojë «teknikëve e drejtuesve» etj. Ajo duhet të luftojë kundër vetëkënaqësisë e mendjemadhësisë, të cilat çojnë në një punë për zhurmë e për bujë.

Nënvleftësimi i punës edukative në rini, bile pas punimit të Historisë së Partisë, heqja dorë nga format e organizuara për edukimin e masave të rinisë, duke menduar se me nxënësit këtë e bën shkolla, se në qendrat e punës rinia edukohet në bashkimet profesionale, ndërsa në fshat në Frontin Demokratik, ishte gjithashtu një gabim tjetër serioz.

Shfaqje të liberalizmit prekën edhe jetën e brendshme të Bashkimit të Rinisë, format dhe metodat e punës së tij. Direktiva shumë e drejtë e Partisë për të luftuar shfaqjet e zyrtarizmit, të burokratizmit, format e ngurta, për të aplikuar një punë të zhdërvjellët me rininë, u interpretua në mënyrë liberale. Ajo u kuptua si një çlirim i organizatës nga çdo rregull i domosdoshëm, gjë që çoi në shkeljen e disa normave më themelore të përcaktuara në Statutin e Bashkimit të Rinisë. Në fakt, mbledhjet filluan të bëheshin të rralla, kurse mungesat në to bëheshin më të shpeshta, jeta e organizatave-bazë dhe e forumeve, si dhe lidhjet midis tyre filluan të dobësohen.

Përveç udhëheqjes së rinisë, për dobësitë që janë shfaqur në punën organizative të saj, përgjegjësi të madhe kanë edhe organizatat e komitetet e Partisë, të gjithë komunistët.

Komiteti Qendror i Partisë me të drejtë ka theksuar gjithnjë nevojën për t'u lënë më shumë iniciativë e vetëveprim organizatave të rinisë. Por mos vallë kjo do të thotë se Partia duhet të kujdeset më pak për rininë, se nuk është e nevojshme udhëheqja e vazhdueshme e saj mbi organizatat e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë? Te Partia gjen forcën, orientimin dhe frymëzimin e saj rinia. Kuadrot më të mirë të Partisë duhet të ngarkohen t'i flasim rinisë, t'i shpjegojnë asaj qartë direktivat dhe vendimet që merr Partia. Dhe të mos ngjasë që edhe kandidatit që, porsa pranohet në Parti nga radhët e rinisë, të largohet

nga organizata e rinisë ose edhe kur merr pjesë, të mos japë atje asnjë ndihmë.

Të mos harrojmë kurrë se rinia ka qenë dhe mbetet gjithnjë objekt i veprimtarisë të të gjithë armiqtve. Prandaj duhet kalitur e duhet brumosur ajo vazhdimisht si revolucionare, si duke i folur për të kaluarën, për luftën e për vështirësitë e kapërcyera, ashtu dhe duke e hedhur në aksione, duke e bërë që të angazhohet seriozisht në punë: sa kohë që e reja ose i riu është nxënës e student — në mësim, ndërsa kur del në jetë — në punën prodhuese apo kudo që të caktohet. Në tërë punën që po bën sot Partia për forcimin e përgjithshëm të gjendjes, një vend të veçantë duhet të zërë forcimi i Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, përgjithësisht forcimi i punës me rininë. Të kujdesemi që shkolla, institucionet artistike e kulturore, tërë mjetet e propagandës, sporti etj., të vihen më mirë në shërbim të edukimit revolucionar të rinisë.

Rinia, si kurdoherë edhe këtë radhë, i ka kuptuar drejt dhe po i vë në jetë me të tëra forcat e saj këshillat dhe mësimet e Partisë. Kjo është një dëshmi tjetër që tregon lidhjen e ngushtë të rinisë me Partinë. Çështja tani është që të thellojmë punën me rininë për t'i kuptuar akoma më mirë edhe nga ana ideologjike këto probleme, që ajo të angazhohet sa më gjerë e aktivisht në luftën klasore, në mësim për përvetësimin e teorisë marksiste-leniniste, të shkencës dhe të teknikës, në punë e në aksione për ndërtimin e socializmit, në përgatitjen fizike ushtarake, për mbrojtjen e vendit dhe mbi këtë bazë të shëndoshë ta kalitim atë më tej si forcë e pamposhtur revolucionare në luftën që po udhëheq Partia për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

PËR NJË KUPTIM TË DREJTË TË CENTRALIZMIT E TË DEMOKRACISË NË DREJTIMIN E EKONOMISË

Deri tani folëm për problemet e artit e të letërsisë, si dhe të edukimit ideestetik e moral të masave. Por fronti i luftës kundër liberalizmit, siç e vërtetoi edhe diskutimi që u bë, është shumë më i gjerë. Me shfaqje të tilla ne ndeshemi edhe në një fushë të tillë të rëndësishme siç është ekonomia.

Karakteristikë e përgjithshme e ekonomisë sonë është zhvillimi i saj i shpejtë e i pandalshëm. Edhe në këta dy vjetët e fundit prodhimi industrial është rritur me një ritëm mesatar prej 10,5 për qind, pra, me ritëm më të lartë nga sa ishte parashikuar në planin pesëvjeçar. Një rritje dinamike e prodhimit është ruajtur edhe në bujqësi. Sukseset e arritura deri tani dhe mobilizimi e entuziazmi i punonjësve tregojnë qartë se edhe sivjet detyrat e caktuara do të realizohen.

Fitoret e arritura deri sot përbëjnë një bazë të shëndoshë për të plotësuar detyrat që lindin nga nevoja historike e ndërtimit të socializmit, për të përballuar pasojat që na imponon rrethimi imperialisto-revizionist. Por duke e parë punën tonë me sy kritik, në praktikën e drejtimit e të administrimit të ekonomisë ka edhe anomali e të meta, të cilat nuk janë as të reja as edhe të panjohura. Kështu, mjaft herë janë vërejtur qëndrime të njëanshme e lëshime ndaj detyrave, përgjegjësi e ligjeve shtetërore, dobësim të kontrollit e të kërkesës së llogarisë, tulatje të vigjilencës revolucionare dhe të luftës së klasave. Të tilla shfaqje të karakterit liberal nuk mund të mos ndikojnë për të keq në çështje kaq të rëndësishme, siç janë disiplina e planit dhe e punës, hozrashoti e kontrolli me anën e lekut, normimi e shpërblimi, administrimi i pasurisë së përbashkët socialiste etj.

Natyrisht anomali të e të metat në fushën e ekonomisë nuk rrjedhin as nga sistemi ynë i drejtimit as edhe nga politika ekonomike e Partisë, parimet themelore të të cilave kanë qenë kurdoherë e mbeten të drejta, gjë që e ka provuar koha, vetë realiteti ynë. Por ato e kanë burimin në ndikimin dhe në presionin që ushtron mbi njerëzit tanë rrethimi kapitalisto-revizionist, në mentalitetet e vjetra mikroborgjeze, në kuptimin e ngushtë të direktivave të Partisë.

Në disa nga çështjet, që kanë të bëjnë me drejtimin e administrimin e ekonomisë, vihet re një liberalizëm që më tepër anon nga njëfarë voluntarizmi e subjektivizmi. Jo rrallëherë ndeshen nënvleftësime të ligjeve ekonomike, nuk mbahen parasysh sa duhet kërkesat e tyre nga organet përkatëse ekonomike e shtetërore. Posa rendimenti i punës u përcaktua në metodologjinë e re të planifikimit si tregues llogaritës, filloi të pakësohet edhe vëmendja ndaj tij. Si rrjedhim, në mjaft ndërmarrje, rrethe e ministri u dukën shenjat e fryrjes së planeve të fuqisë punëtore, duke e quajtur një gjë normale mbajtjen ose kërkesën e punëtorëve të tepërt e mbi planin. Së këtejmi u shfaq fenomeni tjetër negativ që, ndërsa fondi i pagave tejkalohej, plani i prodhimit në disa ndërmarrje nuk plotësohej, ose plotësohej jo në masën e duhur, duke shkaktuar në këtë mënyrë shpërpjesëtime midis rritjes së fuqisë blerëse dhe fondit të mallrave që duhen për mbulimin e saj. Me mosmbajtjen sa duhet parasysh të kërkesave të ligjeve ekonomike shpjegohet dobësimi i hozrashotit, dobësimi i kontrollit mbi përdorimin e fondeve themelore e të mjeteve të xhiros, kujdesi i pamjaftueshëm për të llogaritur me hollësi e deri në fund leverdinë ekonomike për çdo prodhim, për çdo shpenzim e investim, duke u nisur nga mendimi: «Të prodhojmë një herë, pa të tjerat rregullohen, vijnë pas». Në nënvleftësimin e levave ekonomike e ka burimin heqja për një kohë dhe dobësimi i kontrollit mbi fondin e pagave dhe mbi investimet.

Komisioni i Planit, Ministria e Financave dhe dikasteret e tjera është e domosdoshme të rishikojnë thellësisht e në mënyrë kritike praktikën e derisotme të punës së tyre. Organet financiare duhet ta fuqizojnë kontrollin financiar për shpenzimet që caktohen nga buxheti në ekonomi e në çdo fushë tjetër, me qëllim që të rritet efikasiteti i tyre. Dikasteret qendrore gjithashtu duhet të përcaktojnë masa konkrete për forcimin e mëtejshëm të hoxra-shotit, për të rritur rentabilitetin në përgjithësi e sidomos në degët e ndërmarrjet e prapambetura, ose që punojnë me humbje. Vitin e kaluar 208 ndërmarrje nuk plotësuan planin e fitimit, ose i tejkaluan humbjet e planifikuara. Tre vjetët e fundit, mesatarisht çdo vit kanë dalë nga prapambetja 100-110 ndërmarrje, ndërsa kanë rënë në prapambetje 90 deri në 100 të tjera. Dikasteret gjithashtu duhet të forcojnë kërkesat për rritjen e rendimentit të punës dhe për përdorimin racional të fuqisë punëtore, sidomos në sektorët ndihmës të prodhimit e ata socialkulturorë, duke përsosur vazhdimisht normimin e shtrënguar të punës dhe vetë organizimin e saj.

Vendi ynë është një vend i vogël, por që i ka vënë vetes detyra e pikësynime të mëdha për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste. Po të kemi parasysh edhe faktorët e njohur politikë dhe ekonomikë, që rrjedhin nga rrethimi kapitalisto-revizionist, atëherë bëhet edhe më e qartë domosdoshmëria e asaj norme të lartë akumulimi që zbatohet te ne, e investimeve shumë të mëdha që jemi të detyruar të bëjmë, e ritmeve të larta që duhet të ruajë ndërtimi ynë socialist, nevoja e vendosjes së një regjimi të rreptë e të gjithanshëm kursimi.

Shumë fakte e të dhëna flasin se mbeturinat në ndërgjegjen e njerëzve dhe ndikimet e huaja borgjezo-revizioniste për ta parë ngushtë interesin e çastit personal, dikasterial, lokal e të grupit, edhe kur ai bie në kundërshtim me interesin e përgjithshëm e perspektiv, u kanë hapur rrugë në praktikën e përditshme mjaft veprimeve të shtrembra e që pengojnë kombinimin e drejtë e revolucionar të këtyre interesave.

Shikimi i ngushtë jo me syrin politik i interesave lokale e dikasteriale i shtyn disa kuadro të bëjnë kërkesa të tilla për investime, për fuqi punëtore e materiale, të cilat nuk mund të përballohen nga ekonomia jonë ose nuk justifikohen me shtimin përkatës të prodhimit, me rritjen e rendimentit të punës dhe të të ardhurave.

Mjaft ndërmarrje dhe organe drejtuese në rrethe e në qendër, në kohën kur hartohen planet, paraqitin shumë arsyeime e llogaritje mbi gjoja nevojën e këtij apo të atij investimi. Por, pa u tharë mirë boja e aprovimit të tyre, fillojnë kërkesat për ndryshimin e fondeve ose zëvendësimin e njërit objekt me një objekt tjetër të paparashikuar fare në plan. Vitin e kaluar 9 rre-

the, si Tirana, Durrësi, Korça, Fieri, Gjirokastra etj., për të realizuar një numër objektesh të planifikuara, kërkuar një shtesë fondesh prej rreth 30 për qind më shumë nga sa ishte aprovuar në fillim. Vetëm rrethet e Peshkopisë e të Gramshit në tremujorin e katërt të vitit të kaluar kërkuar shtesë ose pakësim fondesh për 65 objekte. Nuk mund të lejohet më tej që investuesit, projektuesit dhe zbatuesit të marrin nëpër këmbë planet e aprovuara dhe të ndryshojnë fondet e caktuara për çdo objekt, si dhe kufijtë e tyre të financimit.

Ndodh edhe ndryshe. Fillohet një punë me mendimin e mirë e zotimin se ajo do të kryhet me forcat e veta dhe pastaj vërshojnë kërkesat e presionet deri në Qeveri për materiale e pajisje nga importi, duke e vënë shtetin para alternativës: ose t'i plotësojë këto kërkesa, ose të pranojë si fakt të kryer bllokimin e fondeve monetare e materiale në një objekt të papërfunduar.

Ka ndërmarrje, komitete ekzekutive rrethesh dhe dikastere qendrore që, si pa të keq, kërkojnë ose mbajnë për vete materiale në sasi më të mëdha nga sa janë nevojat e tyre ose nga sa u janë planifikuar. Kush i dha të drejtën Ministrisë së Industrisë e të Minierave, e cila në vitin 1972, pa autorizim të Qeverisë, ka përdorur për ndërmarrjet e veta mbi sasi të planifikuara naftë, në një kohë kur mjaft ndërmarrjeve të dikastereve të tjera nuk iu plotësua plani i furnizimit? Këto veprime e këto praktika janë jo vetëm një shkelje flagrante e disiplinës së planit dhe e kërkesave të ligjeve ekonomike, por ato dëshmojnë edhe për një kuptim liberal të situatave politike dhe ekonomike, të brendshme e të jashtme, në të cilat jetojmë dhe luftojmë për ndërtimin e socializmit. Pra, këto çështje duhen parë thellë dhe me sy politik partie. Fenomenet që po kritikojmë jo vetëm i sjellin dëme e çrregullime ekonomisë, por ndikojnë keq edhe në ndërgjegjen e njerëzve. Prandaj këtyre praktikave të dëmshme duhet t'u pritët rruga një herë e mirë dhe të merren masat e nevojshme për mospërsëritjen e tyre në të ardhmen.

Klasa jonë punëtorë punon dhe realizon detyrat me një frymëzim e entuziazëm gjithnjë e më të madh, me një ndërgjegje gjithnjë e më të lartë. Dhe këto cilësi të mrekullueshme të saj shihen në rezultatet madhështore që ka arritur dhe po arrin vendi ynë në industrializimin socialist, në përparimin e bujqësisë, në zhvillimin e kulturës, në ngritjen e pandërprerë të mirëqenies dhe të përmirësimit të vazhdueshëm të jetesës. Këto cilësi janë karakteristikë e përgjithshme për shumicën e punonjësve. Por ka edhe punonjës të prapambetur, të cilët, për shkak të prejardhjes së tyre sociale, të stazhit të paktë në prodhim ose të ndonjë arsyeje tjetër, nuk janë çliruar akoma nga mjaft koncepte mikroborgjeze, nuk kanë fituar akoma vetitë e vërteta të klasës. Ndaj këtyre ndodh që disa drej-

tues të ekonomisë të mbajnë një qëndrim sentimental, gjë që është e huaj me frymën revolucionare e parimore. Në diskutimet e zhvilluara në qendrat e punës e të prodhimit janë bërë mjaft kritika e vërejtje në këtë drejtim. Përse u dashka të mbahen norma të ulëta pune që tejkalohen lehtë, pa shumë mund e djersë dhe që pastaj punëtorë e kooperativistë të veçantë të zhvatin nga shoqëria më shumë nga sa u takon dhe nga sa i kanë dhënë asaj në të vërtetë? Kujt i shërben ngritja në mënyrë artificiale e pa baza e kategorive të vendeve të punës, me qëllim që gjoja midis punëtorëve të ndërmarrjes apo të degës së tyre të mos ketë dallime të theksuara në shpërbimin e punës? Megjithëse janë marrë vendime të prera që të mos lejohen shtesa në rrogat e punonjësve të administratës derisa të bëhet studimi që është caktuar, ka ministri, të cilat, me qëllim që të ngrenë rrogat e punonjësve të administratës, i paraqitin propozime Qeverisë për të ngritur në kategori disa nga ndërmarrjet e tyre. Të tilla prirje duhen goditur si të dëmshme për ekonominë, si të papranueshme për shoqërinë tonë socialiste.

Shfaqjet e huaja në ekonomi janë jo rrallë rezultat i një kuptimi e zbatimi të pathelluar të raportit ndërmjet centralizmit e demokracisë, drejtimit unik dhe vijës së masave. Këto kanë çuar në dobësimin e kërkesës së llogarisë dhe të kontrollit të rreptë për zbatimin e detyrave, në shkëljen flagrante të disiplinës. Këto janë edhe pasojat më evidente e më të përhapura të liberalizmit në ekonomi.

Jo një herë Komiteti Qendror ka ngulur këmbë që planet të plotësohen jo vetëm si sasi, por edhe për çdo asortiment dhe në përputhje të plotë me kërkesat e standardeve e të kushteve teknike. Dhe përgjithësisht tani nga viti në vit vihet re një përmirësim i dukshëm, janë shtuar përpjekjet për t'iu përmbajtur me rreptësi planit të shtetit dhe kërkesave të tij, është vënë re një kuptim më i drejtë i nevojës së përmbushjes deri në fund të të gjitha zërave e treguesve të planifikimit e të prodhimit. Por në praktikë ndodh që prodhimi të ndiqet e të realizohet vetëm në shifra globale, ndërsa disa mijëra tonë krom e qymyr, disa mijëra metra linear tekstile dhe disa mijëra palë këpucë e konfeksione janë prodhuar në kundërshtim me kushtet teknike e standardet, duke rënduar ekonominë me mallra stoqe, me mbinormativa, me prodhime skarco. Megjithëse në strukturën e mallrave të tregtisë ndihen edhe mungesa, në fillim të këtij viti ndërmarrjet tregtare kishin mbi normativë rreth 250 milionë lekë mallra. Tekstilet, konfeksionet dhe këpucët e pashitura në tregti kanë tendencë rritjeje. Edhe pse dy vjetët e fundit janë zhvleftësuar mbi 46 milionë lekë mallra, prodhimi i tyre me cilësi të dobët vazhdon akoma në disa ndërmarrje e reparte.

Njerëz të pandërgjegjshëm, duke spekuluar në demokracinë tonë socialiste, shkelin rëndë disiplinën në punë. Ata vijnë e ikin nga puna kur t'u dojë qejfi, ndërpresin punën sa herë të duan, sorollaten nëpër ndërmarrje pa pyetur fare për rregullat në punë. Vitin e kaluar rreth 3 000 punëtorë mungonin pa arsye mesatarisht çdo ditë; me mijëra fshatarë nuk dilnin në punë, ndërsa një e katërta e gjithë kooperativistëve kryen më pak se 200 ditë-punë, kur në bujqësi shumë punime nuk bëhen në kohë e me cilësi. Koha e punës nuk shfrytëzohet plotësisht as në administratat shtetërore.

Ka njerëz që përpjekjet e drejtuesve të Partisë, të pushtetit e të ekonomisë për të vendosur rregull e disiplinë orvatën t'i kundërshtojnë në emër të demokracisë e të vijës së masave. Centralizmi demokratik kërkon, siç e ka shpjeguar Lenini dhe siç e ka theksuar kurdoherë Partia jonë, që gjërat të vendosen bashkërisht pas një diskutimi e shkëmbimi të lirë mendimesh, në mënyrë më demokratike e me frymë revolucionare. Por, pasi ato të jenë vendosur, secili duhet të përgjigjet deri në një për detyrën e ngarkuar, të zbatojë e të respektojë disiplinën e planit, atë teknike e të punës. Në kërkimin e kësaj llogarie centralizmi demokratik kalon medoemos nëpër veprimin e pandashëm të drejtimit unik, të bindjes ndaj urdhrat të eprorit, të drejtuesit, që është i ngarkuar i shtetit, i klasës në fuqi, për realizimin konsequent dhe pa të çara të politikës ekonomike të Partisë. Çdo qëndrim tjetër liberal e sentimental është i dëmshëm dhe i huaj. Sa më shumë shtohen të drejtat e kompetencat, aq më shumë rriten edhe detyrat dhe përgjegjësitë për zbatimin e tyre nga cilido.

Këta muajt e fundit, kur klasa punëtore u ngrit në këmbë dhe kritikoi me ashpërsi të metat e dobësitë e konstatuara, rezultoi se kudo u vu një rregull më i mirë, u forcua mjaft disiplina në punë, kontrolli dhe kërkesa e llogarisë u rritën, përgjithësisht u shtua mobilizimi dhe këmbëngulja për të arritur objektivat e caktuar. A nuk tregon kjo se ekzistojnë të gjitha mundësitë dhe të gjitha kushtet objektive e subjektive që shpejt dhe me vendosmëri të mënjanohen vështirësitë e pengesat, që e gjithë puna jonë të ngrihet në një nivel më të lartë, që ekonomia jonë të ecë kurdoherë përpara me ritme të shpejta dhe pa u ndalur?

Klasa punëtore përbën në çdo pikëpamje themelin e ndërtimit tonë socialist, faktorin vendimtar të tij. Asaj i përket të drejtë, të ushtrojë kontrollin e ndikimin e vet, si në kuadrin e përgjithshëm shtetëror, ashtu edhe drejtpërdrejt në të gjitha hallkat e ekonomisë e të administratës shtetërore. Rezultatet e arritura në këtë drejtim janë të dukshme. Lufta e Partisë kundër burokratizmit nuk do të kishte pasur atë gjerësi e thellësi,

po të mos qe ngritur me guxim revolucionar klasa punëtore, po të mos kishte shpërthyer kontrolli i saj masiv, i drejtpërdrejtë, kudo e mbi cilindo. Prandaj është absolutisht e domosdoshme që këtë kontroll ta zgjerojmë e ta forcojmë edhe në luftën kundër shfaqjeve të liberalizmit në ekonomi. Siç ka theksuar Partia, kontrolli punëtor duhet të përfshijë të gjitha sferat e veprimtarisë sonë shoqërore. Por ai duhet të zhvillohet edhe si vetëkontroll në gjirin e klasës. Sa më e fuqishme dhe e papajtueshme të zhvillohet lufta e klasave brenda radhëve të saj kundër liberalizmit dhe çdo shfaqjeje tjetër të ideologjisë së huaj, aq më efikas do të jetë edhe kontrolli punëtor nga poshtë-lart brenda ndërmarrjes e jashtë saj.

Vënia e theksit mbi kontrollin e drejtpërdrejtë punëtor as nuk e përjashton, as edhe nuk e zëvendëson kontrollin shtetëror, i cili është atribut i pandarë i veprimtarisë organizative drejtuese të diktaturës së proletariatit. Mirëpo kohët e fundit në hallka të ndryshme të aparatit shtetëror dhe të ekonomisë ka pasur jo pak shenja të nënvleftësimit të kërkimit të llogarisë dhe mungesës së vënies përpara përgjegjësisë. Kjo prirje sa e dëmshme, aq edhe e rrezikshme, u ka lënë shteg qëndrimeve e veprimeve të huaja në administrimin e ekonomisë, frymës së lëshimeve e dobësimit të disiplinës në kryerjen e detyrave dhe deri në njëfarë mase i ka inkurajuar ato.

Praktika tregon se veprimet ekonomike antishtetërore jo vetëm denoncohen shumë rrallë para organeve përkatëse, por edhe kur bëhet një gjë e tillë, fajtorët e kalojnë lehtë e lehtë, ndaj tyre nuk merren masa në rrugë administrative dhe mbahen qëndrime të buta, oportuniste. Pse ndonjë drejtues i ekonomisë i mbyll sytë kur njerëz të pandërgjegjshëm dëmtojnë pasurinë socialiste, marrin më tepër nga sa u takon dhe përvetojnë mallin e popullit? A nuk e kupton ky se me lëshime e me qëndrime të tilla liberale u sjell një dëm të madh interesave të socializmit dhe vetë atyre që kryejnë këto dëmtime e shpërdorime?

Duhet thënë gjithashtu se edhe organet e drejtësisë nuk e kanë kryer kurdoherë mirë detyrën e tyre për zbatimin e legjislacionit ekonomik kundër çdo veprimi antisocialist. Ato kanë bërë lëshime, janë treguar sentimentale e të pavendosura, duke lënë shtigje për veprime të përsëritura në dëm të ekonomisë e të shoqërisë sonë.

Partia gjithnjë na ka porositur të mos harrojmë për asnjë çast se ndërtimi ynë socialist zhvillohet në prani të luftës së klasave, të kontradiktave, të vështirësive dhe pengesave të ndryshme. Kapërcimi i tyre kërkon medoemos forcimin e diktaturës së proletariatit, organizim, rregull, disiplinë e përgjegjësi. Prandaj kontrolli shtetëror, i kombinuar sa më mirë me kontrollin punëtor, të fuqizohet në të gjitha hallkat nga qendra deri në

bazë, në të gjitha format e tij administrative, juridike, financiare, bankare etj. Ai duhet të jetë sistematik, i thellë dhe i efektshëm për të luftuar shfaqjet e huaja e për të parandaluar të metat e gabimet.

Një parim themelor i ndërtimit tonë socialist është mbështetja në forcat e veta. Ky parim ka hyrë thellë në shpirtin e në gjakun e punonjësve tanë, të cilët i karakterizon një besim i pafund në energjitë, në iniciativën dhe në veprimin e tyre revolucionar. Punëtorët, kooperativistët, kuadrot inxhiniero-teknikë dhe drejtuesit e ekonomisë, duke zbatuar me guxim parimin e mbështetjes në forcat e veta, kanë përballuar me nder detyra të rënda e të ndërlikuara dhe kanë kapërcyer jo pak vështirësi. Ky parim i madh dhe kjo frymë revolucionare po shprehen me forcë edhe gjatë zbatimit të detyrave të pesëvjeçarit të pestë. Duke filluar nga veprat e mëdha e duke përfunduar te repartet e vogla, janë shtuar përpjekjet për thjeshtësimin e projekteve e të punimeve, ngritjen e makinave e të mekanizmave të rinj në vend, shkurtimin e importeve. Mbështetja në forcat e veta shprehet sidomos në rritjen e përgjithshme të frymës krijuese të racionalizimeve e të kursimeve, në rritjen e emulacionit për të ndërtuar e për të prodhuar shpejt, mirë dhe lirë. Nuk ka dyshim se përvoja e fituar në këtë drejtim do të pasurohet edhe paskëta, ajo do të mbahet mirë parasysh, sidomos gjatë hartimit të projektplanit të pesëvjeçarit të gjashtë për periudhën 1976-1980.

Por ne do të na mbulonte ndjenja e pafalshme e vetëkënaqësisë, sikur prapa atyre gjërave që janë arritur të mos shihnim edhe ato shfaqje të huaja, që janë dukur në çështjen e kuptimit e të zbatimit të drejtë të parimit të mbështetjes në forcat e veta.

Në emër të tejkalimit të planit të prodhimit, konsumohen lëndë të para e materiale mbi planin duke përdorur, në kundërshtim me rregullat e caktuara, rezervat e sigurimit. Me gjithë porositë e Komitetit Qendror dhe të Qeverisë, sipas të cilave lufta dhe përpjekjet e kolektivave punonjës duhet të përqendrohen, në radhë të parë e mbi të gjitha, për tejkalimin e planit në ata artikuj, lënda e parë e të cilëve sigurohet në vend e nuk është deficitare, në mjaft raste veprohet ndryshe. Përse të lejohet që mundësitë e krijuara nga ulja e normave të konsumit të materialeve deficitare ose të importit të përdoren për tejkalimin e planit të prodhimit dhe jo për të shtuar e për të fuqizuar rezervat operative, ashtu siç ka theksuar vazhdimisht Partia? Është e tepërt të thuhet se ata drejtues të ekonomisë dhe ato organizata partie, që lejojnë veprime të tilla, nuk i kanë kuptuar në thelb parimin e mbështetjes në forcat e veta, si dhe kushtet e veçanta që na imponon rrethimi kapitalisto-revizionist.

Me këtë sy duhen parë edhe ato raste dhe ata njerëz që për

çdo pajisje apo makineri që u duhet, për çdo problem që ushtrohet për të zgjidhur në ndërmarrje, në kooperativë, në rreth apo në ministri, pa e vrarë mendjen shumë, gjejnë rrugën më të shkurtër, i drejtojnë sytë nga jashtë, e kanë në majë të gjuhës të kërkojnë valutë ose të shkojnë jashtë shtetit, gjoja që të njihen me eksperiencën e përparuar, në vend që t'u drejtohen mundësive e përvojës së brendshme, në vend që të rritin përpjekjet për t'i zgjidhur me forcat e veta problemet që dalin. Është shqetësues sidomos fakti kur prirje të tilla përkrahen pa u thelluar edhe nga disa kuadro në organet drejtuese të ekonomisë e të shtetit. Përveç dëmit ekonomik, harxhimit pa kriter të valutës, dashje pa dashje ata kultivojnë te njerëzit edhe koncepte të gabuara, përhapin një frymë çmobilizuese, frymën e mbajtjes së syve nga importi e dorës së lëshuar, kur është fjala për paratë e shtetit.

Qeveria ka marrë masa, ka caktuar edhe fonde që njerëzit tanë të kenë mundësi të njihen në një mënyrë apo në një tjetër me arritjet e shkencës e të teknikës jashtë vendit. Por këto fonde duhet të përdoren në mënyrë sa më racionale, të merren e të mësohen në radhë të parë ato gjëra për të cilat ka nevojë më shumë ekonomia jonë, që kanë mundësi të zbatohen në kushtet tona dhe që sigurojnë një efekt ekonomik të shpejtë e të madh. Në këtë kuptim duhet t'u pritët rruga iniciativave të atyre njerëzve që, pa njohur realitetin e mundësitë tona, vetëm pse kanë parë ndonjë gjë diku në ndonjë libër, paraqesin relacione e «projekte të mëdha», pa menduar mirë se për t'u bërë ato duhen disa qindra mijëra e nganjëherë edhe miliona dollarë.

Analiza e këtyre të metave e dobësive tregon se në një masë të konsiderueshme ato janë edhe rezultat i lëshimeve të mjaft kuadrove drejtues nga baza deri në qendër. Shkelja e ligjeve dhe e normave që rregullojnë gjithë veprimtarinë e shoqërisë sonë dhe që mbështeten fuqimisht në ideologjinë tonë marksiste-leniniste, është e dënueshme për këdo. Por, kur këto nuk respektohen e nuk zbatohen me përpikëri nga kuadrot, i bëhet një dëm i madh ekonomisë dhe gjithë punës së Partisë. Prandaj kuadrot tanë të dalë nga gjiri i masave, të mbujtur me ideologjinë marksiste-leniniste, të kalitur në kudhrën e Partisë, duhet të kuptojnë e të vlerësojnë si duhet rolin e përgjegjësive e tyre, të nxjerrin konkluzione e detyra të drejta e rigorozë për veten dhe për masat dhe të vënë çdo ditë në balancë të ndërgjegjes klasore gjithë veprimtarinë e vet.

Vendosja kudo e në çdo gjë e rregullit dhe e disiplinës proletare është, në radhë të parë, çështje ndërgjegjeje, edukimi, bindjeje e kalitjeje të masave punonjëse, çështje organizimi dhe zbatimi të rreptë të ligjeve e të normave shtetërore. Në këtë kuptim lind nevoja që edhe bashkimet profesionale të shikojnë

e të përsosin më tej punën e tyre. Përparimet në këtë drejtim janë të njohura. Por edhe të metat që janë shfaqur duhen parë në sy, të vlerësohen drejt dhe pa hezitim të luftohen.

Në veprimtarinë e bashkimeve profesionale vihet re një ndjenjë vetëkënaqësie, gjë që ka ushqyer disa shfaqje formalizmi në punën e tyre. Detyra themelore e bashkimeve profesionale është edukimi i klasës, ngritja e ndërgjegjes politike e ideologjike të saj, organizimi dhe mobilizimi i punonjësve në luftë për ndërtimin socialist, tërheqja e tyre aktive në qeverisjen e vendit. Bashkimet profesionale nuk duhet të lejojnë që t'u nënshtrihen presioneve të ndryshme për t'u marrë me çështje korentë ekonomike në një plan tekniko-administrativ, sepse kjo do t'i largonte, siç ka ndodhur në disa raste, nga përmbushja e detyrave të tyre kryesore. Nga kjo pikëpamje organizatat e bashkimeve profesionale nuk duhet të kënaqen vetëm me rezultatet e përgjithshme që arrin klasa punëtore në prodhim, por duhet të preokupohen seriozisht e të luftojnë edhe më mirë kundër qëndrimeve të huaja ndaj punës e ndaj pronës, siç janë thyerjet e disiplinës, dëmtimet e shpërdorimet e pasurisë së përbashkët, prodhimet me cilësi të dobët, mbajtja e normave të ulëta etj., që shprehin edhe mungesën e një pune efektive edukative.

Nga ana tjetër, bashkimet profesionale punonjësive duhet ta shikojnë jo vetëm në marrëdhëniet e tij me punën, por edhe në jetën e tij shoqërore-familjare, si qytetar e si prind. Shembullor punëtori duhet të jetë jo vetëm në fabrikë e në punë, por edhe jashtë saj, në shtëpi, në rrugë, në shoqëri e kudo.

Zgjidhja e këtyre detyrave kërkon një punë të thelluar e të diferencuar. Ajo nuk duron as formalizmin as punën me bujë. Duke luftuar për t'u shkrirë me masat, organet e bashkimeve profesionale nuk duhet t'u nënshtrihen në asnjë rast presioneve mikroborgjeze të punëtorëve apo të grupeve të veçanta punëtorësh të paformuar, por të luftojnë për të ngritur masat në lartësinë e misionit të klasës. Partia ka theksuar se klasën punëtore duhet ta marrim ashtu siç është. Në radhët e saj ka edhe njerëz që akoma nuk i kanë fituar tiparet e vërteta të klasës, që shkelin rregullat e punës e normat e shoqërisë. Prandaj bashkimet profesionale, pa hequr dorë në asnjë rast nga metoda e bindjes dhe e edukimit, si e vetmja metodë në të tëra veprimet e tyre, duhet të luftojnë për respektimin e për zbatimin me rreptësi të ligjeve të shtetit dhe të rregulloreve të vendosura. Nga ana tjetër, ato duhet të mbrojnë më mirë e më me vendosmëri interesat themelore të klasës punëtore. Në këtë kuadër të luftojnë çdo shtrembërim burokratik që shkel të drejtat e punonjësve, të ngrihen me vendosmëri kundër kujtqo që cenon ligjet e shtetit, qoftë ky drejtues apo punëtor.

Në mënyrë të veçantë, nga bashkimet profesionale kërko-

het që ato të mënjanojnë të metat dhe të përsosin më tej punën edukative për kalitjen ideopolitike të klasës punëtore. Krahas forcimit të sistemit të edukimit të punëtorëve, duhet të gjallërohet më tej jeta politike në organizatat profesionale, të lidhet më mirë puna edukative me problemet që nxjerr praktika, të zhvillohen gjerësisht fryma e papajtueshmërisë me të metat, kritika dhe autokritika në gjirin e organizatës. E gjithë kjo punë duhet të shërbejë që të zhvillohet i vrullshëm emulacioni socialist, të fuqizohen iniciativat dhe aksionet politiko-ideologjike, ekonomike, kulturore e shoqërore, duke përdorur një larmi formash.

Diskutimet që janë bërë kohët e fundit rreth këtyre problemeve kanë qenë një nxitje e re për organizatat e Partisë e të masave, për organet e ekonomisë e të pushtetit, për të gjithë punonjësit e qytetit e të fshatit, që ata të reflektojnë thellë e të dënojnë me frymë të shëndoshë kritike e autokritike shfaqjet e huaja, prirjet e liberalizmit në ekonomi dhe të marrin masa e të forcojnë luftën kundër tyre.

Në mbarë vendin tonë, në qytet e në fshat, në gjirin e klasës punëtore e të fshatarësisë punonjëse, kritika ndaj të metave është shndërruar në një forcë mobilizuese dhe ka ngjallur entuziazëm dhe optimizëm. Një ngritje e përgjithshme vihet re në të gjithë sektorët e ekonomisë. Kudo shihet një përmirësim i ndjeshëm në punë dhe në zbatimin e detyrave. Rezultatet e deritanishme janë mjaft inkurajuese. Plani i shtetit po realizohet me sukses. Ndërsa në dy muajt e parë të këtij viti ishin krijuar nga shumë ndërmarrje deficite të ndjeshme, në fund të muajit maj plani i prodhimit industrial si pesëmuajor u realizua 101 për qind, ndërsa si gjashtëmuajor parashikohet të plotësohet 101,4 për qind. Të gjitha këto dëshmojnë për ndërgjegjen e lartë politike të punonjësve tanë, të klasës sonë punëtore e të fshatarësisë kooperativiste, që me vepra po i vënë në jetë vijën e qëndrimit e drejta të Partisë. Por të gjitha këto e të tjera rezultate të arritura duhen parë vetëm si një hov i ri e inkurajues i asaj lufte të vazhdueshme që Partia dhe të gjithë punonjësit duhet të bëjnë pandërprerë për të çuar përpara ekonominë dhe gjithë ndërtimin socialist të vendit.

ORGANIZATAT E PARTISË DHE KOMUNISTËT TË QËNDROJNË NË BALLË TË LUFTËS KUNDËR SHFAQJEVE TË IDEOLOGJISË SË HUAJ

Partia kurrë nuk i ka fshehur të metat e dobësitë, ajo nuk është druajtur t'i denoncojë ato hapur e me guxim para komunistëve dhe popullit. Kështu ka vepruar ajo në të kaluarën,

kështu po vepron edhe sot. Kritikat tona nuk i errësojnë aspak sukseset e fitoret madhështore, që ka arritur Partia në të gjitha fushat e ndërtimit socialist të vendit. Ato janë një provë tjetër e seriozitetit të Partisë, e forcës së saj, e lidhjeve të ngushta me popullin. Autoriteti i Partisë dhe besimi i popullit ndaj saj kurrë nuk kanë qenë më të lartë dhe më të fortë sesa sot.

Vija e Partisë ka qenë dhe është e drejtë, revolucionare, marksiste-leniniste, por direktivat e saj për disa çështje të rëndësishme që trajtohen në këtë raport nuk janë kuptuar dhe nuk janë zbatuar kurdoherë drejt, bile ka pasur edhe shtrembërimet. Të gjitha këto kanë ndodhur para syve të mjaft komunistëve, të kuadrove, të organizatave dhe të komiteteve të Partisë. Po pse janë lejuar këto? Përse disa shokë u prirën nga interpretimi i njëanshëm i direktivave të Partisë? Përse u nënvleftësuan shumë shfaqje të huaja dhe u dobësua lufta kundër tyre? Burimin kryesor të së keqes duhet ta kërkojmë dhe ta gjejmë në liberalizimin e koncepteve dhe të qëndrimeve për një sërë çështjesh të rëndësishme. Dhe këtë të keqe duhet ta shkuarim nga rrënjët.

Liberalizmi nuk bie nga qielli, ai është produkt i presionit ideologjik të armikut të jashtëm e të brendshëm, që ka për qëllim të minojë pushtetin popullor dhe socializmin. Por shfaqja e këtij fenomeni, dhe sidomos shkalla e përhapjes së tij, varen shumë nga puna e Partisë, nga kuptimi i rrezikshmërisë së tij dhe nga lufta që bën Partia për edukimin dhe për kalitjen revolucionare të komunistëve dhe të punonjësve. Fakti që ky fenomen nuk është bërë kurrë një sëmundje e përgjithshme për Partinë tonë, flet qartë për vigjilencën dhe luftën e drejtë që ka bërë dhe bën ajo. Megjithatë, shfaqjet e liberalizmit që po kritikojmë sot në jetën e shoqërisë, duhet t'i shikojmë të lidhura ngushtë me ato shfaqje të liberalizmit që janë dukur edhe në vetë jetën e Partisë e në veprimtarinë e saj. Por duhet theksuar se ky problem u trajtua pak në mbledhjet e organizatave-bazë.

Ku shprehet liberalizmi në jetën e Partisë?

Në radhë të parë, në faktin që në mjaft organizata-bazë nuk ka gjithnjë një ndjenjë të plotë përgjegjësie si organizatë në tërësi dhe nga secili komunist në veçanti për të zbatuar vijën e Partisë në të gjitha sferat e jetës ku vepron ajo. Në disa sektorë, si në ata të artit, të kulturës e të arsimit organizatat-bazë të Partisë nuk kanë qenë kurdoherë në rolin e tyre udhëheqës, në krye të punëve. Ato nuk janë marrë me problemet themelore të përmbajtjes së veprimtarisë së këtyre institucioneve, nuk kanë ushtruar ndikimin dhe kontrollin e tyre për kuptimin dhe zbatimin e drejtë të vijës së Partisë. Kanë dëmtuar në këtë drejtim edhe konceptet e gabuara, sipas të cilave problemet e artit e të kulturës janë çështje që u përkasin kryesisht

specialistëve dhe se organizatat e Partisë nuk kanë pse të përzihen shumë në këto punë.

S'ka dyshim se mendimi i specialistëve duhet të dëgjohej e të respektohet, sepse ata kanë dalë nga gjiri i popullit, janë njerëz të Partisë, të edukuar me mësimet e saj. Por organizata-bazë në çdo rast mban përgjegjësi të plotë për zbatimin e drejtë të vijës së Partisë. Nga komunistët mund të mos kërkohet të dinë me hollësi anët teknike dhe artistike, por mbrojtja e vijës është detyrë themelore e tyre. Për vijën e Partisë specialist duhet të jetë çdo komunist. Dhe fakti është se kur organizatat e Partisë të institucioneve kulturore-artistike u angazhuan seriozisht në analizën e punës së këtyre institucioneve, ato treguan se janë plotësisht në gjendje t'i trajtojnë thellë e t'i zgjidhin drejt edhe problemet e përmbajtjes ideestetike të veprimtarisë së sektorit të tyre.

Është e domosdoshme të kuptohet thellë në parim dhe të realizohet mirë në praktikë se forcimi i rolit udhëheqës të organizatave-bazë është një detyrë e përhershme dhe jetike e Partisë, sepse roli i saj udhëheqës realizohet nëpërmjet tyre. Përmirësimet janë të mëdha por ka akoma mjaft organizata që bëjnë një jetë partie të vakët. Rutina dhe praktika e përditshme i bëjnë disa organizata-bazë që të merren me çështje korente, si me kalendarin bujqësor, ato nuk angazhohen kështu si duhet me problemet thelbësore ideopolitike, me edukimin e njerëzve.

Ka pastaj organizata-bazë që edhe kur shqyrtojnë problemin, qofshin ideopolitike apo ekonomike, këto shpesh nuk i trajtojnë politikisht, nuk thellohen në shkaqet ideologjike kur vihen re të meta e dobësi dhe nuk përcaktojnë mirë masat për zhdukjen e tyre, nuk punojnë sa duhet për t'u çelur punonjësve perspektivën.

Liberalizmi në jetën e brendshme të organizatave-bazë e ka burimin edhe në moszbatimin e normave të Partisë. Nuk njihet mirë e nga të gjithë Statuti, në të cilin janë sintetizuar normat e parimet e Partisë. Pikërisht këtu e kanë burimin mungesa e një kritike e autokritike luftarake, preokupacioni e përgjegjësia e pamjaftueshme për mbledhjet e Partisë, dobësitë në kërkesën e llogarisë etj.

Puna me vendimet në mjaft raste është e dobët. Ka bile organizata-bazë që s'marrin fare vendime, ndërsa disa të tjera i marrin ato në forma të përgjithshme. Kjo bën që komunistët të mos aktivizohen dhe të mos nxjerrin detyra e për pasojë edhe disiplina e Partisë lë për të dëshiruar. Në këtë mënyrë edhe kontrolli për zbatimin e detyrave dobësohet së tepërmi.

Një ndryshim i dukshëm pozitiv vihet re tani që organizatat-bazë diskutuan për materialet e fundit të Partisë. Në mbledhjet e tyre u shtruan shumë probleme të rëndësishme, në to

u bë një analizë e thellë e punës. Komunistët folën hapur e me kurajë, bënë autokritikë për të metat e gabimet e tyre dhe kritikuan me forcë shfaqjet e fenomenet e huaja. Kjo i shkundi shumë organizata partie dhe i vuri ato në pozita të shëndosha revolucionare.

Por këtu duhet të na shqetësojë një gjë: Për se lejohen të grumbullohen shumë çështje, për se u dashka një mbledhje që të zbrazen të gjitha, për se duhet të pritët vetëm nxitja nga lart për kapjen dhe trajtimin e problemeve që na shqetësojnë? Shumë komunistë i kanë parë shfaqjet e huaja në letërsi e në art, në shkolla e në qendra pune, deri edhe në familjet e tyre. Por disa kanë mbajtur një qëndrim indiferent, nuk kanë ngritur zërin, nuk janë ndeshur me to, kanë pritur t'i zgjidhë dikush tjetër, ashtu siç ka pasur edhe të atillë që janë pajtuar me këto shfaqje.

Këto nuk janë qëndrime prej revolucionarësh, nuk pajtohen me normat e Partisë. Partia kërkon jo vetëm nga çdo komunist, por edhe nga çdo punonjës që ta thotë hapur e pa frikë fjalën e tij, të mos jetë sehirxhi, por të reagojë e të veprojë kur shikon se shkelen e shtrembërohen direktivat e Partisë e ligjet e diktaturës së proletariatit, kur abuzohet e spekulohet me lirinë e demokracinë proletare.

Liberalizmi në punën e Partisë është shfaqur edhe në kuptimin jo si duhet të rolit pararojë të komunistit në zbatimin e detyrave. Në mjaft organizata-bazë komunistit nuk i kërkohet llogari se si e kryen ai detyrën si militant politik, si aktivist shoqëror, si e kryen ai detyrën në punën e caktuar dhe a dallohet nga punonjësit pa parti, a jep shembullin personal dhe a i frymëzon punonjësit pa parti që ka rreth vetes, që edhe ata të punojnë si duhet për realizimin plotësisht të detyrave.

Komunisti, goftë ky punëtor, fshatar, ushtarak, nëpunës e intelektual duhet të jetë luftëtar i zjarrtë për mbrojtjen dhe zbatimin e vijës së Partisë. Asnjë komunist, i çfarëdo profesioni goftë, nuk mund të jetë ndryshe nga të tjerët. Dhe kjo nuk mund të justifikohet me asnjë lloj specifike të punës apo të sektorit. Por ka komunistë, sidomos në sektorët e artit e të kulturës, që i lejojnë vetes lloj-lloj pretendimesh, ndryshe nga të tjerët ata nuk japin llogari për punën e kryer, preken nga kritikata e tregohen hakmarrës. Ka edhe disa komunistë që punojnë në institucione qendrore, të cilët e reduktojnë punën e Partisë vetëm me pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e organizatës-bazë dhe mendojnë se janë në rregull vetëm me kryerjen e funksionit të tyre shtetëror.

Komunisti nuk mjafton të jetë korrekt e pararojë vetëm në punë. Ai duhet të jetë i tillë në tërë veprimtarinë e vet, në gjithë jetën e tij. Si mund të jenë në rolin pararojë e shembull për të tjerët ata komunistë fëmijët e të cilëve kthehen në rrugaçë, va-

gabondë, përçues të modës e të shijeve borgjeze ekstravagante? Figura e komunistit është një dhe e pandarë dhe si e tillë ajo duhet të shfaqet kudo e kurdoherë.

Në radhët e Partisë, si rezultat i ndikimeve të huaja, i pranimëve të bëra disa herë pa kritere të shëndosha, i punës së pamjaftueshme edukative, ka komunistë inaktivë, që nuk i kryejnë detyrat e Partisë, që me qëndrimet e tyre ndikojnë për keq në masat, ulin figurën morale e revolucionare të komunistit. Këta komunistë duhet të shkunden nga plogështia, të kritikohen e të ndihmohen që të korrigjohen në luftë e në punë dhe ndaj atyre që do të vazhdojnë të hiqen zvarrë, të merren masa deri në largimin nga Partia, sepse ata molepsin jetën e Partisë, pengojnë revolucionarizimin e saj.

Partia ka rritur dhe edukuar një armatë të tërë kuadrosh të devotshëm ndaj çështjes së socializmit e të revolucionit, besnikë të popullit dhe të marksizëm-leninizmit. Kuadrot përbëjnë një thesar të madh të Partisë dhe të popullit. Ata mbajnë mbi supet e tyre barrë të rënda dhe kanë zgjidhur e zgjidhin me sukses probleme të mëdha të ndërtimit socialist e të mbrojtjes së atdheut. Partia edhe në të ardhmen duhet të tregojë një kujdes të vazhdueshëm për kuadrin, që ky të jetë kurdoherë i pastër politikisht e ideologjikisht, i lidhur ngushtë me masat dhe luftëtar i vendosur për përparimin dhe për fuqizimin e atdheut tonë socialist.

Eksperiencia e hidhur e Bashkimit Sovjetik tregon se rreziqet që vijnë nga dobësimi i frymës revolucionare të kuadrove janë shumë të mëdha. Ajo ka provuar gjithashtu se mundësitë e degjenerimit të kuadrove vijnë nga dy anë, si nga burokratizimi, ashtu edhe nga liberalizimi i tyre, fenomene këto që janë të lidhura ngushtë dhe ndikojnë mbi njëri-tjetrin.

Duhet thënë se në diskutimin e materialeve të fundit të Partisë, në organizatat-bazë nuk i është kushtuar vëmendja që meriton analizës së punës së kuadrit, lidhur me gjithë këto shfaqje të liberalizmit që janë dënuar. Me të drejtë janë kritikuar fenomenet e huaja në ekonomi, në art e në kulturë, në jetën e Partisë e të shoqërisë etj. A kanë lidhje këto me punën e kuadrove? Mos vallë përgjegjësi ka vetëm punëtori që u tregua i padisiplinuar ose që përpiqet të mbajë norma të ulëta apo vetëm fshatari që nuk dilte në punë dhe nxënësi ose studenti që braktiste shkollën a mësimin? Jo, faj kanë edhe kuadrot, që i kanë lejuar e nuk kanë luftuar kundër këtyre shfaqjeve të huaja. Dhe ka ndodhur kjo, sepse fryma e liberalizmit, e lëshimeve dhe e tolerancës është shfaqur edhe në vetë kuadrot. Kjo është ajo që duhet të shqetësojë Partinë më shumë, sepse janë pastaj të rënda pasojat e pikëpamjeve, të qëndrimeve e të veprimeve të kuadrove në masat. Kur një kuadër bën një lëshim, kur ai

tregohet liberal në një çështje, të tjerët i lejojnë vetes të bëjnë dhjetë. Nëse një kuadër, pavarësisht nga arsyet që e shtyjnë, vetë shkel ligjin, normat e shkruara e të pashkruara të Partisë, bën hatëre apo vepron me pronën e kooperativës si me mallin e vet, atëherë ai s'ka pse të çuditet kur edhe të tjerët kryejnë veprime të tilla të dëmshme. Faktet tregojnë se ndikimet e huaja zënë vend edhe në kuadrot, se edhe ndërgjegjja e tyre zë pluhur. Prandaj ky pluhur duhet shkundur. E mira është që kjo të mos bëhet një herë e me tërmet, por me furçë e përditë, ashtu siç pastrojmë rrobat çdo mëngjes.

Kuadrot tanë duhet të jenë kurdoherë korrektë ndaj ligjeve të shtetit e normave të Partisë, ata duhet të jenë shembull në punë e në jetën personale, të dëgjojnë zërin e masave e të jetojnë midis tyre. Partia ka porositur gjithnjë që kuadrot të japin rregullisht llogari për veprimtarinë e tyre para masave dhe që këto të ushtrojnë një kontroll të vazhdueshëm për punën, sjelljen e qëndrimin e kuadrove.

Duke marrë parasysh rolin e rëndësishme që ka kuadri për mbarëvajtjen e punës në të gjitha fushat e hallkat, duhet të luftohen me vendosmëri ato shfaqje të liberalizmit e të subjektivizmit që vihen re jo rrallë në zgjedhjen dhe vendosjen e kuadrit, kur për të shpesh gjykohet nga ndonjë kontakt i rastit apo nga ndonjë diskutim në mbledhje, kur mbizotërojnë shijet e prirjet personale të disa drejtuesve, të cilët i duan t'i kenë varësit e tyre sipas fytyrës së vet, të predispozuar për të zbatuar çdo gjë që u thotë përgjegjësi, apo kur kuadri zgjidhet në bazë të lidhjeve fisnore, familjare dhe të miqësisë.

Një kujdes i veçantë duhet treguar për zbatimin me rreptësi të direktivave të Partisë për qarkullimin e kuadrit dhe pjesëmarrjen e tij në punën prodhuese, sepse edhe këtu ka pasur shfaqje të liberalizmit. Duhet hedhur poshtë ato justifikime, pengesa e vështirësi, që nxirren për qarkullimin e punën prodhuese të kuadrit, nën pretextin e specifikës e të karakterit të veçantë të disa punëve, të gjoja pamundësisë së zëvendësimit të disa njerëzve, që janë në fakt shprehje e koncepteve intelektualiste e teknokratike.

Në këtë raport, folëm më lart për dobësitë e të metat në punën e organizatave të masave e sidomos të rinisë e të bashkimeve profesionale. Sigurisht, për këto të meta kanë përgjegjësi vetë organizatat e masave dhe organet e tyre drejtuese, por një përgjegjësi më të madhe ka vetë Partia që i udhëheq e i drejton këto organizata. Është realitet që asnjë organizatë dhe komitet partie nuk i ka dhënë Komitetit Qendror ndonjë raport apo informacion për gjendjen në organizatën e rinisë. Megjithatë direktivat e Partisë për punën me rininë kanë qenë kurdoherë të drejta e të qarta, pse komitetet dhe organizatat

e Partisë lejuan që ato të shkelen e të shtrembërohen? Pse lejuan ato që shumë organizata të rinisë të mos mblidhen për muaj të tërë, që të dështojnë mbledhjet e plenumeve e konferencat e rinisë, që pranimet në rini të bëhen formalisht, që të dobësohet puna edukative ideopolitike?

Nga këto duhen nxjerrë mësimet. Fakti që organizatat e masave kanë forumet e tyre drejtuese nga baza në qendër nuk përjashton aspak si detyrën, ashtu edhe përgjegjësinë e organizatave dhe të komiteteve të Partisë për drejtimin dhe udhëheqjen e këtyre organizatave. Partia është për zhvillimin e iniciativës dhe të vetëveprimit të organizatave të masave, por këto duhet të zhvillohen në vijën dhe nën udhëheqjen e Partisë. Ne jemi kundër tutelës dhe metodave të të diktuarit, por jemi edhe kundër çdo dobësimi sadopak të udhëheqjes së Partisë në organizatat e masave. Ashtu si në gjithë jetën e vendit, roli udhëheqës i Partisë duhet rritur e duhet forcuar edhe në organizatat e masave.

Në mjaft organizata dhe komitete të Partisë duket se nuk ka akoma një kuptim të drejtë për vendin dhe rolin e organizatave të masave, për problemet që i shqetësojnë këto organizata dhe shtresat e kategoritë punonjëse të ndryshme që ato përfaqësojnë. Prandaj edhe kujdesi e ndihma që u jepet këtyre nga organizatat e Partisë shpesh nuk është në nivelin e duhur. Nuk u hapen horizonte, nuk u zbërthehen plotësisht direktivat e Partisë dhe nuk ushtrohet kontroll i nevojshëm mbi veprimtarinë e tyre.

Gjatë diskutimit të materialeve të fundit të Partisë janë bërë mjaft vërejtje edhe për aktivizimin e komunistëve në organizatat e masave. Në mbledhje të Frontit mungojnë mjaft komunistë. Mjaft të rinj, me t'u bërë anëtarë partie, shkëputin lidhjet me organizatën e rinisë. Kemi mijëra shoqe komuniste, po ato nuk militojnë si duhet në organizatën e gruas. Ka edhe komunistë që kërkojnë t'u bëjnë bisht zgjedhjes së tyre në organet drejtuese të organizatave të masave.

Këtu kemi të bëjmë me një fenomen serioz, me shfaqje të indiferentizmit dhe me njëfarë ndjenje të epërsisë dhe të mendjemadhësisë që krijohet te disa komunistë me t'u bërë të tillë. Me sa duket nuk kuptohet thellë si nevoja e lidhjeve të Partisë me masat, ashtu edhe ajo që komunisti duhet të jetë një aktivist i shquar shoqëror. Puna shoqërore si një punë e papaguar është një element i komunizmit dhe pikërisht këtu duhet të dallohen në radhë të parë komunistët.

Kujdes të veçantë duhet të tregojë Partia për edukimin e aktivitetit të organizatave të masave, nga puna e të cilit varet shumë veprimtaria e këtyre organizatave. Këto përbëjnë një armatë të madhe aktivistësh shoqërorë që punojnë pa u lodhur

e me devocion për çështjen e Partisë dhe që përbëjnë një burim të pashtershëm për shtimin e radhëve të Partisë e për përgatitjen e kadrove të saj.

Udhëheqja e Partisë, siç e kemi theksuar dhe herë të tjera, është para së gjithash një udhëheqje politiko-ideologjike. Kjo do të thotë që Partia duhet të zhvillojë një punë të gjerë ideopolitike për kuptimin e drejtë të direktivave të saj dhe për t'i bërë punonjësit të ndërgjegjshëm për zbatimin e tyre. Kjo është një fushë shumë e gjerë e punës së Partisë dhe me rëndësi vendimtare. Shumë dobësi e të meta që po kritikojmë e kanë burimin pikërisht te dobësitë e kësaj pune, te cektësia, njëanshmëria, mungesa e lidhjes me jetën, te formalizmi dhe karakteri i saj shpeshherë i përgjithshëm. Në qoftë se ka pasur kuptime të ngushta e të njëanshme të rrethimit gjeografik kapitalist e revizionist, të centralizmit dhe të demokracisë, të kontrollit shtetëror e të kontrollit punëtor, të të drejtave e të detyrave, të emancipimit të gruas, në qoftë se ka pasur keqkuptime e shtrembërime për disa çështje në fushën e letërsisë dhe të artit, të arsimit e të kulturës, kjo tregon se në mjaft raste direktivat e Partisë nuk zbërthehen në mënyrë të plotë e të gjithanshme, teorikisht e praktikisht, prandaj ndodh që ato nuk mishërohen si duhet në veprimtarinë e përditshme të komunistëve e të punonjësve, ka luhatje sa nga njëri krahu në tjetrin, kapet njëra anë dhe lihet pas dore ana tjetër.

Këto kuptime e qëndrime të njëanshme dhe kalime sa nga njëra anë në tjetrën, sa nga konservatorizmi në liberalizëm dhe anasjelltas kanë te ne edhe një bazë reale në karakterin mikroborgjez të trashëguar nga e kaluara, që nuk mund të themi se është zhdukur plotësisht.

Mikroborgjezi është i prirë të lërë një problem e të zërë një tjetër, të kapë njërin e të lërë pas dore tjetrën anë, të kalojë nga njëri ekstrem në tjetrin. Ideologjia e psikologjia mikroborgjeze, që ka rrënjë të thella te ne, është një bazë mbështetëse si për ideologjitë e vjetra patriarkale, feudale e fetare, ashtu edhe për ideologjitë e sotme borgjezo-revizioniste, është ajo urë që lidh konservatorizmin e liberalizmin, që i ushqen e i nxit ata.

Kjo do të thotë që komitetet dhe organizatat e Partisë duhet të thellohen më shumë në problemet ideologjike e të merren më mirë me to, sepse shohim që në praktikë direktivat e Partisë nuk zbërthehen e nuk kuptohen deri në fund, problemet e fenomenet nuk analizohen thellë nga pikëpamja ideologjike e politike. Pak çështje të këtij karakteri shtrohen e diskutohen, shpesh i tërheq rutina e punëve të vogla e të përditshme. Këtu duhet të shikojmë ne edhe një nga të metat kryesore të punës së Partisë për çështjet që po diskutojmë. Po nuk u kuptua the-

llë kjo e metë, është vështirë që të korrigojen të metat e dobësitë që po kritikojmë dhe punët të na ecin mbarë.

Është e nevojshme të formojmë një kuptim më të drejtë për punën e Partisë përgjithësisht dhe për punën e saj edukative në mënyrë të veçantë. Me gjithë rolin e madh që luan edukimi, ky në asnjë mënyrë nuk mund të absolutizohet. Në fakt mbivlerësimi i punës edukative, i ndërgjegjes, çoi në shumë raste në dobësimin e masave organizative, administrative, teknike dhe ekonomike, që u bë shkak i shfaqjeve të ndryshme liberale në qëndrimin ndaj punës e pronës, mësimit, kryerjes së detyrës, organizimit të kontrollit, kërkesës së llogarisë etj.

Puna e Partisë është shumë komplekse, pse e tillë është vetë jeta që ajo drejton e udhëheq. Kjo do të thotë që problemet e ndryshme nuk mund të zgjidhen duke i bërë thirrje vetëm ndërgjegjes së njerëzve, bile edhe vetë edukimi nuk arrihet vetëm me leksione e konferenca. Në jetë problemet zgjidhen me një kompleks masash politike dhe ekonomike, arsimore e kulturore, organizative e administrative. Në këtë kompleks bëhet dhe vetë edukimi i njerëzve, kalitet ndërgjegjja e tyre revolucionare.

Detyra e Partisë është të ngrejë masat në nivelin e ndërgjegjes së saj. Por ne duhet të jemi realistë, të kemi parasysh shkallën e arritur të ndërgjegjes së masave, të mos e konfundojmë atë me ndërgjegjen e pararojës dhe të kërkojmë prej tyre atë që mund dhe duhet të kërkojmë nga pjesa më e përparuar e klasës dhe e masave që është e organizuar në Parti. Kjo nuk duhet harruar në asnjë rast, sa herë që shtrojmë detyra të reja, ndryshe pararoja shkon shumë përpara, largohet e shkëputet nga masat gjë që çon pastaj në pasoja të rënda.

Ashtu si gjithë puna e Partisë edhe direktivat e saj formojnë një unitet të vetëm, ato nuk duhen marrë kurrë të shkëputura nga njëra-tjetra. Do të ishte gabim të mendohej se tani direktivat e mëparshme të Partisë për luftën kundër burokratizmit dhe zhvillimin e demokracisë, për kontrollin punëtor dhe luftën kundër arbitraritetit, për marrëdhëniet e drejta që duhet të ekzistojnë midis Partisë, klasës e masave, për revolucionarizimin e shkollës e të ushtrisë etj., bien dhe nuk janë më të vlefshme. Qëndrimet e Partisë janë konsekuente dhe në direktivat e saj nuk ka kontradikta. Do të ishte një praktikë krejt e gabuar në metodën e punës ajo që, kur del një direktivë e re, një vendim apo fjalim i ri, lihen mënjanë gjithë të mëparshmit. Kjo çon si në punën me fushata, ashtu edhe në shikimin e njëanshëm të problemeve.

Prandaj edhe lufta kundër liberalizmit dhe konservatorizmit duhet bërë në rrugë të drejtë. Elementët konservatorë do të donin që luftën kundër liberalizmit ta zhvillonin nga pozitë

e tyre, ashtu si elementët liberalë u përpoqën ta shfrytëzojnë luftën kundër konservatorizmit për të përhapur liberalizmin. Qëndrimi i vetëm i drejtë në këtë çështje është që si lufta kundër liberalizmit, ashtu edhe kundër konservatorizmit mund të zhvillohet me sukses vetëm nga pozitë parimore marksiste-leniniste.

Po nuk u kuptua drejt ky problem, ka rrezik që tani, kur po luftojmë kundër shfaqjeve të ideologjisë borgjeze e revizioniste e të qëndrimeve liberale, të biem në gabime, të mbahen qëndrime sektare, të ngurta dhe ekstremiste. E theksojmë këtë se ka disa njerëz, edhe kadro, që mendojnë se tani erdhi koha të shtrëngohen rripat, që priren pas masave administrative, që duan të ringjallin arrogancën e arbitraritetin dhe të zëvendësojnë me këto punën bindëse edukative të Partisë.

Duke folur për dobësitë e punës së Partisë, detyra të rëndësishme dalin edhe për aparatit e Komitetit Qendror të Partisë, për të gjithë sektorët e tij. Në punën e tij aparati ka pasur përmirësime të dukshme dhe rezultate të mira. Por shfaqjet e liberalizmit dhe përhapja e ndikimeve të huaja tregojnë se ai ka edhe mjaft dobësi. Shpesh duke u rrëmbyer pas punëve korente, aparati i Komitetit Qendror nuk ka treguar kujdesin e nevojshëm për të parë në plan të gjerë se si zbatohet politika e Partisë në fusha të ndryshme. Në këtë çështje ka ndikuar moszërthimi i thellë e i gjithanshëm i direktivave të Partisë, sidomos në aspektin politik e ideologjik, si dhe mosorganizimi i një kontrolli sistematik e të kualifikuar për zbatimin e vendimeve të Partisë. Ashtu si përpara gjithë organizatave e komiteteve të Partisë, edhe para sektorëve të ndryshëm të aparatit të Komitetit Qendror shtrohet detyra që të përmirësojnë në mënyrë efektive metodën e stilit e punës.

Çështjet që po shtrojmë në këtë Plenum lidhen ngushtë me një problem të madh e kardinal, me kuptimin dhe me zhvillimin e drejtë të luftës së klasave. Partia e ka bërë të qartë prej kohësh se lufta e klasave është një nga forcat kryesore lëvizëse të shoqërisë sonë socialiste, se ajo është një luftë shumë e gjerë që zhvillohet në të gjitha fushat, si kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm, ashtu edhe në gjirin e popullit e të Partisë, se një rëndësi të veçantë në kushtet aktuale merr lufta klasore në frontin ideologjik.

Në vendin tonë lufta e klasave është zhvilluar drejt, prandaj kanë dështuar të gjitha planet e armiqve dhe revolucionin ynë ka ecur gjithnjë përpara. Në këtë luftë është forcuar e është kalitur Partia, është forcuar diktatura e proletariatit, është çelikosur më tej uniteti i Partisë me klasën dhe masat punonjëse, është rritur ndërgjegjja revolucionare e popullit. Por kjo

nuk do të thotë që në kuptimin e zhvillimit e luftës së klasave nuk ka të meta e dobësi. Në praktikë ne jemi ndeshur me mjaft kuptime të cekta, të ngushta dhe të njëanshme, me zbutje të luftës së klasave e nënvleftësim të armiqve, me mosnjohjen e thellë të taktikave të tyre aktuale, me qëndrime indiferente dhe oportuniste.

Janë konstatuar mjaft pakujdesi në punën për përgatitjen ushtarake. Shumë mungesa bëheshin në stërvitjet dhe shumë formalizëm kishte në to, si nga pjesëmarrësit, ashtu edhe nga oficerët që i drejtonin ato. Tani kjo detyrë e dorës së parë duhet të jetë kuptuar më mirë, sepse në stërvitjet e këtyre kohëve të fundit pjesëmarrja i ka kaluar kudo të 90 për qind. Në disa rrethe ato punime për mbrojtje, që s'ishin bërë për vite të tëra, u plotësuan me aksion brenda disa ditëve. Ky interesim e mobilizim duhet të mbahet edhe në të ardhmen dhe të shkojë duke u rritur.

Ndërsa në fushën e vigjilencës ndaj armikut të brendshëm të klasës ka pasur në disa raste shfaqje krejt të pafalshme. Nga diskutimet ka dalë se janë mbajtur qëndrime oportuniste ndaj elementëve me qëndrim të keq politik. Ka pasur raste që, sapo kthehet nga burgu një i dënuar për veprimtari armiqësore, i kanë shkuar këtij në shtëpi deri edhe komunistë «ta urojnë»! Dikur, sidomos në zonat kufitare, çdo të huaji që kalonte i kërkoheshin dokumentet, tani në shumë raste as interesohet njeri për këtë punë etj.

T'i përmbahesh apo të mos i përmbahesh luftës së klasave, të kesh për të një kuptim të plotë apo të cekët, ta zhvillosh atë frontalisht apo në mënyrë të njëanshme, ta zbatosh atë drejt në rrugë revolucionare, apo ta dobësosh e të bësh lëshime, kjo është një çështje jetike, nga e cila varet fati i socializmit. Armiqtë tanë atë duan, që ne të dobësojmë vigjilencën dhe të shuajmë luftën e klasave. Po ne ç'duhet të bëjmë? Të kundërtën. Të forcojmë vigjilencën e të zhvillojmë me konsekuencë luftën e klasave për të mbrojtur fitoret e arritura, për ta bërë atdheun tonë, Shqipërinë socialiste, edhe më të fortë, edhe më të pathyeshme, për të mirën e popullit dhe çështjen e komunizmit.

*
*
*

Problemet që ngrii Partia nuk i shpiku, por ato qenë shqetësimet e vetë klasës e të të gjithë punonjësve. Partia nuk bëri gjë tjetër veçse këto shqetësime, që klasa dhe masat i kishin shprehur në forma të ndryshme, i përgjithësoi dhe ua shtroi

atyre duke u treguar si rrezikshmërinë, ashtu edhe rrugët për kapërcimin e fenomeneve negative që qenë vënë re në jetën e shëndoshë të shoqërisë sonë socialiste.

Gjatë këtyre muajve u zhvillua një punë e madhe nga Partia. Diskutimi për këto probleme u bë një shkollë e vërtetë për edukimin e komunistëve dhe të masave. Por të mos kujtojmë se tani gjithçka është zgjidhur e ka marrë fund. Po të gzykonim kështu, do të mendonim shumë gabim. Lufta kundër shfaqjeve të ideologjive të huaja nuk është fushatë, por një luftë e vazhdueshme dhe e gjatë. Partia, klasa punëtore e të gjithë punonjësit nuk duhet ta ndërpresin kurrë këtë luftë. Në qoftë se do të dobësohet vigjilenca jonë, këto ose shfaqje të tjera të huaja nesër do të gjallërohen prapë. Boshllëk ideologjik nuk ka dhe nuk mund të ketë. Po nuk zuri vend ideologjia jonë, boshllëku do të mbushet nga ideologjia e huaj.

Lufta që po zhvillojmë kundër shfaqjeve të ideologjisë së huaj dhe qëndrimeve liberale ndaj tyre, po e pasuron më tej eksperiencën e Partisë, metodën dhe stilin e punës së saj. Edhe në të ardhmen problemet që na shqetësojnë t'i shtrojmë hapur para masave dhe t'i zgjidhim bashkë me to, ashtu siç kemi bërë vazhdimisht. Në asnjë mënyrë të mos mbetemi në diskutime të gjata, por të marrim masa konkrete dhe të ushtrojmë kontroll të rreptë për zbatimin e tyre. Të ngremë në këmbë masat dhe t'ia nënshtrojmë veprimtarinë e Partisë kritikës dhe autokritikës së hapët të komunistëve dhe të punonjësve.

E gjithë kjo eksperiencë të na shërbejë që të mbajmë kurdoherë lart frymën revolucionare në Parti dhe në masa, vigjilencën dhe gatishmërinë e tyre luftarake, hovin dhe mobilizimin në punë për të realizuar me sukses detyrat e mëdha që kemi përpara, për të forcuar pavarësinë, për të mbrojtur atdheun, për të zhvilluar ekonominë dhe kulturën kombëtare, për të çuar gjithnjë përpara çështjen e revolucionit e të socializmit.

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha
«Raporte e fjalime 1972-1973»,
f. 297. Tiranë, 1974*

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha «Të
thellojmë luftën ideologjike
kundër shfaqjeve të huaja
e qëndrimeve liberale ndaj
tyre». Tiranë, 1973*

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «TË THELLOJMË LUFTËN IDEOLOGJIKE KUNDËR SHFAQJEVE TË HUAJA DHE QËNDRIMEVE LIBERALE NDAJ TYRE»

28 qershor 1973

Plenumi i 4-t i Komitetit Qendror të PPSH në mbledhjen e datës 26 deri 28 qershor 1973, pasi dëgjoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja dhe qëndrimeve liberale ndaj tyre», mbajtur nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, dhe diskutoi gjerësisht rreth tij,

V e n d o s i :

1. — Të aprovojë plotësisht raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH.

2. — T'u rekomandojë komiteteve të Partisë të rretheve, organizatave-bazë, organeve shtetërore dhe ekonomike, si dhe organizatave të masave që në të gjithë punën dhe luftën e tyre ideologjike kundër shfaqjeve të huaja dhe qëndrimeve liberale, të udhëhiqen nga materialet e rëndësishme të këtij Plenumi.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë në ga-
zetën «Zëri i popullit», Nr. 154
(7760), 29 qershor 1973*

NGA PËRSHENDETJA E SEKRETARIT TË PARË TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH, KOMANDANT SUPREM I FORCAVE TË ARMATOSURA TË RPSH, SHOKUT ENVER HOXHA, DREJTUAR USHTARËVE DHE OFICERËVE ME RASTIN E 30-VJETORIT TË THEMELIMIT TË USHTRISË POPULLORE

9 korrik 1973

Të dashur shokë ushtarë e oficerë,

Në këtë ditë të shënuar të 30-vjetorit të themelimit të Ushtrisë sonë Popullore, në emër të Komitetit Qendror të Partisë e të Këshillit të Ministrave, përshëndes efektivin e ushtrisë, punëtorët, fshatarët, inteligjencien popullore dhe gjithë rininë tonë heroike, që, duke punuar në frontet e ndërtimit socialist të vendit dhe duke mësuar në bankat e shkollës, qëndrojnë vigjilentë e të gatshëm për të mbrojtur atdheun me pushkë në dorë.

Duke festuar 10 Korrikun, të gjithë ne së bashku kujtojmë ato ditë heroike dhe legjendare kur lindi ushtria jonë e lavdishme, në flamujt e së cilës është shkruar me gjak fitorja mbi armiqtë barbarë nazifashistë dhe çlirimi i Shqipërisë. Ne kujtojmë plot krenari Luftën vigane Nacionalçlirimtare të popullit tonë, veprën e pavdekshme të partizanëve trima, që hodhën themelet e patundshme të Republikës Popullore të Shqipërisë, të pushtetit popullor, të jetës së re që gëzojmë sot.

Mendjet dhe zemrat tona u drejtohen sot me nderim dhe me mirënjohje të thellë heronjve dhe heroinave që dhanë jetën e tyre të re për lirinë dhe për pavarësinë e atdheut, që Shqipëria të shpëtonte një herë e mirë nga të huajt, nga tregtarët e bejlerët, që të zhdukeshin përgjithmonë uria dhe skamja.

Lindja dhe forcimi i Ushtrisë Popullore, gjithë rruga e saj 30-vjeçare, që nga njësitet e para guerile deri tek armatosja e gjithë popullit, janë vepër e Partisë sonë të lavdishme. Asaj i përket merita e madhe historike në hartimin e programit të Revolucionit

Popullor, në përpunimin e bazave teorike dhe të parimeve themelore të ndërtimit, të edukimit e të përgatitjes së ushtrisë, në përcaktimin e rrugëve për forcimin e fuqisë mbrojtëse të vendit, në hedhjen e themeleve dhe në zhvillimin e shkencës sonë ushtarake popullore.

Ushtria Popullore u krijua në bazë të mësimëve të marksizëm-leninizmit dhe, mbi traditat shumë të pasura të luftërave të gjata të popullit tonë për liri e pavarësi, u krijua si armë në duart e popullit për çlirimin e atdheut, për vendosjen e pushtetit popullor dhe për ruajtjen e fitoreve të revolucionit.

Këto qëllime të mëdha e fisnike përcaktuan edhe karakterin e saj thellësisht popullor, klasor e revolucionar. Në luftë me armiqtë dhe me vështirësitë e panumërta, e frymëzuar nga idealët e mëdha të Partisë sonë dhe nën udhëheqjen e drejtpërdrejtë të saj, ajo u formua e u kaloi si një ushtri e fortë revolucionare. Me heroizmin e pashoq të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, me gjakun e bijave dhe të bijve më të mirë të Shqipërisë u shkrua epopeja e Luftës legjendare Nacionalçlirimtare, luftës më të përgjakshme e më të madhe që ka bërë populli ynë gjatë gjithë historisë së tij, por që i solli edhe fitoren e lavdishme më të madhe në historinë e tij shumëshekullore.

Forcimi dhe modernizimi i vazhdueshëm i Ushtrisë sonë Popullore kanë qenë dhe mbeten në qendër të vëmendjes së Partisë dhe të pushtetit popullor. Ata e kanë parë këtë detyrë kurdoherë si një faktor vendimtar për mbrojtjen e atdheut dhe të revolucionit, si pjesë përbërëse të ndërtimit socialist të vendit.

Në kushtet e reja të pasluftës ushtria jonë duhej të organizohej dhe të armatosej sa më mirë, të përgatitej politikisht dhe ushtarakisht, të bëhej plotësisht e ndërgjegjshme dhe e gatshme për të përballuar e për të thyer me sukses çdo agresion ngado që të vinte.

Partisë iu desh që në fillim të hidhte poshtë jo vetëm pikëpamjet borgjeze mbi ndërtimin e ushtrisë, por të luftonte me vendosmëri edhe kundër teorizimeve oportuniste të revizionistëve modernë e ndërhyrjeve të tyre, si në të gjitha çështjet e tjera, edhe në fushën e ushtrisë. Në kundërshtim me tezat e tyre që e bënin gati të panevojshme ekzistencën e ushtrisë sonë dhe që pretendonin se ajo duhej të ndërtohej vetëm sipas modeleve të huaja dhe jo në përshtatje me detyrat dhe me kushtet e vendit tonë, Partia, me urtësinë dhe me largpamësinë e saj, zbatoi një politikë konsekuente dhe mori një varg masash konkrete për forcimin e gjithanshëm të ushtrisë, për pajisjen e saj me armë moderne, për përsosjen e ndërtimit të saj strukturor, për përgatitjen e saj luftarake e teknike, për forcimin e drejtimit të Partisë në të dhe të edukimit ideopolitik, duke u mbështetur si në artin

modern të luftës ashtu edhe në eksperiencën e pasur të Luftës Nacionalçlirimtare. Në këtë rrugë u hodhën bazat dhe u përpunuan në mënyrë shkencore parimet e Artit tonë Ushtarak Popullor — bazë e patundur për organizimin e mbrojtjes së pathyeshme të vendit tonë.

Eksperienca e gjithë këtyre viteve vërtetoi plotësisht drejtësinë e kësaj vije marksiste-leniniste të Partisë. Shqipëria socialiste u ka qëndruar dhe u qëndron si shkëmb graniti të gjitha rrebesheve që janë vërsulur mbi të gjatë kësaj periudhe, ajo u ka rezistuar me guxim presioneve, kërcënimeve dhe shantazheve të ujqve imperialistë e revizionistë, ka mbrojtur ballëhapur lirinë dhe pavarësinë, punën e vet paqësore.

Ushtria jonë është e fortë dhe e pathyeshme pasi ajo, duke ndjekur mësimet e Partisë, ka qenë e ndërgjegjshme se fuqia e saj nuk qëndron vetëm tek armët dhe organizimi i saj, por edhe te sigurimi i përhershëm i udhëheqjes së Partisë, te lidhjet e çeliktë të saj me masat, te bindjet e ndërgjegjshme të të gjithë efektivit për detyrat e larta që i janë ngarkuar, qëndron, më në fund, në potencialin ekonomik e kulturor të vendit tonë.

Me këtë shpjegohen shkrirja e interesave të ushtrisë me interesat e gjithë popullit, puna e përbashkët për mbrojtjen dhe për ndërtimin e socializmit, fakti që populli është i gjithë ushtar dhe ushtria është me të vërtetë e popullit.

I madh e i vogël te ne e kanë bërë të tyre parullën luftarake të Partisë «Të ndërtojmë socializmin duke mbajtur në njërën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën». Problemi i mbrojtjes së atdheut është bërë çështje e masave të gjera të popullit, ashtu si përgatitja e tyre ushtarake është bërë pjesë e pandarë e ndërtimit të socializmit. Sot ushtria jonë heroike, kjo armë e dashur dhe besnike e popullit, mbrojtëse e fuqishme e diktaturës së proletariatit, përfshin në radhët e veta gjithë popullin tonë trim, punëtor e patriot.

Përvjetori i tridhjetë i gjen efektivin e forcave tona të armatosura, mbarë popullin shqiptar, të përfshirë në një atmosferë entuziazmi, mobilizimi e vrulli revolucionar për të vënë në jetë vendimet historike të Kongresit të 6-të të Partisë, për të realizuar me sukses detyrat e mëdha të vitit të tretë të planit të pestë pesëvjeçar. Populli ynë e feston këtë datë të shënuar i angazhuar në luftën e madhe për revolucionarizimin e mëtejshëm të të gjithë jetës së vendit, për forcimin gjithnjë e më shumë të vigjilencës revolucionare, për përgatitjen dhe për gatishmërinë luftarake.

Situata e vendit tonë është sot më e shëndoshë se kurrë. Pozita ndërkombëtare e Shqipërisë socialiste është forcuar shumë. Atdheu ynë ka një autoritet të merituar dhe gëzon respekt të

madh kudo në botë. Kanë kaluar një herë e përgjithmonë ato kohë kur Shqipërinë e merrnin nëpër këmbë dhe flisnin me të nga pozitat e forcës. Vendi ynë sot ka miq të shumtë, besnikë e të fortë në të gjithë botën.

Me ne janë gjithë popujt revolucionarë të botës.

Por në të njëjtën kohë Partia, populli dhe ushtria jonë janë të ndërgjegjshëm për kërcënimin dhe për rrezikun e madh e të vazhdueshëm që i vjen vendit tonë nga rrethimi imperialist e revizionist. Pavarësisht nga disfatat e shumta, nga krizat e thella dhe nga kontradiktat që i brejnë nga brenda fuqitë imperialisto-revizioniste, politika agresive, synimet dhe veprimet e tyre armiqësore mbeten të pandryshueshme. Të dy superfuqitë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, thurin plane për vatra të reja luftime, kombinojnë komplete politike e prapaska të pabesa, përgatitin tradhti dhe provokacione të reja, nënshkruajnë marrëveshje për ndërhyrje në punët e brendshme të popujve, për agresione të armatosura. Ato zgjerojnë bashkëpunimin e tyre në dëm të vendeve të tjera dhe kërkojnë hapësira të reja për të shtrirë ndikimin dhe hegjemoninë e tyre.

Rrethimi imperialist-revizionist i vendit tonë, si i vetmi vend në Evropë që mban lart e mbron me besnikëri flamurin ngadhënjimtar të marksizëm-leninizmit, nuk sjell vetëm rrezikun e agresionit të hapur të armatosur. Ai ushtron ndaj nesh edhe një presion të vazhdueshëm, një diversion ideologjik, kulturor e psikologjik të pandërprerë. Në këtë rrugë armiqitë kërkojnë të helmatisin dhe të atrofizojnë jetën dhe mendjen e popullit, të çoroditin dhe të neutralizojnë aktivitetin dhe frymën revolucionare të masave, të liberalizojnë e të dobësojnë diktaturën e proletariatit. Në llogaritë e imperialistëve dhe të revizionistëve agresioni ideologjik e kulturor paraprin e parapërgatit agresionin e armatosur, ai spastron rrugën dhe u hap shtigje topave dhe avionëve të tyre.

Prandaj Partia i ka mësuar dhe i mëson vazhdimisht popullin dhe ushtrinë që ta kuptojnë politikisht dhe ideologjikisht këtë rrethim të vendit tonë, ta vlerësojnë drejt e realisht, për t'i parë dhe për t'i njohur rreziqet imediate e ato të ardhshme, me qëllim që të merren të gjitha masat e nevojshme politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake për të luftuar e për të fituar mbi të.

Vendimet e Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror të Partisë, që iu kushtua thellimit të luftës ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre, janë një armë e fuqishme në duart e Partisë dhe të mbarë masave punonjëse për ngritjen e mëtejshme të nivelit ideologjik e politik të njerëzve tanë, për forcimin e vigjilencës revolucionare dhe të luftës kundër

presioneve dhe ndikimeve të huaja, ngado që të vijnë. Ato do ta ndihmojnë për ta çuar edhe më përpara jetën e vendit, ndërtimin e socializmit, për të forcuar figurën morale dhe frymën luftarake të masave punonjëse, për të forcuar disiplinën proletare dhe përgatitjen luftarake të ushtrisë dhe të popullit, për të fuqizuar edhe më shumë mbrojtjen e atdheut. Garanci e forcës së pathyeshme të ushtrisë sonë, e besnikërisë së saj të patundur ndaj popullit dhe çështjes së socializmit, e fitoreve të saj, sot e në të ardhmen ka qenë dhe mbetet udhëheqja e Partisë.

Masat e rëndësishme që ka marrë Partia vitet e fundit për revolucionarizimin e mëtejshëm të Forcave të Armatosura, kanë vërtetuar plotësisht në praktikë drejtësinë e tyre, kanë pasur një efekt të madh në fuqizimin e mbrojtjes së atdheut. Por në këtë rrugë ne duhet të ecim përpara pa u ndalur. Duhet punuar pa u lodhur për edukimin revolucionar të të gjithë efektivit të Forcave të Armatosura me veti të larta morale dhe disiplinë të hekurt proletare. Është e nevojshme të ngrihet në një shkallë më të lartë gjithë puna që bëhet për stërvitjen luftarake të ushtrisë dhe të mbarë popullit, duke ngulur këmbë që ajo të arrijë plotësisht objektivat e caktuar. Më shumë se kudo në stërvitjen ushtarake nuk mund të lejohen formalizmi, liberalizmi dhe konformizmi.

Ashtu si dhe deri më sot, respektimi i disiplinës së çeliktë proletare, zbatimi me rreptësi nga të gjithë, që nga oficeri më i lartë e deri tek ushtari i thjeshtë, i rregulloreve ushtarake dhe i urdhrave të komandave, ruajtja gjithnjë e pastër e figurës morale të ushtarit të popullit, janë ligje të shenjta për ushtrinë tonë dhe, si të tilla, duhen vënë në jetë me fanatizmin më të madh.

Partia ka besim se ushtarët e oficerët, vullnetarët e vullnetaret, nxënësit e studentët, të bashkuar rreth Partisë dhe Komitetit të saj Qendror, do t'i karakterizojnë si kurdoherë lufta dhe përpjekjet për t'i kryer sa më mirë detyrat e shërbimit, gatishmëria e përhershme luftarake, puna e palodhur krijuese, lufta këmbëngulëse dhe guximi për kapërcimin e vështirësive, bindja e thellë në drejtësinë e vijës së Partisë dhe besimi në fitore.

Shokë ushtarë dhe oficerë,

Mbani kurdoherë lart flamujt tuaj luftarakë, flamujt e be-tejave legjendare të luftës së lavdishme për çlirimin e Shqipërisë, qëndroni kurdoherë vigjilentë e të disiplinuar, përvetësoni me ngulm artin ushtarak dhe bëhuni mjeshtër të luftimit, jini kurdoherë të gatshëm, të vendosur e të bashkuar për të mbrojtur punën ndërtimtare të njerëzve tanë, për të luftuar me trimëri

dhe për të fituar kundër çdo armiku që do të guxonte të prekte atdheun tonë socialist!

Rroftë populli ynë besnik!

Rroftë Partia trimë e Punës, krijuesja dhe udhëheqësja e forcave tona të armatosura!

Rroftë Ushtria jonë Popullore!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Sekretari i Parë i KQ të PPSH dhe
Komandant Suprem i Forcave të Armatosura të RPSH

Enver Hoxha

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 163 (7769), 10 korrik 1973*

V E N D I M

I BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI DISA PËRMIRËSIME NË ORGANIZIMIN GJYQËSOR

22 tetor 1973

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, pasi shqyrtoi relacionin e Gjykatës së Lartë «Mbi disa probleme të organizimit gjyqësor të RPSH», në mbledhjen e saj të datës 22 tetor 1973, vërejt:

Masat e marra në vitet 1966 dhe 1968 për organizimin gjyqësor siç ishin suprimimi i Ministrisë së Drejtësisë, i gjykatave të qarqeve dhe i institutit të avokatisë, si dhe krijimi i zyrave të ndihmës juridike dhe i gjykatave të fshatrave, të qyteteve dhe të lagjeve të qyteteve, e kanë revolucionarizuar më tej punën e organeve të drejtësisë. Këto masa të drejta, siç ka vërtetuar praktika e këtyre viteve të fundit, kanë demokratizuar më tej punën e organeve të drejtësisë, i kanë afruar më tepër këto organe me masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit dhe kanë bërë që t'i shërbehet më mirë popullit dhe ndërtimit të socializmit.

Rritja e kompetencave të gjykatave të rretheve përqendroi më mirë dhënien e drejtësisë në rreth, kurse krijimi i gjykatave të fshatrave, të qyteteve dhe të lagjeve të qyteteve tërhoqi mijëra njerëz, aktivistë shoqërorë, në dhënien e drejtësisë.

Si rrjedhim i ngritjes së mëtejshme të ndërgjegjes politike dhe juridike të masave punonjëse, këto vitet e fundit është rritur numri i denoncimeve të shtetasve kundër elementit keqbërës. Shtetasit, duke njohur më thellë ligjet e pushtetit popullor dhe të drejtat që ato u sigurojnë, gjithnjë e më shumë po u drejtohen gjykatave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridike civile. Në këtë situatë të shkëlqyer revolucionare të vendit tonë, organet e drejtësisë e kanë organizuar më mirë luftën kundër shkeljeve të ligjit.

Luftën kundër shfaqjeve të liberalizmit dhe ndikimeve të huaja në kuptimin dhe zbatimin e ligjeve, organet e drejtësisë, të udhëhequra nga Partia, po e zhvillojnë me sukses. Në këtë

drejtim ato duhet të shmangin dhe të denoncojnë çdo ndërhyrje të padrejtë që mund t'u bëhet në zgjidhjen e çështjeve konkrete. Gjykatat, për çështjet që u vijnë për shqyrtim, duhet të vendosin duke u mbështetur vetëm në politikën e Partisë, që shprehet qartë në ligjet.

Gjykata e Lartë si organi më i lartë i dhënies së drejtësisë ka për detyrë kryesore drejtimin e veprimtarisë së gjithë gjykatave të rrethit dhe të bazës. Puna e saj për drejtimin, për kontrollin dhe ndihmën mori një rëndësi të veçantë sidomos me krijimin e gjykatave të fshatrave dhe të lagjeve të qyteteve.

Gjithashtu, Gjykata e Lartë, duhet të bëjë studime dhe përgjithësime të thelluara për probleme të kriminalitetit dhe të shkeljeve të ndryshme të ligjshmërisë që dalin nga shqyrtimi i çështjeve penale dhe civile, si dhe të përgjithësojë praktikën gjyqësore duke dhënë udhëzime të qarta dhe të sakta në interpretimin e ligjeve.

Gjykata e Lartë duhet të punojë më shumë për kualifikimin e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve dhe të punonjësve të zyrave juridike.

Me qëllim që të realizohen më mirë nga organet e drejtësisë detyrat e rëndësishme që shtron Partia, Byroja Politike

V e n d o s i :

Të bëhen disa përmirësime në organizimin gjyqësor:

1. — Gjykata e Lartë të shkarkohet nga gjykimi në shkallë të dytë i çështjeve të vogla, asaj t'i lihen për shqyrtim çështjet më të rëndësishme penale dhe civile.

2. — Gjykimi në shkallë të dytë i shumë çështjeve të bëhet nga gjykatat e rretheve, të cilat janë më afër bazës, duke siguruar kështu një shpejtësi më të madhe në gjykimin e çështjeve dhe mënjanimin e sorollatjeve të shtetasve për të ndjekur gjykimin larg rretheve përkatëse.

3. — I rekomandohet Presidiumit të Kuvendit Popullor që me ligj të caktojë kompetencat e Gjykatës së Lartë dhe të gjykatave të rretheve lidhur me shqyrtimin e çështjeve në shkallë të dytë.

4. — Me qëllim që të përballohet volumi i punës së gjykatave, i rekomandohet Këshillit të Ministrave që të shqyrtojë organikat e tyre dhe të bëjë plotësimet e nevojshme.

Kjo duhet të ndikojë jo vetëm për përmirësimin e punës në gjykimet e shkallës së parë dhe të dytë, por sidomos në ndihmën dhe kontrollin që duhet t'u jepet gjykatave të fshatrave, të qyteteve dhe të lagjeve të qyteteve, që të gjallërohet më shumë puna

e tyre, gjë që përbën një nga format mjaft të rëndësishme të aktivizimit të masave të gjera punonjëse për ushtrimin e drejtësisë.

5. — Me qëllim që edhe në të ardhmen të kemi kuadro të kualifikuar për organet e drejtësisë, duhet që komitetet e Partisë në rrethe dhe Ministria e Arsimit dhe e Kulturës të tregojnë vëmendje të veçantë në zgjedhjen e studentëve që do të dërgohen në degën e drejtësisë të Fakultetit të Shkencave Politiko-Juridike, të cilët përveç besimit politik duhet të kenë edhe përparim të mirë në mësimet.

Fakulteti duhet të marrë masa për një organizim më të mirë të punës pedagogjike si në dhënien e leksioneve, ashtu edhe për organizimin e praktikave, si dhe për periudhën e stazhit të studentëve.

Gjykata e Lartë duhet të marrë masa organizative akoma më shumë për kualifikimin e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve dhe të punonjësve të zyrave juridike.

6. — Të krijohet në Gjykatën e Lartë sektori i studimeve, i cili të merret me studimin dhe me përgjithësimin e problemeve të kriminalitetit dhe të çështjeve që shtrohen në fushën e marrëdhënieve civile si dhe të problemeve të tjera të drejtësisë sonë socialiste.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI DISA MASA PËR TË NXITUR PRODHIMIN E MISHIT

22 tetor 1973

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH në mbledhjen e datës 22 tetor 1973, pasi mori në shqyrtim relacionin e Kryesisë së Këshillit të Ministrave, me qëllim që të shtohet, të nxitet dhe të bëhet më i interesuar prodhimi i mishit nga ekonomitë prodhuese,

V e n d o s i :

1. — Për blerjen e mishit të gjedhëve e të bagëtive të imëta në rritje dhe të derrit nga ekonomitë prodhuese shtetërore e kooperativiste, kur dorëzohen me peshë mbi kufijtë e caktuar, e gjithë sasia e mishit të blihet me çmime 26-32 për qind më të larta.

Organet shtetërore të grumbullimit të blejnë në këmbë (pa peshë ose me peshë) bagëtitë e oborreve kooperativiste me një çmim rreth 20-25 për qind më të lartë nga çmimet që janë në fuqi, pavarësisht nga pesha.

2. — Mishi i gjedhit dhe i derrit t'i shitet popullsisë sipas ndarjes anatomike...

3. — Të bëhet njësimi i çmimit të shitjes së qumshtit me pakicë, duke zbatuar çmimin e periudhës së dimrit për gjithë vitin.

4. — Ngritja e çmimit të blerjes së mishit të shërbejë si një nxitje e madhe për të gjitha ekonomitë prodhuese, të cilat të thellojnë më tej masat tekniko-organizative për krijimin e tufave të majmërisë, për të gjitha llojet e bagëtive dhe për t'i shitur ato në organet shtetërore me pesha sa më të larta.

Rritja e peshës për krerë të të gjitha llojeve të bagëtive në përputhje me aftësitë prodhuese të tyre, rritja e prodhimeve të bimëve foragjere dhe ulja e koston e tyre, si dhe rritja e efekti-

vitetit të ushqimeve për të marrë nga çdo njësi ushqimi më shumë prodhim mishi, të konsiderohen rrugët kryesore për shtimin e prodhimit të mishit, për të ulur vazhdimisht koston e tij dhe për ta bërë atë më të leverdishëm për ekonomitë prodhuese.

5. — Sigurimi dhe fuqizimi i bazës ushqimore, aktualisht e në perspektivë, sidomos në drejtim të rritjes së rendimenteve të bimëve foragjere, përbëjnë faktorin më të rëndësishëm për shtimin e prodhimit të mishit dhe për uljen e koston e tij. Prandaj edhe vëmendja kryesore e komiteteve, e organeve dhe e organizatave të Partisë dhe e gjithë organeve shtetërore e ekonomike në përpjekjet për shtimin e fondit të mishit, të përqendrohet në radhë të parë e mbi të gjitha për të marrë prej bimëve foragjere rendimente sa më të larta. Komitetet e Partisë në rrethe, organet shtetërore dhe ekonomike të shtojnë kujdesin dhe punën e tyre për përmirësimin dhe zgjerimin e bazës ushqimore, për rritjen e rendimenteve të kulturave foragjere, si dhe për kombinimin e drejtë të ushqimeve të bagëtive.

Organizatave të Partisë duhet të bëjnë një punë të veçantë për kuptimin e këtyre detyrave dhe të ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm në punën e kryesive të kooperativave dhe drejtorive të ndërmarrjeve bujqësore për mbjelljen e të gjitha sipërfaqeve të planifikuara me bimë foragjere, për shtimin e vazhdueshëm të sipërfaqes me bimë të dyta e ndërmjetëse, veçanërisht të tërfilitit e të kolzës, pas të lashtave, të cilat të shfrytëzohen deri në mbjelljet e pranverës, për shërbimet e nevojshme të bimëve foragjere me tërë seriozitetin e duhur dhe për rritjen e efektivitetit të tyre përmes përpunimit dhe kombinimit racional. T'u bëhet e qartë të gjithë punonjësve të bimëve të arave e të blegtorisë se prodhimi i mishit të gjedhit, të derrit dhe të bagëtive të imëta nga ndërmarrjet bujqësore e sidomos nga kooperativat bujqësore, mund të shtohet në një masë të ndjeshme në qoftë se do të sigurohen për bagëtitë në çdo kohë, gjatë gjithë vitit, pa ndërprerje, ushqime të bollshme e me përmbajtje të lartë proteinike. Ky duhet të jetë edhe objektivi konkret ku duhet të synojnë të arrijnë të gjitha ekonomitë bujqësore të vendit brenda një periudhe sa më të shkurtër.

6. — Për arritjen e këtij objektivi, Ministria e Bujqësisë dhe organet ekonomike e shtetërore të marrin masa konkrete për organizimin e tufave të majmërisë në ato ekonomi bujqësore ku ende nuk janë ngritur dhe për forcimin e gjithanshëm të punës në ato ekonomi bujqësore ku ka filluar ngritja e tyre.

Për të siguruar një shtesë sa më të madhe mishi të përdoren gjerësisht të dy mënyrat e mbajtjes së bagëtive për mish: në ekonomitë bujqësore që nuk kanë kullota e livadhe, shtesa në peshë dhe majmëria të organizohen mbi bazën e shtimit të prodhimit të foragjereve dhe shfrytëzimit intensiv të të gjitha burimeve të

brendshme që ka secila prej tyre; në ekonomitë bujqësore që kanë ose u janë dhënë dhe kullota natyrore, shtesa në peshë dhe majmëria të organizohen në radhë të parë mbi bazën e përmirësimit dhe të shfrytëzimit sa më racional dhe të kombinuar të kapacitetit të tyre prodhues.

Ministria e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve të studiojnë dhe të përcaktojnë konkretisht kullotat natyrore, që do të përdoren për rritjen e bagëtive të imëta e të trasha për mish, duke organizuar e kombinuar shfrytëzimin e tyre me kooperativat dhe ndërmarrjet bujqësore.

7. — Ministria e Bujqësisë, komitetet e Partisë dhe të gjitha organet shtetërore dhe ekonomike, krahas punës për llojet e tjera të bagëtive, të tregojnë një vëmendje më të madhe për shtimin e bagëtive të imëta (të dhenve e të dhive) për prodhim qumshti, leshi dhe mishi. Të mos lejohen qëndrime e veprime që çojnë në nënvleftësimin e tyre. Çdo mundësi e kusht objektiv që ekziston për shtimin e numrit të bagëtive të imëta, si dhe për prodhimin e mishit të shfrytëzohet plotësisht dhe sa më parë. Në lidhje me këtë, organet përkatëse të marrin masa konkrete për caktimin e drejtë të kullotave që duhet të lejohen për mbajtjen e bagëtive të imëta, veçanërisht të dhive, për shfrytëzimin e plotë e racional të mundësive që kemi në këtë drejtim dhe për shtimin e aftësive prodhuese të dhenve dhe të dhive nëpërmjet përmirësimeve të gjithanshme dhe shtimit të numrit të tyre.

8. — I rekomandohet Këshillit të Ministrave të nxjerrë dispozita të veçanta për caktimin e çmimeve të blerjes për çdo lloj bagëtie e sipas peshave dhe të çmimeve të shitjes me pakicë të mishit sipas ndarjeve anatomike si edhe për njësimin e çmimit të shitjes së qumshtit me pakicë.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

NGA PROTOKOLLI

I BYROSË POLITIKE TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH LIDHUR ME STUDIMIN «RRETH DREJTIMEVE KU MUND TË PËRSOSET MË TEJ PËRDORIMI I DISA LEVAVE EKONOMIKE PËR FORCIMIN E HOZRASHOTIT»

22 tetor 1973

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH në mbledhjen e saj të datës 22 tetor 1973 shqyrtoi studimin e paraqitur nga Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste dhe nga Instituti i Studimeve Ekonomike «Rreth drejtimeve ku mund të përsoset më tej përdorimi i disa levave ekonomike për forcimin e hozrashotit».

Byroja Politike studimin e vlerësoi të mirë dhe që ndihmon organet shtetërore në punën e tyre për të përsosur metodën e drejtimit të ndërmarrjeve. Prandaj ajo u rekomandon Këshillit të Ministrave dhe organeve ekonomike shtetërore të marrin masa për të vënë në jetë problemet që trajton studimi dhe tërheq vëmendjen sidomos për çështjet e mëposhtme:

1. — Partia ka bërë dhe bën një luftë të vazhdueshme për të përsosur përdorimin e levave ekonomike. Rruga që ka ndjekur ajo në këtë çështje ka qenë e drejtë, revolucionare, marksiste-leniniste. Por është detyrë e organeve shtetërore dhe të ekonomisë që të kujdesen vazhdimisht për të përsosur përdorimin e levave ekonomike, të nxjerrin konkluzione e të marrin masa në përputhje me marksizëm-leninizmin, me mësimet e Partisë dhe me përvojën tonë të re që fitohet gjatë ndërtimit të plotë të socializmit.

2. — Për forcimin e hozrashotit të zbatohet më në thellësi parimi që me të ardhurat ndërmarrja të mbulojë shpenzimet dhe të japë akumulim për shoqërinë. Ky parim themelor i hozrashotit nuk duhet absolutizuar (duke u nisur nga interesat e përgjithshme të ekonomisë, është e pranueshme që ndërmarrje apo produkte të veçanta të dalin përkohësisht me humbje), por as edhe nuk duhet lejuar që të nënvleftësohet, goftë edhe kur ndërmarrja planifi-

kohet me humbje. Të bëhen përpjekje të pareshtura për të pakësuar numrin e ndërmarrjeve që planifikohen ose dalin me humbje.

Në kuadrin e forcimit të hozrashotit të studiohen në mënyrë të veçantë sidomos dy probleme të rëndësishme: përsosja e mëtejshme e sistemit të çmimeve me shumicë e me pakicë, si edhe përdorimi më racional i fondeve themelore e të xhiros së ndërmarrjes.

Është e nevojshme gjithashtu të merren masa të veçanta që elementët e hozrashotit të forcohen edhe në kooperativat bujqësore, duke e shtrirë zbatimin e disave prej tyre deri në brigadë.

3. — ... Investimet e ndërmarrjeve dhe të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të mbulohen me bazë materiale sipas rregullave.

4. — Fondi i veçantë i ndërmarrjes të vazhdojë të krijohet sipas kushteve formuese ekzistuese, duke i diferencuar këto kushte në përputhje me natyrën e degës dhe të ndërmarrjes ekonomike...

Me qëllim që në përdorimin e fondit të veçantë të ndërmarrjeve të kufizohen sa të jetë e mundur më shumë shfaqjet e subjektivizmit në këtë çështje, është e domosdoshme të forcohen kriteret e shpërndarjes, duke marrë edhe mendimin e kolektivit punonjës...

5. — Organet shtetërore të ekonomisë të shtojnë përpjekjet dhe luftën për të mos lejuar shpëputje midis prodhimit të produktit shoqëror dhe shpërndarjes së tij të caktuar në planin e shtetit. Për këtë qëllim veprimtaria e ndërmarrjes të mos vlerësohet në mënyrë të njëanshme, vetëm me treguesin e prodhimit global, por në mënyrë komplekse, duke kërkuar realizimin e gjithë treguesve kryesorë të planit të shtetit...

6. — Që të ngrihet në një shkallë më të lartë lufta lidhur me përmirësimin e cilësisë së prodhimit, është e domosdoshme të shpejtohen marrja e masave për vendosjen e normave teknike të harxhimit të materialeve dhe për hartimin e kartave teknologjike, si dhe marrja e masave për respektimin e standardeve shtetërore.

7. — Për shumë probleme të përdorimit të levave ekonomike dhe të metodologjisë së planifikimit, ndonëse janë gjetur zgjidhje të drejta, të sanksionuara me ligje, urdhëresa e udhëzime, ato nuk vihen plotësisht në jetë. Është detyrë e Komisionit të Planit të Shtetit dhe e Ministrisë së Financave të ndjekin zbatimin e tyre në organet qendrore e të bazës dhe, po ta lypë nevoja, të marrin masa organizative e administrative të veçanta.

Byroja Politike e Komitetit Qendror thekson që organet shtetërore dhe të ekonomisë, si dhe institucionet e specializuara në fushën e studimeve ekonomike, të vazhdojnë të thellohen në stu-

dimin e të gjitha atyre çështjeve e problemeve që kanë të bëjnë me përsosjen e sistemit tonë të drejtimit të ekonomisë, me vënien e tij mbi baza më të shëndosha shkencore.

Sekretari i Komitetit Qendror të PPSH

Hysni Kapo

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

VENDIM
I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH
MBI PUNËN PËR EDUKIMIN MARKSIST-LENINIST
TË KOMUNISTËVE

24 janar 1974

Edukimi marksist-leninist i komunistëve ka qenë dhe mbetet kurdoherë një detyrë e madhe për Partinë, sepse roli pararojë i Partisë dhe i çdo komunisti varet nga shkalla e përvetësimit të thellë dhe e zbatimit krijues të doktrinës marksiste-leniniste.

Për edukimin marksist-leninist të komunistëve është bërë një punë e madhe. Partia ka krijuar një sistem të tërë shkollash, kurseve e formash, ku komunistët e punonjësit studiojnë teorinë marksiste-leniniste, ka përgatitur një numër të madh kadrosh dhe ka vënë në dispozicion të tyre botime të shumta nga veprat e klasikëve e nga materialet e ndryshme të Partisë. Me vlerë të madhe teorike dhe me rëndësi të veçantë për edukimin marksist-leninist të lidhur ngushtë me praktikën tonë revolucionare, janë Veprat e shokut Enver dhe teksti i Historisë së Partisë sonë.

Si rezultat i përpjekjeve për zbatimin e detyrave që shtroi Kongresi i 6-të i PPSH për studimin e teorisë, për thellimin e revolucionit ideologjik e kulturor, në luftë me mbeturinat e shfaqjet e ideologjive të huaja, janë forcuar e janë kalitur më tej ndërgjegjja e botëkuptimi marksist-leninist i komunistëve, figura e tyre moral-politike, është ngritur në një shkallë më të lartë roli udhëheqës i Partisë, tërë puna e saj organizuese e drejtuese.

Rrethanat në të cilat jetojmë dhe problemet që kemi përpara për të zgjidhur, kërkojnë që Partia t'i kushtojë një kujdes më të madh edukimit marksist-leninist të komunistëve e punonjësve dhe ta shohë këtë si një detyrë të dorës së parë.

Ne jetojmë e punojmë në kushtet e rrethimit të përgjithshëm

imperialisto-revizionist dhe të presionit të tij të gjithanshëm politik, ekonomik, ushtarak, psikologjik etj. Tani një rëndësi të veçantë i japin armiqtë agresionit ideologjik, qëllimi i të cilit është të minojë pozitat e ideologjisë sonë socialiste, të helmojë ndërgjegjen e njerëzve, të kalbëzojë diktaturën e proletariatit, të degjenerojë tërë rendin tonë socialist. Lufta kundër ideologjisë borgjeze e revizioniste që vjen nga jashtë lidhet ngushtë edhe me luftën kundër të gjitha mbeturinave të ideologjive të huaja që kemi trashëguar nga e kaluara dhe që ruhen në ndërgjegjen e njerëzve tanë. Lufta në frontin ideologjik, si një front kryesor i luftës së klasave, është me rëndësi jetike. Për ta zhvilluar me sukses këtë luftë kërkohet armatosja e pandërprerë e komunistëve dhe e gjithë punonjësve me ideologjinë e Partisë, me botëkuptimin marksist-leninist.

Vendi ynë ka hyrë në një etapë të re të zhvillimit të revolucionit e të ndërtimit socialist. Para nesh kanë dalë sot shumë probleme që kërkojnë zgjidhje. Ato kanë të bëjnë me forcimin e Partisë e të diktaturës së proletariatit në luftë kundër burokratizmit e liberalizmit, me zhvillimin e revolucionit ideologjik e kulturor, me ndërtimin e bazës materialo-teknike dhe me përsosjen e bazës ekonomike të socializmit, me zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor, me zbatimin e vijës së masave e zgjerimin e kontrollit punëtor, me forcimin e mëtejshëm të aftësisë mbrojtëse të atdheut etj. Kuptimi i thellë dhe zgjidhja e drejtë e të gjitha këtyre problemeve kërkojnë jo vetëm njohjen e ideve të klasikëve të marksizëm-leninizmit mbi këto çështje, por dhe një reflektim të gjerë mbi bazën e eksperiencës së fituar dhe një zbatim krijues të këtyre ideve në kushtet tona.

Është fakt se shumë nga shfaqjet e huaja që u dukën në fusha të ndryshme të jetës politike, ekonomike, kulturore, ushtarake etj. dhe që u kritikuan me forcë gjatë vitit të kaluar nga Partia e kanë burimin edhe në dobësitë e punës edukative të Partisë për formimin e koncepteve të drejta për një sërë çështjesh të rëndësishme të zhvillimit të revolucionit dhe të ndërtimit socialist të vendit. Diskutimi i madh që u zhvillua në Partinë dhe në masa lidhur me materialet e Plenumit të 4-t të KQ të Partisë, nxori në shesh se shumë organizata dhe komitete partie në rrethe rrëmbehen akoma shpesh nga rutina e punëve të vogla e të përditshme, fenomenet nuk analizohen thellë nga pikëpamja politike e ideologjike, pak çështje të këtij karakteri shqyrtohen e diskutohen në mbledhjet e tyre. Ka njëfarë nënvleftësimi të punës ideologjike në përgjithësi, të rëndësisë dhe të rolit të teorisë dhe një keqkuptim të raportit midis teorisë dhe praktikës, që kanë çuar në një trajtim shpeshherë teknik, praktik e burokratik të problemeve të rëndësishme e jetike për fatet e socializmit në vendin tonë.

Detyra e organizatave dhe e komiteteve të Partisë është që

të përmirësojnë tërë punën e tyre ideologjike, t'i kushtojnë një kujdes më të madh edukimit të komunistëve dhe masave punonjëse, armatosjes së tyre me teorinë revolucionare të Partisë. Komitetet dhe organizatat e Partisë duhet të përpiqen më shumë që të kuptojnë e të shpjegojnë bazën teorike të direktivave të ndryshme të Partisë, të futen më thellë në problemet e jetës, t'i analizojnë e t'i trajtojnë ato nga pozita parimore ideologjike, të luftojnë kundër njëanshmërisë, cektësisë e formalizmit në punën edukative, të kalitin komunistët me botëkuptimin marksist-leninist, të formojnë tek ata bindje të thella e të qëndrueshme ideologjike.

Pas Kongresit të 5-të të Partisë është bërë një punë e mirë për të luftuar shfaqjet e shkollarizmit, dogmatizmit e shkëputjes nga jeta që viheshin re në sistemin e arsimit në Parti. Përgjithësisht puna e bërë ka qenë e frytshme, e dobishme dhe ka ndihmuar komunistët, si për kalitjen e vetvetes, ashtu dhe për kuptimin ideologjik e zbatimin praktik të direktivave të Partisë. Edukimi është lidhur më mirë me problemet që ka shtruar Partia dhe që ka nxjerrë jeta, janë rritur më shumë iniciativa dhe përgjegjësia e organizatave dhe e komiteteve të Partisë.

Megjithatë, sistemi i sotshëm i arsimit në Parti vuan nga praktikizmi dhe thjeshtëzimi i problemeve, ai nuk i armatosi si duhet komunistët me bazën e nevojshme teorike, që ata të mund të orientohen e të zgjidhin drejt problemet e ndryshme, me të cilat ndeshen në veprimtarinë e tyre praktike për të vënë në jetë detyrat e direktivat e Partisë. Ai pra nuk plotëson ashtu si duhet detyrën për formimin e bindjeve të thella ideologjike dhe për ngritjen e nivelit teorik të komunistëve dhe të kuadrove.

Në këto të meta ka ndikuar një kuptim i ngushtë i qëllimit për të cilin është ngritur sistemi i arsimit në Parti, kuptim që ka çuar në një praktikizëm të theksuar saqë në mjaft raste nuk dallohet forma e arsimit nga mbledhja e organizatës-bazë apo e kolektivit punonjës. Kanë ndikuar gjithashtu dobësitë në punën për zgjedhjen, edukimin dhe përgatitjen e propagandistëve, ndihma e pamjaftueshme nga qendra dhe rrethi për format e arsimit në Parti, qëndrimet liberale që janë vënë re në zbatimin e rregullit e të disiplinës në sistemin e arsimit dhe të kërkesës së llogarisë ndaj komunistëve për edukimin e tyre.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH tërheq vëmendjen e komiteteve dhe organizatave të Partisë mbi këto të meta e dobësi dhe i porosit ato që të marrin të gjitha masat për të forcuar e për të përmirësuar punën për edukimin marksist-leninist të komunistëve.

1. — Në themel të sistemit të arsimit në Parti, ashtu si deri tani, duhet të vihet studimi i teorisë marksiste-leniniste lidhur ngushtë me jetën, me praktikën e ndërtimit socialist të vendit. Qëllimi

i këtij sistemi është të armatosë komunistët me parimet e ligjet themelore të marksizëm-leninizmit, me botëkuptimin dhe me ideologjinë e Partisë, me mënyrën marksiste-leniniste të interpretimit të fenomeneve dhe të zgjidhjes së problemeve, t'u japë atyre çelësat e kuptimit materialist-dialektik që të orientohen vetë në luftën për zbatimin e drejtë të vijës dhe të direktivave të Partisë. Për këtë kërkohet që të studiohen veprat e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, dokumentet e Partisë sonë dhe materialet e tjera të saj, në të cilat sintetizohet pasuria e madhe e doktrinës sonë revolucionare. Komunistët duhet ta konsiderojnë studimin e këtyre veprave si detyrë të dorës së parë, pa të cilën ata nuk mund të formohen si duhet, si komunistë të vërtetë dhe nuk mund të kryejnë rolin e tyre pararojë. Çdo nënvleftësim dhe pakujdesi ndaj kësaj detyre janë të palejueshëm për cilindo. Asnjëri të mos mendojë se, meqë ka kryer një shkollë apo një kurs teorik, nuk ka nevojë të studiojë më tej teorinë marksiste-leniniste.

Ky studim nuk duhet të jetë kurrë një qëllim në vetvete, ai duhet të bëhet lidhur ngushtë me praktikën revolucionare dhe t'i shërbejë kësaj praktike. Prandaj të studiohet jo çdo gjë që bie në dorë, por me një pikësynim të caktuar të studiohen ato parime themelore të teorisë marksiste-leniniste që na shërbejnë për të kuptuar e për të zgjidhur drejt problemet që na preokupojnë sot. Theksi duhet vënë te studimi i thellë e i gjithanshëm i realitetit të kohës sonë, i problemeve që nxjerr jeta dhe që shtron Partia, duke i analizuar dhe duke i shpjeguar ato nën dritën e teorisë marksiste-leniniste.

Studimi i teorisë duhet bërë në luftë me pikëpamjet dhe me argumentet e kundërshtarëve tanë ideologjikë, e në radhë të parë, të revizionistëve modernë, të këtyre armiqve të tërbuar të marksizëm-leninizmit, në luftë me të gjitha ndikimet e shfaqjet e ideologjisë borgjeze, mikroborgjeze e revizioniste. Secili duhet të reflektojë thellë mbi atë që studion, të ballafaqohet me parimet, të analizojë në mënyrë kritike ndërgjegjen dhe punën e tij e të shokëve, të nxjerrë detyra e konkluzione për veprimtarinë praktike. Vetëm nëpërmjet ballafaqimit të pikëpamjeve dhe të debatit mund të përvetësohen mirë idetë e marksizëm-leninizmit, mund të formohen bindje të qëndrueshme e të realizohet një edukim i vërtetë revolucionar, mund të hidhen bazat e një imuniteti aktiv ndaj ideologjisë së huaj.

2. — Programi i arsimit në Parti të ndërtohet mbi bazën e këtyre orientimeve. Ai duhet të jetë problemor, domethënë të trajtojë disa probleme themelore të teorisë marksiste-leniniste që dalin më të mprehta në periudha të ndryshme të zhvillimit të vendit dhe për të cilat kërkohet të formohet një kuptim i drejtë dhe unik në të gjithë Partinë, duke synuar që në çdo rast të studiohen disa nga veprat kryesore të marksizëm-leninizmit që

lidhen me kuptimin e parimeve bazë dhe me formimin e botë-kuptimit marksist.

Duke vënë në bazë të sistemit të arsimit në Parti një program teorik problemor, kjo nuk përjashton rastet kur në periudha të caktuara dhe për kategori të ndryshme komunistësh, e sidomos kuadrosh, teoria marksiste-leniniste të jepet edhe në sistem. Po kështu kjo nuk përjashton që në format e arsimit në Parti të studiohen edhe problemet që ngrihen në kongreset, në plenumet e në materiale të tjera të rëndësishme të Partisë, duke vënë theksin në aspektin teorik, me qëllim që të kuptohet përmbajtja ideologjike, baza teorike e tyre.

Programi bazë, si deri tani, është i domosdoshëm të përcaktohet çdo vit nga sektori i edukimit pranë aparatit të KQ të Partisë. Ai duhet të jetë pak a shumë i përbashkët për gjithë Partinë. Por kjo nuk duhet t'u presë aspak iniciativën organizatave-bazë dhe komiteteve të Partisë, të cilat vetë duhet të zgjedhin temat që u duken më të përshtatshme për kushtet e tyre, t'i zbërthejnë e t'i konkretizojnë ato, si dhe të shtojnë tema të tjera që do t'i gjejnë të nevojshme në masën 20-30 për qind të programit.

Për t'i ardhur në ndihmë masës së komunistëve për studimin e teorisë marksiste-leniniste, literatura e rekomanduar të zgjidhet me kujdes dhe të përmbledhet në botime të veçanta. Njëkohësisht të shikohet mundësia e ribotimit me tirazh masiv të teksteve të materializmit dialektik e historik, të ekonomisë politike të socializmit, si dhe të merren masa për hartimin sa më shpejt të tekstit të ekonomisë politike të kapitalizmit.

3. — Sistemi i arsimit në Parti të ndërtohet në mënyrë të shkallëzuar me qëllim që t'u japë komunistëve dije në përshtatje me nivelin dhe me nevojat e tyre. Për masën e komunistëve format të ngrihen mbi bazën e organizatës së Partisë ashtu siç janë sot. Por kudo ku është e mundur, gjithnjë brenda ndërmarrjes, kooperativës apo institucionit, të ngrihen forma të veçanta për kuadrot që kanë një përgatitje më të madhe kulturore e teorike.

Në disa qytete të mëdha që kanë një numër të nevojshëm kuadrosh e pedagogësh të kualifikuar, mund të hapen kurse teorike pa shkëputje nga puna, ku të jepen në sistem bazat e filozofisë për ata kuadro që duan ta ndjekin këtë kurs e bazat e ekonomisë politike për kuadro të tjerë. Kështu mund të ngrihen kurse të veçanta edhe për studimin e bazave të socializmit shkencor, të historisë së PPSH, të estetikës apo të etikës marksiste-leniniste etj. Programet e kurseve teorike të hartohen nga vetë komitetet e Partisë të rretheve, në bazë të eksperiencës së Shkollës së Lartë të Partisë «V. I. Lenin», e cila duhet t'u japë rretheve një ndihmë të veçantë për organizimin e këtyre kurseve.

Një kujdes i madh të tregohet për edukimin e kandidatëve të Partisë. Gjatë periudhës së stazhit, në forma të ndryshme,

atyre detyrimisht t'u jepen njohuri mbi socializmin dhe komunizmin, mbi historinë dhe Statutin e Partisë.

Sistemi i arsimit në Parti të vihet mbi bazën e një disipline më të fortë e të kontrollueshme si nga komitetet e Partisë ashtu dhe nga organizatat-bazë. Për këtë gjithë sistemi i arsimit në Parti të fillojë në shtator dhe të mbarojë në qershor të vitit pasardhës. Gjithashtu duhet caktuar një pasdite në javë jashtë orarit të punës që t'i kushtohet edukimit komunist dhe që nuk duhet zënë me asnjë lloj aktiviteti tjetër. Kjo pasdite, sipas rastit, të përdoret për mbledhje të formës së arsimit, për studim kolektiv të literaturës apo për bashkëbisedime.

Metoda e punës në format e edukimit duhet të synojë që të nxitë sa më shumë studimin individual të materialeve nga çdo komunist, të inkurajojë e të zhvillojë frymën e diskutimeve e të debatit, me qëllim që të formojë bindje sa më të thella ideologjike dhe të nxirren mësimet për veprimtarinë praktike. Në format e shkallës së ulët propagandistët duhet të shpjegojnë mësimin dhe detyrimisht duhen bërë bashkëbisedime përfundimtare në të gjitha format e arsimit në Parti.

4. — Ngritja e nivelit të propagandës në sistemin e arsimit në Parti nuk mund të arrihet pa përmirësuar në mënyrë të dukshme punën me propagandistët. Kujdes i veçantë t'u kushtohet zgjedhjes së propagandistëve, nivelit të tyre arsimor e ideologjik, figurës së tyre moralopolitike dhe aftësive të tyre metodike.

Në raste të veçanta, detyrën e propagandistit mund ta kryejnë edhe njerëz pa parti, por duke i zgjedhur me kujdes të veçantë. Propagandisti është mirë të jetë nga organizata përkatëse ku është ngritur forma, por nuk do përjashtuar mundësia, kur gjykohet e nevojshme, të caktohet si propagandist edhe një komunist nga një organizatë tjetër, si rregull nga e njëjta ndërmarrje, kooperativë bujqësore apo institucion.

Me qëllim që të evitohen lëvizjet e shpeshta të propagandistëve, në fillim të çdo viti sekretariati i komitetit të Partisë të aprovojë listën e propagandistëve të rrethit, sipas propozimeve të organizatave-bazë dhe të byrove të Partisë, kurse për ndryshimet që mund të ndodhin gjatë vitit të vendosë sekretari që ka propagandën.

Me zgjerimin e madh që ka marrë sistemi i arsimit në Parti dhe në organizatat e masave duhet të ruhet funksioni i kryepropagandistit, si i ngarkuar i byrosë së Partisë në ndërmarrje apo në kooperativë, që ndjek mbarëvajtjen e arsimit në Parti dhe si konsulent në ndihmë të propagandistëve, si të atyre të formave të Partisë ashtu dhe të atyre të organizatave të masave. Këta të përbëjnë në të njëjtën kohë edhe aktivin e komitetit të Partisë të rrethit për t'u konsultuar, për të shkëmbyer mendime dhe për të përgjithësuar përvojën e punës në format e edukimit.

Edukimi dhe kualifikimi i propagandistëve, si një problem shumë i rëndësishëm, duhet të merren direkt në dorë nga komitetet e Partisë dhe të mos mbeten këto si detyrë e kryepropagandistëve. Me propagandistët duhet bërë një punë e gjithanshme për t'u hapur atyre horizont, për të shkëmbyer eksperiencë, për të shqyrtuar problemet që dalin dhe masat që duhen marrë, për të rritur mjeshtërinë e tyre propagandistike. Një ndihmë e veçantë u duhet dhënë atyre nëpërmjet botimeve, artikujve e broshurave të ndryshme që duhet të përgatitin si qendra ashtu dhe rrethet. Gjatë verës të organizohen, si në qendër ashtu dhe në rrethe, seminare disaditore për të zbërthyer programin vjetor të edukimit.

5. — Puna me leksione, si një formë tjetër e rëndësishme e propagandës së Partisë, duhet të intensifikohet më shumë dhe të organizohet më mirë si në qendër ashtu edhe në rrethe e në bazë. Për këtë qëllim duhen vënë më mirë në lëvizje organizatat e masave, institucionet kulturore, arsimore, shkencore dhe gjithë organizmat e tjerë. Të organizohen grupet e lektorëve pranë komiteteve të Partisë dhe të krijohen grupe të tilla, kur është e mundur, edhe në ndërmarrjet e kooperativat bujqësore të mëdha. Në këtë punë duhet aktivizuar më shumë inteligjencia, e cila mund dhe duhet të japë një kontribut të madh për përhapjen e dijeve politike e shkencore në masat e popullit. Gjithashtu më shumë duhet të bëjë Ndërmarrja e Botimit të Librit Politik me anë broshurash të ndryshme për kuadrot dhe për masat e popullit. Vëmendja kryesore duhet të përqendrohet në cilësinë e leksioneve, që ato të trajtojnë probleme të rëndësishme dhe me nivel të lartë ideologjik e teorik.

6. — Të forcohet dhe të përmirësohet më tej puna në kurset 3-mujore të Partisë në rrethe. Në këto kurse të dërgohen sekretarë dhe anëtarë të byrove të organizatave-bazë të Partisë, anëtarë të plenumit të rrethit, kuadro drejtues të organizatave të masave, të pushtetit dhe të ekonomisë, propagandistë, si dhe komunistë me perspektivë e shoqe.

Në kurset 3-mujore duhet synuar që në radhë të parë t'u jepen pjesëmarrësve disa njohuri themelore të teorisë marksiste-leniniste. Në programet e tyre të përfshihet studimi i problemeve të tilla si mbi luftën e klasave e diktaturën e proletariatit; mbi Partinë, rolin dhe organizimin e saj; mbi punën dhe pronën; çështje të moralit komunist, të revolucionit ideologjik e kulturor etj. Veç këtyre në kurset 3-mujore të studiohen materialet e rëndësishme aktuale të Partisë dhe t'u jepen pjesëmarrësve njohuritë e nevojshme sipas profileve të punës që bëjnë. Shkolla e Partisë, ashtu si deri sot, duhet t'u japë kurseve 3-mujore të rretheve një ndihmë të veçantë në ndërtimin e programeve, në përcaktimin e literaturës për studim, si dhe në metodat e mësimdhënies.

Të merren masa për përmirësimin e bazës materiale të kur-

seve 3-mujore, për të krijuar ambiente të përshtatshme jete dhe studimi.

7. — Mbarëvajtja e arsimit marksist-leninist të komunistëve varet shumë nga drejtimi i kësaj pune nga ana e komiteteve dhe organizatave të Partisë, të cilat duhet ta vlerësojnë këtë si një nga detyrat më të rëndësishme. Vëmendja e tyre duhet të përqendrohet kryesisht në çështjet e përmbajtjes së edukimit, me qëllim që puna në sistemin e arsimit në Parti të jetë sa më efikase, t'u shërbejë sa më mirë edukimit dhe kalitjes ideologjike të komunistëve.

Kujdes i veçantë duhet treguar për edukimin e për kualifikimin e propagandistëve. Me qëllim që t'u jepet atyre një ndihmë e gjithanshme të ngrihen kudo në rrethe kabinetet e Partisë. Detyra e tyre të jetë edukimi i propagandistëve të formave të Partisë dhe të masave dhe puna me leksione. Ato të jenë pjesë përbërëse e sektorëve të edukimit të komiteteve të Partisë në rrethe. Rreth tyre të tërhiqet një numër i madh aktivistësh e konsulentësh nga njerëzit më të aftë.

Ndjekja e punës në format e edukimit, kontrolli mbi zbatimin e programeve dhe disiplina e serioziteti në to mbeten detyra të rëndësishme të komiteteve dhe të organizatave të Partisë. Ato herë pas here, por doemos në fund të çdo viti arsimor, duhet të bëjnë analiza të plota dhe të nxjerrin konkluzione e detyra për përmirësimin e punës. Duhet të ngjallet dëshira e të kalitet vullneti i të gjithë komunistëve për studim. Çdo komunist duhet t'i konsiderojë ngritjen e nivelit të tij ideologjik, studimin e teorisë marksiste-leniniste si detyra shumë të rëndësishme partie. Asnjë justifikim nuk mund të ketë për ta neglizhuar këtë detyrë. Secili duhet ta organizojë punën në një mënyrë të tillë që të gjejë kohën e nevojshme për studim.

Edukimi marksist-leninist i komunistëve dhe i punonjësve është një detyrë sa e rëndësishme aq edhe e vështirë e komplekse. Sistemi i arsimit në Parti është vetëm një hallkë e kësaj pune. Detyra e organizatave të Partisë është që të përmirësojnë punën edukative në të gjitha drejtimet, duke përdorur të gjitha rrugët, format e mjetet dhe të bëjnë që me edukimin e njerëzve të merren të gjithë komunistët e sidomos kuadrot, jo vetëm ata të Partisë e të organizatave të masave, por edhe të pushtetit e të ekonomisë. Çdo komunist e kuadër, pavarësisht nga vendi ku punon e posti që mban, duhet të jetë një propagandist e agjikator i flaktë i vijës dhe i ideologjisë së Partisë.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH ka bindje se komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë, të gjithë komunistët dhe kuadrot do ta kuptojnë rëndësinë e madhe të problemit që shtrohet, do të marrin të gjitha masat për ta ngritur më lart pu-

nën edukative të Partisë dhe do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të përvetësuar vazhdimisht e me këmbëngulje prej komunisti teorinë tonë gjithnjë fitimtare, marksizëm-leninizmin.

Ky vendim të punohet në të gjitha komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë. Për ndjekjen e për zbatimin e tij ngarkohet sektori i edukimit së bashku me gjithë aparatën e Komitetit Qendror të PPSH.

Sekretari i Komitetit Qendror të PPSH

Hysni Kapo

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

VENDIM

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI DISA PROBLEME TË PËRSOSJES SË ORGANIZIMIT SOCIALIST TË PUNËS E TË SHPËRBLIMIT TË SAJ

28 mars 1974

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e saj të datës 28 mars 1974, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave me shkresën Nr. 468 prot. sekret, datë 6 mars 1974 «Mbi zbatimin e orientimeve të Byrosë Politike dhe masat e mëtejshme për përsosjen e marrëdhënieve të shpërndarjes sipas punës»,

V e n d o s i :

1. — Të konsiderojë të drejta çështjet kryesore të këtij studimi, të cilat synojnë në përsosjen e organizimit socialist të punës e të shpërblimit të saj, në nxitjen e mëtejshme të përpjekjeve të punonjësve për lartësimin e nivelit ideopolitik, arsimor, kulturor e tekniko-profesional të tyre, në përputhje me detyrat që shtrojnë sot e në perspektivë revolucionarizimi i mëtejshëm i jetës së vendit, zhvillimi i shpejtë i rendit tonë ekonomiko-shoqëror socialist, drejtimi shkencor i ekonomisë e i kulturës dhe ngritja cilësore e prodhimit.

2. — Vlerësimi i shkallës së kualifikimit të punëtorëve të bëhet me anë të atestimit kulturor e profesional të tyre, t'i korrespondojë kategorizimit të proceseve dhe vendeve të punës dhe të synojë në përgatitjen e tyre si prodhues të të mirave materiale dhe si pjesëmarrës në drejtimin e ekonomisë e të jetës së vendit.

Mbi shkallën më të lartë të kualifikimit të punëtorëve të vendoset titulli «mjeshtër».

Atestimi të shtrojë para punëtorëve kërkesa teorike dhe praktike të karakterit arsimor, kulturor, teoriko-shoqëror, etiko-moral, tekniko-profesional e të vjetërsisë në punë, të cilat të aftësojnë gradualisht punëtorët për të përballuar detyrat e tyre në rritje.

3. — Të kalohet në vlerësimin e kualifikimit të personelit zbatues tekniko-administrativ me anë të atestimit, të cilit t'i korrespondojnë pagat fikse me kategori. Ky të shërbejë për kalitjen e vazhdueshme ideopolitike dhe për aftësimin tekniko-profesional të specialistëve, me qëllim që të rritet efektiviteti i veprimtarisë së aparateve shtetërore, të ekonomisë e të kulturës dhe të përsoset metoda e stili i tyre i punës.

Kërkesat e atestimit të jenë për nivelin arsimor të kulturës së përgjithshme, për njohuritë teoriko-shoqërore, etiko-morale, tekniko-profesionale, për vjetërsinë në punë etj.

Mbi kategorinë e lartë të kualifikimit të mbahet titulli kryespecialist me pagë fikse.

Për të lidhur më mirë kualifikimin me pagën dhe duke mbajtur kurdoherë parasysh orientimet e Partisë sonë për ngushtimin gradual e të arsyeshëm të dallimeve në shpërblimin e punës, të njësohet paga e specialistëve që punojnë në detyra zbatuese brenda së njëjtës degë ekonomike, pavarësisht nga grupi ku bën pjesë ndërmarrja, si dhe në komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve; të njësohet paga midis specialistëve të profilit teknik dhe të ekonomistëve e të tjerëve në komitetet ekzekutive të këshillave popullorë, në tregti dhe në ndonjë degë tjetër ku nuk justifikohen diferencat.

4. — Studimi sistematik dhe përcaktimi shkencor i kategorizimit të proceseve dhe të vendeve të punës në përputhje me zhvillimin e ekonomisë dhe me ndryshimet që ndodhin brenda degëve, janë të domosdoshëm për zbatimin sa më të drejtë të parimit socialist të shpërndarjes sipas sasisë dhe cilësisë së punës. Të tregohet kujdes i veçantë për vënien në jetë të përmirësimeve të kategorizimit të vendeve të punës dhe paralelisht me ngritjen e nivelit arsimor e tekniko-profesional të punëtorëve të ecet drejt zvogëlimit të numrit të kategorive.

5. — Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë vendimet përkatëse për zbatimin e orientimeve dhe kritereve themelore të lartpërmendura.

6. — Duke vlerësuar punën që është bërë në drejtim të përsosjes së normimit të punës, Byroja Politike, tërheq vëmendjen e organizatave të Partisë dhe sidomos të organeve shtetërore dhe ekonomike mbi nevojën e shpejtimit të ritmeve për zgjerimin e

punës me norma, për rishikimin e normave të vjetruara, për shtrirjen në gjerësi të normave teknike dhe për respektimin e përpiktë të parimeve e të kritereve shkencore të normimit të punës.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

PROTOKOLL

I SEKRETARIATIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI ROLIN UDHËHEQËS TË ORGANIZATAVE-BAZË DHE TË BYROVE TË PARTISË NË KOOPERATIVAT BUJQËSORE TË TIPIT TË LARTË PËR REALIZIMIN E DETYRAVE TË PLANIT DHE PËR FORCIMIN EKONOMIKO-ORGANIZATIV TË KOOPERATIVAVE BUJQËSORE

10 maj 1974

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 10 maj 1974, mori në shqyrtim raportet e paraqitura nga komitetet e Partisë të rretheve Fier dhe Berat «Mbi rolin udhëheqës të organizatave-bazë të Partisë në kooperativat bujqësore të tipit të lartë për realizimin e detyrave të planit dhe forcimin ekonomik-organizativ të tyre» dhe vërejtji se:

Organizatave-bazë dhe byrotë e Partisë në kooperativat bujqësore të tipit të lartë kanë udhëhequr mirë punën për të realizuar orientimin që kooperativat e tipit të lartë të forcohen organizativisht dhe të fuqizohen ekonomikisht. Ato kanë luftuar që të sigurohet stabiliteti në zhvillimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale për të cilat ka më shumë nevojë ekonomia popullore, të shpejtohen ritmet e zhvillimit, si dhe të përsoset më tej organizimi i tyre, në mënyrë që ato të kthehen gradualisht në ekonomi moderne të prodhimit të zgjeruar socialist. Një punë të kujdeshme kanë bërë ato për përqendrimin dhe specializimin e prodhimit bujqësor.

Edukimi ideologjik e politik i komunistëve e i kooperativistëve, ka pasur përmirësime, janë shtuar forcat e Partisë, duke përsosur më tej shtrirjen dhe shpërndarjen e saj. Më mirë është punuar për të rritur edhe rolin e levave të Partisë dhe thellimin e demokracisë kooperativiste.

Kooperativat e tipit të lartë kanë fuqizuar më tej bazën e tyre materiale e teknike. Ato janë furnizuar me më shumë ma-

kineri bujqësore, plehra kimike, kanë marrë më shumë fonde për investime, gjë që ka ndihmuar për të rritur me ritme më të larta se kooperativat e tjera prodhimet bujqësore e blegtorale.

Megjithatë puna e Partisë në disa kooperativa të tipit të lartë nuk u është përgjigjur kërkesave të kohës. Si pasojë e punës së pamjaftueshme ideopolitike e organizative dhe e lëshimeve të bëra nga organet shtetërore e kooperativiste disa kooperativa të tipit të lartë nuk kanë realizuar si duhet detyrat për rritjen e prodhimit dhe në mjaft prej tyre kanë zënë vend edhe disa koncepte e qëndrime që frenojnë mobilizimin e kooperativistëve dhe të mjeteve të tyre të brendshme për realizimin e detyrave të planit.

Me qëllim që puna e organizatave-bazë dhe e byrove të Partisë në kooperativat e tipit të lartë të përmirësohet më tej dhe të arrihen rezultate të mira në realizimin e orientimeve të Partisë dhe detyrave të prodhimit, Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH porositi:

1. — Komitetet e Partisë të rretheve, duke pasur parasysh specifikën dhe detyrat e kooperativave të tipit të lartë, duhet të organizojnë një ndihmë të veçantë për organizatat-bazë të Partisë për të ngritur në një nivel më të lartë rolin e tyre udhëheqës dhe edukues për të rritur iniciativën e vetëveprimin, si dhe ndjenjën e përgjegjësisë për zbatimin e drejtë të politikës së Partisë e të ligjeve të shtetit për zhvillimin e këtyre ekonomive me ritme të shpejta.

Kjo kërkon që të forcohet jeta e brendshme e organizatave-bazë të Partisë nëpërmjet zhvillimit të debatit ideologjik dhe zbatimit me rigorozitet të normave të Partisë. Krahas kësaj të rriten kërkesat ndaj komunistëve e organizatave-bazë të Partisë, me qëllim që të ndihet më shumë përgjegjësia nga secili komunist për fatin e punëve dhe realizimin e detyrave në shkallë sektori e kooperative.

Komitetet e Partisë të ndihmojnë me seminare të veçanta dhe forma e mjete të tjera, që të krijohet një përfytyrim më i drejtë dhe më i gjerë për drejtimin e ekonomisë nga ana e organizatave-bazë të Partisë. Këto të merren me problemet më kryesore e të perspektivës, t'i trajtojnë ato politikisht, të kontrollojnë zbatimin e vendimeve të Partisë dhe në përgjithësi të rritin rolin e tyre për të zbatuar drejt politikën e Partisë për vënien në jetë të detyrave që shtron Partia dhe plani i shtetit.

Duke marrë parasysh edhe detyrat e mëdha që kanë përpara këto ekonomi, organizatat-bazë të Partisë duhet të ndihmohen më nga afër për të ndërtuar, sipas specifikës e kushteve, një edukim të dendur politik-ideologjik me komunistët e masat për futjen e gjakut të ri në Parti, për zbatimin e vijës së masave, duke tërhequr zërin e masave dhe, duke dhënë llogari para tyre, për të siguruar një udhëheqje efektive mbi organizatat e masave.

2. — Komitetet e Partisë të rretheve t'u hyjnë më thellë problemeve të kooperativave të tipit të lartë në këtë fazë të zhvillimit të tyre dhe t'u japin një ndihmë më të kualifikuar byrove të Partisë. Është e nevojshme të përsoset më tej veprimtaria e këtyre byrove për të ngritur rolin udhëheqës dhe për të rritur përgjegjësinë që ato kanë para komiteteve të Partisë të rretheve për forcimin e punës në organizatat-bazë të Partisë, për t'u marrë më mirë vetë me zbatimin e vendimeve e të direktivave, duke ndihmuar konkretisht çdo organizatë-bazë sipas kushteve konkrete. Veçanërisht duhet të punohet për të grumbulluar dhe për të përgjithësuar përvojën pozitive që ekziston në çdo rreth, për të rritur rolin udhëheqës të byrove të Partisë mbi organizatat e masave dhe ato ekonomike e shoqërore në territorin e kooperativës për forcimin e punës politiko-ideologjike për edukimin e komunistëve dhe të masave, për funksionimin e aktiveve të Partisë dhe informimin e të gjitha organizatave-bazë nga ana e byrove për punët (dobësitë, të metat, fenomenet, prirjet që lindin) në njërin apo në tjetrën organizatë-bazë etj.

Komitetet e Partisë të punojnë veçanërisht me sekretarët e byrove të Partisë, t'u kërkojnë më shumë llogari për zbatimin e vijës së Partisë, që ata të ndiejnë përgjegjësi të plotë për mbarëvajtjen e të gjitha punëve në kooperativë, të mbajnë në korent të vazhdueshëm komitetin e Partisë të rrethit mbi situatën dhe problemet politiko-ekonomike e të tjera dhe, duke vënë në lëvizje organizatat-bazë, organet ekonomike e organizatat e masave, të bëjnë që të zgjidhin me sukses të gjitha detyrat ekonomike që shtrohen para kooperativave.

Gjithashtu në kooperativat e tipit të lartë të dërgohen kuadro specialistë dhe ekonomistë nga më të aftët që ka rrethi për të drejtuar byrotë e Partisë, kryesitë e kooperativave, degët pranë tyre dhe sektorët e këtyre ekonomive.

3. — T'i kushtohet më shumë kujdes punës për edukimin ideologjik e politik të komunistëve, kuadrove dhe kooperativistëve për kuptimin e drejtë të problemeve që kanë të bëjnë me organizimin dhe veprimtarinë ekonomike të kooperativave të tipit të lartë, për kuptimin e drejtë të pronës, të sistemit të shpërblimit, të organizimit të punës dhe për të ngritur në një shkallë më të lartë ndjenjën e përgjegjësisë për realizimin e detyrave në prodhim. Komitetet e Partisë duhet të ndihmojnë byrotë e Partisë, sekretarët e këtyre byrove, organizatat-bazë dhe organizatat e masave që, mbi bazën e specifikës së kooperativave të tipit të lartë dhe koncepteve që shfaqen, të ndërtojnë punën ideopolitike. Të forcohet më tej lufta ideologjike në Parti e në masa për të çrrënjësuar konceptet e mendimet e gabuara që shfaqen jo vetëm te mjaft kooperativistë, por dhe te komunistë e kuadro «se tani jemi njësoj me punëtorët», se «pagën e kemi të garantuar e sido

që të ndodhë shteti nuk na lë pa paguar» etj. Po ashtu të luftohen prirjet dhe veprimet e gabuara për të vendosur paga më të larta se mundësitë reale, për të marrë nga shteti etj.

4. — Komitetet e Partisë, organizatat-bazë dhe byrotë e Partisë në kooperativat bujqësore të luftojnë për të ngritur vazhdimisht nivelin e punës së tyre udhëheqëse në ekonomi në kooperativat e tipit të lartë. Ato duhet të luftojnë që të njihen e të zbatohen drejt parimet e statutit dhe rregulloret e brendshme, të organizimit të punës dhe të shpërblimit në kooperativat e tipit të lartë, si dhe planet e prodhimit bujqësor e blegtoral.

Një vëmendje e veçantë t'i kushtohet luftës kundër mendimeve të gabuara, siç janë ato se «edhe sikur të mos investojmë ne, kooperativa, do të investojë shteti» etj., të cilat nxitin prirjet e huaja për të kërkuar sa më shumë ndërtime, makineri e pajisje me fonde të drejtpërdrejta të shtetit dhe që të ardhurat e realizuara nga prodhimi kooperativist të mos shpërndahen me kritere të drejta, siç e kërkojnë nevojat e zhvillimit të mëtejshëm të ekonomisë dhe rritja e prodhimit. Prandaj organet dhe organizatat e Partisë, si dhe organet shtetërore dhe ekonomike të bëjnë një punë më sistematike sqaruese e bindëse për kuptimin dhe zbatimin më mirë të parimit të mbështetjes në forcat e veta, për të kuptuar në parim e në praktikë se pjesëmarrja e shtetit me investime në këto kooperativa është një faktor i rëndësishëm që duhet të ndikojë, në radhë të parë, në mobilizimin dhe përdorimin më racional të burimeve të punës dhe atyre materiale të vetë kooperativave për realizimin dhe tejkalimin e detyrave të planit të prodhimit e të atij financiar.

5. — Kooperativat e tipit të lartë janë pajisur e furnizuar gjithnjë e më shumë me makineri, plehra kimike e materiale të tjera, por rendimentet e prodhimit, që janë arritur në mjaft prej tyre nuk u përgjigjen sa e si duhet këtyre investimeve e shpenzimeve. Si rrjedhim i mosplotësimit të planit të prodhimeve në radhë të parë, raporti midis shpenzimeve të prodhimit dhe të ardhurave është i lartë, ndërsa rentabiliteti është akoma relativisht i ulët. Prandaj organet shtetërore dhe të ekonomisë duhet të kërkojnë dhe të luftojnë më shumë për të rritur efektivitetin e investimeve e të shpenzimeve të prodhimit që bëjnë kooperativat e tipit të lartë; të punojnë e të ecin me llogari, me ekonomi, të forcojnë hozrashotin, të rritin më tej rentabilitetin e prodhimit dhe shkallën e vetëveprimit të tyre, të forcojnë vazhdimisht regjimin e kursimit dhe të përdorin me kritere ekonomike bazën materialo-teknike.

6. — Organizatat e Partisë në kooperativat bujqësore të tipit të lartë të luftojnë që të zbatohen më mirë vendimet e Komitetit Qendror të Partisë për të siguruar vazhdimësi në ndjekjen dhe zbatimin e studimeve pedologjike e agrokimike, për sistemimin

e tokave, për specializimin, strukturat e prodhimit e qarkullimet e bimëve bujqësore dhe, duke i parë këto probleme kurdoherë në dinamizëm, të përsosën vazhdimisht. Ato të kërkojnë dhe të drejtojnë organet shtetërore dhe ekonomike që t'i plotësojnë këto me studime të tjera. Kështu, është e nevojshme që të studiohen më thellë raportet midis kulturave bujqësore dhe, në vartësi me këtë, raportit midis krahëve të punës e mekanizimit, mungesat që mund të ketë dhe mënyrën e mbulimit të tyre, në radhë të parë nëpërmjet mekanizimit të vogël; shpërpjesëtimet eventuale midis detyrave të prodhimit e sasisë së plehrave që disponohen dhe rrugët e kompensimit të tyre etj.

Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë shpreh bindjen se komitetet e Partisë të rretheve, byrotë dhe organizatat-bazë të Partisë në kooperativat bujqësore të tipit të lartë do t'i kuptojnë dhe do të udhëheqin më mirë punën për zgjidhjen e problemeve të forcimit ekonomiko-organizativ të kooperativave të tipit të lartë, do të vënë të gjitha forcat dhe do të mobilizojnë gjithë kooperativistët për realizimin e detyrave të mëdha që ka shtruar para tyre Partia për të rritur me ritme të shpejta prodhimin bujqësor e blegtoral, për t'u bërë shembull për kooperativat e tjera bujqësore.

Sekretari i Komitetit Qendror të PPSH

Hysni Kapo

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

VENDIM

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI DISA MASA PËR ZHVILLIMIN E SHPEJTË TË ZONAVE KODRINORE-MALORE

25 qershor 1974

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e saj të datës 25 qershor 1974, pasi mori në shqyrtim raportin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave «Mbi zbatimin e detyrave që shtroi Kongresi i 6-të i PPSH për zhvillimin më të shpejtë të zonave kodrinore-malore», konstatoi se, në përgjithësi, zonat kodrinore-malore kanë ecur përpara në të gjitha drejtimet, por mbeten akoma mjaft probleme për t'u zgjidhur dhe një punë shumë e madhe për t'u bërë, që të realizohen plotësisht e në të gjitha këto zona orientimet e Partisë mbi zhvillimin e tyre të gjithanshëm.

Me qëllim që të përkrahet e të nxitet zhvillimi i kooperativave bujqësore të zonave kodrinore-malore, për forcimin e mëtejshëm të bazës materialo-teknike dhe për shtimin më të shpejtë të prodhimeve bujqësore e blegtorale nga ana e tyre, si bazë kryesore për rritjen e mirëqenies së fshatarësisë kooperativiste të këtyre zonave, Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH

V e n d o s i :

1. — Problemet dhe detyrat që shtrohen në raportin e Këshillit të Ministrave për shtimin më të shpejtë të prodhimeve bujqësore e blegtorale në kooperativat e zonave kodrinore-malore, organet shtetërore e të ekonomisë t'i mbajnë parasysh si gjatë hartimit të planit të vitit 1975 dhe të pesëvjeçarit të ardhshëm, ashtu dhe për vënien e tyre në jetë.

2. — Të pranohet propozimi i Këshillit të Ministrave të PPSH mbi marrjen e disa masave favorizuese për kooperativat bujqë-

sore të këtyre zonave me një përfitim vjetor prej rreth 60 milionë lekësh.

Këto fonde të përdoren në radhë të parë për të kryer investime që kanë të bëjnë me zhvillimin e forcimin ekonomik të kooperativave bujqësore dhe me shtimin e mëtejshëm të prodhimeve bujqësore, blegtorale, të frutikulturës etj., si dhe për ngritjen e çmimeve të blerjes nga ana e shtetit të disa prodhimeve bujqësore.

3. — Të pranohet propozimi që në kooperativat bujqësore të ngrihet minimalja e pensionit të plotë të pleqërisë nga 100 lekë në 150 lekë në muaj dhe masa e llogaritjes së pensionit të pleqërisë nga 50 për qind në 60 për qind¹.

4. — Ngarkohet Këshilli i Ministrave i RPSH për zbatimin e këtij vendimi dhe për të përcaktuar me hollësi kriteret për përdorimin e drejtë të masave të mësipërme.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

1 Në zbatim të vendimit të KQ të PPSH, me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH, Nr. 5415, datë 25.V.1976, pensioni i pleqërisë u rrit nga 60 për qind në 70 për qind dhe minimalja e pensionit në fshat u rrit në 25 për qind.

PLENUMI I 5-TË I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë 25-26 korrik 1974

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror të PPSH u mbledh në datën 25 e 26 korrik 1974 nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror, shokut Enver Hoxha. Plenumi shqyrtoi raportin e Byrosë Politike mbi problemin e forcimit të mëtejshëm të mbrojtjes së vendit, e diskutoi atë gjerësisht dhe mori masat përkatëse.

Në fund të mbledhjes mbajti një fjalim të rëndësishëm Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

PLENUMI I 6-TË I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 16-17 dhjetor 1974

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Plenumi i 6-të i Komitetit Qendror të PPSH, në datën 16 dhe 17 dhjetor 1974 u mbledh nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha. Plenumi shqyrtoi zbatimin e detyrave që vendosi Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror për forcimin e punës në ushtri.

Në Plenum shoku Enver Hoxha mbajti një fjalim të rëndësishëm.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

VENDIM

I BYROJË POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI PLANIN E ZHVILLIMIT TË EKONOMISË DHE TË KULTURËS NË RPSH PËR VITIN 1975

26 dhjetor 1974

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH në mbledhjen e datës 26 dhjetor 1974, pasi mori në shqyrtim dhe diskutoi projektplanin e zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës në RPSH për vitin 1975 konstatoi se gjatë vitit 1974, masat punonjëse të vendit, të udhëhequra me guxim e urtësi nga Partia, me një mobilizim e entuziazëm të paparë, për nder të 30-vjetorit të Çlirimit të atdheut dhe triumfit të Revolucionit Popullor, arritën rezultate të kënaqshme në të gjitha degët e ekonomisë e të kulturës.

Por në të njëjtën kohë në disa degë të ekonomisë, për zëra të veçantë, detyrat e planit të këtij viti nuk u plotësuan. Kështu në shpim-kërkime për naftë, jo vetëm për vitin 1974, por për të gjitha vitet e këtij pesëvjeçari, nuk janë arritur rezultate në zbulimin e vendburimeve të reja dhe në rritjen e rezervave industriale e gjeologjike sipas detyrave që caktoi Kongresi i 6-të i PPSH, gjë që ka sjellë anomali të padëshirueshme edhe në shfrytëzimin e vendburimeve ekzistuese dhe, si pasojë, detyrat për nxjerrjen e naftës nuk janë plotësuar sipas planit. Deficite të ndjeshme, gjithashtu, janë krijuar në disa prodhime bujqësore e blegtorale e në mënyrë të veçantë në prodhimin e pambukut, lulediellit, patates e fasules, të cilat kanë sjellë zhbilancime e vështirësi, gjë që e ka detyruar shtetin t'i mbulojë ato me prodhime të sjella nga importi.

Organizatave bazë dhe organet e Partisë, me gjithë përmirësimet, akoma nuk janë kudo në lartësinë e detyrës së udhëheqjes së plotë e efektive të levave të tyre, organeve shtetërore e ekonomike dhe organizatave të masave e të gjithë punonjësve për të

plotësuar ritmikiisht, në çdo zë e tregues detyrat e rëndësishme të planit.

Lidhur me detyrat e planit të vitit 1975, Byroja Politike e Komitetit Qendror

V e n d o s i :

1. — Të miratojë planin e zhvillimit të ekonomisë e të kulturës në RPSH për vitin 1975 dhe të tërheqë vëmendjen e organeve e organizatave të Partisë, organeve shtetërore dhe ekonomike, si dhe të organizatave të masave, që të vënë të gjitha forcat për një mobilizim të gjithanshëm e të plotë të masave të gjera punonjëse në realizimin e në tejkalimin e detyrave të këtij plani.

Realizimi i planit të vitit 1975, që është viti i fundit i pesëvjeçarit të pestë, të konsiderohet kudo e nga të gjithë si detyra kryesore në veprimtarinë e masave të gjera punonjëse dhe të luftohet për të plotësuar çdo ditë, çdo muaj e çdo tremujor planin në të gjithë treguesit e tij ekonomikë, financiarë e cilësorë.

2. — Organet dhe organizatat e Partisë të rritin më tej rolin e tyre organizues e udhëheqës në luftën për realizimin e detyrave të planit. Ato të kontrollojnë e të kërkojnë më tepër llogari për zbatimin e plotë të detyrave që plani të realizohet e të tejkalohet në të gjitha degët e ekonomisë e të kulturës. Në të njëjtën kohë, ato të mbajnë drejtpërdrejt përgjegjësi për realizimin e planit dhe, kur konstatojnë të meta e dobësi që pengojnë realizimin e tij, të vënë para përgjegjësisë së Partisë të gjitha levat, kuadrot e komunistët.

3. — Një rëndësi e veçantë t'u kushtohet kërkimit e zbulimit të vendburimeve të reja të naftës, gazit, kromit e të gjitha mineraleve të tjera të dobishme, si dhe industrisë nxjerrëse e përpunuese. Instituti i Kërkimeve të Naftës dhe të Gazit të përmirësojë rrënjësisht punën e tij dhe të përdorë më me efektivitet mjetet materialo-teknike, eksperiencën dhe të dhënat gjeologjiko-teknike, për të zbuluar sa më parë vendburime të reja për naftë e gaz dhe për të mbuluar plotësisht nevojat e ekonomisë për këto prodhime të dorës së parë.

I rekomandohet Këshillit të Ministrave që të analizojë dhe të marrë masa për përsosjen e punës e të organizimit në kërkimet dhe në metodat e nxjerrjes së naftës, me synim që të rriten sa më shpejt mundësitë e nxjerrjes dhe rezervat industriale e gjeologjike për naftë.

4. — Një nga drejtimet kryesore të punës së Partisë dhe të veprimtarisë së organeve shtetërore e të ekonomisë të jetë plotësimi i planit sipas asortimenteve dhe rritja e cilësisë së prodhime-

ve. Të mos lejohet prodhimi thjesht për realizim plani, por ai prodhim që u duhet popullit dhe ekonomisë, duke marrë masa njëkohësisht për pakësimin sistematik, deri në eliminimin e mallrave mbinormative dhe stoqe që kanë akoma ndërmarrjet prodhuese e përdoruese. Lufta dhe masat konkrete për përmirësimin rrënjësor të cilësisë së punës, prodhimeve, ndërtimeve, riparimeve dhe shërbimeve, të bëhet një nga aksionet më të rëndësishme masive gjatë vitit 1975. Kontrolli për cilësinë të ngrihet në shkallë më të lartë, të bëhet gjatë gjithë proceseve të punës e të prodhimit dhe nga të gjithë kuadrot e punonjësit.

5. — Plotësimi i detyrave të planit në bujqësi të jetë një nga preokupacionet kryesore të komiteteve dhe organizatave të Partisë, si dhe të të gjitha organeve shtetërore. . . Një kujdes e punë të madhe e të gjithanshme t'u kushtohet plotësimit të detyrave për prodhimin e drithërave të bukës, që përbëjnë detyrën kryesore në bujqësi, si dhe bimëve industriale, blegtorisë dhe frutikulturës. Në veçanti të vlerësohet më mirë kultura e misrit, i cili të mbillet në sipërfaqe më të mëdha në tokat nën ujë dhe prej tij të merren rendimente të larta. Krahas me këtë dhe pa nënvleftësuar detyrat e tjera, të merren të gjitha masat e nevojshme për të likuiduar medoemos prapambetjen që ekziston në prodhimin e patates e të fasules dhe për të siguruar plotësimin e nevojave të ekonomisë e të popullit me këta artikuj. Organet dhe organizatat e Partisë, si dhe organet shtetërore dhe ekonomike të organizojnë analiza, diskutime, ballafaqime dhe të përcaktojnë masa konkrete për prodhimin e patates e të fasules në çdo brigadë, sektor, kooperativë e ndërmarrje bujqësore.

6. — Përfundimi i veprave të reja industriale sipas afateve të caktuara në planin e vitit 1975, të qëndrojnë kurdoherë në qëndër të vëmendjes së dikastereve përkatëse, të organeve shtetërore në rrethe dhe të organeve e të organizatave të Partisë, të cilat njëkohësisht të marrin të gjitha masat e nevojshme për vënien e tyre në shfrytëzim sa më shpejt.

7. — Kujdes i madh t'i kushtohet kursimit të fuqisë punëtore e në mënyrë të veçantë asaj që tërhiqet nga fshati. Organet e organizatat e Partisë dhe sidomos Komisioni i Planit të Shtetit dhe dikasteret qendrore, si dhe organet ekonomike e shtetërore në rrethe e në bazë të studiojnë me kujdes zënien me punë të gjithë krahëve të aftë në qytete, me synim që të lirohen ato forca, të cilat i kanë familjet e tyre në fshat për të plotësuar nevojat që kanë ndërmarrjet ekonomike që veprojnë larg qyteteve dhe të vetë kooperativave bujqësore. Problemi i fuqisë punëtore të trajtohet konkretisht dhe në mënyrë sa më të studiuar për të kufizuar sa më shumë tërheqjen e fuqisë punëtore nga fshati. Njëkohësisht, për rritjen e prodhimit bujqësor, të studiohet e të merren masa për përdorimin e të gjitha forcave të lira që ka në ndërmarrjet bujqësore.

8. — Aparati i Komitetit Qendror të Partisë të përmirësojë më tej punën në drejtim të kontrollit dhe të ndihmës komiteteve të Partisë në rrethe e në ushtri dhe organizatave të Partisë në diskutere që të rritet roli i tyre drejtues dhe të kontrollojë nga afër zbatimin e direktivave të Komitetit Qendror në fushën e plotësimit të planit ekonomik të shtetit.

Byroja Politike shpreh bindjen se masat e gjera punonjëse, të udhëhequra nga Partia, si kurdoherë, edhe në vitin 1975 do të mobilizojnë energjitë e tyre mendore e fizike për realizimin dhe tejkalimin me sukses të detyrave të planit.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

KONKLUZIONE

TË BYROSE POLITIKE TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI PUNËN QË BËHET DHE PROBLEMET QË DALIN PËR EDUKIMIN IDEOESTETIK DHE ETIKO-MORAL TË RINISË NË LUFTË KUNDËR SHFAQJEVE TË HUAJA

26 dhjetor 1974

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH në mbledhjen e datës 26 dhjetor 1974, mori në shqyrtim raportin e paraqitur nga Komiteti Qendror i BRPSH «Mbi punën që bëhet dhe problemet që dalin për edukimin ideoestetik dhe etiko-moral të rinisë në luftë kundër shfaqjeve të huaja».

Byroja Politike konstatoi se në luftë për zbatimin e detyrave që vuri Plenumi i 4-t i KQ të PPSH, nën drejtimin e Partisë, u shënuan përmirësime të dukshme në punën edukative me rininë dhe në gjallërimin e organizatës. BRPSH, mbështetur në këto vendime dhe në fjalimet e shokut Enver, ka zhvilluar dhe po zhvillon një veprimtari të gjerë edukative për formimin marksist-leninist të rinisë, për edukimin e saj me traditat patriotike revolucionare, për ta hedhur rininë në aksione ideologjike kundër shfaqjeve të huaja dhe qëndrimeve liberale ndaj tyre, në aksione të tjera kombëtare e lokale, për aktivizimin e rinisë në lëvizjen kulturore-artistike e sportive etj. Veprimtaria më e gjerë edukative dhe praktika revolucionare kanë sjellë edhe forcimin e mëtejshëm të organizatës së BRPSH. Me gjithë rezultatet e arritura, Byroja Politike porositi që në asnjë mënyrë nuk duhet të mendohet se çdo gjë u kapërcye. Lufta kundër shfaqjeve të ideologjive të huaja borgjezo-revizioniste duhet të zhvillohet pandërprerë e me forcë, duke ngritur gjithnjë më lart si ndërgjegjen socialiste të rinisë ashtu dhe vigjilencën politike të saj.

1) **Rinia dhe organizata e saj duhet të angazhohen më mirë në problemet e mëdha të vendit, në punë, mësim e përgatitje për mbrojtjen e atdheut.**

Nën udhëheqjen e Partisë, rinia ka qenë kurdoherë një forcë e madhe revolucionare, ajo ka milituar aktivisht në të gjitha frontet e ndërtimit socialist të vendit, është treguar kurdoherë e gatshme të vërë në jetë direktivat dhe vendimet e Partisë. Edhe në të ardhmen organizatat e Partisë kanë për detyrë t'i mobilizojnë gjerësisht forcat e mëdha të rinisë, ta edukojnë atë me ndjenjën e përgjegjësisë për detyrat, për vendin e rolin që i takon të luajë në gjithë jetën e vendit, në zgjidhjen e problemeve të mëdha që kanë vënë para saj Partia dhe shteti. Duhet të kuptohet mirë dhe të realizohet drejt në praktikë se asnjë detyrë nuk mund të zgjidhin me sukses organizatat e Partisë pa llogaritur mbi masat e në rastin konkret mbi forcën e rinisë.

Të mos harrohet për asnjë çast se presioni armik i brendshëm dhe i jashtëm synon që në rrugë e në forma të ndryshme t'i largojë vëmendjen dhe energjitë e rinisë nga problemet e mëdha të vendit dhe të nxitë tek ajo prirjet e një jete të lehtë, pa telashe. Megjithëse janë goditur ashpër, përsëri vihen re shfaqje të huaja te disa të rinj si tendenca për të zënë punë të rrehatshme, për të mos vajtur atje ku ka punë, për t'u larguar nga fshati etj. Në luftë me këto shfaqje të huaja, në organizatat e rinisë kanë lindur iniciativa, si «Të duam fshatin dhe profesionin e bujkut», «Të punojmë në sektorët më të vështirë», «Të punojmë në veprat e mëdha të pesëvjeçarit» etj. Këto lëvizje e të tjera duhet të gjallërohen e të zhvillohen që të edukojnë e të rrënjosin thellë te rinia dashurinë për fshatin, për profesionin e nderuar të bujkut, ta përgatitin ideologjikisht e shpirtërisht atë për të punuar në sektorë të vështirë, në vepra të mëdha e kudo ku ka nevojë atdheu.

Në punë dhe nëpërmjet punës për të vënë në jetë programin e Partisë për ndërtimin e socializmit bëhen dhe edukimi e kalitja revolucionare e rinisë. Për këtë arsye komitetet e Partisë në rrethe, organet e pushtetit, organizatat e BRPSH dhe organizatat e tjera të masave duhet të kujdesen vazhdimisht për zënien me punë të të gjithë të rinjve që dalin nga shkollat. Asnjë i ri dhe e re nuk duhet të mbetet pa u sistemuar në një punë. Kjo kërkon një punë të gjerë sqaruese për t'i bindur të shkojnë kudo ku ka punë. Kjo kërkon gjithashtu masa praktike e organizative për trajtimin e çështjes së zënies së të rinjve e të të rejave me punë me kujdes të veçantë, ngrohtësi dhe sipas moshës, seksit e aftësisë.

Organizatat e Bashkimit të Rinisë në bashkëpunim me organizatat e Bashkimeve Profesionale duhet të bëjnë një punë të gjerë edukative me të rinjtë punëtorë, sidomos me ata të rinj e të reja që nisin punën për herë të parë, për t'i lidhur fort me ndërmarrjen, me punën, për t'i edukuar me shprehitë e disiplinës proletare, për të mësuar nga punëtorët e vjetër, për të nxitur tek ata dëshirën për përvetësimin e teknikës e të teknologjisë së përparuar.

Një kujdes më i madh duhet të tregohet për rininë e fshatit, për ta mobilizuar atë më mirë në konsolidimin e mëtejshëm ideologjik të kolektivizimit të kooperativave bujqësore, në forcimin e tyre ekonomik dhe organizativ. Të inkurajohet iniciativa e rinisë dhe e organizatës së saj për studimin, propagandimin dhe zbatimin e të rejave të shkencës, agroteknikës dhe të eksperiencës së përparuar në bujqësi, si një nga hallkat më të rëndësishme për rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral. Ministria e Bujqësisë, komitetet ekzekutive dhe organizatat e Partisë duhet t'u japin organizatave të BRPSH gjithë përkrahjen dhe ndihmën e tyre për t'u organizuar sa më mirë ky aktivitet i rëndësishëm për edukimin e rinisë.

Forcimi dhe përmirësimi i punës edukative me rininë shkollore duhet të tërheqin edhe në të ardhmen më shumë vëmendjen e organizatave dhe komiteteve të Partisë. Të gjallërohen më shumë jeta politike dhe ideologjike e organizatave të rinisë në shkolla, puna për edukimin ideologjik marksist-leninist të rinisë shkollore e studenteske, të kalitet vullneti në mësim për rezultate të larta në përvetësimin e dijeve dhe përgatitjen fizike e ushtarake. Të luftohet për përsosjen e figurës morale për ta angazhuar rininë e shkollave më fort në luftën kundër shfaqjeve të huaja.

Të ruhet e të ngrihet më lart fryma e aksioneve të rinisë, duke i besuar edhe në të ardhmen organizatës së saj aksione në shkallë kombëtare e lokale. Aksioni ka qenë dhe mbetet një metodë e rëndësishme pune dhe edukimi për rininë. T'i jepet rëndësi e veçantë organizimit të jetës politike dhe edukative të rinisë në aksione, që ato të lënë mbresa sa më të thella në kalitjen e saj me shpirtin praktik të punës, të organizimit, të rregullit e disiplinës, me koncepte të drejta për punën dhe pronën socialiste.

2) Edukimi i rinisë me shijet e normat proletare është një drejtim tjetër shumë i rëndësishëm i punës së Partisë me rininë. Nën udhëheqjen e organizatave të Partisë brezi i ri është angazhuar frontalisht në luftë me çdo shfaqje të huaj e në këtë proces ai po konsolidon më tej tiparet e moralit komunist proletar. Tani detyra është që ai opinion luftarak e i shëndoshë që u krijua pas fjalimit të 15 marsit të shokut Enver Hoxha dhe të Plenumit të 4-t të KQ të mbahet vazhdimisht i ngritur. Organizatat e Partisë duhet ta përdorin rininë dhe organizatën e saj më mirë si një forcë goditëse e sulmuese në luftën si kundër mbeturinave patriarkale, zakoneve prapanike e besimeve fetare që kanë filluar të gjallërohen, ashtu dhe kundër shfaqjeve të ideologjive borgjeze e revizioniste e qëndrimeve liberale ndaj tyre. Nuk duhet kënaqur me atë që është arritur në luftën kundër shfaqjeve të huaja, veçanërisht në fushën e shijeve estetike dhe të normave morale.

Plenumi i 4-t i KQ të Partisë theksoi me forcë nevojën e in-

tensifikimit të vazhdueshëm të luftës ideologjike kundër presionit të ideologjisë borgjeze e revizioniste. Me gjithë punën që është bërë e sukseset që janë arritur në edukimin ideoestetik dhe etiko-moral të rinisë, prapë vihen re përsëritje të shfaqjeve të huaja në modë, në sjellje, ndjekje të muzikës dekadente, akte rrugaçerie e kriminaliteti etj. Dhe jo gjithnjë e kudo rrethohen këto shfaqje e akte me zjarrin e opinionit kritik revolucionar. Prandaj lipset të forcohet më tej puna shpjeguese e bindëse me masat e rinisë, të ngrihet më lart opinioni shoqëror kritik kundër bartësve të koncepteve dhe shfaqjeve të huaja duke forcuar frontin unik të edukimit, duke bashkërenduar më mirë veprimtarinë edukative të organizatave të masave, të shkollës, familjes dhe shoqërisë. Të luftohet kundër sjelljeve të padenja, përdorimit të fjalorit banal, shfaqjeve të rrugaçerisë e veseve të vjedhjes, pijes, të mashtrimit etj., që, ndonëse janë të kufizuara, paraqesin rrezikshmëri. Kujdes i madh të tregohet për fëmijët që futen në rrugën e sjelljeve të padenja.

Në gjithë veprimtarinë për t'u mbyllur shtigjet e për të likuiduar çdo ndikim të ideologjive të huaja borgjeze e revizioniste i duhet kushtuar rëndësi e dorës së parë punës për formimin e brumosjen e rinisë me ideologjinë marksiste-leniniste. Në themel të të gjithë punës edukative të vihet studimi i thellë e krijues i literaturës marksiste, i materialeve të Partisë sonë dhe i Veprave të shokut Enver. Në këtë kuadër të forcohet e të përmirësohet puna në sistemin e edukimit marksist-leninist të rinisë. Të punohet më mirë për informimin politik të rinisë në organizatën e rinisë e në forma të tjera, që rinia të jetojë aktivisht me ngjarjet politike ndërkombëtare, të njohë mirë qëndrimet e Partisë e të shtetit tonë. Të rriten e të zgjerohen aktivitetet për njohjen dhe edukimin e masave të rinisë me traditat patriotike revolucionare të popullit tonë për liri, me traditat e Luftës Nacionalçlirimtare dhe të ndërtimit socialist të vendit. Kjo punë të thellohet si në përmbajtje ashtu dhe në format e mjetet e saj. Ngritja cilësore e punës edukative, rritja e efikasitetit të saj të konsiderohet si një nga detyrat më të rëndësishme të punës së Partisë me rininë dhe kjo kërkon që të lidhet ngushtë me praktikën e jetën, me problemet që ngre Partia dhe që nxjerr jeta, që secili të ballafaqohet me mësimet e Partisë e të shokut Enver, që në plan të parë për çdo gjë të vihet politika e Partisë, sqarimi e bindja e njerëzve.

Rinia duhet të edukohet me dashuri për krijimtarinë dhe artin e popullit. Përfshirja e saj në aksionet e rëndësishme kulturore-artistike gjatë vitit 1974 që një punë e dobishme për edukimin e saj me shije të shëndosha. Edhe në të ardhmen t'u jepet rëndësi përvetësimit dhe interpretimit të krijimtarisë së popullit, njohjes dhe studimit të veprave të shkrimtarëve, poetëve, kompozitorëve, piktorëve e skulptorëve tanë të talentuar. Të zgjero-

het akoma më shumë pjesëmarrja e rinisë në lëvizjet kulturore-artistike e fizkulturalo-sportive, rinia të jetë shpirti i këtyre lëvizjeve e aktiviteteve që e tërheqin dhe e edukojnë atë, i zënë asaj në mënyrë të dobishme kohën e lirë. Kujdes më i madh të tregohet për edukimin dhe aktivizimin e talenteve të reja në këto fusha.

3) Detyrat për edukimin e kalitjen e gjithanshme të rinisë nuk mund të realizohen me sukses pa forcuar më tej vetë organizatën e BRPSH. Është bërë mjaft punë për likuidimin e të metave dhe dobësive që u vunë re, por ato nuk mund të quhen të kapërcyera përfundimisht. Duke punuar për konsolidimin e masave që kishin për qëllim likuidimin e shfaqjeve liberale në jetën e organizatës, i duhet kushtuar kujdes më i madh problemit të forcimit të përmbajtjes së punës për ta lidhur më ngushtë shpirtërisht anëtarin me organizatën e tij, për njohjen dhe zbatimin e normave e të rregullave të Statutit të BRPSH. Një punë shumë më e madhe duhet të bëhet sidomos për forcimin e organizatës së rinisë në ushtri, për ta bërë atë një levë të fuqishme të Partisë në këtë sektor shumë të rëndësishëm.

Të forcohet akoma më tepër bashkëveprimi midis KQ të BRPSH dhe organeve qendrore të organizatave të masave, me dikasteret etj., me qëllim që në të ardhmen të bëhet akoma më i fuqishëm e më efektiv veprimi i frontit unik për edukimin e brezit të ri.

Veçanërisht duhet të forcohet e të përmirësohet udhëheqja dhe drejtimi i organizatave dhe i komiteteve të Partisë në organizatën e rinisë. Të kuptohet qartë e të realizohet në praktikë drejt se gjithë veprimtaria e BRPSH udhëhiqet nga Partia, se gjithë puna e saj për edukimin e mobilizimin e rinisë duhet të orientohet e të drejtohet nga organizatat dhe komitetet e Partisë, në bazë të direktivave dhe vendimeve të Partisë. Sa më mirë ta udhëheqë organizata e Partisë rininë dhe sa më mirë kjo e fundit të sigurojë udhëheqjen e Partisë atë më me sukses BRPSH do të luajë rolin e saj si ndihmës e rezervë e Partisë.

Byroja Politike porosit komitetet e Partisë në rrethe dhe në ushtri, të gjitha organizatat-bazë dhe grupet e Partisë që të rritin akoma më shumë kujdesin për forcimin e gjithanshëm të punës në organizatën e Bashkimit të Rinisë, të përmirësojnë në mënyrë të dukshme udhëheqjen konkrete e të drejtpërdrejtë në veprimtarinë e kësaj leve shumë të rëndësishme të Partisë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI STUDIMIN E PËRBALLIMIN E NEVOJAVE TË EKONOMISË ME ENERGJI ELEKTRIKE

24 janar 1975

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, pasi mori në shqyrtim studimin «Mbi përballimin e nevojave të ekonomisë me energji elektrike», paraqitur nga Komisioni i Planit të Shtetit dhe Ministria e Industrisë dhe e Minerave,

V e n d o s i :

1. — Studimi «Mbi përballimin e nevojave të ekonomisë me energji elektrike» të mbahet parasysh e të shërbejë si bazë për hartimin e planit të pesëvjeçarit të gjashtë. Në të njëjtën kohë të vazhdojnë studimet për rritjen e burimeve energjetike dhe të prodhimit të energjisë elektrike për të plotësuar më mirë nevojat e ekonomisë, duke shfrytëzuar më gjerësisht burimet hidrike si dhe qymyret e dobëta në termocentralet ekzistuese e në të rinjtë që mund të ndërtohen pranë vendburimeve.

Sekretari i Komitetit Qendror të PPSH

Hysni Kapo

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

P R O T O K O L L

I BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI KURSIMIN E FUQISË PUNËTORE NË MINIERA, NË NDËRMARRJET E SHFRYTËZIMIT TË PYJEVE DHE NË NDËRTIM

24 janar 1975

Byroja Politike në mbledhjen e datës 24 janar 1975 pasi shqyrtoi raportin e paraqitur nga Ministria e Industrisë dhe e Minerave «Mbi zbatimin e detyrave të Kongresit të 6-të të PPSH për kursimin e fuqisë punëtore në miniera e në sharra nëpërmjet mekanizimit të proceseve të punës», si dhe raportin e Ministrisë së Ndërtimit «Mbi zbatimin e detyrave të Kongresit të 6-të të PPSH për kursimin e fuqisë punëtore në ndërtim nëpërmjet përqendrimit dhe industrializimit» arriti në këto konkluzione:

Mekanizimi i punimeve në miniera e në sharra, si dhe industrializimi i ndërtimeve kanë shkuar vazhdimisht në rritje dhe janë plotësuar më mirë detyrat që kanë shtruar Partia e Qeveria për rritjen e rendimentit të punës, për uljen e kostos së prodhimit e të ndërtimit, si dhe për lehtësimin e punës duke siguruar kështu një kursim të mirë të fuqisë punëtore.

Megjithatë Byroja Politike vuri në dukje se rezultatet mund të ishin më të mëdha, në qoftë se organet dhe organizatat e Partisë në miniera e në sharra, si dhe në ndërtim do t'i merrnin më mirë në dorë këto probleme dhe do të mobilizoheshin më shumë punonjësit për një shfrytëzim më racional të mundësive që janë krijuar. Jo kudo është treguar kujdes; kështu, ndërsa në minierat e qymyrit e të hekur-nikelit shkalla e mekanizimit të punimeve të brendshme ka arritur një nivel të kënaqshëm, në minierat e kromit ajo është akoma e ulët. Në procesin e transportimit të lëndës në sharrat shumë procese pune që mund të

mekanizohen kryhen akoma me dorë duke angazhuar fuqi punëtoresh të shumtë.

Në veçanti Byroja Politike kritikoi masat e pamjaftueshme që janë marrë në drejtim të shfrytëzimit racional e të plotë të makinerive e të mekanizmave që kanë këto degë të ekonomisë. Makinaria e rëndë në ndërtim gjatë gjithë vitit punon vetëm 140 gjer në 200 ditë dhe fare pak punojnë me dy e tri ndërresa; teleferikët në sharra shfrytëzohen rreth 50 për qind; ka raste kur makineri e pajisje të prodhuara rrinë me muaj të tërë pa punuar etj. Të gjitha këto kanë bërë që të përdoret më shumë fuqi krahu, duke rritur nevojat për fuqi punëtoresh dhe duke dëmtuar përdorimin racional të saj. Njëkohësisht Byroja Politike kritikoi zvarritjen e dorëzimit në afat të veprave të ndërtimit, që gjithashtu keqëson përdorimin e drejtë të fuqisë punëtoresh, e cila shpërndahet në shumë objekte me një rendiment më të ulët.

Me qëllim që në kursimin e fuqisë punëtoresh në miniera, në sharra e në ndërtim të arrihen më shumë rezultate, Byroja Politike e KQ

Porosit:

1. — Organet dhe organizatat-bazë të Partisë, organet shtetërore dhe të ekonomisë, detyrat e shtruara nga Partia në fushën e mekanizimit të punimeve, jo vetëm në sektorët që u përmendën më lart, por në të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë, t'i konsiderojnë si faktor të rëndësishëm për kursimin e fuqisë punëtoresh dhe t'i kenë kurdoherë në qendrën e vëmendjes të punës së tyre. Për këtë të shfrytëzohen deri në një të gjitha mundësitë e brendshme që ka çdo ndërmarrje, si dhe ato që ka e krijon vazhdimisht ekonomia jonë popullore. Para së gjithash, organizatat e Partisë të bëjnë një punë më të gjerë e më të thellë politike e ideologjike që të formohet bindja e qëndrueshme te çdo punonjës për domosdoshmërinë e mekanizimit të mëtejshëm të punimeve në miniera e në sharra, për industrializimin e mëtejshëm të ndërtimeve, për të tërhequr sa më pak fuqi punëtoresh nga fshati.

2. — Organet e Partisë e të pushtetit në rreth, organizatat-bazë të Partisë dhe organet ekonomike të bëjnë një luftë më të madhe politike dhe ideologjike, organizative e teknike, që jo vetëm të mos mbetet asnjë makineri e mekanizim pa u vënë në shfrytëzim, por të shfrytëzohen ato tërësisht e sipas kapaciteteve të tyre të plota. Të merren të gjitha masat organizative e teknike që, sipas kushteve të prodhimit dhe nevojave ekonomike kë-

to makineri e mekanizma të punojnë me dy e tri ndërresa. Të bëhet problem i gjithë kolektivit dhe, sipas rastit, edhe i organizatave-bazë të Partisë, kur një makineri nuk punon.

3. — Organet e organizatat e Partisë, organizatat e masave dhe organet ekonomike e shtetërore, të marrin më mirë në dorë punën për njohjen e për zbatimin e përvojës së përparuar në këto degë. Në sektorin e minierave të shfrytëzohet më mirë përvoja e minierave të përparuara, si në punimet nëntokësore, ashtu dhe në ato të sipërfaqes. Në punimet e avancimit në Mborje-Drenovë apo Memaliaj realizohet 60-65 metra në muaj ose në Përrenjas 80 metra në muaj duhet që edhe në minierat, e kromit të arrihen këto ritme e jo të mbeten në 30 apo 40 metra. Në qoftë se në bonifikime e në ndërtime ka sot disa ekskavatoristë të cilët, me ekskavatorë që kanë kova një metër kub, realizojnë 150 000 m³ lëvizje dheu, kjo duhet të arrihet sa më parë në të gjitha këto tipe e jo të qëndrohet në 100 000 m³ për vite me radhë. Në qoftë se në Çervenakë janë arritur rezultate të mira në mekanizimin e punimeve të sipërfaqes, që angazhojnë sot një numër të konsiderueshëm punëtorësh, pa humbur kohë duhet të përhapet e të zbatohet një përvojë e tillë në të gjitha minierat.

4. — Ministria e Industrisë dhe e Minierave të vlerësojë më mirë punën për zgjerimin e mekanizimit të punimeve në miniera e në sharra dhe të marrë masa për të ndihmuar nga afër ndërmarrjet për shfrytëzimin e plotë të parkut të mekanizmave e të makinerive që kanë. Veçanërisht ajo të ndjekë prodhimin e pajisjeve dhe të mekanizmave në vend, si dhe pjesëve të ndërrimit, duke rritur shkallën e specializimit të ndërmarrjeve prodhuese dhe kooperimin e tyre në shkallë dege dhe ekonomie.

5. — Ministria e Ndërtimit të marrë masa për të çuar më përpara industrializimin e ndërtimeve dhe të mos lejojë që iniciativat e marra në këtë drejtim të mos çohen gjer në fund, siç ndodhi për linjat e panelave të parafabrikuara për banesa.

Përqendrimi i punimeve dhe respektimi i afateve të dorëzimit të veprave sipas planit, në kohën e tanishme përbën një nga detyrat më të mprehta si për Ministrinë e Ndërtimit, ashtu dhe për investitorët. Organet dhe organizatat e Partisë në këtë drejtim të bëjnë një punë më të madhe edukative, për të luftuar prirjet e gabuara të realizimit të planit në vëllimin global, neglizhencat e qëndrimet liberale për moszbatimin në kohë të detyrave të planit të shtetit.

6. — Organet dhe organizatat e Partisë, si dhe organet shtetërore dhe ekonomike çështjet e mekanizimit të mëtejshëm të punimeve në miniera e në sharra, në ndërtim dhe në të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë t'i trajtojnë kurdoherë si probleme të mëdha politike, ideologjike, ekonomike dhe shoqërore. Zgjerimi i mekanizimit dhe forcimi i organizimit e i disiplinës

duhet të çojnë në rritjen e vazhdueshme e të pandërprerë të rendimentit të punës. Ato të mbajnë vazhdimisht parasysh se kursimi i fuqisë punëtore në këto degë lidhet drejtpërsëdrejti me kufizimin e me pakësimin e tërheqjes së krahëve të punës nga fshati, ku sot ka nevoja të mëdha për to.

Byroja Politike shpreh bindjen se organet dhe organizatat-bazë të Partisë, organet shtetërore dhe ekonomike do të vlerësojnë si duhet problemet e mësipërme e do të marrin të gjitha masat që të zgjidhen drejt dhe sa më parë.

Sekretari i Komitetit Qendror të PPSH

Hysni Kapo

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

KONKLUZIONE

TË SEKRETARIATIT TË KQ TË PPSH «MBI MASAT PËR ZBATIMIN E DETYRAVE TË PLENUMIT TË 11-TË TË KQ TË PARTISË PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT TË FËMIJËVE»

3 mars 1975

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 3.3.1975, pasi mori në shqyrtim raportin e Ministrisë së Shëndetësisë «Mbi masat për zbatimin e detyrave të Plenumit të 11-të të KQ të Partisë për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve», arriti në këto konkluzione:

Si rezultat i punës dhe i masave të zbatuara nga organet e Partisë dhe ato shtetërore, nga organizatat e masave dhe sidomos nga organet e shëndetësisë, pas Plenumit të 11-të të Komitetit Qendror të PPSH në mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve vërehet një përmirësim i dukshëm: sëmundjet e rënda infektive pothuajse janë parandaluar plotësisht, shërbimi pediatrik dhe ndihma mjekësore për fëmijët janë zgjeruar dhe përmirësuar, vdekjet e fëmijëve të vegjël në përgjithësi janë ulur dhe kanë krijuar njëfarë qëndrueshmërie, në përgjithësi çdo fshat ka maminë, infermieren, çerdhen dhe konsultoren e vet, ndërsa çdo kooperativë bujqësore ka shtëpinë e lindjes. Organet dhe organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe ekonomike, organizatat e masave dhe veçanërisht organet e shëndetësisë e kanë vlerësuar gjithnjë e më mirë këtë problem, kanë shtuar kujdesin, kanë marrë masa më të efektshme dhe kanë bërë studime më të thella për përmirësimin e shërbimit ndaj nënës e fëmijës, si dhe për parandalimin e sëmundjeve dhe të vdekjeve të fëmijëve.

Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë theksoi se për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve nuk ka vend për asnjë vetëkënaqësi, pasi mbetet shumë për të bërë, veçanërisht në rrethet Pukë, Tropojë, Kukës, Dibër, Shkodër, Lezhë, Gramsh, ku vdekshmëria e fëmijëve është ende e lartë, sepse, në krahasim me

masat që ka marrë Partia për rritjen e nivelit material e kulturor dhe me shtrirjen e forcimit e shërbimit shëndetësor, ulja e vdekshmërisë së fëmijëve është akoma e ngadalshme. Po kështu puna propagandistike që bëjnë organizatat e Partisë, ato të masave, organet dhe kuadrot e shëndetësisë për edukimin higjieno-sanitar të punonjësve, sidomos të nënave, për të luftuar kundër koncepteve e zakoneve prapanike, si dhe masat organizative, teknike dhe ekonomike të domosdoshme për mbrojtjen e nënës e të fëmijës nuk janë kudo dhe kurdoherë në nivelin e kërkesave të kohës dhe në disa raste nga organet e Partisë e ato shtetërore ka shfaqje të një vlerësimi e kujdesi të pamjaftueshëm.

Për të përmirësuar gjendjen dhe për të rritur në një shkallë më të lartë kujdesin për shëndetin e fëmijëve, Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH porositi:

1. — Organet e Partisë në rrethe dhe organizatat-bazë në institucionet shëndetësore, në ndërmarrjet dhe në kooperativat bujqësore të kuptojnë thellë dhe të zbatojnë më mirë në praktikë porosinë e Partisë se kujdesi për shëndetin dhe mirërritjen e fëmijëve ka një përmbajtje të thellë dhe rëndësi të madhe politike, ideologjike dhe shoqërore, që lidhet me të ardhmen e popullit tonë dhe me ngritjen e mëtejshme të nivelit material e kulturor të masave punonjëse. Prandaj zbatimi si duhet i detyrave në këtë fushë dhe mënjanimi i shkaqeve, sidomos i atyre të jashtme, që shpien në sëmundjen dhe vdekjen e fëmijëve të vegjël, mund të jenë efektive vetëm atëherë kur masat teknike dhe organizative lidhur me kujdesin për fëmijët dhe me kurimin e sëmundjeve të tyre, me profilaksinë, higjienën e pastërtinë, do të gërshetohen si duhet me një punë sistematike ideopolitike nga organet dhe organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe organizatat e masave.

Komitetet dhe organizatat e Partisë të bëjnë një punë më të organizuar dhe më të thelluar në këtë drejtim, të ushtrojnë kontroll më të fortë dhe të kërkojnë nga organet shtetërore, të shëndetësisë dhe të ekonomisë, si dhe nga organizatat e masave që t'i vlerësojnë, të merren më mirë dhe të zgjidhin në kompleks e në kohë problemet e rëndësishme që lidhen me shëndetin dhe mirërritjen e fëmijëve, siç janë lindjet e tyre para kohe dhe nën peshë (prematurre), ushqimi dhe trajtimi i nënave shtatzëna dhe fëmijët e gjirit etj., duke i konsideruar ato si një problem të madh shoqëror e mjekësor.

2. — Organizatat e Partisë dhe ato të masave, organet shtetërore dhe në veçanti mjekët dhe gjithë punonjësit e shëndetësisë, të zhvillojnë një punë të gjerë me masat, sidomos në fshat dhe ta konsiderojnë këtë si një detyrë shumë të rëndësishme për edukimin dhe ngritjen e nivelit e të kulturës shëndetësore të tyre, posaçërisht të nënës. Me këta kuadro të bëhet një punë

më e mirë për t'i ndihmuar, kontrolluar dhe për t'i edukuar, që të kuptojnë dhe të zbatojnë detyrat e mëdha në fushën e kurimit dhe të masave profilaktike në mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve. Për këtë qëllim është e nevojshme të thellohet më tej lufta ideologjike në të gjitha format e saj nëpërmjet debatit, fletërrufeve, këmbimit të mendimeve, propagandës higjieno-sanitare dhe të formave e rrugëve të tjera.

3. — Të rritet më tej roli udhëheqës dhe shembulli personal i komunistëve për të gjitha problemet e shëndetit të nënës e të fëmijës, sidomos në intensifikimin e luftës për çrrënjosjen e koncepteve e të zakoneve prapanike dhe të paragjykimëve fetare, që janë akoma të përhapura veçanërisht në fshat, zakone këto që ndikojnë në lindjet pa ndihmë mjekësore dhe ato para kohe, në ushqimin dhe kujdesin e pamjaftueshëm të gruas shtatzënë dhe të fëmijës etj. Është detyrë e organizatave të Partisë, organizatës së gruas, e çdo komunisti, e mjekëve pediatër dhe e gjithë personelit mjekësor, e vetë nënës dhe e opinionit shoqëror që të merren më mirë me edukimin e nënës, të shtojnë kujdesin për të, për higjienën e pastërtinë dhe të ngrihen me forcë më të madhe e të mos lejojnë shkeljen e ligjeve dhe të të drejtave që mbrojnë shëndetin e nënës e të fëmijës.

4. — Të bashkërendohen më mirë përpjekjet e punonjësve të shëndetësisë me ato të organeve shtetërore dhe ekonomike për të marrë masat e nevojshme lidhur me pajisjen e mëtejshme, mirëmbajtjen dhe krijimin e kushteve më të përshtatshme që influencojnë në funksionimin normal të shtëpive të lindjes, konsultoreve, çerdheve, reparteve pediatrike, spitaleve dhe ambulancave në fshat e në qytet. Organizatat e Partisë dhe ato të masave të ndjekin nga afër zbatimin në kohën e duhur të këtyre masave dhe të kërkojnë deri në fund realizimin e tyre. Organet dhe organizatat e Partisë, organet e shëndetësisë dhe të pushtetit në bazë e në qendër të ndiejnë më shumë përgjegjësi në marrjen dhe zbatimin e masave profilaktike dhe kurative që çojnë në uljen e numrit të lindjeve para kohe, të fëmijëve rakitikë dhe distrofikë etj.

5. — Ministria e Shëndetësisë të tregojë një kujdes më të madh dhe të ndiejë më shumë përgjegjësi për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve. Të marrë masa dhe të krijojë një raport më të drejtë midis mjekëve pediatër që punojnë në qytet e në fshat. Duke pasur parasysh gjendjen ekzistuese të kuadrit, brenda vitit 1975 të plotësohen me mjekë pediatër të gjitha spitalet zonale. Gjithashtu, në bashkëpunim me organet e Partisë dhe të pushtetit në rrethe, në të ardhmen të bëhet një shpërndarje më e mirë e mjekëve në fshat e në qytet, duke pasur parasysh se shumica e popullsisë është në fshat.

Është e nevojshme që Ministria e Shëndetësisë dhe organet

e saj vartëse të ngrenë në nivel më të lartë punën studimore e shkencore lidhur me shkaqet e sëmundjeve dhe vdekjeve të fëmijëve, si dhe për forcimin e masave propagandistike, profilaktike dhe kurative në këtë drejtim. Të punohet më tepër për njohjen, përpunimin dhe përhapjen e eksperiencës së përparuar dhe të shembullit pozitiv të punonjësve të shëndetësisë, të konsultoreve, shtëpive të lindjes, çerdheve etj.

Përmirësimi e zgjerimi i shërbimit pediatrik ambulator dhe spitalor, në fshat dhe në qytet, të konsiderohet një nga detyrat më themelore për organet e shëndetësisë. Krijimi i urgjencës dhe i shërbimit në banesë në fushën e pediatrikës të ketë prioritet, ndërsa përgatitja, kualifikimi dhe plotësimi sa më parë i kuadrit, veçanërisht i mamive në fshat, të vihet menjëherë në rrugë të drejtë dhe të zgjidhet në perspektivë.

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH shpreh bindjen se organet dhe organizatat e Partisë, organizatat e masave, organet shtetërore e të ekonomisë dhe gjithë punonjësit e shëndetësisë, do të kuptojnë akoma më mirë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e masave që duhet të merren për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve, për realizimin e porosisë së Partisë që, «të gjithë fëmijët që lindin, duhet të jetojnë dhe të rriten të shëndoshë».

Sekretari i Komitetit Qendror të PPSH

Hysni Kapo

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI FORCIMIN E MËTEJSHËM TË PUNËS IDEOPOLITIKE TË PARTISË NË USHTRI

6 mars 1975

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH në mbledhjen e datës 6 mars 1975, pasi shqyrtoi raportin e paraqitur nga aparat i Komitetit Qendror të PPSH mbi gjendjen dhe masat që duhen marrë për të forcuar punën ideopolitike dhe ndërtimin e Partisë në ushtri,

Vendosi:

1. — Puna edukative-politike dhe ideologjike e Partisë në ushtri gjatë vitit 1975 të synojë në kuptimin e thellë ideologjik dhe zbatimin në praktikë të detyrave të mëdha e shumë të rëndësishme që shtruan Plenumi i 5-të dhe i 6-të i Komitetit Qendror të Partisë.

Për vitet e ardhshme puna edukative me ushtarët të ndërtohet mbi bazën e një programi 2-3-vjeçar, ku të përfshihet studimi i historisë së PPSH, i njohurive mbi karakterin e ushtrisë e të luftës popullore, si dhe i njohurive mbi socializmin e komunizmin. Ky program të plotësohet me probleme që lindin edhe nga jeta e puna e përditshme e Partisë.

Qëllimi kryesor e i përhershëm i gjithë punës edukative, ideopolitike të Partisë në ushtri duhet të jetë përgatitja e lartë ushtarake dhe forcimi i gjithanshëm i gatishmërisë luftarake i të gjitha forcave aktive dhe rezerviste, duke synuar t'i bëjë ato të ndërgjegjshme e të afta për detyrën e shenjtë — mbrojtjen e atdheut socialist. Gjithë puna ideopolitike dhe organizative e Partisë duhet të jetë e lidhur përherë me këtë detyrë të madhe.

2. — Mbi këtë bazë të aprovohen orientimet kryesore të Komitetit Qendror për punën edukative politike dhe ideologjike, të cilat t'u dërgohen organizatave të Partisë në ushtri.

Komitetet e Partisë në njësi e reparte (regjimente), si dhe organizatat-bazë të Partisë, duke u mbështetur në orientimet e Komitetit Qendror, të përpilojnë dhe të aprovojnë programet konkrete vjetore të punës edukative me ushtarët, komunistët e kuadrot. Në bashkëpunim me komitetet e Partisë të rretheve përkatëse të përpilojnë e të aprovojnë edhe programet e punës edukative me rezervistët e vullnetarët.

3. — Edukimi dhe kalitja e komunistëve, e kuadrove dhe e ushtarëve bëhet jo vetëm nëpërmjet punës së programuar, por edhe nëpërmjet gjithë mbledhjeve të Partisë e të rinisë, gjithë aktiviteteve politike e kulturore, lëvizjeve e aksioneve të ndryshme, vetë punës për përgatitjen ushtarake etj.

4. — Puna edukative, ideopolitike nuk duhet të kufizohet vetëm në veprimtarinë e komisarëve dhe propagandistëve të ngarkuar posaçërisht me këtë çështje. Ajo është detyrë e çdo komunisti dhe e të gjithë kuadrove, pavarësisht nga funksioni që kryejnë.

5. — Të rritet kujdesi i organizatave të Partisë për punën e organizatave të rinisë. Të insistohet sidomos në forcimin e punës edukative të tyre, si dhe në gjallërimin e jetës së organizatave të BRPSH.

6. — Për përgatitjen dhe kualifikimin e kuadrit të ushtrisë të merren këto masa:

a — Pranë Shkollës së Lartë të Partisë «V.I. Lenin» të çelet një kurs 3-mujor ku të kalojnë kuadro politikë dhe ushtarakë.

b — Në Shkollën e Lartë të rregullt 2-vjeçare të Partisë «V. I. Lenin» të kalojnë për çdo vit kuadro politikë dhe ushtarakë të ushtrisë me të cilët përveç programit të përgjithshëm të zhvillohet një cikël i veçantë temash për vijën ushtarake të Partisë. Ndërsa në kurset e larta pranë Shkollës së Partisë të dërgohen herë pas here kuadro të ushtrisë, sidomos për plotësimin e nevojave të kuadrit të lëndëve shoqërore në shkollat ushtarake.

c — Duke filluar nga shtatori i këtij viti të riçelen kurset 3-mujore të Partisë në bazë të korpuseve dhe të reparteve të një rangu me to, në të cilat të kalojnë veç kuadrove politikë efektivë edhe kuadro politikë rezervistë.

7. — Për plotësimin e organikave të kuadrit politik të ushtrisë të merren këto masa:

a — Komitetet e Partisë të reparteve ushtarake në bashkëpunim me komitetet e Partisë të rretheve të zgjedhin një numër komunistësh rezervistë nga më të mirët, të cilët, pasi të kryejnë një kurs të shkurtër, të emërohen me detyrën e komisarit politik në repartet ku mungojnë.

b — Në të njëjtën kohë komitetet e Partisë në repartet ushtarake të zgjedhin me kujdes kuadro nga radhët e komunistëve që janë efektivë, për t'i emëruar në detyrën e komisarit politik.

c — Në ato kompani e bateri ku ka ushtarë efektivë, të caktohen përsëri komisarë politikë efektivë, siç ka qenë më parë.

8. — Për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi ngarkohen aparati i Komitetit Qendror të Partisë, komitetet e Partisë të korpuseve, të grupimeve dhe të rretheve, si dhe Drejtoria e Shkollës së Lartë të Partisë «V. I. Lenin».

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

O R I E N T I M E

TË BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH PËR PUNËN POLITIKE E IDEOLOGJIKE TË PARTISË NË USHTRI

6 mars 1975

Partia i ka kushtuar kurdoherë vëmendje dhe kujdes të madh edukimit ideopolitik të komunistëve, kuadrove e ushtarëve, kalitjes së tyre revolucionare, armatosjes me botëkuptimin marksist-leninist, me mësimet dhe normat e Partisë sonë. Ajo ka luftuar që të rritë e të forcojë pa ndërprerje karakterin klasor proletar të ushtrisë, lidhjet e saj me popullin, ta edukojë atë me veti e virtyte të larta moralo-politike, për të qenë kurdoherë armë e fuqishme e diktaturës së proletariatit, besnike deri në fund e popullit dhe e Partisë, e gatshme të kryejë në çdo kohë detyrën e mbrojtjes së atdheut dhe fitoret e revolucionit tonë socialist.

Armiqtë e brendshëm e të jashtëm janë përpjekur vazhdimisht që ta dobësojnë ushtrinë dhe mbrojtjen e atdheut, kanë synuar ta shkëpusin atë nga Partia, ta shturin e ta degjenerojnë në një armë të kundërrevolucionit, ta bëjnë të paaftë për t'i rezistuar agresionit imperialisto-revizionist. Në këtë drejtim punuan edhe armiqtë e Partisë e të popullit, grupi komplotist i kryesuar nga Beqir Balluku, Petrit Dume e Hito Çako, por ata dështuan me turp në saje të vigjilencës së Partisë, të vijës së saj të drejtë marksiste-leniniste, të unitetit monolit të Partisë, popullit e ushtrisë, që si një trup i vetëm u ngritën në këmbë dhe demaskuan e shpartalluan këtë bandë tradhtarësh.

...Për të shëruar gjendjen, për të fuqizuar ushtrinë dhe gjithë mbrojtjen e vendit, për të vënë çdo gjë në vend, në bazë të vijës e normave të Partisë, Komiteti Qendror i PPSH porositi

që, në radhë të parë, të forcohet roli udhëheqës i organizatave të Partisë, të vihet në themele të shëndosha puna politike e ideologjike në ushtri, të përmirësohet ajo rrënjësisht, duke flakur tej çdo gjë të huaj, armiqtësore, borgjeze e revizioniste.

II

Gjithë puna edukative, ideopolitike e Partisë në ushtri duhet t'i shërbejë qëllimit kryesor: forcimit të gjithanshëm të gatshmërisë luftarake, përgatitjes së lartë ushtarake të të gjitha forcave të armatosura, efektive e rezerviste.

Për vitin 1975, puna edukative në ushtri të synojë në kuptimin e thellë ideologjik dhe zbatimin në praktikë të detyrave të mëdha e shumë të rëndësishme që shtruan Plenumi i 5-të e i 6-të i KQ të Partisë dhe fjalimet e shokut Enver.

Formimi e forcimi i koncepteve të drejta për Partinë e rolin e saj udhëheqës në ushtri dhe në të gjithë jetën e vendit që çdo njeri ta kuptojë mirë se është Partia ajo që udhëheq e drejton kudo, se asaj i binden e i japin llogari të gjithë, përbën çështjen kryesore në këtë drejtim. Kjo kërkon të formohen koncepte të shëndosha lidhur me nevojën dhe rrugët e revolucionarizimit të pandërprerë të organizatave të Partisë e të komunistëve, duke zbatuar me rigorozitet normat e Partisë, kundër shfaqjeve të burokratizmit, liberalizmit, zyrtarizmit, në jetën dhe veprimtarinë e tyre, duke zhvilluar kritikën dhe autokritikën kundër fshehjes së të metave, lustrimit të gjendjes dhe mashtrimit, duke forcuar disiplinën dhe përgjegjësinë e secilit për detyrat e ngarkuara, duke luftuar kundër hierarkisë ushtarake në jetën e Partisë për zbatimin e barazisë së plotë në të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Partisë.

Punës edukative në ushtri i takon gjithashtu të formojë e të forcojë koncepte të drejta për karakterin popullor e revolucionar të ushtrisë sonë në luftë me konceptet klasike për ushtrinë, që e shkëpusin atë nga populli, e mbyllin në vetvete, kundër kastave ushtarake. Ajo duhet të synojë në edukimin e komunistëve, kuadrove e ushtarëve me frymën e dashurisë për popullin, atdheun, Partinë dhe me urrejtjen për armiqtë imperialistë, social-imperialistë etj. Të insistohet në kuptimin e thellë dhe zbatimin e drejtë në praktikë të masave që ka marrë Partia për revolucionarizimin e vazhdueshëm të ushtrisë, siç janë heqja e gradave dhe e komandës unike, vendosja e komiteteve të Partisë dhe e komisarëve politikë etj. Ka rëndësi të kuptohet e të zbatohet drejt vija e masave në ushtri, të forcohen marrëdhëniet shoqërore midis oficerëve dhe ushtarëve, të përsoset sistemi i dhënies llogari të gjithë kuadrove para masës së ushtarëve, të

ushtrohet gjerësisht kontrolli punëtor-ushtar kundër fenomeneve të huaja që cenojnë lidhjet e Partisë e të kuadrove me masat, kundër arrogancës e prepotencës, arbitraritetit, kultit të drejtuesve, kundër marrjes nëpër këmbë të personalitetit të oficerit dhe ushtarit. Të forcohen e të çelikosen pa pushim lidhjet e ushtrisë me popullin.

Puna edukative e Partisë në ushtri duhet të synojë për krijimin e një kuptimi më të qartë dhe për zhvillimin e drejtë të luftës së klasave. Për këtë qëllim të insistohet në kuptimin e thellë të rrethimit imperialisto-revizionist, të rrezikut që përfaqëson ai për vendin tonë, si në fushën ushtarake ashtu dhe në atë politike, ideologjike dhe ekonomike, duke luftuar kundër çdo shfaqjeje të nënvlehtësimit të presionit të gjithanshëm që ushtron ai mbi ne, sidomos të agresionit ideologjik. Të rritet vigjilenca politike si ndaj mbeturinave të klasave të përmbysura ashtu edhe ndaj elementëve të rinj që degjenerojnë në kundërrevolucionarë, duke luftuar çdo shfaqje oportuniste, liberale e sentimentale në qëndrimin ndaj tyre. Të rrënjosen koncepte të drejta mbi luftën e klasave në gjirin e popullit e të Partisë, të zhvillohet ajo me vendosmëri e pa ndërprerje. Të forcohet lufta ideologjike ndaj mbeturinave fetare, zakoneve prapanike, koncepteve liberale, burokratike e teknokratike.

Puna ideopolitike t'i shërbejë përgatitjes dhe gatishmërisë luftarake të ushtrisë e gjithë popullit. Këtu rëndësi të dorës së parë merr kuptimi politikisht dhe ushtarakisht i artit ushtarak mbi luftën popullore. Në mënyrë të veçantë puna e gjithanshme edukative e Partisë në ushtri duhet të ndihmojë për kuptimin e thellë të nevojës së forcimit dhe vendosjes së një disipline të ndërgjegjshme dhe të hekurt ushtarake, e cila përbën kushtin themelor për ekzistencën e një ushtrie të fortë popullore, revolucionare dhe për kryerjen në çdo kohë e mirë të detyrës së shenjtë të mbrojtjes së atdheut.

2. — **Byroja Politike orienton që për vitet e ardhshme puna ideopolitike me ushtarët të ndërtohet mbi bazën e një programi 2-3-vjeçar dhe sipas vjetërsisë që kanë në shërbimin ushtarak.** Në këtë program të përfshihen: studimi i Historisë së PPSH, njohuri mbi karakterin e ushtrisë, të mbrojtjes e luftës popullore, si dhe disa njohuri mbi socializmin e komunizmin, të cilat do të zënë një pjesë të kohës të caktuar për punën edukative të programuar. Pjesa tjetër do të plotësohet me problemet që do të lindin nga vendimet e direktivat e Komitetit Qendror të PPSH, nga puna dhe jeta e reparteve ushtarake.

Përgatitja marksiste-leniniste e komunistëve dhe e kuadrove të ushtrisë të ndjekë ato synime që ka e gjithë puna edukative e Partisë edhe në terren, duke përfshirë dhe disa probleme specifike që ka ushtria.

Për edukimin e forcave rezerviste, të vullnetarëve të vetëmbrojtjes popullore dhe nxënësve e studentëve, bazë duhet të jetë puna që zhvillojnë organizatat e Partisë e të masave në terren, ku problemet e mbrojtjes duhet të zënë një vend më të madh. Ndërkohë gjatë periudhës së stërvitjes ushtarake me rezervistët, me forcat vullnetare të vetëmbrojtjes popullore, si dhe me nxënësit e studentët duhet të zhvillohet një punë ideopolitike e veçantë edukative mbi bazën e një programi të ndërtuar në bashkëpunim me shokët e komiteteve të Partisë të rretheve.

3. — Si bazë për realizimin e tërë punës edukative, ideopolitike në ushtri të shërbejnë veprat e klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe veçanërisht dokumentet e Partisë e Veprat e shokut Enver, ku përgjithësohet nga pozita marksiste-leniniste eksperiencia më se 30-vjeçare e Partisë sonë.

Studimi dhe përvetësimi i marksizëm-leninizmit në lidhje të ngushtë me përvojën revolucionare të Partisë sonë i ndihmon komunistët, kuadrot e ushtarët, organizatat e komitetet e Partisë për të kuptuar drejt e thellë direktivat që shtron aktualisht Partia, politikën që ajo ndjek, i ndihmon për t'u orientuar në situata të ndërlikuara, në zgjidhjen e problemeve që dalin, si dhe në zbulimin e tendencave të zhvillimit të ardhshëm. Ajo i ndihmon të ndjekin një kurs të drejtë, të dallojnë ç'është e mirë e ç'është e keqe, ç'është marksiste, revolucionare dhe ç'është e huaj, revizioniste e borgjeze. Studimi i përvojës së Partisë sonë është i domosdoshëm për t'i bërë ballë me sukses presionit të brendshëm borgjez e mikroborgjez, si dhe agresionit ideologjik imperialisto-revizionist nga jashtë.

III

Edukimi i komunistëve, i kuadrove dhe i ushtarëve nuk mund të realizohet vetëm në procesin e punës së programuar. Ky është një koncept i ngushtë që duhet flakur tej si i gabuar dhe i dëmshëm.

Edukimit e kalitjes revolucionare të komunistëve, kuadrove e ushtarëve duhet t'i shërbejnë mbledhjet e organizatave të Partisë e të rinisë, puna masive politiko-kulturore, diskutimet, ballafaqimet e kritikimet me fletërrufe, mbledhjet e efektivit, aksionet e ndryshme, puna me shtypin, radion, televizionin, aktivitetet e ndryshme për njohjen e traditave patriotike revolucionare të popullit, të transformimeve që janë bërë në vendin tonë, tërë puna për përgatitjen ushtarake të ushtarëve e oficerëve, për forcimin e disziplinës, respektimin e rregulloreve ushtarake, jeta kolektive e organizuar e repartit etj.

Gjithë koha që përdoret për punën kulturore-politike, të

gjitha format e mjetet me të cilat realizohet ajo, që nga agjitacioni i vogël gojor, ai figurativ, informacioni politik, kultura masive etj., duhet të shërbejnë për të zërthyer e shpjeguar direktivat dhe problemet kryesore që shtron Partia përpara ushtrisë dhe ato që i dalin repartit, problemet e jetës së vendit, të rrethit, ngjarjet ndërkombëtare etj.

Është e palejueshme që koha e caktuar për punën politike e kulturore masive të përdoret për qëllime të tjera... Ajo të përdoret mirë për të organizuar aktivitete edukative, politike dhe ideologjike që t'i shërbejnë efektivisht stërvitjes ushtarake.

Në edukimin e ushtarëve dhe të oficerëve të rinj, një rol të madh luan organizata e BRPSH... Organizata e rinisë është ndihmësja më aktive e Partisë në punën për edukimin e rinisë në ushtri me dashurinë për atdheun socialist, me frymën revolucionare të Partisë, me një qëndrim komunist ndaj detyrës ushtarake e ndaj pronës shtetërore, me një disiplinë të fortë në zbatimin e rregulloreve, me shpirtin e sakrificës dhe të vetëmohimit, me norma dhe sjellje të moralit tonë proletar, me një qëndrim të papajtueshëm ndaj çdo shfaqjeje të ideologjive të huaja, konservatore e liberale, borgjeze e revizioniste. T'u kushtohet kujdes forcimit e gjallërimit të jetës së brendshme të organizatave të rinisë, zhvillimit gjerësisht të iniciativës së anëtarëve, kritikës e autokritikës dhe luftës së guximshme kundër frymës së komandimit e shfaqjeve të pasivitetit.

IV

Forcimi dhe revolucionarizimi i punës ideopolitike varen shumë nga përmirësimi i drejtimit të kësaj pune nga ana e organizatave dhe e komiteteve të Partisë në ushtri. Duhet të kuptohet thellë se janë organizatat dhe komitetet e Partisë ato që përgjigjen për edukimin e komunistëve, kuadrove e ushtarëve, se janë ato që duhet t'i japin tonin gjithë veprimtarisë ideopolitike në ushtri.

1) Atyre u takon të merren më mirë me përmbajtjen e punës ideopolitike që zhvillohet në të gjitha format, me forcimin e gjendjes moralo-politike të efektivit, të njohin e të analizojnë problemet që shqetësojnë repartin dhe që dalin nga veprimtaria politike ushtarake e Partisë dhe e komandave, të shqyrtojnë herë pas here rezultatet e punës edukative, difektet e të metat që vihen re dhe të marrin masa për përmirësimin e vazhdueshëm të saj. Komitetet dhe organizatat e Partisë t'i kushtojnë vëmendje të posaçme punës për edukimin dhe aftësimin e propagandistëve.

2) Me punën edukative, politike dhe ideologjike duhet të

merren të gjithë komunistët dhe kuadrot, komisarët dhe komandantët, punëtorët e aparateve politike dhe të shtabeve. Të udhëhiqemi nga mësimi i shokut Enver se pa qenë komisar i mirë, nuk mund të jesh as komandant i mirë, dhe pa qenë komandant i mirë, nuk mund të jesh gjithashtu komisar i mirë.

3) Të tregohet kujdes për përsosjen e mëtejshme të metodave të punës ideopolitike. Në bazë të të gjithë punës edukative të komunistëve dhe kuadrove të vihet studimi individual. Duhet hedhur poshtë koncepti i gabuar se studimi individual bëhet vetëm në orët e caktuara. Komunistët dhe kuadrot të gjejnë çdo ditë kohë për të studiuar. Duke i dhënë rëndësi studimit individual të materialeve të Partisë e të shokut Enver dhe diskutimit kolektiv, të mos injorohet e neglizhohet roli i leksioneve e referateve për sqarimin e zërthimitin e përmbajtjes së problemeve që shtrohen. Sidomos me ushtarët këto janë të domosdoshme.

Rëndësi e veçantë i duhet kushtuar debatit ideologjik duke krijuar një atmosferë të ngrohtë shoqërore ku njerëzit të shfaqin lirisht mendimet e tyre dhe të zhvillojnë diskutime të gjalla mbi problemet që shtrohen, të ballafaqojnë veten, shokun dhe gjendjen e repartit me mësimet dhe kërkesat që shtron Partia. Por në të tëra këto forma të luftohet zyrtarizmi e shkollarizmi.

* * *

Komiteti Qendror i Partisë ka besim se organizatat e Partisë në ushtri do të mobilizohen me të gjitha forcat për të kapërcyer me sukses pasojat e veprimtarisë armiqësore të Beqir Ballukut, Petrit Dumes e Hito Çakos, se do të marrin të gjitha masat për ta vënë në themele të shëndosha punën politike dhe ideologjike në ushtri, për ta përmirësuar atë rrënjësisht e për ta forcur vazhdimisht, me qëllim që ushtria jonë të mbetet kurdoherë besnike e idealeve të larta të Partisë e të popullit, gjithnjë e gatshme për mbrojtjen e atdheut tonë socialist.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PROTOKOLL

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI DISA PROBLEME TË OBORRIT NË KOOPERATIVAT BUJQËSORE

24 prill 1975

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 24 prill 1975, pasi shqyrtoi dhe diskutoi studimin e paraqitur nga Ministria e Bujqësisë «Mbi disa probleme të oborrit në kooperativat bujqësore»,

Porosit:

1) Organet dhe organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe ekonomike të bëjnë një punë më të gjerë ideopolitike për një kuptim më të thellë dhe më të plotë mbi thelbin dhe karakterin e oborrit si ndihmës në plotësimin e nevojave të familjeve kooperativiste. Ato duhet t'ua shpjegojnë dhe t'ua bëjnë akoma më të qartë kooperativistëve se ndryshimet që do t'i bëhen në të ardhmen oborrit kooperativist, me dëshirën dhe me vullnetin e kooperativistëve, do të lidhen me krijimin e kushteve të nevojshme në radhë të parë me shkallën e zhvillimit dhe të pjekurisë së pronës kooperativiste, me ritmet e shtimit të prodhimit të madh socialist. Prandaj nuk duhet të lejohen veprime që çojnë në zgjidhjen e problemeve të oborrit me rrugë dhe masa administrative. Unifikimi i oborreve kur janë në madhësi të ndryshme brenda një kooperative, të bëhet dora-dorës kur të pihen kushtet dhe kur të forcohen ekonomikisht të gjithë anëtarët e kooperativës.

Po kështu nuk duhet të lejohet shtimi i sipërfaqes së oborrit kooperativist si pasojë e ndarjes së familjeve kooperativiste.

Në rastet kur ekzistojnë mundësitë, siç parashikohet dhe në Statut, anëtarët e kooperativave mund të hapin vetë tokë të re për të plotësuar sipërfaqen e oborrit deri 300 metra katrorë. Nga kjo del edhe detyra që ato familje që kanë ose do të kenë më pak tokë sesa parashikon Statuti, kooperativat duhet t'i furnizojnë më me përparësi se të tjerat me produkte bujqësore e blegtorale dhe me ushqime për mbajtjen e bagëtive personale.

2) Duke marrë parasysh karakterin e dyfishtë të oborrit, si ndihmës për ekonominë kooperativiste, por edhe si shtrat i ngrohtë që mban gjallë e kultivon psikologjinë e pronës private, komitetet e Partisë të rretheve, byrotë dhe organizatat e Partisë në kooperativat bujqësore dhe organet e pushtetit në qendër e në bazë, të përmirësojnë punën ideopolitike dhe organizative me masën e kooperativistëve për t'i bindur ata plotësisht që të derdhin tërë punën dhe djersën e tyre në radhë të parë në kooperativë dhe, po të arrihet kjo plotësisht, atëherë me siguri do të kenë përfitime më shumë, do të realizojnë të ardhura më të mëdha dhe do të përmirësojnë më mirë nivelin e jetesës.

3) Mbjellja e sipërfaqes së tokës që disponon oborri kooperativist me perime, foragjere, drithëra etj., u përgjigjet orientimeve të Partisë, por oborri duhet të prodhojë për të plotësuar nevojat e familjes kooperativiste dhe jo për treg.

Krahas me këtë të luftohen mentaliteti dhe praktika e vjetër e mjaft fshatarëve që mbajnë sa më shumë krerë bagëtish, gjë që ka shpënë në rritjen e dukshme të numrit të tyre në oborret kooperativiste. Si në prodhimin shtetëror e kooperativist, ashtu edhe në atë të oborrit, synimi të jetë shtimi i prodhimit të mishit, të qumshtit, të vezëve e të leshit për njësinë e sipërfaqes së tokës, duke mbajtur bagëti me prodhimtari të lartë, dhe jo shtimi i numrit të krerëve për krerë. Nën këtë prizëm të punohet edhe për respektimin e normave të Statutit dhe për mënjanimin e shkeljeve nga kooperativistë të veçantë që mbajnë bagëti mbi ato që lejon Statuti.

4) Të merren të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e plotë të detyrave të Deklaratës së 29 prillit 1967 të Komitetit Qendror të PPSH e të Këshillit të Ministrave të RPSH mbi furnizimin e anëtarëve nga kooperativat bujqësore me produkte bujqësore e blegtorale dhe me ushqime për mbajtjen e bagëtisë¹. Rritja e mirëqenies materiale e kulturore të fshatarësisë kooperativiste dhe problemet e oborrit që lidhen me të, të mos shkelputen nga vetë mënyra e shpërndarjes dhe e përdorimit të produkteve bujqësore e blegtorale midis fshatit dhe qytetit. Është e nevojshme që t'i kushtohet rëndësi e veçantë dhe vëmendje më e madhe shpërndarjes së drejtë të këtyre prodhimeve, duke e

¹ Shih: «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. V, f. 258.

konsideruar këtë, ashtu siç është, një nga problemet e rëndësishme të politikës ekonomike të Partisë.

a) Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Industrisë së Lehtë e Ushqimore dhe Ministria e Tregtisë, si dhe organet shtetërore dhe ekonomike në rrethe e në bazë të përmirësojnë rënjësisht punën për planifikimin e prodhimit dhe të shpërndarjes së produkteve bujqësore e blegtorale në kooperativat bujqësore. Në hartimin e planit të shpërndarjes së produkteve bujqësore e blegtorale që prodhojnë kooperativat bujqësore, ato të mbajnë mirë parasysh dhe të llogaritin drejt njëkohësisht si nevojat e qytetit ashtu edhe ato të fshatit. Sasia e këtyre produkteve në përdorimin për frymë në qytet e në fshat, duke llogaritur për fshatin edhe atë sasi që sigurohet nga oborri, duhet të vijë duke u barazuar.

b) Po kështu organet shtetërore dhe ekonomike në të gjitha nivelet duhet të ndjekin, të përgjigjen e të japin llogari, të lavdërohen ose të kritikohen për plotësimin e planit të prodhimit të produkteve bujqësore e blegtorale në tërësi, për plotësimin e planit të grumbullimeve dhe për plotësimin e planit të përdorimit për nevojat vetjake të kooperativistëve.

Duke filluar nga ky vit, grumbullimet e produkteve bujqësore e blegtorale nga organet shtetërore të ndiqen e të realizohen kurdoherë në përpjesëtim me realizimin e planit të prodhimit të tyre, duke mbajtur mirë parasysh si pjesën e produkteve që do t'u lihet kooperativave për plotësimin e nevojave të anëtarëve (zahire, perime, fasule, patate, qumësht, mish etj.), ashtu edhe pjesën që do të grumbullohet nga shteti për plotësimin e nevojave të qytetarëve. Të konsiderohet e dëmshme dhe e palejueshme praktika e ndjekur deri tani nga mjaft organe të Partisë, shtetërore e të ekonomisë që kanë kërkuar e kanë zbatuar në mënyrë të njëanshme plotësimin e planit të grumbullimeve, pa i përfillur nevojat e anëtarëve të kooperativave dhe shpeshherë duke pakësuar në minimum furnizimin e tyre.

c) Kooperativat bujqësore në bilancin e ushqimeve për blegtorinë, të parashikojnë më shumë se gjer më sot ushqime për bagëtinë e oborreve kooperativiste. Furnizimi i anëtarëve me ushqim për bagëtinë, si rregull, të bëhet sipas planit të aprovuar nga asambleja, dhe, në çdo rast, ai të jetë në përpjesëtim të drejtë me realizimin e planit të prodhimit të foragjereve nga kooperativa.

ç) Komitetet e Partisë të rretheve dhe organizatat e Partisë në organet e grumbullimit dhe në kooperativat bujqësore të kontrollojnë zbatimin e drejtë e të përpiktë të këtyre orientimeve. Sasia e produkteve bujqësore e blegtorale që prodhojnë oborret kooperativiste për nevojat vetjake, si dhe trajtimi i njëanshëm i nevojave që ka qyteti për këto produkte, nuk duhet të lejohen

që të merren si pretekste për t'i lënë fshatit kontingjente më të vogla për përdorim vetjak.

5) Shtimi i prodhimit të madh kooperativist përbën bazën vendimtare për rritjen e mirëqenies materiale e kulturore të fshatarësisë kooperativiste, rrugën kryesore për rritjen e të ardhurave e të fuqisë blerëse të saj dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të furnizimit të qytetit e të fshatit me produkte bujqësore e blegtorale.

Organet dhe organizatat e Partisë, organet e pushtetit dhe veçanërisht ato të bujqësisë, të zhvillojnë një punë më të dendur dhe më të organizuar që ky problem themelor të kuptohet thellë nga masat kooperativiste dhe t'i mobilizojnë e t'i drejtojnë ato që të arrihen, brenda një kohe sa më të shkurtër, rezultate konkrete sa më të mëdha.

Sekretari i Komitetit Qendror të PPSH

Hysni Kapo

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PLENUMI I 7-TË I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 26-29 maj 1975

K O M U N I K A T Ë

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Prej datës 26-29 maj 1975, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi i 7-të i Komitetit Qendror të PPSH, i cili diskutoi rreth raportit të Byrosë Politike mbi masat për forcimin e mëtejshëm ekonomik të vendit, mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike e sekretar i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Haki Toska dhe mori vendimet përkatëse.

Në përfundim të punimeve të Plenumit, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, mbajti një fjalim të rëndësishëm.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

V E N D I M

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI DISA MASA PËR LUFTËN KUNDËR BUROKRATIZMIT, VEÇANËRISHT PËR THJESHTIMIN E ORGANIKAVE

27 qershor 1975

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH në mbledhjen e datës 27 qershor 1975, pasi mori në shqyrtim raportin e Këshillit të Ministrave «Mbi rezultatet në luftën kundër burokratizmit veçanërisht për thjeshtimin e organikave të aparateve shtetërore dhe ekonomike», vërejtë se gjatë këtij viti, nën udhëheqjen e organizatave dhe organeve të Partisë, është bërë një punë e gjerë edukative, politike dhe ideologjike në Parti, në organet e pushtetit, në administratat, në ndërmarrjet ekonomike, në kooperativat bujqësore, në arsim e kulturë, në ushtri e kudo e shoqëruar kjo me disa masa organizative për përmirësimin e metodës e të stilit revolucionar në punë dhe për shkurtimin e për thjeshtimin e aparateve administrative dhe ekonomike.

Byroja Politike miratoi në parim raportin dhe masat e parashikuara nga Këshilli i Ministrave dhe

V e n d o s i :

1) Organet dhe organizatat e Partisë, organizatat e masave dhe organet shtetërore e ekonomike problemin e luftës kundër burokratizmit të mos e konsiderojnë të përfunduar, të mos e konceptojnë ngushtë vetëm me punën e zhvilluar deri tani dhe me disa rezultate në shkurtimin e organikave të aparateve administrative.

Është e nevojshme të bëhet një punë e pandërprerë edukative, e organizuar dhe sistematike për kuptimin e përmbajtjes politike dhe ideologjike të të gjitha problemeve dhe aspekteve

që lidhen me luftën kundër burokratizmit, me shfaqjet e tij, me intelektualizmin, teknokratizmin etj. Komitetet dhe organizatat e Partisë të shpjegojnë thellë rrezikun real që u kanoset diktaturës së proletariatit dhe socializmit në vendin tonë nga burokratizmi dhe të kujdesen që ky t'u ngulitet thellë në mendje dhe në ndërgjegje njerëzve, çdo komunisti, punonjësi e kuadri. Të kuptohet dhe të realizohet mirë në praktikë se lufta kundër burokratizmit është luftë klasash që do të vazhdojë derisa të ekzistojnë klasat, derisa të ekzistojë shteti. Prandaj kjo luftë duhet të vijë duke u intensifikuar dhe duke u thelluar në të gjitha aspektet, veçanërisht në kuptimin dhe vendosjen e raporteve të drejta midis organeve të zgjedhura, pushtetit shtetëror, nga njëra anë, dhe aparateve, administratës shtetërore në shërbim të këtyre organeve, nga ana tjetër; në organizimin dhe forcimin e kontrollit punëtor e të masave dhe të kontrollit të Partisë e të shtetit; në përsosjen e metodës e të stilit revolucionar në punë. Duke rritur vazhdimisht rolin e organeve të zgjedhura, organizatat e Partisë në të gjitha hallkat të luftojnë dhe të mos lejojnë fryrjen e aparateve, t'i mbajnë ato të lehta, të manovrueshme, të shkathta, të pastra, kurdoherë në shërbim të klasës e të masave, zbatuese dhe jo urdhëruese e sunduese mbi klasën e mbi masat.

2) T'i rekomandojë Këshillit të Ministrave që brenda vitit 1975 të studiojë dhe të marrë masat e nevojshme për thjeshtimin dhe për shkurtimin e mëtejshëm të aparateve administrative, sidomos në këto drejtime:

a) Në përmirësimin dhe në thjeshtimin e strukturave organizative të ndërmarrjeve ekonomike dhe të kooperativave bujqësore për të pakësuar më tej numrin e reparteve, sektorëve, fabrikave, kantierëve, hozrashoteve, të degëve pranë administratave etj., në mënyrë që drejtoritë e ndërmarrjeve dhe kryesitë e kooperativave të jenë sa më afër punëtorëve e kooperativistëve dhe prodhimit. Në këtë çështje të mbahet parasysh që të mos dobësohen sektorët e planit e të financës në kooperativat bujqësore.

b) Institucionet kërkimore e shkencore të shndërrohen në bërthama të vogla të drejtimit dhe të organizimit të punës shkencore, të cilat në tërë veprimtarinë e tyre të mbështeten në radhë të parë në aktivistë të jashtëm, kryesisht nga ata që punojnë drejtpërdrejt në prodhim ose qendra pune, duke hequr dorë nga organikat e fryra me një numër të madh kuadrosh e specialistësh.

3) Në hartimin e planit të vitit 1976 dhe të krejt pesëvjeçarit 1976-1980 organet shtetërore të studiojnë më thellë dhe të arrijnë të vendosin raporte sa më të drejta midis punëtorëve e nëpunësve, midis punëtorëve të prodhimit dhe atyre të shër-

bimit në tërësi, midis punëtorëve kryesorë e ndihmës brenda ndërmarrjeve dhe institucioneve.

4) Komitetet e Partisë, dikasteret, institucionet qendrore dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve të marrin të gjitha masat për të sistemuar në punë sa më parë kuadrot dhe nëpunësit që shkurtohen nga organikat, duke i vendosur në radhë të parë sa më afër prodhimit dhe në prodhim.

Organet dhe organizatat e Partisë të mënjanojnë konfuzionin, pritsshmërinë, paqartësinë ose hutimin që mund të shkaktohet nga kuptimi i pamjaftueshëm dhe nga zbatimi jo si duhet i direktivave të Partisë për shkurtimin e organikave, për qarkullimin e kuadrove dhe zëvendësimin e tyre me punëtorë, ose nga presioni i ideologjisë borgjezo-revizioniste. Të merren masa të gjithanshme edukuese dhe organizative në mënyrë që kuadrot të realizojnë në praktikë porosinë e Partisë për të punuar kudo ku ka nevojë atdheu, sidomos në fshat, në miniera, në qendra pune jashtë qyteteve, në frontet kryesore të punës e të prodhimit.

Në zgjidhjen e kësaj çështjeje të mbahet parasysh edhe fakti që jo vetëm dhe kurdoherë gruaja të shkojë pas burrit, por edhe anasjelltas, burri të shkojë pas gruas kur kjo ka përgjegjësi më të madhe ose është me arsim të lartë dhe shihet e nevojshme të lëvizë.

5) Të ngarkohet një komision i posaçëm i Komitetit Qendror të Partisë dhe i Këshillit të Ministrave që, brenda këtij viti, të studiojë dhe t'i paraqesë Byrosë Politike një raport mbi zhvillimin perspektiv të arsimit të mesëm të përgjithshëm e profesional dhe të arsimit të lartë, me qëllim që të përputhet më mirë përgatitja e kuadrove me nevojat e zhvillimit të ekonomisë e të kulturës për degë dhe specialitete të veçanta.

6) Lëvizja e popullsisë nga një qendër banimi në një tjetër dhe në veçanti ajo e fuqisë punëtore të trajtohet si një problem i madh me rëndësi politike, ideologjike, shoqërore dhe strategjike nga organet dhe organizatat e Partisë, nga organet shtetërore dhe organizatat e masave.

Të kufizohet tërheqja e fuqisë punëtore nga fshati për nevojat e qendrave të punës, të minierave, të sharrave, të veprave të ndërtimit etj. Nga ana tjetër, të organizohen dhe të drejtohen sa më mirë iniciativat për t'i kthyer në një lëvizje të madhe e të vazhdueshme për zhvillimin dhe për thellimin e zhvendosjes së popullsisë: nga qyteti i Tiranës për në Kombinatin Metalurgjik e nga Kombinati Metalurgjik në fshat, nga qytetet për në qendrat e punës e të prodhimit jashtë qyteteve e nga këto në kooperativat bujqësore. Socializmi u siguron punë të gjithëve, por njerëzit duhet të venë të punojnë ku është puna, ku është prodhimi, ku hapen frontet e prodhimit. Për këtë qëllim duhet zhvilluar kurdoherë një punë e dendur bindëse edukative me

punonjësit e kombinuar me masa organizative për të qenë të gatshëm dhe për të shkuar atje ku e kërkojnë interesat e atdheut. Anëtarët e Partisë dhe ata të BRPSH duhet të japin shembullin duke shkuar jashtë qyteteve atje ku puna është më e vështirë, jo për një ose dy vjet, por përgjithmonë.

Sekretari i Komitetit Qendror të PPSH

Hysni Kapo

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PROTOKOLL

I SEKRETARIATIT TË KQ TË PPSH MBI NGRITJEN E MËTEJSHME TË NIVELIT IDEOPOLITIK TË GAZETAVE LOKALE DHE DREJTIMIN E TYRE NGA KOMITETET E PARTISË TË RRETHEVE

26 shtator 1975

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e tij të datës 26 shtator 1975, shqyrtoi raportet e paraqitura nga komitetet e Partisë të rretheve të Dibrës, të Elbasanit e të Lushnjës «Mbi ngritjen e mëtejshme të nivelit ideopolitik të gazetave lokale dhe drejtimin e tyre nga komitetet e Partisë» dhe vërejtji se shtypi lokal, si pjesë përbërëse e shtypit tonë kombëtar, nën udhëheqjen e Partisë, ka krijuar tanimë fizionominë e vet, ai lexohet e shfrytëzohet nga një rreth i gjerë punonjësish të qytetit e të fshatit dhe luan një rol të rëndësishëm në edukimin e masave me ideologjinë e Partisë dhe me mësimet e shokut Enver. Gazetat lokale kanë sjellë freski e gjallëri në shtypin tonë popullor dhe janë bërë ndihmëse aktive të Partisë për mobilizimin e masave e të kuadrove në luftën për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut. Komitetet e Partisë kanë filluar të komunikojnë më mirë me masat punonjëse dhe të drejtojnë edhe përmes gazetave, si organe të tyre. Por që puna në redaksitë e organeve të komiteteve të Partisë në rrethe të organizohet më mirë, që ato të bëhen më luftarake në përmbajtje, më interesante në interpretime e në formë, që të luajnë më mirë rolin e agjitorit, të propagandistit e të organizatorit kolektiv, për zbrëthimin e vijës së Partisë, Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH porosit:

1. — Komitetet e Partisë dhe, nën drejtimin e tyre, redaksitë e gazetave ta përqendrojnë vëmendjen më shumë në punën për ngritjen e nivelit ideologjik e politik të shkrimeve duke u mbështetur në baza teoriko-politike e organizative, të bëjnë përgjithësime e zbrëthime të argumentuara të direktivave të

Komitetit Qendror dhe përgjithësime të praktikës revolucionare të masave punonjëse, duke u bazuar në kushtet e në karakteristikat e rrethit. Ato duhet ta shikojnë si një çështje kryesore planifikimin shkencor të çdo numri të gazetës dhe të luftojnë prirjet për të botuar ç'tu dalë përpara. Kjo do të bëjë të shmanget spontaneiteti që duket nëpër shkrimet dhe karakteri thjesht informativ i tyre, të ketë analizë të shkaqeve, të sukseseve a të të metave, duke treguar edhe rrugët. Kjo do të eliminojë gjithashtu trajtimin me fraza të përgjithshme boshe, paradat dhe lustrimin e gjërave. Masat kanë nevojë që në shtypin lokal të gjejnë më tepër ide, mendime, konkluzione ideopolitike, më tepër ndjenjë e pasion.

2. — Komitetet e Partisë, duhet t'i kushtojnë më tepër vëmendje tematikës së gazetave të tyre e të trajtojnë tema të tilla siç janë zhvillimi i drejtë i luftës së klasave, parimi i mbështetjes në forcat e veta, mbajtja parasysh e rrethimit imperialisto-revizionist, vija e masave, kontrolli punëtor, vënia e politikës në plan të parë, forcimi i kritikës e i autokritikës, dhënia llogari e kuadrove para masës, metoda e aksionit masiv me goditje të përqendruar, ruajtja e raporteve të drejta në pasqyrimin e sektorëve të ndryshëm, emulacioni socialist, ndjekja e zotimeve dhe e detyrave të planit, përhapja e eksperiencës së përparuar në prodhim dhe në gjithë sektorët e jetës. Ngushtësia aktuale e problematikës duhet kapërcyer. Problemet shoqërore, ato të luftërave për liri, tokë e drejtësi, të historisë së lavdishme të çdo rrethi, të kulturës, të muzikës e të arteve duhet të gjejnë pasqyrimin e tyre në kolonat e gazetave të rretheve. Kjo do të rritë vlerën edukuese, frymëzuese e propagandistike të gazetave, do t'i bëjë ato më të afërta, më tërheqëse për lexuesit. Për këtë është e nevojshme që redaksitë të krijojnë rrethin e bashkëpunëtorëve për trajtimin e këtyre temave me dinjitet e aftësi. Dhe këta sot nuk janë të paktë.

Puna me bashkëpunëtorët e me korrespondentët vullnetarë dhe me letrat nga populli, si nga komitetet e Partisë ashtu edhe nga redaksitë, duhet të organizohet më mirë. Gazetat lokale, si organe të komiteteve të Partisë në rrethe, duke pasur kuadër të kufizuar në numër, janë ndërtuar e janë orientuar në mënyrë që punën e tyre ta mbështetin fuqimisht në korrespondentët punëtorë e fshatarë dhe në bashkëpunëtorët e ndryshëm. Prandaj redaksitë, me punën e tyre, duhet të tërheqin e të aktivizojnë një rreth të gjerë bashkëpunëtorësh nga sektorët e ndryshëm, por duke u kujdesur për pastërtinë e figurës morale e politike të atij që shkruan.

3. — Shtypi lokal në rrethe është ndihmës i gjithë shtypit e i institucioneve të tjera të propagandës së Partisë. Si i tillë, ai edhe duhet ndihmuar më shumë e më mirë. Kjo është ndih-

më reciproke. Organet qendrore të shtypit si dhe radio Tirana mund të botojnë e të transmetojnë më tepër nga shkrimet e shtypit lokal. Kësisoj duhet të veprojnë edhe gazetatat lokale, duke botuar artikuj nga shtypi qendror, e sidomos nga njëra-tjetra. Organet qendrore duhet t'i ndihmojnë më mirë gazetatat e rretheve, duke bërë këmbime redaktorësh për periudha të caktuara. Shkrimtarët dhe gazetarët e qendrës, gjithashtu, duhet ta ndiejnë për detyrë të shkruajnë në shtypin e Partisë në rrethe. ATSH-ja duhet të përgatitë për gazetatat e rretheve rubrikë me disa lajme të jashtme me specifikë të veçantë për zonat kufitare.

4. — Kritika në shtypin lokal duhet të forcohet e të konkretizohet akoma më tepër, të jetë gjithnjë parimore, pa fyerje personale, pa të shara e irritime, pa prekur dinjitetin e personit. Forca e kritikës qëndron në trajtimin ideopolitik të problemit, në argumentimin e tij. Komitetet e Partisë duhet ta inkurajojnë frymën e kritikës e të autokritikës në gazetë, të luftojnë konceptet e huaja mikroborgjeze sipas të cilave kritika «i nxin punët», «emrin e mirë të rrethit» dhe prek «autoritetin» e kuadrit. Ato të japin vetë shembuj të mirë të autokritikës e të kritikës në shtypin lokal, të interesohen që kolektivat punonjës të përgjigjen për kritikën që boton gazeta duke treguar masat për përmirësimin e gjendjes. Gjithashtu, është në të mirën e punës të ketë kritika me përgjegjësi në shkallë rrethi për problemet më të rëndësishme, duke mënjanuar botimin e kritikave për cikërrima. Gazetat lokale e kanë këtë mundësi, por e kanë edhe detyrë për faktin se shtypi qendror, për arsye të njohura, nuk i trajton dot në hollësi këto fenomene. Aq më tepër gazetatat lokale duhet t'i pasqyrojnë më gjerë e më mirë punën dhe jetën e gjithë rrethit, duke praktikuar gjini e mjete të tilla gazetareske që komunikojnë më thjesht, më ngrohtë e në mënyrë më intime me lexuesit. Po kështu, një punë më e organizuar duhet të bëhet nëpërmjet rubrikave.

5. — Komitetet e Partisë t'i kushtojnë më tepër vëmendje punës për një drejtim nga afër, konkret e operativ të gazetave. Ato duhet të ndiejnë si nevojë organike drejtimin e komunikimit me masat nëpërmjet shtypit, jo vetëm duke dhënë orientime të përgjithshme, por duke bërë herë pas here zberthimin ideopolitik të vendimeve e të direktivave më të rëndësishme të Partisë dhe duke nxjerrë detyra konkrete.

Ka ende një kuptim të ngushtë lidhur me zbatimin në praktikë të parimit të udhëheqjes së gazetës nga komiteti i Partisë. Vartësia e gazetës nga sekretari i propagandës, lidhja më e ngushtë me sektorin e edukimit, nuk duhet t'i mënjanojë, siç ndodh në shumicën e rasteve, sekretarët e tjerë, pjesën tjetër të aparatit të Partisë, nga përgjegjësia për gazetën, nga

ndihma e kontrolli i tyre për t'i kapur e për t'i pasqyruar në kohë e drejt problemet. Gazeta është organ i komitetit të Partisë. Kjo të mbahet mirë parasysh, me gjithë përgjegjësitë e detyrat që rrjedhin nga ky parim.

Herë pas here vërehen raste reagimi me vonesë nga shtypi lokal ndaj direktivave e fushatave që fillon «Zëri i popullit». Kjo nxjerr nevojën që shtypi i Partisë në rrethe të orientohet më mirë në punën e tij nga organi i KQ të Partisë për sa u takon tematikës së problemeve kryesore, direktivave e parullave të ditës, lëvizjeve e iniciativave revolucionare, natyrisht, duke i trajtuar ato në përshtatje me kushtet e rrethit dhe, në frymën e tyre, të bëhet edhe iniciator lëvizjesh revolucionare.

6. — Zgjidhja e disa vështirësive teknike do të ndihmojë gjithashtu në përmirësimin e mëtejshëm të gazetave lokale... Me vënien në shfrytëzim të Kombinativit Poligrafik, Drejtoria e Përgjithshme e Shtypshkronjave ta përmirësojë e ta plotësojë bazën tipografike të shtypshkronjave lokale. Me t'u krijuar baza e nevojshme tipografike, gazetave e rretheve të Lushnjës, Sarandës, Skraparit e Krujës të fillojnë të dalin dy herë në javë.

Spektori i shtypit pranë Komitetit Qendror ta ndihmojë më nga afër shtypin lokal për sa u takon orientimeve e kualifikimit ideoprosesional të kuadrit gazetar, përmes seminareve e analizave të veçanta, dërgimit për ndihmë të gazetarëve me eksperiencë, qarkullimit të gazetarëve të qendrës në rrethe e anasjelltas. Më mirë dhe më sistematikisht duhet të aktivizohen për këtë organizata e Bashkimit të Gazetarëve dhe revista «Tribuna e gazetarit».

Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë shpreh bindjen se komitetet e Partisë dhe redaksitë e gazetave të tyre do ta përmirësojnë më tej punën me shtypin lokal, do t'i bëjnë gazetave lokale tribuna të mendimit revolucionar të masave, do t'i shndërrojnë ato akoma më mirë në organe luftarake të Partisë për ndërtimin e socializmit e për mbrojtjen e atdheut.

Sekretari i Komitetit Qendror të PPSH

Ramiz Alia

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PLENUMI I 8-TË I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 10 tetor 1975

K O M U N I K A T E

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në datën 10.10.1975, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi i 8-të i Komitetit Qendror të PPSH, i cili në zbatim të detyrës që shtroi Kongresi i 6-të i PPSH, diskutoi çështjen e hartimit të Kushtetutës së re dhe mori vendimet përkatëse.

Plenumi nderoi kujtimin e anëtarit të Komitetit Qendror të PPSH shokut Kahreman Ylli, të Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste (M.L.) të Kolumbisë, shokut Pedro Leon Arboledas, që u vra nga forcat e regjimit borgjez diktatorial kolumbian, si dhe të shokëve heroikë të Partisë Komuniste (M.L.) të Spanjës, që u pushkatuan nga regjimi gjakatar fashist i Frankos.

Në fund të punimeve të Plenumit shoku Enver Hoxha mbajti një fjalim të rëndësishëm.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

R A P O R T

MBI PROJEKTIN E KUSHTETUTËS SË RE

10 tetor 1975

Kongresi i 6-të i Partisë shtroi detyrën e hartimit të një Kushtetute të re të shtetit tonë. Në zbatim të kësaj detyre, Byroja Politike e Komitetit Qendror qysh në fillim të vitit 1973 krijoi një komision, i cili, duke aktivizuar edhe një numër të madh specialistësh të fushave të ndryshme, juristë, filozofë, ekonomistë, historianë etj., zhvilloi një punë disavjeçare dhe hartoi një Projekt të Kushtetutës së re. Ky Projekt, pasi u shqyrtua nga Byroja Politike, u ripunua në bazë të vërejtjeve që u bënë dhe sot i paraqitet për diskutim Plenumit të Komitetit Qendror.

I. — TRANSFORMIMET E MËDHA SHOQËRORE-EKONOMIKE DHE NEVOJA E HARTIMIT TË KUSHTETUTËS SË RE

Kushtetuta që është sot në fuqi u miratua nga Asambleja Kushtetuese më 14 mars 1946, pa kaluar as një vit e gjysmë nga çlirimi i vendit dhe triumfi i Revolucionit Popullor në Shqipëri. Asaj iu bënë gjatë viteve të mëvonshme ndryshime e plotësime të ndryshme, sidomos në korrik të vitit 1950.

Pranimi i Kushtetutës së vitit 1946 ishte një fitore e madhe politike për popullin dhe për Partinë tonë.

«Rëndësia e saj — theksoi shoku Enver Hoxha në Kongresin e 6-të të Partisë — qëndronte në faktin se ajo ligjëroi atë përmbysje të thellë e rrënjësore që u bë në jetën e shoqërisë sonë si rezultat i triumfit të Revolucionit Popullor, sanksionoi nga pikëpamja juridike të gjitha ato fitore të mëdha politike, ekonomike e shoqërore që populli kishte arritur me luftën e vet heroike dhe hapi perspektiva

të qarta për transformime të tjera revolucionare në të gjitha fushat e jetës mbi baza socialiste... u bë mbështetja dhe burimi i gjithë legjislacionit të shtetit tonë të ri demokratik popullor»¹.

Por periudha së cilës i shërbeu kjo Kushtetutë tanimë ka kaluar. Nga koha kur u miratua Kushtetuta e parë, në rendin ekonomik-shoqëror të Shqipërisë, si rezultat i zbatimit konsequent e krijuës të marksizëm-leninizmit nga Partia jonë e Punës, janë bërë ndryshime të tilla revolucionare që shënojnë një etapë të tërë historike të kapërcyer.

Në vendin tonë prej kohësh është zgjidhur plotësisht detyra e ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit. Në vitin 1967 në sektorin socialist të ekonomisë u krijuan rreth 100 për qind të të ardhurave kombëtare. Atë vit sektori socialist përfshinte 100 për qind të prodhimit të përgjithshëm industrial, rreth 100 për qind të prodhimit të përgjithshëm bujqësor, 100 për qind të tregtisë me shumicë, 95 për qind të tregtisë me pakicë dhe 100 për qind të transportit kombëtar. Siç shihet, vendin e ekonomisë shumëformëshe e zuri sistemi i vetëm socialist i ekonomisë, vendin e pronës private e zuri prona shoqërore socialiste mbi mjetet e prodhimit. Mbi këtë bazë u vendosën plotësisht marrëdhëniet socialiste në prodhim si në qytet ashtu edhe në fshat.

Vënia në jetë me sukses e politikës së Partisë për ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit solli me vete edhe ndryshimin rrënjësor të strukturës së vjetër të klasave të shoqërisë sonë. Me vendosjen e marrëdhënieve socialiste në prodhim mori fund edhe procesi i zhdukjes së klasave shfrytëzuese si klasa. Qysh në fundin e viteve 60, punëtorët (së bashku me familjet e tyre) përbënin rreth 33 për qind të popullsisë së vendit, fshatarësia kooperativiste mbi 55 për qind dhe inteligjencia popullore mbi 11 për qind. Pra në këtë kohë borgjezia dhe çifligarët janë zhdukur si klasë shoqërore. Tani në vendin tonë ekzistojnë dy klasa mike, klasa punëtore dhe fshatarësia kooperativiste, si edhe shtresa e inteligjencies popullore.

Ndryshime rrënjësore qysh nga koha e miratimit të Kushtetutës së parë të shtetit tonë socialist kanë pësuar vetë klasa punëtore, fshatarësia punonjëse dhe inteligjencia. Klasa jonë punëtore, nga një klasë e vogël në fillim, është bërë numerikisht një forcë e madhe, si rezultat i punës së madhe të Partisë e të levave të saj janë ngritur, pa krahasim me të kaluarën, niveli arsimor-kulturor e tekniko-profesional, përgatitja ideopolitike,

¹ Enver Hoxha, Raport në Kongresin e 6-të të PPSH, f. 124.

ndërgjegjja socialiste dhe vetëdija e saj mbi rolin historik udhëheqës që i përket në shoqërinë tonë. Si pasojë, kemi një rritje cilësore të rolit që luan e të peshës që mban klasa punëtore në ndërtimin ekonomik, si edhe në zhvillimin e revolucionit socialist të pandërprerë e në qeverisjen e vendit. **Fshatarësia punonjëse**, në procesin e kolektivizimit të bujqësisë, u shndërrua nga klasë e pronarëve të vegjël të tokës në një klasë socialiste. Bashkë me këtë, kanë pësuar një transformim të thellë botëkuptimi dhe psikologjia e fshatarit tonë, i cili po brumoset çdo ditë e më shumë me shpirtin e kolektivizimit dhe ideologjinë e klasës punëtore; janë rritur përgatitja e gjithanshme dhe aftësitë e fshatarësisë sonë në përpunime me kërkesat e prodhimit të madh bujqësor socialist. Gjatë kësaj periudhe gati 30-vjeçare, në vendin tonë u krijua një shtresë e gjerë e inteligjencisë së re, e dalë nga radhët e popullit punonjës dhe e lidhur ngushtë me interesat e tij, e edukuar dhe e brumosur me botëkuptimin marksist-leninist dhe idealet e socializmit, me frymën e besnikërisë ndaj Partisë sonë, klasës punëtore, popullit e atdheut socialist, me një përgatitje të shëndoshë profesionale e shkencore; ajo luan një rol të rëndësishëm në të gjitha fushat e ndërtimit të socializmit.

Aleanca e dy klasave socialiste, nën udhëheqjen e klasës punëtore, dhe mbi këtë bazë ngritja e unitetit socialekonomik e ideopolitik të popullit në një shkallë cilësisht të re, përbëjnë tiparin dallues themelor të strukturës së sotme klasore të shoqërisë sonë.

Vendosja e pronës socialiste dhe struktura e re e klasave zhdukën një herë e përgjithmonë shfrytëzimin e njeriut prej njeriut si edhe të gjitha antagonizmat e tjerë shoqërorë midis fshatit e qytetit, midis punës mendore e punës fizike, ndërsa dallimet esenciale midis tyre po ngushtohen gradualisht. Ato i dhanë fund shtypjes shekullore të gruas dhe siguruan kushtet themelore për çlirimin e saj të plotë, për pjesëmarrjen e saj aktive e të barabartë me burrin në qeverisjen e vendit dhe në të gjitha sferat e ndërtimit socialist e të veprimtarisë shoqërore.

Marrëdhëniet e reja shoqërore-ekonomike u bënë ai faktor vendimtar që siguroi zhvillimin e vrullshëm të forcave prodhuese, që hapi rrugën për përparimin e gjithanshëm të vendit tonë. Brenda një kohe shumë të shkurtër, si rezultat i politikës së Partisë për industrializimin socialist, Shqipëria është shndërruar nga një vend i prapambetur bujqësor, në një vend bujqësor-industrial të përparuar. Janë krijuar shumë degë të reja të industrisë, të cilat përpunojnë në vend pasuri minerale dhe lëndë të tjera të para, deri në prodhimin e artikujve të gatshëm. Tani në rendin e ditës është shtruar detyra e një hapi të ri cilësor, e kthimit të Shqipërisë në një vend industrialo-bujqësor. Krijimi i rendit kooperativist dhe masat e shumanshme që janë marrë për for-

cimin e bazës materialo-teknike të prodhimit bujqësor, e kanë vënë bujqësinë tonë në rrugën e një zhvillimi intensiv e modern.

Ndryshimet rrënjësore në bazën ekonomike e materiale-tek-nike, si dhe në përbërjen klasore të shoqërisë sollën ndryshime të mëdha edhe në superstrukturën e saj. Nën kujdesin e vazhdueshëm të Partisë, shteti i demokracisë popullore, i cili me Çlirimin e vendit kryen funksionet e diktaturës së proletarietit, u konsolidua më tej. Lufta kundër burokratizmit e liberalizmit, për një stil e metodë të re në punë, gjallërimi dhe thellimi i vijës së masave dhe rritja e kontrollit punëtor të drejtpërdrejtë, përsosja e marrëdhënieve kuadro-masa, armatosja dhe përgatitja ushtarake e gjithë popullit etj. kanë forcuar superstrukturën politike të shoqërisë socialiste dhe kanë pasuruar praktikën e funksionimit të shtetit e të jetës sonë shoqërore në të gjitha hallkat. Zhvillimi me sukses i revolucionit ideologjik e kulturor, në luftë të ashpër klasore kundër ideologjive të vjetra të shoqërive shfrytëzuese dhe kundër presionit e ndikimeve të sotme ideologjike të botës kapitaliste e revizioniste, revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës dhe zhvillimi i revolucionit tekniko-shkencor, zhdukja e institucioneve fetare, puna e gjithanshme e Partisë për edukimin komunist të punonjësve, veçanërisht për kalitjen e brezit të ri si vazhdues i denjë e i sigurt i çështjes së revolucionit e të socializmit, të gjitha këto kanë sjellë ndryshime të dukshme në superstrukturën ideologjike të shoqërisë sonë. Në këtë proces të revolucionarizimit të vazhdueshëm të të gjithë jetës së vendit, është grumbulluar një përvojë e re historike, me vlerë të madhe teorike e praktike, që përbën një kontribut të rëndësishëm të Partisë sonë në thesarin e marksizëm-leninizmit, se si të sigurohet ecja gjithnjë përpara e revolucionit socialist deri në fitoren e plotë e përfundimtare dhe t'i pritët rruga rrezikut të kthimit prapa në kapitalizëm.

E parë në prizmin e të gjitha këtyre ndryshimeve të mëdha që janë bërë në të gjitha fushat e jetës së vendit, Kushtetuta në fuqi, me gjithë vlerën e madhe që ajo pati në këtë periudhë historike, në shumë aspekte është kapërcyer dhe nuk pasqyron realitetin socialist që ekziston sot në Shqipëri. Jeta, në zhvillimin e saj dinamik revolucionar, ka shtruar sot nevojën e hartimit të Kushtetutës së re, e cila të pasqyrojë transformimet që kanë ndodhur dhe përvojën e re historike të diktaturës sonë të proletarietit, në mënyrë që, si pjesë përbërëse e rëndësishme e superstrukturës politike, ajo t'i shërbejë më mirë gjithë zhvillimit socialist të shoqërisë.

II. — TIPARET THELBËSORE TË PROJEKTIT TË KUSHTETUTËS SË RE DHE PROBLEMET THEMELORE QË TRAJTON AI

Në hartimin e Projektit të Kushtetutës së re janë bërë përpjekje për të mbajtur parasysh disa kërkesa e kritere kryesore, që rrjedhin nga orientimet e Kongresit të 6-të të Partisë dhe porosinë e dhëna nga shoku Enver. Ato përbëjnë, njëkohësisht, disa tipare thelbësore, që përcaktojnë përmbajtjen, ndryshimet nga Kushtetuta e parë e shtetit tonë, si edhe dallimet parimore e rrënjësore të Projektit nga kushtetutat borgjeze e revizioniste.

Një ndër kërkesat që shtroi Kongresi i 6-të i Partisë ishte hartimi i një Kushtetute të re, e cila **t'i përshtatet etapës së sotme të zhvillimit të vendit**, asaj të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Kjo do të thotë, nga njëra anë, të hartohet një Kushtetutë, e cila të pasqyrojë atë që është e re në krahasim me etapën e mëparshme dhe, në të njëjtën kohë, siç porosit shoku Enver, të rikonfirmojë përvojën dhe rrugën e drejtë të ndjekur nga Partia gjatë etapës së kaluar, që solli fitoret e sotme, duke përfshirë edhe disa probleme kushtetuese e qëndrime parimore që përmbahen në Kushtetutën ekzistuese. Nga ana tjetër, detyra e Kushtetutës së re është jo thjesht të regjistrojë e të sanksionojë fitoret e arritura, por edhe **të shprehë tendencën e të hapë perspektivën e zhvillimit të mëtejshëm socialist të vendit**, të shërbejë, në njëfarë kuptimi, edhe si një program pune e luftë për të ardhmen, që i frymëzon e i mobilizon punonjësit për fitore të reja, por pa kapërcyer artificialisht kufijtë e etapës së sotme.

I parë në këtë prizëm, Projekti i Kushtetutës së re, duke pasqyruar etapën e sotme të zhvillimit tonë socialist, atë të ndërtimit të plotë të socializmit, nuk hedh poshtë në mënyrë metafizike Kushtetutën e vjetër, e cila është pasqyrim i etapës së mëparshme të ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit, por është vazhdim i drejtpërdrejtë i saj, siç është objektivisht etapa e tanishme vazhdim i asaj të mëparshmes. Në të njëjtën kohë, Projekti i tanishëm, duke pasqyruar dallimin thelbësor midis këtyre dy etapave të zhvillimit tonë socialist, shënon, në krahasim me Kushtetutën ekzistuese, një kapërcim dialektik të saj, një hop cilësor nga më e ulëta tek më e larta.

Kushtetuta e re, theksonte më tej Kongresi i 6-të i Partisë, duhet të jetë një dokument juridik, politik e ideologjik që **të pasqyrojë plotësisht vijën e PPSH**, të mishëruar në praktikën tonë revolucionare, vijën e zhvillimit të revolucionit socialist, të pandërprerë, të ndërtimit e të mbrojtjes së socializmit, duke u mbështetur kryesisht në forcat e veta, e cila i ka sjellë popullit tonë fitore të shkëlqyera, si edhe qëndrimet internacionale dhe luftën parimore të saj në arenën ndërkombëtare kundër imperializmit e

revizionizmit modern, në përkrahje të lëvizjes revolucionare e çlirimtare në vendet e tjera, për fitoren e çështjes së socializmit e të komunizmit në botë.

Gjithashtu, në përputhje me orientimet e Kongresit të 6-të të Partisë, janë bërë përpjekje që Projekti i Kushtetutës së re **të afirmojë mësimet e marksizëm-leninizmit dhe të paraqesë tiparet e vërteta të socializmit**, të cilat e dallojnë atë nga të gjitha shtembërmet e falsifikimet që i kanë bërë atij revizionistët modernë. Në të njëjtën kohë, duke nxjerrë mësim nga kundërrevolucionari paqësor në Bashkimin Sovjetik e në disa vende të tjera, si edhe mbi bazën e përvojës revolucionare të Partisë e të vendit tonë, e cila përbën një kontribut të çmueshëm në teorinë dhe në praktikën e socializmit shkencor, në Projektin e tanishëm të Kushtetutës kanë gjetur pasqyrim masat themelore për t'i prerë rrugën rrezikut të lindjes së revizionizmit dhe të degjenerimit paqësor të diktaturës së proletariatit e të rendit socialist.

Në kundërshtim me orvatjet e revizionistëve modernë, që përpiqen të mohojnë përmbajtjen klasore të shtetit dhe të të gjithë shoqërisë socialiste, për të mbuluar kështu diktaturën e tyre borgjeze dhe politikën e tyre kundërrevolucionare, është mbajtur parasysh porosia e shokut Enver që në Projektkushtetutën e re **të gjitha problemet të trajtohen nga pozita të qarta klasore proletare dhe nën prizmin e luftës së klasave kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm dhe në gjirin e popullit**, që mbetet një forcë e madhe lëvizëse edhe pas likuidimit të klasave shfrytëzuese si klasë, deri në komunizëm.

Krahas kësaj dhe kurdoherë nga pozita konsekuente klasore proletare, është synuar që në Projektin e Kushtetutës së re **të gjejë pasqyrim të plotë karakteri thellësisht demokratik e humanitar i rendit tonë shoqëror e shtetëror socialist, i diktaturës sonë të proletariatit**, ku vetë populli punonjës është në fuqi dhe ku çdo gjë bëhet në emër e në interes të tij, krejt në të kundërtën e predikimeve mashtruese të revizionistëve mbi «demokracinë e humanizmin mbiklasor», prapa të cilave fshihet shtypja e shfrytëzimi i punonjësve nga klasa e re borgjeze.

Në hartimin e Projektit të Kushtetutës së re është pasur parasysh, si një kërkesë thelbësore, që **jo vetëm të shpallen e të fiksohen parimet demokratike, por edhe të jepen garancitë reale për zbatimin e tyre në jetë**. Në këtë qëndron, gjithashtu, një ndër dallimet rrënjësore të tij nga kushtetutat mashtruese të vendeve borgjeze (dhe revizioniste), ku, siç vinte në dukje Lenini, vetëm shpallen formalisht barazia, të drejtat e liritë demokratike, ndër-sa me një mijë kufizime e ndërlikime reale punonjësit privohen prej tyre dhe bëhen skllëvër me mëditje.

Më së fundi, duke mbajtur parasysh se Kushtetuta është ligji themelitar që përcakton drejtimit e parimet themelore të funksio-

nimit të shtetit e të jetës së shoqërisë sonë socialiste përgjithësisht dhe që do të shërbejë si bazë për tërë legjislacionin tonë, është synuar që, ashtu siç ka theksuar shoku Enver, Projekti i Kushtetutës së re të përmbajë atë më kryesoren, pa hyrë në hollësi të panevojshme, të cilat mund të të lidhin duart, të bëhen pengesë për zhvillimin e mëtejshëm socialist të vendit dhe të të detyrojnë t'i bësh Kushtetutës ndryshime të herëpashershme, gjë që nuk është e dëshirueshme. Por njëkohësisht është synuar që teksti i Kushtetutës së re të jetë i formuluar në mënyrë të përcaktuar mirë, i saktë e shkencor, që të mos lërë shteg për kurrfarë interpretimesh që të vijnë në kundërshtim me frymën e saj të përgjithshme revolucionare, të deformojnë parimet dhe normat e rendit tonë socialist.

Janë bërë gjithashtu përpjekje që ligji themeltar i shtetit tonë, ky dokument kaq i rëndësishëm, zbatimi i të cilit është çështje jetike e të gjithëve, të shkruhet me një gjuhë të qartë, të thjeshtë e të kuptueshme për masat e gjera të popullit punonjës.

*
* *

Duke u nisur nga këto kritere e kërkesa, në Projektin e Kushtetutës së re kanë gjetur pasqyrim problemet kushtetuese themelore. Rreth më kryesoreve prej tyre, veçanërisht rreth atyre çështjeve që përfaqësojnë të renë në krahasim me Kushtetutën në fuqi, është përqendruar vëmendja si më poshtë:

1. Përvoja e popullit shqiptar e këtyre dekadave të fundit ka provuar se **udhëheqja e PPSH** përbën faktorin vendimtar të fitoreve më të mëdha në historinë e tij, të çlirimit të vendit nga pushtuesit fashistë, të vendosjes së pushtetit popullor dhe të ndërimit me sukses të socializmit. Dihet gjithashtu se udhëheqja e pandarë e partisë proletare është shprehja e koncentruar e rolit udhëheqës të klasës punëtore në shoqërinë socialiste dhe kushti numër një i ekzistencës së diktaturës së proletariatit. Ky realitet historik dhe ky parim bazë i jetës së shoqërisë sonë është fiksuar në Projektin e ri të Kushtetutës, ku shpallet e sanksionohet drejtpërdrejt, jo vetëm në Hyrjen por edhe në njërin prej neneve të para, se «Partia e Punës e Shqipërisë, pararoja e klasës punëtore, është forca e vetme politike udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë» (neni 3).

Afirmimi i rolit udhëheqës të Partisë në Projektin e Kushtetutës së re merr një rëndësi të veçantë në kushtet aktuale edhe për faktin se drejtohet kundër teorive revizioniste që sulmojnë mësimet e marksizëm-leninizmit mbi partinë proletare: kundër predikimeve revizioniste të sistemit shumëpartish në socializëm,

kundër koncepteve të revizionistëve jugosllavë mbi partinë si një forcë «thjesht ideologjike», por jo udhëheqëse e drejtuese, kundër tezave të revizionistëve hrushovianë mbi «partinë e të gjithë popullit», që do të thotë mohim i rolit udhëheqës të klasës punëtore.

Sanksionimi në Kushtetutë i rolit udhëheqës të Partisë sonë të Punës është me rëndësi të madhe edhe në luftën kundër armiqve të socializmit brenda vendit, të cilët në orvatjet e tyre për të minuar e për të përmbysur rendin socialist, diktaturën e proletariatit, goditjet e veta i drejtojnë, në radhë të parë, kundër shtabit udhëheqës të klasës punëtore e të popullit tonë, Partisë, kundër rolit drejtues e kontrollues të saj në të gjitha fushat e hallkat. Për këtë mësim jetik, të vërtetuar tanimë nga një eksperiencë e tërë historike e vendit tonë dhe e vendeve të tjera, dëshmon me qartësi të plotë edhe veprimtaria antiparti e komplotuese e elementëve armiq, burokratë e teknokratë në sferën e krijimtarisë kulturore e letraro-artistike, në ushtri e në ekonomi, e cila u denoncua e u shpartallua nga Partia jonë në plenumet e 4-t, 5-të, 6-të e 7-të të Komitetit Qendror.

Në Projektin e ri të Kushtetutës është fiksuar gjithashtu se në shtetin tonë marksizëm-leninizmi, ideologjia revolucionare e klasës punëtore dhe e Partisë së saj, është ideologjia sunduese, se në bazë të parimeve të tij organizohet e zhvillohet gjithë rendi shoqëror socialist. Shpallja e kësaj teze si një normë kushtetuese është me rëndësi të madhe teorike e praktike, sepse sanksionon një realitet të arritur gjatë një periudhe 30-vjeçare të zhvillimit të revolucionit socialist në fushën e ideologjisë e të kulturës; drejtohet kundër predikimeve borgjeze e revizioniste mbi «qarkullimin e lirë të ideve e të kulturave» dhe përbën një barrikadë kundër çfarëdo orvatjeje për të përhapur në vendin tonë ide joproletare e antisocialiste; përcakton bazën ideologjike të rendit tonë shoqëror dhe afirmon mësimin e madh se socializmi mund të ndërtohet vetëm sipas parimeve të teorisë marksiste-leniniste; përfaqëson një ndër shprehjet kryesore të rolit udhëheqës të klasës punëtore e të Partisë së saj revolucionare në shoqërinë tonë socialiste.

2. Siç ka theksuar shoku Enver Hoxha në Kongresin e 6-të të Partisë, problem kyç i revolucionit deri në arritjen e fitores së komunizmit ka qenë dhe mbetet problemi i pushtetit shtetëror, i diktaturës së proletariatit. Çështja e diktaturës së proletariatit, nëse ajo do të ruhet e do të forcohet apo do të degjenerojë e do të përmbysset, përbën thelbin e luftës klasore gjatë tërë periudhës historike të socializmit, në çfarëdo fushe të jetës shoqërore që të zhvillohet kjo luftë. Kjo çështje e madhe parimore e jetike për fatet e socializmit, që para së gjithash ka të bëjë me përmbajtjen apo natyrën klasore të shtetit tonë, zë në Projektin e Kushtetutës së re një vend të dorës së parë.

Aty thuhet se «**Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë është shtet i diktaturës së proletariatit**» (neni 2). Ky përkufizim nisat nga premisa se lufta e klasave vazhdon pa ndërprerje gjatë gjithë periudhës historike të socializmit dhe se për ta çuar atë me sukses deri në fitoren e plotë e përfundimtare të rrugës socialiste mbi atë kapitaliste është e domosdoshme diktatura e proletariatit. Ai është në përputhje të plotë me tezën e famshme të K. Marksit se gjatë tërë periudhës së kalimit nga kapitalizmi në komunizëm «shteti nuk mund të jetë tjetër veçse diktaturë e proletariatit», si edhe me tezën e V. I. Leninit se «kalimi nga kapitalizmi në komunizëm sigurisht nuk mund të mos japë një shumicë të madhe formash politike, por thelbi do të jetë gjithmonë po ai: diktaturë e proletariatit». Në këtë përkufizim të shtetit tonë si diktaturë e proletariatit gjen shprehje konkrete roli udhëheqës i klasës punëtore, i cili nuk mund të kuptohet pa partinë **proletare** dhe shtetin **proletar**.

Një përcaktim i tillë i qartë jo vetëm që i përgjigjet realitetit tonë, por njëkohësisht ka një rëndësi politike të veçantë, edhe ndërkombëtare, sidomos në rrethanat e sotme, kur revizionistët sovjetikë dhe përkrahësit e tyre përhapin teorinë se diktatura e proletariatit gjoja nuk është e domosdoshme gjatë gjithë periudhës së kalimit nga kapitalizmi në komunizëm dhe me zhdukjen e klasave shfrytëzuese shndërrohet gradualisht në «shtet të të gjithë popullit». Por dihet se duke predikuar tezat mbi «shtetin dhe partinë e gjithë popullit» roli udhëheqës i klasës punëtore mbetet një frazë boshe dhe se prapa këtyre predikimeve fshihet në fakt diktatura socialfashiste e borgjezisë së re, që ka uzurpuar pushtetin në Bashkimin Sovjetik.

Në Projektin e Kushtetutës së re është përcaktuar në mënyrë të saktë baza sociale e shtetit tonë të diktaturës së proletariatit në etapën e tanishme. «**Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë** — thuhet në nenin 2 — **mbështetet në unitetin e popullit dhe ka në themel aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë kooperativiste nën udhëheqjen e klasës punëtore**». Në këtë përkufizim janë pasqyruar një varg momentesh të rëndësishme: aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë si një parim themelor i diktaturës së proletariatit; roli udhëheqës i klasës punëtore ndaj fshatarësisë dhe ndaj gjithë popullit punonjës; etapa aktuale e kësaj aleance, e cila paraqitet sot si aleancë e klasës punëtore me fshatarësinë **kooperativiste**; një realitet i vendit tonë, sepse fshatarësia ka luajtur kurdoherë një rol të madh në historinë e Shqipërisë dhe sot ajo vazhdon të jetë një forcë me shumë rëndësi për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste dhe mbrojtjen e atdheut; ideja se diktatura e proletariatit në vendin tonë mbështetet sot në një bazë më të gjerë, në unitetin e popullit, gjë që përbën një nga realizimet më të mëdha të Partisë e të socializmit te ne.

Një çështje e rëndësishme, e lidhur ngushtë me përmbajtjen klasore të shtetit tonë të diktaturës së proletariatit, është ajo e **formës dhe e emërimit të tij në fazën e sotme të zhvillimit**. Shteti ynë ka qenë qysh në fillim diktaturë e proletariatit në formën e demokracisë popullore dhe pikërisht duke u nisur nga kjo, ai u quajti Republika Popullore e Shqipërisë. Por një emërtim i tillë nuk i përgjigjet si duhet etapës së sotme të zhvillimit të vendit tonë. Prandaj në Projekt Kushtetutën e re shteti ynë është quajtur **Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë** (neni 1). Arsyet kryesore që flasin në favor të një zgjidhjeje të tillë janë se emërtimi i ri pasqyron më mirë përmbajtjen klasore të shtetit tonë dhe ndryshimet cilësore që ne kemi realizuar në ndërtimin e marrëdhënieve socialiste, dhe, në të njëjtën kohë, ruan atë traditë të shëndoshë e atë vend të denjë që ka zënë tanimë, sidomos në arenën ndërkombëtare, shteti ynë me emrin «Republika Popullore e Shqipërisë».

3. **Problemet e bazës politike të pushtetit dhe parimet themelore të funksionimit të mekanizmit shtetëror e shoqëror** në vendin tonë përbëjnë një grup tjetër të çështjeve të rëndësishme që kanë gjetur pasqyrim në Projektin e Kushtetutës së re. Këtu spikat me tërë qartësinë karakteri thellësisht demokratik i shtetit tonë, del në pah demokracia jonë socialiste në veprim, që e dallon rrënjësisht rendin tonë shtetëror e shoqëror nga e ashtuquajtura «demokraci» mashtruese borgjeze e revizioniste, kanë gjetur sanksionim kushtetues një varg masash të rëndësishme revolucionarizuese që ka marrë Partia jonë për zbatimin e thellimin e vazhdueshëm të vijës së masave, për të luftuar e për të çrrënjësuar të keqen e burokratizmit, të liberalizmit e çdo fenomen të huaj që mban farën e degjenerimit borgjez e revizionist të shtetit tonë të diktaturës së proletariatit.

Një nga problemet themelore në Kushtetutë është ai i **sovranitetit**, me të cilin kuptohet pushteti më i lartë në çdo shtet, si brendapërbrenda kufijve të tij ashtu edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Dy aspekte të këtij problemi meritojnë veçanërisht vëmendjen:

Së pari, në Projektin e tanishëm të Kushtetutës është forcuar elementi bazë i sovranitetit popullor, elementi klasor, që është shprehur në kontekstin e neneve 2, 3 dhe 5, ku, përveç parimit se «i gjithë pushteti buron nga populli punonjës dhe i përket atij», është theksuar njëkohësisht roli udhëheqës i klasës punëtore, i realizuar nëpërmjet Partisë së saj politike dhe shtetit të diktaturës së proletariatit. I trajtuar në këtë mënyrë, parimi i sovranitetit popullor u kundërvihet tezave demagogjike të revizionistëve mbi «shtetin e të gjithë popullit».

Së dyti, në Projekt është një paragraf i posaçëm, sipas të cilit askush tjetër veç organeve përfaqësuese (Kuvendit Popullor dhe

këshillave popullorë) nuk mund të ushtrojë sovranitetin e popullit dhe çdo atribut të tij në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë e në emër të saj. Veç të tjerash, me këtë është synuar t'i pritët rruga çdo orvatjeje që mund të bëhej në situata të caktuara (sigurisht hipotetike) nga elementë armiq e tradhtarë (individualisht apo në grupe) për t'i atribuar vetes kompetenca të paligjshme e antikushtetuese, duke iu drejtuar kujtdoqoftë jashtë kufijve të atdheut, gjoja në emër të popullit shqiptar apo të organeve të Republikës sonë, për të kërkuar «ndihmë», me fjalë të tjera «për të legalizuar» një ndërhyrje të huaj të forcave imperialiste, revizioniste apo reaksionare në vendin tonë.

Nga parimi themelor i sovranitetit popullor rrjedh edhe **parimi i unitetit të pushtetit**, që ka qenë kurdoherë në themel të organizimit të shtetit tonë socialist. Përmbajtja e këtij parimi, është përcaktuar në nenin 6, ku thuhet se «të gjitha organet shtetërore e zhvillojnë veprimtarinë e tyre nën drejtimin dhe kontrollin e organeve përfaqësuese, janë përgjegjëse para tyre dhe u japin llogari». Pra, pushteti te ne është një e i pandarë, ai ndodhet në duart e përfaqësuesve të zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.

Është fiksuar gjithashtu se përfaqësuesit e zgjedhur të popullit kanë të drejtë të kontrollojnë organet e ndryshme shtetërore dhe ekonomike, të ndërhyjnë pranë tyre për zbatimin e përpiktë të Kushtetutës e të ligjeve, ndërsa këto organe janë të detyruara të shqyrtojnë vërejtjet, kërkesat e propozimet e përfaqësuesve të popullit, t'u përgjigjen në kohë dhe të marrin masat e nevojshme për vënien e tyre në jetë.

Në Projektkushtetutë ka gjetur pasqyrim edhe raporti i organeve përfaqësuese e i anëtarëve të tyre me popullin që i zgjedh ata. Lidhur me këtë, krahas tezës se «klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe punonjësit e tjerë e ushtrojnë pushtetin nëpërmjet organeve përfaqësuese, si edhe drejtpërsëdrejti» (neni 5), është vënë ideja se organet përfaqësuese dhe përfaqësuesit e popullit jo vetëm **zgjidhen** nga populli, por edhe **kontrollohen** prej tij, **përgjigjen e japin llogari** para popullit. Thelbësore është gjithashtu e drejta e zgjedhësve për të revokuar ata përfaqësues të popullit që nuk justifikojnë besimin.

Në këtë mënyrë krijohet një bazë e shëndoshë kushtetuese për të luftuar si rrezikun e shpëputjes së organeve përfaqësuese e të njerëzve të tyre nga populli, ashtu edhe çfarëdo shfaqjesh të nënvleftësimit e të formalizmit në veprimtarinë e tyre, sidomos prirjet e rrezikshme për t'i vënë organet ekzekutive e administratat mbi organet përfaqësuese të pushtetit, për ta identifikuar shtetin e diktaturës së proletariatit me administratat e nëpunësit.

Tërë Projekti i Kushtetutës së re përshkohet nga **parimi i centralizmit demokratik**, që është parim bazë e i përgjithshëm i

ndërtimit shtetëror socialist dhe i funksionimit të sistemit të diktaturës së proletariatit. Trajtimi i këtij parimi në Projekt karakterizohet nga disa momente thelbësore, që janë pasqyrim i përvojës së re të ndërtimit tonë socialist, si dhe i mësimave që rrjedhin nga përvoja negative e disa vendeve të tjera.

Para së gjithash, zbatimi i parimit të centralizmit demokratik në Projektin e Kushtetutës lidhet me luftën kundër dy të këqijave të mëdha, prej nga vjen rreziku i degjenerimit paqësor të diktaturës së proletariatit: me luftën kundër burokratizmit dhe kundër liberalizmit. Ky është përgjithësim i një eksperience të tërë historike të diktaturës së proletariatit dhe një kontribut i Partisë sonë në teorinë dhe në praktikën e socializmit shkencor.

Në Projektkushtetutë trajtohen për të parën herë dy parime të rëndësishme të shtetit e të shoqërisë sonë, që janë konkretizim i centralizmit demokratik: **vija e masave dhe kontrolli i klasës punëtore**.

Zbatimi i vijës së masave, iniciativa krijuese e shtresave të gjera të punonjësve, pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e tyre në qeverisjen e vendit, në hartimin dhe në diskutimin e planeve, të ligjeve e të çështjeve më të rëndësishme, në zhvillimin, organizimin dhe në drejtimin e prodhimit, të arsimit, të kulturës e të revolucionit tekniko-shkencor, në mbrojtjen e vendit e të rendit socialist etj., është bërë e po bëhet gjithnjë e më shumë praktikë e përditshme e jetës sonë shoqërore, që e dallon rrënjësisht atë nga jeta në vendet borgjeze e revizioniste. Kjo vijë e masave, e cila është shprehja më e gjallë e karakterit me të vërtetë popullor e demokratik të pushtetit tonë, ka gjetur sanksionim kushtetues në nenin 11, si edhe në nenet 5, 7, 13, 52 e 58 të Projektit. Këtu janë mbajtur parasysh mësimet parimore e jetike të Partisë e të shokut Enver se pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e masave në qeverisjen e vendit është shprehje e thellimit të mëtejshëm të revolucionit socialist të pandërprerë, drejtimi kryesor i zhvillimit të demokracisë socialiste në veprim dhe rruga e përgjithshme për forcimin e diktaturës së proletariatit, kusht i domosdoshëm për të siguruar përvojën e masave të gjera punonjëse në ndërtimin e socializmit, për të shumëfishuar forcën e aparatit shtetëror proletar, për t'i bërë punonjësit gjithnjë më të vetëdijshëm se ata vetë janë zotërit e plotfuqishëm të vendit, që duhet të thonë për çdo gjë fjalën e tyre vendimtare, për t'i mësuar gradualisht të gjithë të qeverisin.

Kontrolli i drejtpërdrejtë e i organizuar i klasës punëtore mbi tërë veprimtarinë e organeve shtetërore, të organizatave ekonomike e shoqërore dhe të punonjësve të tyre për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit dhe për forcimin e rendit socialist, si edhe përgjithësisht kontrolli i masave nga poshtë, përbën gjithashtu një tipar shumë të rëndësishëm të realitetit tonë shoqëror, i cili është

sanksionuar në mënyrë të posaçme në Projektin e Kushtetutës së re. Në këtë mënyrë kanë gjetur pasqyrim kushtetues tezat origjinale e me vlerë të madhe teorike e praktike të Partisë sonë e të shokut Enver mbi kontrollin punëtor të drejtpërdrejtë si një domosdoshmëri e një parim bazë i jetës shoqërore gjatë tërë periudhës historike të socializmit, si një ndër shprehjet konkrete e të gjalla të rolit udhëheqës të klasës punëtore e të demokracisë proletare në veprim, si një armë e mprehtë në luftën kundër burokratizmit dhe ndikimeve të huaja, si një formë shumë e efektshme e edukimit proletar të vetë masave punëtore, si një e drejtë e pamohueshme e klasës punëtore për të ruajtur e për të forcuar diktaturën e proletariatit dhe rendin socialist dhe një ndër garancitë themelore për të shmangur rrezikun e revizionizmit e të kthimit prapa në kapitalizëm.

Një moment i rëndësishëm i demokracisë së masave, që ka gjetur pasqyrim në Projektin e Kushtetutës së re, është **përcaktimi i vendit të organizatave të masave në jetën tonë shoqërore**. Në trajtimin e kësaj çështjeje është mbajtur parasysh jo vetëm e drejta e shtetasve për t'u bashkuar në organizata të tilla, por, para së gjithash, që ato janë pjesë përbërëse e rëndësishme e sistemit tonë të diktaturës të proletariatit dhe se në procesin e zhvillimit të mëtejshëm të revolucionit e të ndërtimit socialist, me thellimin e mëtejshëm të demokracisë socialiste do të shkojë duke u rritur vazhdimisht roli i tyre si tribuna të zërit, të veprimit revolucionar e të pjesëmarrjes aktive të masave në qeverisjen e vendit, si leva të rëndësishme për edukimin komunist të punonjësve.

Sanksionimi kushtetues i **marrëdhënieve të drejta, me të vërtetë socialiste midis kadrove drejtues, nëpunësve dhe masave punonjëse**, pa të cilat nuk mund të bëhet fjalë as për marrëdhënie socialiste në prodhim e as për demokraci socialiste, zë në Projektin e paraqitur një vend të rëndësishëm. Përvoja historike vërteton se, po të mos vendosen marrëdhënie të drejta midis kadrove dhe masave, ekziston rreziku real që në gjirin e shoqërisë socialiste të krijohet një aristokraci «punëtore» apo një klasë e re borgjeze, gjë që mund të çojë deri në degjenerimin paqësor dhe në përmbysjen e diktaturës së proletariatit, siç ndodhi në Bashkimin Sovjetik e në disa vende të tjera. Duke u nisur nga mësimet që rrjedhin këtej dhe nga përvoja pozitive e Partisë sonë, sidomos e kësaj dekade të fundit, duke mbajtur parasysh mësimin e madh të Komunës së Parisit, se klasa punëtore për të ruajtur sundimin e vet si klasë duhet të sigurohet prej vetë nëpunësve e funksionarëve të saj, të mos lejojë shndërrimin e tyre në zotër mbi shoqërinë, dhe duke synuar që kadrot të vihen në kushte të tilla materiale e sociale që të mbeten revolucionarë deri në fund të jetës së tyre, në Projektin e Kushtetutës së re janë sinte-

tizuar një sërë masash efektive. Në këtë kontekst ka gjetur pasqyrim parimi se kadrot e nëpunësit janë shërbëtorë të popullit, që duhet të shkrihen e të jetojnë me masat, të mendojnë e të ndiejnë njëlloj si klasa punëtore e fshatarësia kooperativiste, janë përcaktuar edhe rrugët që ata të mbeten kurdoherë të tillë. Të tilla rrugë janë: pjesëmarrja e kadrove dhe e nëpunësve në punën drejtpërdrejtë në prodhim bashkë me punëtorët e kooperativistët dhe shpërblimi në raport të drejtë me ta; dhënia llogari përpara popullit; kontrolli i klasës punëtore e i masave punonjëse mbi kadrot e nëpunësit; mosnjohja e kurrfarë privilegjeve për shkak pozite shoqërore etj.

Demokracia socialiste është e pandarë nga **centralizmi proletar**.

«Çdo qëndrim i njëanshëm në këtë çështje të madhe parimore, — na mëson shoku Enver Hoxha — shkelja qoftë e parimit të centralizmit proletar qoftë e demokracisë socialiste është tepër e rrezikshme për rendin socialist»¹.

Ndërsa cungimi i demokracisë socialiste çon në burokratizimin e diktaturës së proletariatit, cenimi i centralizmit proletar çon në degjenerimin liberalo-anarkist të saj. Në Projektin e Kushtetutës së re, krahas problemeve të demokracisë socialiste, janë përcaktuar e janë sanksionuar edhe bazat e centralizmit proletar e të disiplinës proletare në shoqërinë tonë: udhëheqja e pandarë e PPSH, e Partisë revolucionare të klasës punëtore; përqendrimi i gjithë pushtetit në duart e organeve përfaqësuese dhe varësia e organeve më të ulëta ndaj atyreve më të larta; drejtimi i centralizuar e me plan unik i tërë jetës politiko-shoqërore, i ekonomisë e i kulturës.

Midis parimeve bazë të funksionimit të shtetit e të shoqërisë socialiste një vend me rëndësi zë **parimi i ligjshmërisë socialiste**. Dy elementë përbërës, që janë mbajtur parasysh edhe në Projektin e Kushtetutës së re, shprehin përmbajtjen e tij. Njëri prej tyre ka të bëjë me ekzistencën e një legjislacioni, të hartuar në përputhje me tiparet klasore dhe kushtet objektive të zhvillimit të shoqërisë. Nga kjo pikëpamje, në Projektin e tanishëm është përcaktuar qartë karakteri klasor proletar i ligjshmërisë sonë, si shprehje juridike e vullnetit të klasës punëtore e të masave të tjera punonjëse nën udhëheqjen e saj. Elementi tjetër ka të bëjë me vënien e detyrimit për respektimin dhe për zbatimin e njëllojtë dhe të përpiktë të ligjeve, si nga organet e pushtetit shtetëror, ashtu dhe nga ndërmarrjet, institucionet e ndryshme, orga-

1 Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1969-1970», f. 224.

nizatat shoqërore, përfaqësuesit e pushtetit, nëpunësit dhe të gjithë shtetasit. Kjo përbën, gjithashtu, edhe një nga shprehjet e centralizmit proletar në shoqërinë tonë. Në kushtet e rendit socialist, ku ligji mbron interesat jetike të masave të gjera të popullit punonjës, zbatimi dhe respektimi i ligjeve nga punonjësit kërkon që ata të bëhen të vetëdijshëm për këtë, në mënyrë që mbrojtja e ligjshmërisë proletare të bëhet çështje e të gjithëve.

Në kuadrin e parimit të ligjshmërisë socialiste, në Projekt është përcaktuar qartë **roli i gjykatave popullore** si organe të posaçme shtrëngimi klasor të diktaturës së proletariatit në mbrojtje të rendit juridik socialist, si edhe roli i tyre edukues e parandalues. Zgjedhja e gjyqtarëve dhe e ndihmësgjyqtarëve, pjesëmarrja e popullit në ushtrimin e drejtësisë, publiciteti i procesit gjyqësor etj. vazhdojnë të jenë parimet kryesore që karakterizojnë organizimin dhe veprimtarinë e gjykatave. Një moment i rëndësishëm është rritja e mëtejshme e rolit të prokurorisë si organ i specializuar për mbrojtjen e ligjshmërisë socialiste, për kontrollin e zbatimit të përpiktë e të njëlojtë të ligjeve nga të gjithë. Lidhur me këtë, sanksionohet se «prokurori ka të drejtën e protestës kundër çdo akti të paligjshëm dhe të kërkojë nga organet përkatëse shfuqizimin ose ndryshimin e tij» (neni 108), se «Prokurori i Përgjithshëm parashtrohet në Kuvendin Popullor dhe në Presidiumin e Kuvendit Popullor rastet kur ligjet dhe dekretet nuk pajtohen me Kushtetutën, si dhe në Këshillin e Ministrave rastet kur vendimet e urdhëresat e tij nuk pajtohen me ligjet» (neni 109).

4. Projekti i Kushtetutës së re, duke pasqyruar ato transformime të thella që janë kryer e ato fitore historike që janë arritur në rrugën e ndërtimit të socializmit, **sanksionon rendin shoqëror-ekonomik socialist**, i cili përbën bazën ekonomike të shtetit të diktaturës së proletariatit në vendin tonë në etapën e tanishme të zhvillimit. «Ekonomia e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë — thuhet në nenin 15 të projektit — është ekonomia socialiste që mbështetet në pronën socialiste mbi mjetet e prodhimit. Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë nuk ka klasa shfrytëzuese, janë zhdukur dhe ndalohen prona private dhe shfrytëzimi i njeriut prej njeriut».

Prona private i përket tanimë së kaluarës. Ajo dhe bartësit e saj jo vetëm nuk ekzistojnë, por edhe ndalohet çdo veprimtari që mund të shpjerë në një formë ose në një tjetër në kthimin prapa, në ringjalljen e pronës private dhe të marrëdhënieve shoqërore që ngrihen mbi bazën e saj.

Vendosja e **pronës socialiste** në të gjitha degët e ekonomisë popullore, si **tipi i vetëm i pronësisë mbi mjetet kryesore të prodhimit**, përfaqëson një realitet objektiv dhe një fitore të madhe historike të vendit tonë. Prona socialiste është themeli i patundur i rendit tonë shoqëror-ekonomik, është faktori vendimtar për

zhvillimin e pareshtur të vendit në rrugën e socializmit, për fuqizimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut dhe ngritjen sistematike të përgjithshme të mirëqenies së popullit, prandaj ajo gëzon mbrojtje e përkrahje të gjithanshme nga ana e shtetit socialist.

Në tërësinë e marrëdhënieve të pronësisë, **prona shtetërore, përfaqëson formën më të lartë e mbizotëruese të pronës socialiste**. Kjo është e lidhur me faktin që pronës shtetërore i përket pjesa dërrmuese e fondeve themelore që përdoren në ekonominë popullore dhe në kuadrin e saj krijohen rreth 2/3 e produktit të përgjithshëm shoqëror e të të ardhurave kombëtare të vendit. Kjo formë e pronës shtrihet në degët kyç të ekonomisë, përfaqëson një shkallë më të lartë të shoqërizimit të mjeteve të prodhimit, të punës e të vetë prodhimit dhe siguron një nivel teknik e shkencor më të përparuar, ajo përcakton nga pikëpamja ekonomike edhe karakterin socialist të pronës kooperativiste dhe luan një rol të veçantë për forcimin e rendit socialist. . . Si pronë e gjithë popullit, asaj i përket perspektiva historike për t'u bërë e vetmja formë e pronës mbi mjetet e prodhimit.

Duke mbajtur parasysh natyrën, vendin dhe rolin e pronës shtetërore, në pronësi **vetëm të shtetit** janë përfshirë mjetet e objektet themelore të prodhimit, të qarkullimit e të shërbimit shoqëror, të cilat luajnë rolin vendimtar për zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit, si edhe për ngritjen e vazhdueshme të nivelit material e kulturor të jetës së popullit. Këto janë pronë ekskluzive e shtetit.

Në Projektin e Kushtetutës së re përfshihet në pronësi socialiste shtetërore edhe toka. Toka u jepet në **përdorim** (dhe jo në pronësi) ndërmarrjeve ekonomike dhe institucioneve shtetërore, kooperativave bujqësore, organizatave shoqërore, si edhe shtetasve të veçantë; toka bujqësore mund të përdoret për qëllime të tjera vetëm me pëlqimin e organeve shtetërore përkatëse. Duke shpallur se toka i përket vetëm shtetit, pra, duke shpallur në Kushtetutë **nacionalizimin e tokës**, sanksionohet një e vërtetë e arritur prej kohësh në vendin tonë, sepse sot afro 5/6 e gjithë sipërfaqes së vendit janë pronë shtetërore; tokat bujqësore, që ligjërisht ndodhen në pronë të kooperativave, nuk mund të disponohen e të përdoren sipas interesave të ngushta të tyre, por duke pasur parasysh edhe planin e shtetit, prona e vogël private mbi tokën pothuajse është zhdukur plotësisht; dispozitat ligjore që janë sot në fuqi e ndalojnë tjetërsimin e tokës në çfarëdo formë, qoftë kjo pronë kooperativiste apo pronë e vogël private (duke përfshirë edhe pjesën e oborreve të ndërtesave në qytete), kështu që e drejta e pronësisë mbi tokën është reduktuar në fakt vetëm në të drejtën e përdorimit të saj shoqëror ose vetjak. Kjo rrugë origjinale e zgjidhjes së problemit të pronësisë mbi tokën përbën një zbatim krijues të mësimave të marksizëm-leninizmit

nga Partia jonë, në përshtatje me veçoritë kombëtare, sociale dhe ekonomike të vendit, si dhe me detyrat e perspektivat e ndërtimit socialist të ne.

Projektkushtetuta e re garanton në mënyrë të veçantë pronën kooperativiste. «**Shteti — thuhet në nenin 22 — përkrah zhvillimin dhe fuqizimin e kooperativave bujqësore, shndërrimin e tyre në ekonomi moderne të prodhimit të madh socialist.**» Në këtë çështje është mbajtur parasysh se prona kooperativiste përbën bazën kryesore të marrëdhënieve socialiste e të ndërtimit të socializmit në fshat dhe një ndër themelet e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë në etapën e sotme të zhvillimit të vendit. Ajo ka të bëjë me rreth 60 për qind të popullsisë së përgjithshme të vendit, është një nga faktorët themelorë që sigurojnë rritjen e mirëqenies së fshatarësisë, i cili ndikon në mënyrë të konsiderueshme edhe për mirëqenien e mbarë popullit tonë. Prona kooperativiste zë një vend të rëndësishëm në ekonominë e vendit: kooperativat bujqësore japin rreth 77 për qind të prodhimit të përgjithshëm bujqësor dhe rreth 70 për qind të të ardhurave kombëtare që krijohen në bujqësi, si edhe një pjesë të konsiderueshme të akumulimit socialist për zhvillimin e përgjithshëm të vendit.

Por është e njohur se prona kooperativiste ka karakter historik dhe se qëllimi i fundit i zhvillimit të saj është afrimi e pastaj kthimi i saj në pronë të të gjithë popullit. Natyrisht, ky është një proces i gjatë e i gjithanshëm, që udhëhiqet në mënyrë të vetëdijshme nga Partia dhe shteti socialist, në përputhje me kushtet objektive dhe që realizohet me vullnetin e lirë të kooperativistëve. . .

Në etapën e tanishme të zhvillimit, shteti ynë socialist, ndërson ndalon pronën private mbi mjetet e prodhimit, **njuh dhe mbron pronën vetjake të shtetasve**, e cila ka të bëjë me përvetësimin vetjak të një pjese të produktit shoqëror, të caktuar për plotësimin e nevojave materiale e kulturore të punonjësve. Rëndësi vendimtare ka fakti që prona vetjake është përcaktuar si pronë që shërben **vetëm për konsum vetjak e familjar** dhe që ka si burim kryesor të formimit të saj të ardhurat nga puna e nga burime të tjera të ligjshme. Për t'i mbyllur çdo rrugë spekulimit apo shfrytëzimit me anën e kësaj prone, është theksuar se **prona vetjake nuk mund të përdoret në dëm të interesit shoqëror**. Në këtë çështje Partia jonë i është përmbytur e i përmbahet tezës së Marksit e të Engelsit që përvetësimi vetjak i produkteve të punës t'i shërbejë plotësimit të nevojave të anëtarëve të shoqërisë dhe ky përvetësim të jetë i tillë që të mos lejojë «. . . asnjë teprice, e cila do të mund të krijonte kushtet për të sunduar mbi punën e të tjerëve»¹.

1 K. Marks, F. Engels. «Manifesti i Partisë Komuniste», f. 35. Tiranë, 1974.

Sanksionimi kushtetues i pronës socialiste mbi mjetet e prodhimit ka rëndësi të dorës së parë për të ruajtur e për të zhvilluar karakterin socialist të marrëdhënieve në prodhim, si edhe për të siguruar riprodhimin konsekuent të tyre. Mirëpo kjo nuk është gjithçka. Teoria marksiste-leniniste dhe praktika revolucionare vërtetojnë se përmbytja socialiste e marrëdhënieve në prodhim nuk përcaktohet thjesht nga forma juridike e pronësisë mbi mjetet e prodhimit, por në radhë të parë e mbi të gjitha nga fakti se kush i zotëron realisht mjetet e prodhimit dhe në interes të kujt bëhet përdorimi i tyre; çfarë marrëdhëniesh vendosen në shkëmbimin e veprimtarisë prodhuese, në organizimin e drejtimin e prodhimit e të gjithë jetës së vendit; çfarë marrëdhëniesh veprojnë në shpërndarjen e produktit për vete e të produktit për shoqërinë; kush vihet në plan të parë gjatë përdorimit të mjeteve të prodhimit, interesi shoqëror, i grupit apo ai vetjak (fitimi). Pikërisht për këtë arsye Projektkushtetuta e re, duke pasqyruar drejt luftën e gjithanshme që zhvillohet në vendin tonë në këto drejtime, përvojën e pasur që është arritur, si dhe mësimet që rrjedhin nga ajo që ndodhi në Bashkimin Sovjetik e në disa vende të tjera, ka sanksionuar një sërë parimesh dhe masash që të ruhen e të forcohen marrëdhëniet socialiste në prodhim, që të mos lejohet degjenerimi i pronës socialiste dhe të mos bëhen shtrembërime në karakterin socialist të shpërndarjes së prodhimit shoqëror.

Që të garantohet përdorimi i pronës socialiste me të vërtetë në interes të ndërtimit të socializmit, ashtu siç e kërkon edhe vetë natyra e saj, në Projektin e paraqitur për shqyrtim është përcaktuar qartë se «**Shteti organizon, drejton e zhvillon tërë jetën ekonomike e shoqërore me plan unik e të përgjithshëm, me qëllim që të plotësohen nevojat materiale e kulturore gjithnjë në rritje të shoqërisë, të forcohet pavarësia dhe mbrojtja e vendit**» (neni 25). Kjo normë kushtetuese i detyron shtetin dhe kooperativat bujqësore që mjetet e prodhimit dhe akumulimin shoqëror t'i përdorin në mënyrë të centralizuar, duke siguruar me vetëdije përparësinë e interesave shoqërore, si edhe përputhjen e tyre me interesat e kolektivave e të individit; sjell me vete forcimin e monopolit të shtetit mbi tregtinë e jashtme, përqendrimin gjithnjë më shumë të tregtisë së brendshme në duart e shtetit dhe rritjen e kontrollit të tij edhe mbi atë tregti të vogël që zhvillohet në tregun fshatar; i mbyll rrugën vënies në plan të parë të fitimit, decentralizimit të ekonomisë, lojës së lirë të çmimeve, lindjes së konkurrencës, të spontaneitetit dhe të fenomeneve të tjera kapitaliste, që karakterizojnë jetën ekonomiko-shoqërore të vendeve ku sundojnë revizionistët, me tërë pasojat e njohura që rrjedhin nga këto fenomene.

Me rëndësi të veçantë për ruajtjen e rendit shoqëror-ekonomik

mik socialist nga rreziku i degjenerimit borgjez e revizionist janë masat e parashikuara në Projektin e Kushtetutës së re në fushën e marrëdhënieve të punës e të shpërndarjes.

Duke pranuar si normë kushtetuese se «puna përbën burimin kryesor për sigurimin e mjeteve të jetesës të çdo shtetasi» (neni 29) në shoqërinë tonë askujt nuk i lejohet të jetojë duke përvetësuar punën e tjetrit ose të sigurojë mjete jetese në rrugë të paligjshme, i mbyllet rruga shfrytëzimit të punës me mëditje, spekulimit e parazitizmit në kurriz të masave punonjëse, të cilat janë bërë sot një tipar masiv në vendet ku sundojnë revizionistët.

Krahas kësaj, theksohet se «shteti synon ngushtimin e dallimeve midis punës mendore e punës fizike, midis punës në industri e punës në bujqësi» (neni 29). Vetë përfshirja në Projekt-kushtetutë e kësaj çështjeje parimore të zhvillimit socialist e të ecjes drejt komunizmit e angazhon edhe ligjërisht shtetin dhe të gjitha organet e tij të marrin masat e nevojshme praktike që, duke u mbështetur në rezultatet e deritanishme pozitive, të çojnë më tej përpara zgjidhjen e këtij problemi. Kjo është një politikë diametralisht e kundërt me atë që zbatojnë jo vetëm vendet kapitaliste, por edhe ato revizioniste. Në këto vende është e theksuar kundërvënja ndërmjet punës mendore e asaj fizike, ndërmjet qytetit e fshatit, industrisë e bujqësisë dhe janë tipike fenomene të tilla si braktisja masive e fshatit, dyndja e fshatarësisë në qytete në kërkim të punës dhe shtimi në përmasa të mëdha i qyteteve, duke acaruar e thelluar kontradiktat ekonomike dhe konfliktet sociale.

Në Projektin e Kushtetutës së re është sanksionuar parimi i njohur socialist «nga secili sipas aftësive, secilit sipas punës» (neni 30). Megjithatë, duhet theksuar se vetëm shpallja e këtij parimi nuk e zgjidh vetvetiu e deri në fund çështjen e ruajtjes së karakterit socialist të marrëdhënieve në këtë fushë. Këtë e vërteton më së miri përvoja e hidhur e vendeve revizioniste, ku degjenerimi i marrëdhënieve të shpërndarjes u bë ndër shkaqet kryesore që sollën lindjen e një shtrese të privilegjuar e të borgjezuar, e cila shërbeu si baza sociale e revizionizmit dhe në likuidimin e marrëdhënieve socialiste në prodhim. Pa lejuar shkarje në pozitë e barazisë mikroborgjeze në shpërndarje, Partia jonë është kundër diferencimeve të mëdha në të ardhurat, ajo ka marrë e merr masa për kufizimin sa më shumë të «së drejtës borgjeze» në shpërbllimin e punës

«Standardi i jetesës — thekson shoku Enver — nuk duhet lejuar që të ngrihet me diferencime të mëdha, zyrtarët nuk duhet të rrojnë shumë më mirë se punëtorët dhe fshatarët më keq se aleatët e tyre të qytetit. Kjo gjë rrjedh

veçanërisht nga rrogat e larta të zyrtarëve. Një situatë e tillë krijon ata elementë të borgjezisë së re që lind nga gjiri i klasës, nga gjiri i Partisë, të cilët, në rast se nuk ndreqen e nuk spastrohen, bëhen të rrezikshëm»¹.

Projektkushtetuta e tanishme e mban parasysh këtë çështje jetike për fatet e socializmit dhe e plotëson parimin socialist të shpërndarjes sipas punës me disa norma të tjera kushtetuese, siç janë: shpërbllimi i nëpunësve në raport të drejtë me punëtorët e kooperativistët për të mos lejuar krijimin e ndonjë shtrese të privilegjuar, shpërbllimi i punës duke kombinuar drejt stimujt materialë me ata moralë e duke u dhënë përparësi stimujve moralë, rritja e vazhdueshme, në përputhje me mundësitë që krijon zhvillimi i ekonomisë së vendit, i fondit shoqëror të konsumit për plotësimin e nevojave të përbashkëta të shtetasve, që përfaqëson filiza të shpërndarjes së ardhshme komuniste «nga secili sipas aftësive, secilit sipas nevojave».

Në kuadrin e masave që parashikon Projekti i Kushtetutës së re për ruajtjen dhe për forcimin e rendit shoqëror-ekonomik në vendin tonë, për shmangien e rrezikut të degjenerimit të tij, nga brenda ose nga jashtë qoftë, është konsakruar parimi se zhvillimi i ekonomisë dhe gjithë ndërtimi i socializmit të ne mbështet kryesisht në forcat e veta. Shpallja si një normë kushtetuese e parimit të mbështetjes në forcat e veta në ndërtimin e socializmit në vendin tonë përbën një afirmim të tezës së njohur marksist-leniniste se faktori i brendshëm është faktori kryesor në revolucion e në ndërtimin socialist, ndërsa faktori i jashtëm një faktor ndihmës. Ky është një parim thellësisht revolucionar e mobilizues dhe thellësisht internacionalist, sepse klasa punëtoare dhe punonjësit e secilit vend e kryejnë detyrën e vet ndërkombëtare para së gjithash duke bërë revolucionin e duke ndërtuar me sukses socializmin në vendin e tyre. Siç e ka treguar me qartësi të madhe përvoja jonë historike, zbatimi konsekuent i parimit të mbështetjes në forcat e veta është vendimtar për ruajtjen dhe për forcimin e vazhdueshëm të pavarësisë ekonomike e politike të vendit. Partia jonë ka hedhur poshtë me vendosmëri predikimet e revizionistëve hrushovianë mbi të ashtuquajturën «integracion ekonomik» e «ndarje socialiste ndërkombëtare të punës», të cilat kanë për qëllim skllavërimin ekonomik e politik të vendeve të ndryshme ndaj socialimperializmit sovjetik.

Në të njëjtën kohë, në Projektkushtetutë është fiksuar se ndalohet dhënia e koncesioneve, krijimi i shoqërive dhe institucioneve të tjera ekonomike e financiare të huaja ose të përbashkëta me monopolet dhe shtetet kapitaliste, borgjeze e revizioniste, si

¹ Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1974-1975», f. 168.

edhe marrja e kredive prej tyre. Në këtë mënyrë u mbyllet rruga çfarëdo ndërhyrjeje e ndikimesh nga jashtë, që do të çonin në cenimin e pavarësisë së vendit dhe degjenerimin e rendit tonë socialist, si edhe çfarëdo orvatjeje e spekulimesh, nga cilidoqoftë brenda vendit, për ta futur vendin në të tilla lloj marrëdhëniesh me botën kapitaliste e revizioniste.

5. — Problemet që lidhen me pozitën e njeriut në shoqërinë socialiste zënë një vend të rëndësishëm në Projektin e Kushtetutës së re. Aty janë pasqyruar në mënyrë të plotë dhe të saktë roli dhe synimi i njeriut në shoqërinë tonë socialiste, interesat dhe mënyra e mbrojtjes së tyre, të drejtat dhe detyrat e tij themelore. Duke sanksionuar fitoret e arritura në rrugën e ndërtimit socialist, Projekti shpreh qartë pozitën e njeriut në Shqipërinë socialiste, që karakterizohet nga zhdukja e çdo shtypjeje dhe shfrytëzimi, nga shndërrimi i masave punonjëse, me klasën punëtore në krye, në zot të plotfuqishëm të fateve të veta, të shtetit të vet proletar, që luftojnë e kanë si qëllim përfundimtar ndërtimin e shoqërisë së plotë socialiste e komuniste. **Të drejtat dhe detyrat e shtetasve** dalin, pra, si një shprehje e qartë e çlirimit të vërtetë të personit në kushtet e shoqërisë socialiste dhe si një ndër fushat themelore të demokracisë sonë socialiste për masat më të gjera të punonjësve.

Cilat janë tiparet më të rëndësishme të Projektit të Kushtetutës lidhur me të drejtat dhe me detyrat e shtetasve?

Para së gjithash, Projekti i Kushtetutës së re shpreh e sanksionon **parimin e unitetit të interesave të individit dhe të shoqërisë socialiste, duke u dhënë përparësi këtyre të fundit.** Harmonizimi i interesave vetjake me ato shoqërore, ku përparësinë e kanë interesat e përgjithshme, është tipar dallues i zhvillimit të shoqërisë socialiste. Natyrisht, midis këtyre interesave mund të lindin edhe kontradikta, por tendenca e zhvillimit të shoqërisë socialiste shpie në afrimin gjithnjë më shumë të interesave vetjake e shoqërore. Zhdukja e pronës private dhe e pushtetit politik që ngrihet mbi të dhe vendosja në vend të tyre e pushtetit popullor dhe e pronës shoqërore mbi mjetet e prodhimit përbën bazën e vërtetë për unitetin e interesave të individëve të veçantë dhe të interesave të shoqërisë socialiste në tërësi...

Uniteti i interesave të individit dhe të shoqërisë socialiste gjen konkretizim në **lidhjen e ngushtë e në harmonizimin që ekziston te ne midis të drejtave dhe detyrave të shtetasve.** Në shoqërinë tonë socialiste, ku vetë populli me klasën punëtore në krye është në fuqi, të drejtat dhe detyrat e shtetasve nuk përjashtojnë njëra-tjetrën, por harmonizohen e presupozojnë njëra-tjetrën. Kjo është krejt e kundërta e asaj që ndodh në vendet kapitaliste e revizioniste, ku detyrat e shtetasve ndeshen me liritë e të drejtat demokratike që formalisht shpallen, sepse atje detyrat shprehin

interesat e borgjezisë, të vjetër apo të re, dhe shërbejnë për të shfrytëzuar e për të mbajtur nën sundim punonjësit.

Kjo ka të bëjë edhe me çështjen e raportit midis lirisë e disiplinës në socializëm. Ne hedhim poshtë si praktikat borgjeze e revizioniste-burokratike të privimit efektiv të punonjësve nga të drejtat e liritë demokratike, ashtu edhe predikimet vulgare anarkisto-liberale të «lirisë absolute». Liria «e plotë» apo «absolute» është një frazë boshe. Krahas lirisë të mëdha sociale e politike, socializmi kërkon një shkallë të lartë discipline proletare në punë e në jetë. Por disiplina e urisë dhe e kërbacit, që sundon në botën kapitaliste, ia lëshon vendin në socializëm disiplinës së ndërgjegjshme e të çeliktë proletare në kohën e punës e jashtë saj, në kryerjen e detyrave nga secili, në zbatimin e ligjeve tona revolucionare e të normave të bashkëjetesës socialiste, pa përjashtuar edhe përdorimin e masave të detyrimit ndaj tyre që u shmangen detyrave, thejnë disiplinën dhe shkelin ligjet e diktaturës së proletariatit. Këto çështje të rëndësishme të jetës sonë shoqërore e shtetërore janë pasqyruar gjerësisht në Projektin e Kushtetutës së re.

Aty thuhet gjithashtu se të drejtat dhe detyrat e shtetasve nuk mund të ushtrohen në kundërshtim me rendin socialist. Me këtë theksohet **karakteri klasor i të drejtave dhe i detyrave të shtetasve tanë.** Projekti i Kushtetutës së re nisat në këtë çështje nga teza se nuk mund të bëhet fjalë për liri dhe të drejta abstrakte, se, siç theksonte Lenini, gjithmonë çështja shtrohet vetëm kështu: Liri nga shtypja e cilës klasë? Barazi e cilës klasë dhe me cilën? Demokraci mbi bazën e pronës private apo mbi bazën e zhdukjes së pronës private?

Një tipar me shumë rëndësi për të drejtat dhe detyrat e shtetasve tanë dhe një tregues të qartë të karakterit me të vërtetë demokratik të rendit tonë shtetëror e shoqëror socialist përbën **tendenca e zhvillimit, e zgjerimit dhe e pasurimit të mëtejshëm të këtyre të drejtave e lirisë krahas shkallës së zhvillimit të mëtejshëm socialist të vendit.** Kjo rrjedh edhe nga vetë qëllimi që ndjek te ne ushtrimi i të drejtave dhe i detyrave të shtetasve, i cili i shërben zhvillimit të gjithanshëm të personalitetit të njeriut punonjës, të aftësive e të energjive të tij krijuese, thellimit të vazhdueshëm të demokracisë socialiste, pjesëmarrjes aktive e të ndërgjegjshme të çdo punonjësi në drejtimin e punëve të shtetit e të shoqërisë dhe të gjitha këto së bashku përparimit të mëtejshëm e të pandërprerë të shoqërisë socialiste në tërësi në rrugën drejt komunizmit.

Kjo tendencë e zhvillimit, e zgjerimit dhe e pasurimit të të drejtave e të lirisë të shtetasve është e lidhur ngushtë me kushtet gjithnjë më të favorshme që krijohen e do të krijohen çdo ditë në shoqërinë tonë socialiste për realizimin e tyre në praktikë, gjë për të cilën dëshmon qartë tërë zhvillimi ynë socialist 30-vjeçar.

Për këtë jepen edhe garancitë e nevojshme në Projektin e Kushtetutës së re. Dhe pikërisht kjo është themeloria në tërë çështjen e lirive dhe të drejtave të njeriut punonjës, këtu qëndron dallimi më i thellë i demokracisë socialiste nga «demokracia» e rreme borgjeze e revizioniste në këtë fushë.

Barazia e përgjithshme dhe reale e shtetasve para ligjit, mosnjohja e asnjë kufizimi ose privilegji në të drejtat dhe detyrat e shtetasve për shkak seksi, race, kombësie, arsimit, pozite shoqërore e gjendjeje materiale përfaqëson një ndër parimet më të rëndësishme të institutit të të drejtave e të detyrave të shtetasve. Ajo është gjithashtu një fitore historike e popullit dhe e Partisë sonë, sepse vetëm me përmbysjen e rendit shfrytëzues dhe vendosjen e diktaturës së proletariatit, me zhdukjen e pronës private dhe triumfin e marrëdhënieve socialiste është e mundur të likuidohet pabarazia dhe të sigurohet në fakt, në praktikë barazia që shpallet me ligj.

Parimi i barazisë gjen në Projektin e Kushtetutës një ndër konkretizimet më të rëndësishme në të drejtat e barabarta të gruas me burrin në punë, në shpërblim, në pushim, në sigurimin shoqëror, në arsim, në tërë veprimtarinë shoqërore-politike dhe në familje. Kjo barazi përbën një nga realizimet e mëdha në veprën historike të Partisë dhe të pushtetit tonë, duke pasur parasysh sidomos pozitën e shtypur e të shfrytëzuar të dikurshme të gruas shqiptare. Gruaja zë në shoqërinë tonë socialiste vendin e denjë të pjesëtarit të saj të barabartë, me të drejta dhe me liri të plota civile; ajo është bërë luftëtare aktive e ndërtimit socialist dhe e mbrojtjes së vendit, prandaj edhe ligji themelor i shtetit tonë i kushton çështjes së pozitës së gruas një rëndësi e kujdes të posaçëm. Kjo përbën edhe bazën kushtetuese të luftës së mëtejshme për emancipimin e plotë të gruas në vendin tonë.

Pasqyrim të drejtë ka gjetur në Projektin e Kushtetutës së re parimi i barazisë në çështjen e pakicave kombëtare. Ashtu si edhe në Kushtetutën e derisotme, edhe Projektkushtetuta e re shpall politikën thellësisht demokratike e përparimtare të shtetit tonë ndaj pakicave kombëtare, mbrojtjen dhe zhvillimin e kulturës e të traditave të tyre popullore, zhvillimin e barabartë në të gjitha fushat e jetës shoqërore, përdorimin e gjuhës amtare dhe mësimin e saj në shkollë, ndalimin dhe ndëshkimin e çdo privilegji e pabarazie kombëtare. Në këtë gjejnë pasqyrim mësimet e marksizëm-leninizmit se në një shoqëri të vërtetë socialiste nuk mund të ketë vend për kurrfarë pabarazie e shtypjeje kombëtare, se vetëm në një shoqëri të tillë pakicat kombëtare mund të gjejnë afirmimin e plotë të zhvillimit të barabartë.

Projekti i Kushtetutës u njeht shtetasve të drejta të gjera socialekonomike, si të drejtën për punë, për pushim, për arsim, për ndihmë mjekësore falas, për ndihmë materiale në rast sëmundjeje

ose humbje të aftësisë për punë etj. Këtu duhet të përmendim edhe nenet e tjera të Projektit, ku sanksionohen fitore të tilla të rëndësishme të viteve të fundit, si shtrirja e sigurimit shoqëror edhe në kooperativistët, si një shprehje tjetër e qartë e kujdesit të shtetit tonë socialist për ngritjen e mëtejshme të nivelit të jetesës së fshatit, si një fitore tjetër e madhe e sistemit tonë socialist; po kështu edhe realizimi tjetër, që shpalli për herë të parë në botë Shqipëria socialiste, mbi heqjen e çdo lloj tatimi e takse nga popullsia.

Projekti i Kushtetutës sanksionon gjithashtu të tilla të drejta e liri të rëndësishme demokratike e personale, si liria e fjalës, e shtypit, e organizimit, e grumbullimit, e mbledhjes, e manifestimit publik, e drejta elektorale, paprekshmëria e personit, e banesës, fshehtësia e korrespondencës, e drejta e ankesës etj.

Në detyrat kryesore të shtetasve tanë janë parashikuar: respektimi i Kushtetutës dhe i ligjeve të tjera të vendit; ruajtja dhe forcimi i rendit socialist si dhe zbatimi i rregullave të bashkëjetesës socialiste; ruajtja dhe forcimi i pronës socialiste; mbrojtja e ambientit nga prishja dhe ndotja; mbrojtja e atdheut socialist dhe, lidhur me këtë, detyrimi i përgjithshëm ushtarak dhe përgatitja e vazhdueshme luftarake.

6. Mbi bazën e marksizëm-leninizmit, të programit e të vijës së PPSH, në Projektin e Kushtetutës së re janë përcaktuar e kanë gjetur sanksionim qëllimet dhe detyrat themelore të shtetit tonë të diktaturës së proletariatit, drejtimit kryesor të veprimtarisë së tij në fushën e politikës së brendshme e të jashtme, në përshtatje me etapën e sotme të zhvillimit socialist të vendit dhe epokën tonë historike.

«**Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë** — thuhet në nenin 4 të Projektit — zhvillon pandërprerë revolucionin duke iu përmbajtur luftës së klasave dhe ka për qëllim të sigurojë fitoren përfundimtare të rrugës socialiste mbi rrugën kapitaliste, të arrijë ndërtimin e plotë të socializmit e të komunizmit». Ky objektiv i përgjithshëm gjen zërthim e konkretizim të hollësishtëm në tërë tekstin e Projektit të Kushtetutës (në Hyrjen dhe në nenet e ndryshme të tij). Lidhur me këtë, disa momente thelbësore meritojnë vëmendjen:

Këtu gjen pasqyrim teza marksiste-leniniste se shteti i diktaturës së proletariatit është armë e revolucionit socialist, i cili, siç theksonin Lenini e Stalini, vetëm fillon me marrjen e pushtetit nga klasa punëtore. Nga kjo pikëpamje, misioni historik i shtetit proletar është ta çojë këtë revolucion deri në fund, deri në fitoren e plotë e përfundimtare, duke marrë njëkohësisht të gjitha masat për t'i mbyllur rrugën rrezikut të kthimit prapa në kapitalizëm, siç është ai i degjenerimit revizionist e borgjez të rendit socialist.

Në përshtatje me etapën e tanishme të zhvillimit tonë, shteti i diktaturës së proletariatit të ne përbën armën vendimtare në duart e masave punonjëse nën udhëheqjen e klasës punëtore e të Partisë së saj të Punës për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste dhe zbatimin e parimeve të socializmit. Me fjalë të tjera, ai shërben për zhvillimin e vrullshëm të forcave prodhuese dhe rritjen e fuqisë e të pavarësisë ekonomike të vendit, për përsosjen e përshtur të marrëdhënieve socialiste në prodhim, mbrojtjen e pronës socialiste, ushtrimin e kontrollit mbi masën e punës e të konsumit dhe respektimin e parimit socialist të shpërndarjes, për zhvillimin e kulturës socialiste e të revolucionit tekniko-shkencor, për rritjen e vazhdueshme të mirëqenies materiale e të nivelit kulturor të masave, për sigurimin e të drejtave e të lirive demokratike të punonjësve dhe zhvillimin e personalitetit të njeriut, që përbëjnë qëllimin e socializmit, për ngushtimin gradual të dallimeve klasore dhe përgatitjen e kushteve për kalimin në të ardhmen në shoqërinë komuniste pa klasa.

Për të çuar përpara deri në fund revolucionin socialist dhe ndërtimin e plotë të socializmit, detyra e shtetit tonë të diktaturës së proletariatit është gjithashtu të bashkojë rreth klasës punëtore dhe pararojës së saj, Partisë së Punës, të gjithë punonjësit në arritjen e këtyre objektivave, t'i tërheqë aktivisht ata në qeverisjen e vendit nëpërmjet formave të larmishme të demokracisë socialiste, të zhvillojë një luftë klasore të gjithanshme për çlirimin e ndërgjegjes së punonjësve prej çfarëdo mbeturinash e ndikimesh të huaja, për formimin dhe për kalitjen e njeriut të ri të shoqërisë socialiste, të pajisur me botëkuptim, ideale e virtyte proletare.

Të gjitha këto detyra e funksione të shtetit tonë socialist, që kanë gjetur pasqyrim të gjerë në Projektin e Kushtetutës së re, janë mishërim i parimeve të njohura të klasikëve të marksizëm-leninizmit, të gërshetuara ngushtë me përvojën historike të vendit tonë e të vendeve të tjera.

Rëndësi e veçantë u kushtohet në Projektkushtetutë **problemeve të mbrojtjes së fitoreve të revolucionit e të atdheut socialist**, si një ndër detyrat themelore të diktaturës sonë të proletariatit. Në këtë çështje Projekti pasqyron idetë origjinale të Partisë së Punës të Shqipërisë, veçanërisht vendimet e plenumeve të 5-të e të 6-të të Komitetit Qendror të PPSH.

Partia jonë, duke u nisur nga fakti se ndërtimi i socializmit në Shqipëri bëhet në kushtet e rrethimit imperialisto-revizionist, e konsideron detyrën e mbrojtjes së atdheut si detyrë mbi detyrat. Ruajtja e fitoreve të revolucionit popullor dhe të ndërtimit socialist, mbrojtja e lirisë, e pavarësisë kombëtare, e tërësisë territoriale të vendit, paprekshmëria e kufijve të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe shpallja e territorit të saj si të patjetërsueshëm

kanë marrë sanksionim të plotë në Projektin e Kushtetutës së re. Në të njëjtën kohë, është fiksuar shprehimisht se askujt nuk i njihet e drejta të nënshkruajë ose të pranojë në emër të shtetit tonë kapitullimin ose pushtimin e vendit, gjë që dënohet si tradhti ndaj atdheut, se në territorin e shtetit tonë nuk lejohet vendosja e bazave dhe e forcave ushtarake të huaja. Kështu, nga njëra anë, sanksionohet si një normë kushtetuese e drejta e pamohueshme e popullit shqiptar për të mbrojtur në çfarëdo rrethanash atdheun socialist nëpërmjet luftës popullore dhe u pritët rruga çfarëdo spekulimeve të mundshme për të shitur pavarësinë e vendit, ndërsa nga ana tjetër shpallet se kurrë territori i Shqipërisë socialiste nuk do të lejohet të përdoret si një bazë për të kryer agresion kundër popujve të tjerë.

Projekti i Kushtetutës sanksionon qartë, si një parim të madh, tezën marksiste-leniniste të Partisë sonë se mbrojtja e atdheut dhe e fitoreve të socializmit është çështje e të gjithë popullit dhe sigurohet nga **populli i armatosur**, i organizuar në forcat e armatosura dhe i përgatitur ushtarakisht. Në këtë është përgjithësuar një përvojë e re historike, e cila përbën një kontribut të rëndësishëm të Partisë sonë në doktrinën mbi diktaturën e proletariatit, një zbatim krijues në kushtet tona të mësimave të klasikëve të marksizëm-leninizmit mbi domosdoshmërinë e zëvendësimit të «ushtrisë së kazermës» me popullin e armatosur, duke e bërë «çdo qytetar ushtar dhe çdo ushtar qytetar». Armatosja e gjithë popullit është gjithashtu një ndër shfaqjet më të thella të demokracisë socialiste, një shprehje e gjallë e zbatimit të vijës së masave në luftën klasore kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, është kusht vendimtar për zhvillimin e luftës popullore sipas parimeve të Artit tonë Ushtarak Popullor, si edhe një garanci efektive kundër rrezikut të përdorimit të ushtrisë si një mjet për t'iu imponuar popullit, siç u veprua në Bashkimin Sovjetik e në disa vende të tjera nga renegatët revizionistë që uzurpuan pushtetin.

Projekti i Kushtetutës sanksionon veçanërisht në fushën e mbrojtjes së atdheut parimin tjetër të madh se «**Forcat e armatosura udhëhiqen nga Partia e Punës e Shqipërisë**» (neni 91). Në këtë kuadër, neni 92 fikson se «Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH është Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Kryetar i Këshillit të Mbrojtjes». Në këtë është pasqyruar ajo përvojë e pasur e popullit tonë dhe e socializmit ndërkombëtar, e cila dëshmon se vetëm nën udhëheqjen e Partisë proletare është e mundur të krijohet një ushtri e vërtetë revolucionare e klasës punëtore, se udhëheqja e një partie të tillë është faktori kryesor për t'i ruajtur kurdoherë forcat e armatosura të diktaturës së proletariatit si armë të vetëdijshme të revolucionit e për të mos lejuar shndërrimin e tyre në një armë të verbër të kundër-

revolucionit revizionist e borgjez, se udhëheqja e Partisë është vendimtare për të arritur fitoren në luftën popullore kundër të gjithë armiqve, sado të mëdhenj e të fuqishëm qofshin ata.

Detyrat kryesore të shtetit tonë socialist dhe parimet themelore nga të cilat udhëhiqet ai në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare e të politikës së jashtme janë përcaktuar në mënyrë të posaçme në Projektin e Kushtetutës së re.

Internacionalizmi proletar përbën bazën e bazave të politikës së jashtme e të qëndrimeve të Partisë e të shtetit tonë socialist në trajtimin e të gjitha çështjeve ndërkombëtare. Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë — thuhet në Projekt — ndjek politikën e miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke me shtetet socialiste në bazë të marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar; përkrah lëvizjen revolucionare të klasës punëtore dhe luftën e popujve për liri, pavarësi e përparim shoqëror. Duke i qëndruar besnike në mënyrë të patundur parimit të internacionalizmit proletar, Shqipëria socialiste shpall si një parim kushtetues se kundërshton çdo formë të agresionit imperialist, të shfrytëzimit kolonial, të tutelës, të diktatit dhe të hegjemonisë, të shtypjes kombëtare dhe të dallimit racor dhe i përmbahet parimit të vetëvendosjes së popujve, të ushtrimit të sovranitetit të plotë kombëtar dhe të barazisë së të gjitha vendeve në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Krahas kësaj, në Projektkushtetutë, përcaktohet se Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë është luftëtare konsekuente **për paqen dhe fqinjësinë e mirë**, për marrëdhënie me të gjitha shtetet mbi bazën e barazisë, të respektimit të sovranitetit, të mosndërhyrjes në punët e brendshme dhe të dobisë reciproke.

Siç e ka karakterizuar shoku Enver në fjalimin e tij të 3 tetorit 1974 para zgjedhësve, politika e jashtme e Partisë dhe e shtetit tonë socialist është politikë marksiste-leniniste e thellësisht revolucionare. Ajo është politikë e parimeve të patundura e jo politikë pragmatiste e kompromiseve të paprincipia, e koniunkturave dhe e përfitimeve të çastit; është politikë e hapur që zhvillohet nën dritën e diellit dhe i thotë të katër të vërtetat në fytyrë e jo politikë e prapaskenave në kurriz të popujve, e lajkave, e dredhive dhe e mashtrimeve pas shpine; është politikë e guximit për të ngritur zërin e së vërtetës e për të mbrojtur të drejtat sovrane të popujve e të kombeve e jo politikë e përkuljes së kurrizit, e nënshtrimit dhe e kapitullimit përballë arrogancës e shantazhit të «të mëdhenjve».

Pikërisht sepse Shqipëria socialiste ka ndjekur e ndjek me konsekuencë një politikë të tillë të jashtme, pozita ndërkombëtare e saj është forcuar dita-ditës, ajo ka fituar dashurinë dhe admirimin e popujve të të gjithë botës, autoriteti dhe prestigji ndërkombëtar i saj janë rritur gjithnjë më shumë.

Kjo është, në vija të përgjithshme, përmbajtja themelore e Projektkushtetutës së re. Tani ne kemi në dorë një Projekt-bazë, i cili nga tërë brendia e tij përbën një dokument krejt të ri.

Duke mishëruar parimet themelore të marksizëm-leninizmit, idetë e Partisë sonë dhe përvojën tonë revolucionare, Kushtetuta e re do të jetë një kontribut i ri i Partisë së Punës të Shqipërisë në teorinë dhe në praktikën revolucionare të socializmit. Ajo do të forcojë më tej shtetin dhe gjithë shoqërinë tonë socialiste, do të shërbejë si bazë për zhvillimin e tyre të gjithanshëm, do të armatosë e do të frymëzojë punonjësit në luftën e punën e tyre për të çuar përpara revolucionin, për ndërtimin e plotë të socializmit.

Shpallja e Kushtetutës së re do të shënojë një fitore tjetër të madhe të Shqipërisë së re në rrugën e saj të lavdishme të socializmit e të komunizmit, në të cilën na udhëheq me urtësi e largpamësi Partia jonë e Punës dhe shoku Enver.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI HARTIMIN E KUSHTETUTËS SË RE»

10 tetor 1975

Plenumi i 8-të i Komitetit Qendror të PPSH në mbledhjen e datës 10.10.1975, në zbatim të detyrës që shtroi Kongresi i 6-të i Partisë për hartimin e Kushtetutës së re të shtetit tonë, mori në shqyrtim Projektin e Kushtetutës, si dhe raportin përkatës paraqitur nga Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH dhe, pasi diskutoi gjerësisht rreth tyre,

Vendosi:

1. — Të miratojë Projektin e Kushtetutës së re dhe raportin shpjegues mbi këtë çështje, paraqitur nga Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH.

2. — T'i paraqesë Kuvendit Popullor të RPSH propozimet mbi hartimin e Kushtetutës së re dhe krijimin e një komisioni të posaçëm për këtë qëllim.

3. — Ngarkohen organizatat e Partisë, organet shtetërore, si dhe organizatat e masave që të zhvillojnë një punë të gjerë propagandistike sqaruese me rastin e diskutimit popullor dhe të miratimit të Kushtetutës së re.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

ORIENTIME

TË BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI ORGANIZIMIN E NDIHMËS ME FORCA PUNE NGA QYTETI PËR KOOPERATIVAT DHE PËR NDERMARRJET BUJQËSORE»

22 tetor 1975

Punonjësit e qytetit, të frymëzuar nga mësimet e Partisë, kanë marrë një varg iniciativash revolucionare për të ndihmuar në kryerjen me kohë të punëve të ndryshme në bujqësi. Kjo ndihmë po merr gjithnjë e më shumë karakter masiv, veçanërisht gjatë periudhave në të cilat punonjësit e bujqësisë janë të ngarkuar me shumë punë. Duke i konsideruar këto iniciativa si shprehje të kuptimit politiko-ideologjik të problemeve të bujqësisë, që lidhen me mirëqenien e popullit, me forcimin e ekonomisë dhe me mbrojtjen e atdheut, Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH i përshëndet dhe i vlerëson shumë lart ato dhe porosit të gjitha organet dhe organizatat e Partisë që t'i zhvillojnë më tej, duke pasur parasysh edhe këto orientime:

1. — Të gjitha qendrat e punës e të prodhimit në qytete dhe shkolla t'i japin bujqësisë një ndihmë kurdoherë më të madhe me forca pune për të përballuar më mirë punët intensive në disa periudha të vitit. Për këtë qëllim të bëhet një punë e dendur sqaruese e bindëse me punonjësit, me nxënësit dhe me studentët për të kuptuar thellë përmbajtjen dhe rëndësinë politiko-ideologjike dhe shoqërore-ekonomike të kësaj ndihme. Kjo çështje të trajtohet kurdoherë në prizmin e forcimit të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë, të ngushtimit të dallimeve midis qytetit e fshatit, të ndihmës reciproke, të forcimit të unitetit të popullit tonë dhe të edukimit revolucionar e kalitjes së mëtejshme të punonjësve sidomos të rinisë me frymën e lartë të solidaritetit socialist.

2. — Ndhima për bujqësinë të organizohet mbi baza vullne-

tare kolektive, e programuar dhe e drejtuar. Është e nevojshme që në fillim të çdo viti organet shtetërore dhe ekonomike në rreth të planifikojnë sa forca, ku e kur do t'i dërgojnë ato për të ndihmuar bujqësinë dhe ç'punë do të bëjnë, sidomos në periudhat intensive të punimeve bujqësore, siç janë shërbimet kulturore, korrja dhe shirja e të lashtave, vjelja e prodhimeve bujqësore, mbjellja dhe shërbimet e drurëve frutorë etj.

3. — Nëpunësit, që kryejnë punën drejtpërdrejt në prodhim, si rregull ta bëjnë këtë në bujqësi, brenda ose jashtë rrethit, duke punuar e duke jetuar bashkë me fshatarët e punëtorët, për të mësuar prej tyre dhe për t'u kalitur sa më mirë me jetën. Puna në kooperativat ose në ndërmarrjet bujqësore të jetë një nga frontet kryesore për kryerjen e punës prodhuese të studentëve dhe të nxënësve kur nuk shkojnë të punojnë në aksione kombëtare. Pjesa më e madhe e nxënësve që mbarojnë shkollat e mesme të përgjithshme ta kryejnë në bujqësi stazhin prej 1 viti.

4. — Ndihma me krahë pune nga qyteti për fshatin të çojë në rritjen e mobilizimit dhe të shpirtit revolucionar të klasës punëtore dhe të rinisë shkollore, në zbulimin dhe në shfrytëzimin me efektivitet më të lartë të rezervave e të mundësive të brendshme, në mënyrë që të mos pengohet plotësimi i detyrave të planit në ndërmarrjet ekonomike dhe zbatimimi i programeve mësimore në shkolla. Kjo ndihmë të mos pengojë as pushimin e argëtimit e punonjësve.

5. — Byroja Politike përgëzon gjithë ata punonjës, të rinj e të reja, që kanë shkuar për të jetuar e për të punuar përgjithnjë në fshat dhe u bën thirrje klasës punëtore dhe rinisë që kjo iniciativë të përkrahët e të përhapët gjerësisht. Të zgjerohen e të thellohen edhe iniciativat e tjera të rinisë punëtore për të shkuar në fshat për disa vjet.

6. — I rekomandohet Këshillit të Ministrave të RPSH që, duke u mbështetur në këto orientime, të përcaktojë masat e detyrat konkrete që lidhen me organizimin dhe me drejtimin e ndihmës me forca pune për bujqësinë, në mënyrë që në vitet e ardhshme kjo ndihmë të ngrihet në një nivel edhe më të lartë.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë shpreh bindjen e thellë se këto masa do të mbështeten plotësisht nga klasa punëtore, nga punonjësit e qytetit dhe nga rinia. Ato do të afrojnë më shumë klasën punëtore me fshatarësinë, do të lidhin më mirë qytetin me fshatin dhe do të ndikojnë për ngushtimin gjithnjë e më shumë të dallimeve midis punës në industri dhe punës në bujqësi, midis qytetit dhe fshatit, do të ngrenë çdo ditë e më lart entuziazmin dhe mobilizimin e fshatarësisë kooperativiste dhe të

punonjësve të tjerë të bujqësisë për një organizim më të përsosur të punës dhe për një disiplinë më të fortë në punët e bujqësisë.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI ULJEN E PAGAVE TË LARTA DHE MBI DISA MASA PËR NGUSHTIMIN E MËTEJSHËM TË DALLIMEVE NDËRMJET FSHATIT DHE QYTETIT

26 dhjetor 1975

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 26 dhjetor 1975, mori në shqyrtim studimet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave: «Analizë kritike mbi gjendjen e pagave dhe rrugët për një shpërndarje të drejtë të fuqisë blerëse ndërmjet fshatit dhe qytetit» dhe, pasi diskutoi gjerësisht mbi këto probleme,

V e n d o s i :

1. — Të miratohen në përgjithësi studimet e paraqitura mbi uljen e pagave të larta dhe mbi përballimin nga ana e shtetit të investimeve e të shpenzimeve shoqërore-kulturore të kooperativave bujqësore, duke marrë për bazë relacionin shtojcë, si dhe vërejtjet e propozimet e bëra në mbledhjen e Byrosë Politike.

2. — Këto masa të kuptohen e të zbatohen drejt dhe të bëhen nxitje për një mobilizim më të madh për rritjen e prodhimit dhe për plotësimin e tejkalimin e detyrave të planit.

Si kurdoherë, rruga kryesore për ngritjen e përgjithshme të nivelit të mirëqenies së masave punonjëse të jetë shtimi i prodhimeve bujqësore e industriale, rritja e rendimentit të punës, ulja e kostos dhe, si rrjedhim i këtyre, ulja e çmimeve të artikujve industrialë e ushqimorë.

3. — I rekomandohet Këshillit të Ministrave të RPSH të nxjerrë vendimet përkatëse dhe të marrë masa për zbatimin e tyre.

4. — Organet dhe organizatat e Partisë, organizatat e masave dhe të gjitha organet e shtypit e të propagandës të bëjnë një punë të gjerë e të gjithanshme për të shpjeguar rëndësinë dhe përmbajtjen politiko-ideologjike dhe shoqërore-ekonomike të këtyre masave.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TREGUESI I LENDES

	Faqe
Parathënie	5

1971

1. Letër e Komitetit Qendror të PPSH mbi nevojën e një kthese rrënjësore në përsosjen e organizimit dhe forcimin e disiplinës së punës në bujqësi, 8 janar 1971	9
2. Plenumi i 11-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 25-26 janar 1971	
— Komunikatë	20
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi gjendjen dhe masat që duhen marrë për të ngritur në një nivel më të lartë shërbimin shëndetësor, sidomos profilaksinë dhe higjienën». 26 janar 1971	21
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH mbi thirrjen e Kongresit të 6-të të zakonshëm të Partisë së Punës të Shqipërisë, 26 janar 1971	29
3. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi zhvillimin e mëtejshëm të punës kërkimore-shkencore». 20 prill 1971	31
4. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi disa masa për ngushtimin e mëtejshëm të dallimeve midis fshatit e qytetit dhe për të shpejtuar ngritjen e mëtejshme të mirëqenies së fshatarësisë kooperativiste nëpërmjet përmirësimit të furnizimit dhe sistemit të grumbullimeve». 26 maj 1971	42
5. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi disa masa për zbatimin e drejtë të normave kolektive në bujqësi». 26 maj 1971	47

	Faqe
6. Plenumi i 12-të i Komitetit Qendror të PPSH, Tiranë, 29 qershor — 1 korrik 1971.	
— Komunikatë	50
— Vendim i Plenumit të KQ të PPSH mbi aprovimin e projektdirektivave për planin e pestë pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kulturor të RPSH për vitet 1971-1975. 1 korrik 1971.	51
— Konkluzione nga mbledhja e Plenumit të 12-të të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi masat për përsosjen e mëtejshme të përgatitjes e të gatishmërisë luftarake të ushtrisë dhe të forcave vullnetare të vetëmbrojtjes popullore». 1 korrik 1971	52
7. Plenumi i 13-të i Komitetit Qendror të PPSH, Tiranë, 12 tetor 1971.	
— Komunikatë	68
8. Vendim i Komitetit Qendror të PPSH dhe i Këshillit të Ministrave të RPSH mbi vendosjen e pensioneve për anëtarët e kooperativave bujqësore. 12 tetor 1971	69
9. Vendim i Komitetit Qendror të PPSH dhe i Këshillit të Ministrave të RPSH mbi faljen e kredive që u janë dhënë kooperativave bujqësore për elektrifikimin e krejt fshatrave të vendit. 12 tetor 1971	71
10. Kongresi i 6-të i Partisë së Punës të Shqipërisë. Tiranë, 1-7 nëntor 1971	73
— Raport i mbajtur në Kongresin e 6-të të PPSH nga Sekretari i Parë i KQ të PPSH shoku Enver Hoxha «Mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë». 1 nëntor 1971	75
— Vendim i Kongresit të 6-të të Partisë së Punës të Shqipërisë për aprovimin e raportit «Mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të PPSH». 4 nëntor 1971	203
— Vendim i Kongresit të 6-të të Partisë së Punës të Shqipërisë për aprovimin e raportit të Komisionit Qendror të Kontrollit e të Revizionimit të PPSH. 4 nëntor 1971	204
— Rezolutë e Kongresit të 6-të të Partisë së Punës të Shqipërisë në përkrahje të luftës çlirimtare të popullit vietnamez. 4 nëntor 1971	205

	Faqe
— Vendim i Kongresit të 6-të të Partisë së Punës të Shqipërisë për aprovimin e raportit «Mbi direktivat e planit të pestë pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kulturor të Republikës Popullore të Shqipërisë». 6 nëntor 1971	207
— Direktivat e Kongresit të 6-të të PPSH mbi planin e pestë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës të Republikës Popullore të Shqipërisë për vitet 1971-1975. 6 nëntor 1971	208
— Vendim i Kongresit të 6-të të Partisë së Punës të Shqipërisë mbi aprovimin e direktivave të planit të pestë pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kulturor të Republikës Popullore të Shqipërisë. 6 nëntor 1971	226
— Procesverbal i mbledhjes së Plenumit të 1-rë të Komitetit Qendror të PPSH, Tiranë, 7 nëntor 1971	227
11. Mesazh i Komitetit Qendror të PPSH me rastin e 30-vjetorit të themelimit të BRPSH, 22 nëntor 1971	230
1972	
12. Letër drejtuar organizatave të Partisë, organeve shtetërore dhe ekonomike dhe organizatave të masave mbi disa probleme dhe masa për të përmirësuar propagandën e prodhimit. (Aprovuar në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH). 28 janar 1972	235
13. Plenumi i 2-të i Komitetit Qendror të PPSH, Tiranë, 19-20 qershor 1972	
— Komunikatë	245
— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Të mobilizohemi me të gjitha forcat për të përgjithësuar sistematikisht eksperiencën e përparuar në frontin e prodhimit bujqësor». 19 qershor 1972	246
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH për aprovimin e raportit	277
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi krijimin e Akademisë së Shkencave të RP të Shqipërisë». 20 qershor 1972	278
14. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi organizimin më të mirë të informimit të masave të popullit për veprimtarinë dhe vendimet e organeve shtetërore të zgjedhura. 18 shtator 1972	280

	Faqe
15. Vendim i Sekretariatit të KQ të PPSH mbi forcimin e gjithanshëm të masave tekniko-organizative për sigurimin teknik dhe parandalimin e aksidenteve në punë. 28 tetor 1972	282
16. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi përsosjen e mëtejshme të marrëdhënieve të shpërndarjes sipas punës. 22 nëntor 1972	287
17. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi gjendjen dhe masat që duhen marrë për zhvillimin e mëtejshëm të peshkimit». 22 nëntor 1972	289
1973	
18. Konkluzione të Sekretariatit të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi disa probleme të punës ideopolitike dhe kulturore në ushtri». 19 janar 1973	292
19. Protokoll i Sekretariatit të Komitetit Qendror të PPSH mbi punën e organizatave të Partisë për edukimin masiv agrozooteknik të kooperativistëve. 19 janar 1973	299
20. Plenumi i 3-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 5-6 shkurt 1973.	
— Komunikatë	303
— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi plotësimin e planit të vitit 1972, detyrat kryesore për vitin 1973 dhe disa probleme për përsosjen e mëtejshme të drejtimit të ekonomisë». 5 shkurt 1973	304
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH për aprovimin e raportit	338
21. Protokoll i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi kriteret themelore të kualifikimit dhe të sigurimit të kuadrit në shkollat e larta dhe në institucionet shkencore». 25 prill 1973	339
22. Plenumi i 4-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 26-28 qershor 1973.	
— Komunikatë	346
— Raport i mbajtur nga Sekretari i Parë i KQ të PPSH, shoku Enver Hoxha, «Të thellojmë luftën	

	Faqe
ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre». 26 qershor 1973	347
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH për aprovimin e raportit	400
23. Nga përshëndetja e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, Komandant Suprem i Forcave të Armatosura të RPSH, shokut Enver Hoxha, drejtuar ushtarëve dhe oficerëve me rastin e 30-vjetorit të themelimit të Ushtrisë Popullore. 9 korrik 1973	401
24. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi disa përmirësimet në organizimin gjyqësor. 22 tetor 1973	407
25. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi disa masa për të nxitur prodhimin e mishit. 22 tetor 1973	410
26. Nga protokollin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH lidhur me studimin «Rreth drejtimeve ku mund të përsoset më tej përdorimi i disa levave ekonomike për forcimin e hozrashotit». 22 tetor 1973	413
1974	
27. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi punën për edukimin marksist-leninist të komunistëve. 24 janar 1974	416
28. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi disa probleme të përsosjes së organizimit socialist të punës e të shpërblimit të saj. 28 mars 1974	425
29. Protokoll i Sekretariatit të Komitetit Qendror të PPSH mbi rolin udhëheqës të organizatave-bazë dhe të byrove të Partisë në kooperativat bujqësore të tipit të lartë për realizimin e detyrave të planit dhe për forcimin ekonomiko-organizativ të kooperativave bujqësore. 10 maj 1974	428
30. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi disa masa për zhvillimin e shpejtë të zonave kodrinore-malore. 25 qershor 1974.	433
31. Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 25-26 korrik 1974.	
— Komunikatë	435
32. Plenumi i 6-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 16-17 dhjetor 1974.	
— Komunikatë	436

	Faqe
33. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi planin e zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës në RPSH për vitin 1975. 26 dhjetor 1974.	437
34. Konkluzione të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH mbi punën që bëhet dhe problemet që dalin për edukimin ideestetik dhe etiko-moral të rinisë në luftë kundër shfaqjeve të huaja. 26 dhjetor 1974.	441
1975	
35. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi studimin e përballimit e nevojave të ekonomisë me energji elektrike. 24 janar 1975.	446
36. Protokoll i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi kursimin e fuqisë punëtore në miniera, në ndërmarrjet e shfrytëzimit të pyjeve dhe në ndërtim. 24 janar 1975.	447
37. Konkluzione të Sekretariatit të KQ të PPSH «Mbi masat për zbatimin e detyrave të Plenumit të 11-të të KQ të Partisë për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve». 3 mars 1975.	451
38. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi forcimin e mëtejshëm të punës ideopolitike të Partisë në ushtri. 6 mars 1975.	455
39. Orientime të Byrosë Politike të KQ të PPSH për punën politike e ideologjike të Partisë në ushtri. 6 mars 1975.	458
40. Protokoll i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi disa probleme të oborrit në kooperativat bujqësore. 24 prill 1975.	464
41. Plenumi i 7-të i Komitetit Qendror të PPSH, Tiranë, 26-29 maj 1975.	
— Komunikatë.	468
42. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi disa masa për luftën kundër burokratizmit, veçanërisht për thjeshtimin e organikave. 27 qershor 1975.	469
43. Protokoll i Sekretariatit të KQ të PPSH mbi ngritjen e mëtejshme të nivelit ideopolitik të gazetave lokale dhe drejtimin e tyre nga komitetet e Partisë të rretheve. 26 shtator 1975.	473

44. Plenumi i 8-të i Komitetit Qendror të PPSH, Tiranë, 10 tetor 1975.

- Komunikatë.
- Raport mbi Projektin e Kushtetutës së re. 10 tetor 1975.
- Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi hartimin e Kushtetutës së re». 10 tetor 1975.

45. Orientime të Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi organizimin e ndihmës me forca pune nga qyteti për kooperativat dhe për ndërmarrjet bujqësore». 22 tetor 1975.

46. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi uljen e pagave të larta dhe mbi disa masa për ngushtimin e mëtejshëm të dallimeve ndërmjet fshatit dhe qytetit. 26 dhjetor 1975.

Tirazhi 20.000 kopje

Format 60x92/16

Shtypur: Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «Mihal Duri» — Tiranë, 1978